

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHITJE TË SHQIPES STANDARDE
RRETH EMËRTIMIT TË NJERËZVE
SIPAS VEPRIMTARISË
(IV)**

Recensues

Prof. Dr. Abdullah Zymberi

Prof. Dr. Begzad Baliu

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES
STANDARDE RRETH
EMËRTIMIT TË NJERËZVE
SIPAS VEPRIMTARISË
(IV)**

Prishtinë, 2016

Lexues i nderuar,

Përshëndetje, ...Jemi në dijeni se jo fort moti, tetor 2015, me mbështetjen financiare të qeverisë zvicerane, Shqipëria, ka nënshkruar Marrëveshje me UNDP-në pikërisht për profesionet, kështu që në shqipe do të jetë e kompletuar **Lista kombëtare e profesioneve**, në harmoni me “*standardet europiane të punës*”, me përshkrimin e tyre specifik etj., por me sa dimë identifikimi i tyre bëhet me shifrim, siç ishte bërë edhe në Prishtinë më parë, ndërkaq teksti zyrtar i qëndrueshëm i emërtimeve në shqipe përsëri mbetet problem jo i vogël, prandaj dorëzimi ose mbulimi i problemeve nga institucionet e Kosovës, duke u dorëzuar kompetencat dhe përgjegjësitë institucioneve simotra të Shqipërisë, pa kurrfarë opionence, tregon dobësinë e tyre, ikje nga përgjegjësia që nuk i sjellë kurrfarë të mirë zhvillimit të shkencës e të kultures shqiptare edhe në këtë pikë...

Sidoqoftë, urojmë që kësaj here, vërtet, në kuadër të harmonizimit të krejt terminologjisë tekniko-shkencore në raportin Tiranë/Prishtinë e më gjerë, të kompletohet si duhet në shkallë kombëtare edhe **Lista e profesioneve me emërtime shqipe** dhe kjo të bëhet nga kuadro kompetentë të të gjitha fushave dhe me ekspertë gjuhësorë, ku ndër të tjera, ofrojmë për konsultim që të kihet parasysh edhe ndihmesa jonë modeste (kushtuar po kësaj teme) me këtë dhe me veprën tjetër: *Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktorate)*, Era, Prishtinë, 2015.

Tryeza e lëndës

Përshëndetje

Parathënie	9
1) RRETH EMËRTIMIT TË NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË LIDHUR ME NDËRKOMBËTARIZMAT ME -IK(ë) FUNDORË	13
S q a r i m:	13
Shkurtesat	13
Hyrje	14
I. Grupimi i emërtimeve në shqyrtim	15
Pasqyrëza krahasuese e numrit të emërtimeve	16
II) Konstatime të përgjithshme.....	18
Lista e variacioneve në përdorim:	22
III) Konstatime të veçanta	23
P ë r f u n d i m	36
Përmbyllje.....	Error! Bookmark not defined.
S h ë n i m e t :	39
2) ÇËSHTJE RRETH EMËRTIMIT TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT	41
TABELA E SHEMBUJVE	43
3. ÇËSHTJE RRETH EMËRTIMIT TË PROFESIONEVE NË SHKOLLAT TONA TË MESME	49
a) Vërejtje të përgjithshme	50
b) Vërejtje të veçanta.....	52
P ë r f u n d i m	59
4) MË DREJT KRYERËS I PUNËVE SESA EKZEKUTUES	61
5. RRETH PAQËNDRUESHMËRISË SË FORMANTIT -CIENT NË SHQIPE	65
6. RRETH TRAJTËS TEORICIEN SI RAST I VETMUAR	68
7. INSTALUES UJËSJELLËSI A HIDRAULIK	73
E JO UJËINSTALUES	73
8. RRETH PËRCAKTIMIT TË KUPTIMIT LEKSIKOR TË TERMIT AXHUSTATOR NDËR NE DHE PËRGJITHËSISHT	78

Pasqyra e barasvlerësve përkatës për profesionet adjuster, bravar dhe mashinbravar	80
9. RRETH TERMAVE DOKUMENTIST.....	89
E DOKUMENTARIST	89
10. ZDRUGUES APO RENDIST?	92
11. RRETH KRISTALIZIMIT TË TERMAVE TORNITOR DHE FREZATOR	94
Pasqyra e emërtimeve në shqyrtim:.....	96
12. RRETH PAPERSHTATSHMËRISË SË TERMIT PARAPUNËTOR	98
Pasqyra e barasvlerësve në disa gjuhë.....	102
13. LAJMËRUESE APO PARAQITËSE E PROGRAMIT	103
TË TV-SË?.....	103
14. RRETH PROFILIMIT TË EMËRTIMEVE GRIHËS DHE MPREHËS.....	106
1) Rreth fjalë-termit mprehës	106
2) Rreth fjalë-termit grihë grihës.....	110
15. RRETH FAVORIZIMIT TË TRAJTËS OFERTUES KUNDREJT OFRUES LIDHUR ME TERMIN OFERTË	113
Përmbyllje	119
16) INSTRUMENTIST, JO INSTRUMENTALIST.....	120
17. RRETH BARASVLERËSIT TERMINOLOGJIK PËR SHPREHJEN "NJERIU QË EDUKOHET"	123
Mendimin tonë po e shprehim më poshtë po në dy pika:.....	124
18. RRETH BARASVLERËSIT “MARINES” TË ANLISHTES NË SHQIPE.....	128
19. RRETH SPECIFIKIMIT TË PRAPASHTESAVE NË MËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT NË SHQIPE SIPAS TIPAVE KUPTIMORË.....	132
Pasqyra e numrit të emrave të njerëzve sipas profesionit	135
me prapashtesim sipas fjalorëve përkatës ²	135
Pasqyra krahasuese e shumësisë FGJSH 1954 – FSHSs 1984.....	136
Skema e vargut fjalëformues të shkallëzuar.....	138
pa e me profilim të ngushtë profesioni.....	138
P e r f u n d i m	140
20. EMËRTESAT E GUIDAVE TË SOTME ZYRTARE TË PROFESIONEVE ME SHQIPE TË PËRDËSHIRUAR.....	141
H y r j e.....	141

Konstatime paraprake.....	143
1) Versionet e formulmit të klasifikimit të profesioneve dhe kodimi i tyre	147
2) Numri i grup-profesioneve, sipas guidave në shqyrtim	149
3) Pasqyra e emërimit të grupeve të mëdha sipas burimeve në shqyrtim dhe nivelimi arsimor sipas ISCO-88	149
(1) KONSTATIME TË VEÇANTA RRETH GJUHËS SË TRI GUIDAVE TË SOTME TË PROFESIONEVE	152
1) Konstatime ose vërejtje të përgjithshme formale teknike e parimore.....	154
2. Konstatime dhe vërejtje konkrete gjuhësore	156
1. Disa konstatime dhe vërejtje për defekte	167
të përgjithshme formale (teknike)	167
2 Disa nga vërejtjet e veçanta gjuhësore	171
C. Nga Lista kombëtare e profesioneve	178
1) Konstatime dhe vërejtje të përgjithshme formale (teknike).....	179
2) Vërejtje të përgjithshme e të veçanta gjuhësore	181
Sipërfundim	190
(2) KONSTATIME RRETH EMËRTIMIT TË PROFESIONEVE NË FGJSH 2006 ME THEKS NË KONKURRENCËN EMËRFORMUESE TË PRAPASHTESAVE SPECIALE	191
1. Konstatime rreth lëshimeve formale teknike (si gabime shtypi).....	192
2. Konstatime rreth pranisë së emrave të vepruesit me cilësi profesioni dhe prirja e prapashtesave speciale në luftën e konkurrencës	193
1) Përparësitë e prejppjesorëve me prapashtesën –S ndaj	195
huazimeve me fundore a formante të huaja	195
2) Përparësitë e prapashtesës –TAR ndaj formanteve të tjera.....	198
3) Përparësi e formantit –AN ndaj formanteve të tjera mbi bazë.....	199
të ndërkombëtarizmës me –IK(ë) fundore	199
a) Zgjidhjet në shqipen e sotme pa prapashtesa–AN.....	200
b) Zgjidhjet në shqipen e sotme me prapashtesën –AN:	201
c) Sqarime rasti:	201
4) Formanti i huazuar –IST si fundore-prapashtesë	204
e favorizuar në shqipe	204
5) Bashkëjetesa e formanteve të specializuara –S dhe –TAR	206
mbi temë të njëjtë prodhuese.....	206
(3) KRITERE DHE KONSTATIME PËRMBYLLËSE RRETH EMËRTIMIT TË PROFESIONEVE NË GJUHËN SHQIPE	210

1. Disa kritere themelore rreth hartimit të listës	210
unike kombëtare të profesioneve.....	210
2) Konstatime përmbyllëse rreth plotësim-konsolidimit.....	213
të profesioneve në gjuhën shqipe	213
P ë r m b y l l j e.....	227
Të dhëna bio-bibliografike për autorin.....	230

P a r a t h ë n i e

Në këtë përmbledhje janë përfshirë 20 tituj (punime, kumtesa dhe artikuj) shumica të botuar në vitet '80 që kanë si objekt trajtimi emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë së tyre. E thamë 20 tituj, jo tema, ngase tema të prekura ose të trajtuara ka më shumë, ndërsa probleme të rrahura e të parrahura mirë ka edhe më shumë, madje janë me dhjetra e me qindra çështje të hapura e të diskutueshme. Me thënë të drejtën, pasi tema emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë së tyre (profesioneve) në gjuhën shqipe është temë aq e gjerë edhe si e tillë del jo mjaft e studiuar, andaj del se këtu është prekur vetëm një pjesë e çështjeve të hapura konkrete që lidhen me këtë fushë, madje nuk janë prekur tërësisht as ato me të cilat ishte, është dhe del e ballafaquar aktualisht, qoftë realiteti ynë shoqëror e gjuhësor kosovar në veçanti, qoftë vetë shoqëria shqiptare gjithandëj e gjithkund, përkatësisht gjuha shqipe në përgjithësi.

Gjithsesi njohja dhe zgjidhja e problemeve të tillë është me rëndësi jetike kulturore e mbarë bashkësinë sonë folëse si dhe për praktikën gjuhësore në shkollat dhe organizatat tona punonjëse në veçanti, madje në mënyrë të veçantë për administratën shtetërore e përgjithësisht në shkallë kombëtare.

Me një fjalë, çështja e emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë a sipas profesioneve që ushtrojnë në përgjithësi dhe në bazë të përmbajtjes nga këto punime në veçanti, në vija të trasha, është kundruar sadopak në këto tri dimensione:

1) Çështje nga realiteti ynë shoqëror-gjuhësor në raport terminologjik serbokroatisht – shqipja në Kosovë,

2) Raporti terminologjik aktual i emërtimeve në fjalë Shqipëri – Kosovë dhe

3) Raporti terminologjik aktual e në perspektive i emërtimeve të profesioneve në relacionin gjuhë zyrtare shqipe ndaj terminologjisë përkatëse bashkëkohore ndërkombëtare.

Nuk është vendi të përimitojmë këto fakte në këtë parathënie, porse, në të vërtetë, secili punim i përfshirë këtu paraqiste, siç paraqet edhe sot diçka të re, diçka të nevojshme, diçka të parratur, që vërtet zgjonte apo zgjon edhe sot interes.

Në pyetjen e shtruar: kush ma dha këtë detyrë dhe ku e mora atë vullnet me trajtue këtë temë? Sot nuk e shoh të nevojshme të përgjigjem. Por gjithsesi për t'u kuptuar thelbi dhe vlera e çështjeve të trajtuara të përfshira në këtë vepër duhet pasur parasysh kohëhapësirën përkatëse kur u shkruan që nuk ishte aq e shkurtër dhe pa komplikime, kur kihen parasysh puna jonë vullnetarishte me vetinisativë, si dhe tri dimensionet e sipërcekura. Është e vërtetë, që për ne nuk ka qenë lehtë, jo vetëm në të kuptuarit dhe në të paraqiturit e çështjeve me interes të përgjithshëm para opinionit, por edhe në zbardhjen, përkatësisht në ofrimin e propozimeve për zgjidhjet e ofruara në realitetin tone gjuhësor, jo vetëm te ne (Kosovë –ish Jugosllavi) në krahasim me serbishten, por edhe në raportin me shqipen, gjuhën teknike-terminologjike nga Qendra, me të cilën nuk kishim mundësi as konsultimi, por ndërkohë e me kohë u përpoqëm me e kuptue dhe dhe me zgjerue kërkesën tonë në të mirë të shqipes teknike nga Qendra, e cila duhej avancuar si e tillë në shkallë kombëtare të hapërojë ndërkombëtarisht në këtë pikë krahas gjuhëve të tjera, apo jo?!

Anda pa hyrë në hollësi, kemi bindjen se këto tema të trajtuara prej nesh në periudha të ndryshme e simos këto të fundit do të sfidojnë intelektualët e të gjitha shtresave e sidomos ata në institucione dhe në organizmat e pushtetit që këto dhe problemet si këto ose të ngjashme me to t'i marrin në dorë dhe t'u qasen dhe t'i zgjidhin me seriozitetin e duhur.

Gjithsesi kjo lëndë e paraqitur këtu për këtë pikë del si një material i domosdoshëm për konsultim e ritrajtim, në veçanti nga komisionet përkatëse jo vetëm në kuadër të Këshillit Ndërkademiç rreth qëndrueshmërisë së terminologjisë së shqipes standarde Tiranë-Prishtinë e më gjerë, por edhe për komisione të veçanta ndër-institucionale sipas fushave përkatëse; ndërmarrjeve të prodhimit, të institucioneve të kultures etj. Siç mund të shihet lënda e tillë del e domosdoshme të trajtohet, jo vetëm nga pikëpamja drejtshkrimo-fjalëformuese, por edhe nga ajo gramatiko-leksikore, e sidomos nga pikëpamja formëzuese logjiko-semantike e pragmatike, në mënyrë që asgjë nga problemet e prekura e të tjera nuk duhet lënë stihisë ose nuk duhet lejuar që të mbesin ose të dalin jashtë kontrollit përkatës profesional.

Madje edhe pasi të vihen në binarët e duhur për çështjet e tilla lypset një përkujdesje e vazhdueshme e organizuar në shkallë më të lartë, ngase një punë e tillë shkon në interes kombëtar e ndërkombëtar.

Sa për kërkësi do të rekomandonim që të lexohen me vëmendje të shtuar duke filluar nga punim i pare deri te ai i fundit, jo vetëm sa për të pare të vërtetën se ku ndodhej, por edhe ku ndodhet çastësisht shkenca jonë gjuhësore mbi këtë pikë. Sa është studiuar. Me këtë duam të themi se ne kemi bërë njëfarë trasimi, ndërsa rruga e tillë duhet të zgjerohet, të pasurohet me shtigje të reja, madje të shtrohet të modernizohet, jo do si do, por detyrimisht me shenjat e sigurisë, me punë ekspertësh, të mbikëqyret nga institucionet përkatëse bashkëshitetore, ngase siç u tha kjo është një obligim me interes shoqëror e shtetëror në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

Të vënë në rregull çështja në shqyrtim do t'i shtonte prestigjin shqipes jo vetëm në shkallë të trojeve shqipfolëse, por edhe faqe europiane e botës së qytetëruar.

Së këtejmi, po e shprehim edhe këtë, assesi nuk jemi kundër, përkundrazi e përshëndesim përzemërsisht si domosdoshmëri të vonuar, harmonizimin e krejt terminologjisë tekniko-shkencore në raportin Tiranë/Prishtinë e më gjerë, ashtu si edhe emërtimin e profesioneve, por dorëzimi ose mbulimi i problemeve nga institucionet e Kosovës, duke u dorëzuar kompetencat dhe përgjegjësitë institucioneve simotra të Shqipërisë, pa kurrfarë oponence, tregon dobësinë e tyre, ikje nga përgjegjësia që nuk i sjellë kurrfarë të mire zhvillimit të shkencës e të kultures shqiptare edhe në këtë pikë, ngase me sa kemi konstatuar edhe në Shqipëri lidhur me emërtimet e profesioneve ose të njerëzve sipas veprimtarisë kishte dhe kanë mbetur jo pak çështje të diskutueshme dhe që të dyja shtetet Shqipëria dhe Kosova ashtu si dhe shqiptarët në shtetet e tjera dhe organizmat ndërkombëtarë për këtë pikë (rreth emërtimit e shifrimit të profesioneve) ishin të ballafaquar më herët dhe sigurisht kishin dhe kanë shumë çështje të hapura e specifike të pazgjidhura, siç e pamë gjatë trajtimit të 2 guidave të Tiranës dhe 1 të Prishtinës, të botuara në këtë përmbledhje, ku veneruam me qindra e qindra lëshime.

Jemi në dijeni se jo fort moti, tetor 2015, me mbështetjen financiare të qeverisë zvicerane, Shqipëria, ka nënshkruar **Marrëveshje me UNDP-në** pikërisht **për profesionet**, kështu që në shqipe do të jetë e kompletuar në harmoni me “standartet europiane të punës”, **Lista kombëtare e profesioneve**, me përshkrimin e tyre specifik etj., por me sa dimë

identifikimi i tyre bëhet me shifrim, siç ishte bërë edhe në Prishtinë më parë, ndërkaq teksti zyrtar i qëndrueshëm i emërimit në shqipe përsëri mbetet problem jo i vogël, prandaj urojmë që kësaj here, vërtet, të kompletohet si duhet kjo listë me emërtime shqipe nga kuadro kompetentë të të gjitha fushave dhe me ekspertë gjuhësorë, ku ndër të tjera, ofrojmë që të kihet parasysh edhe ndihmesa jonë modeste (kushtuar po kësaj teme) me **këtë** dhe me veprën tjetër: *Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktorate)*, Era, Prishtinë, 2015.

(Prishtinë, nëntor 2016)

1) RRETH EMËRTIMIT TË NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË LIDHUR ME NDËRKOMBËTARIZMAT ME -IK(ë) FUNDORË

S q a r i m: *Ky punim, me ndonjë lëshim shtypi e stili, është botuar në revistën shkencore "Përparimi" nr. 3/85 (Prishtinë), me titull "Çështje rreth emërtimit të njerëzve sipas veprimtarisë në gjuhën shqipe lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore". Këtu jepet teksti i plotë me pak përmirësime dhe me përmbyllje të re. Dhe meqenëse kjo çështje e mprehtë e shqipes standarde e prekur dhe e definuar atëherë si çështje e hapur, ende ka mbetur e tillë, d.m.th. pa zgjidhje adekuate, mendoj se ribotimi i këtij punimi që po ofrohet si trajtesë e parë në këtë përmbledhje, do të jetë me interes për opinionin tonë të gjerë, si për lexuesit ashtu edhe për studiuesit dhe njëherësh do të shërbejë si cytje për sendërtimin e qëllimit për çka edhe ishte shkruar atëherë e po ribotohet tash.*

(Prishtinë, korrik 2016)

Shkurtesat kyesore:

FGJSH - Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë 1954.

FGJSSH - Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.

SKSH - Fjalor serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1974

FSSK - Fjalor shqip - serbokroatisht, Prishtinë 1981.

FTSSH - Fjalor terminologjik serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1961.

FLSH - Fjalor latinisht - shqip, Prishtinë 1980.

FFSH - Fjalor frëngjisht - shqip(M. Bejta), Prishtinë 1978.

FESHL - Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjëritimit, Prishtinë 1984.

FD - Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë 1976.

REP - Regjistrat e emërtimeve të profesioneve (disa doracakë të botuar te ne si nomenklatura të profesioneve).

Hyrje

Në kuadër të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a të veprimtarisë në gjuhën tonë vend të konsiderueshëm zënë edhe emërtimet që kanë të bëjnë me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore, me të cilat emërtohen zakonisht disiplina të ndryshme shkencore, ndonjë degë e veprimtarisë së njeriut, por në raste të caktuara edhe ndonjë gjendje a dukuri.

Shumica e ndërkombëtarizmave të tillë (ata që u konsultuan) janë të origjinës greke a latine e më pak të ndonjë gjuhe tjetër, por janë të përdorshëm për të gjitha gjuhët moderne. Edhe në gjuhën tonë letrare (standarde) numri i tyre vjen gjithnjë duke u rritur ashtu si edhe prania e tyre në fjalorët përkatës. Ndërsa në Fjalorin e K. Kristoforidhit nuk ishte i shënuar asnjë emërtim i tillë, në Fjalorin e "Bashkimit" ndeshim 4 sosh, në FGJSH (1954) numri i tyre arrin mbi 50, në FGJSSH (1980) kap shifrën 80, kurse në FSHSK (1981) kalon numrin 100.

Natyrisht mbi bazën e emërtimeve të tilla apo në lidhje me kuptimin e tyre janë krijuar edhe emërtimet e njerëzve që merren me veprimtarinë përkatëse. Ka raste që duket se veprimtaria e caktuar është krijuar mbi bazë të emërtimeve të njeriut sipas asaj veprimtarie.

Sidoqoftë emërtimet e tilla në raportin *ndërkombëtarizëm: veprimtari/emërtim profesioni*, kanë ndërvarje kuptimore reciproke.

Ç'është e vërteta, raporti i formimit të emërtimeve të tilla, sidomos i njerëzve sipas veprimtarisë, krahas ngjashmërive e ndikimeve të ndërsjella ka edhe ndonjë dallim në gjuhë të ndryshme, varësisht nga veçoritë përkatëse të strukturës fjalëformuese e formëzuese të gjuhëve të caktuara.

Në shqipen letrare emërtimet e tilla të njerëzve sipas veprimtarisë, sa i përket aspektit të fjalëformimit, dalin mjaft të ndërlikuara, pa model të qartë të kristalizuar, madje edhe me çështje të hapura që kërkojnë zgjidhje. Një problem i tillë, me sa di unë, ende nuk është trajtuar veçanë në gjuhën tonë. Kjo përpjekje le të mbetet, së paku, si nismë apo shtytës i parë për studimin e zgjidhjen e çështjeve që dalin në këtë plan. Ne lëndën e kemi trajtuar në

tre nënkrerë a) Grupimi i emërtimeve në shqyrtim, b) Konstatime të përgjithshme dhe c) Konstatime të veçanta.

I. GRUPIMI I EMËRTIMEVE NË SHQYRTIM

Në FGJSSH ndeshëm të shënuar emërtimet në shqyrtim vetëm pranë 45 ndërkombëtarizmave të tillë, me -IK(Ë) fundore (sepse numri i tyre i ndërkombëtarizmave është përgjysmë më i madh). Emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë përkatëse, pikërisht në saje të karakteristikës së mënyrës së fjalëformimit (temës prodhuese) i renditëm në këto shtatë grupe:

1) Emërtime që u vjen pas fundorja -IKË e ndërkombëtarizmës:

aeronaut (aeronautikë), arkitekt (arkitekturë - arkitektonikë), astronaut (astronautikë), atlet (atletikë), estet (estetikë), gjimnast (gjimnastikë) dhe poet (poetikë). – gjithsej 7 shembuj.

2) Emërtime me prapashtesën -IST, të cilës i ngjitet fundorja -IK(Ë) e fjalës ndërkombëtare:

folklorist (folkloristikë), helenist (helenistikë), kriminalist (kriminalistikë), okulist (okulistikë), publicist (publicistikë), stilist (stilistikë) dhe urbanist (urbanistikë) – gjithsej 7 shembuj.

3) Emërtime me prapashtesën -IST, e cila i vihet temës së përbashkët, ashtu si edhe formanti -IK(Ë) i ndërkombëtarizmës:

botanist (botanikë), digmatist (dogmatikë), harmonist (harmonikë), metodist (metodikë) kronist (kronikë) dhe simbolist (simbolikë) – gjithsej 6 shembuj.

4) Emërtime me prapashtesën -AN, e cila i shtohet tërë fjalës temëprodhuese me -IK(Ë) fundore:

fizikan (fizikë), fonetikan (fonetikë), politikan (politikë), gramatikan (gramatikë), metamatikan (matematikë), republikan (republikë) – gjithsej 6 shembuj.

5) Emërtime me prapashtesën -ANT, e cila i shtohet fjalës temë prodhuese me -IK(Ë) fundore:

fabrikant (fabrikë) muzikant (muzikë) dhe praktikant (praktikë) - gjithsej 3 shembuj.

6) Emërtime, fjalë të prejardhura pa ndajshesë a me konversion:

dogmatik (dogmatikë), hidraulik (hidraulikë), teknik (teknikë), hidroteknik (hidroteknikë), zooteknik (zooteknikë), kritik (kritikë),

lirik (lirikë), mekanik (mekanikë), romantik (romantikë) dhe skolastik (skolastikë) – gjithsej 10 shembuj.

7) Emërtime me prapashtesa të tjera:

a) me prapashtesën -C/IST: *elektracist (elektrikë, elektrik) dhe fizarmonikist (fizarmonikë) – 2 shembuj;*

b) me prapashtesën -(Ë)S: *automatikës (automatikë, automatik) – 1 shembull;*

c) me prapashtesën -UE/S: *kritikues (kritikë - kritikoj), polemizues (polemikë - polemizoj) – 2 shembuj;*

ç) me prapashtesën -TAR: *muziktar (muzikë) – 1 shembull.*

Gjithsej me prapashtesa të tjera, 6 shembuj.

Tabela krahasuese e numrit të emërtimeve FGJSH / FGJSSH

Tabela e numrit të emërtimeve sipas grupeve të regjistruara në FGJSH dhe FGJSSH duket kështu:

Grupi:	B u r i m i	Ndryshimi
FGJSH	FGJSSH	
1)	3	7
2)	5	3
3)	3	6
4)	3 (+1)	6
5)	3	3
6)	6	10
7)	(2)	(6)
a)	1	2
b)	-	1
c)	-	2
ç)	1	1
Gjithsej:	26	45
		19

Në grupin 4) është karakteristike se në FGJSH ndeshet emërtimi *kritikan*, i cili në FGJSSH nuk është regjistruar, por për kuptimin e tillë ndeshet trajta *kritizer*. Në të gjitha grupet shihet njëfarë shumimi simbolik i

numrit, pos në grupin 5) dhe 7)-ç. Rastet në 7-b dhe 7)-c paraqesin mënyrë të re fjalëformimi për këtë nëntip emrash dhe kanë lidhje të tërthortë kuptimore me ndërkombëtarizmën.

Ta mbajmë të gjallë kureshtjen edhe për disa çaste sa të shohim sipas grupeve të mësipërme, sesi janë përfutur disa nga emërtimet në fjalë në disa gjuhë të ndryshme. Këtë e bëj me qëllim që të kundrohet dhe të krahasohet mënyra e reflektimit të formanteve përkatëse si në gjuhë të huaja, ashtu edhe në gjuhën tonë:

- 1) a) *shq. arkitekt, gjerm. Architekt, angl. architect, fr. architecte, gr. arhitektonos, it. architetto, rus. arhitektor, skr. arhitekt(a);*
b) *shq. atlet, gjerm. Athlet, angl. athlete, fr. athlete, it. atleta, skr. atlet(a), gr. athlletos.*
- 2) *shq. publicist, gjerm. Publizist, angl. publicist, fr. publiciste, it publicista, rus. publicist, skr publicist(a).*
- 3) *shq. botanist, gjerm. Botaniker, angl. botanist, fr. botaniste, it. botanico, gr. botanikos (botanollogos), rus. botanik, skr. botaničar.*
- 4) a) *shq. fizikan, gjerm. Physiker, lat. physikus, angl. physicist (physician), fr. physicien, gr. fysikos, it. fisico, skr. fizičar; rus. fizik*
b) *shq. matematikan, lat. mathematicus, gjerm. Mathematiker, angl. mathematician, fr. mathematicallyen, it. matematico, rus. matematik, kr. matematičar, gr. methematikos;*
- c) *shq. politikan, lat. politicus, gjerm. Politiker, angl. politician, fr. politicien politique, politiquer), it. politikante (politico), gr. politikos, rus. politik, skr. političar, (politikant).*
- 5) a) *shq. muzikant (muziktar), gjerm. Musiker (Musikant), lat. musicus, angl. musician, fr. musicien, it. musikante (musicista, musico), gr. musikantos (musikos), rus. muzikant, skr. muzikant (muzičar);*
b) *shq. fabrikant, gjerm. Fabrikant, angl. manufacturer. fr. fabricant (usinier, manufacturier it. fabricante (manifatturiere), rus. fabrikant, skr. fabrikant (tvorničar).*
- 6) a) *shq. mekanik, gjerm. mechaniker, angl. mechanician, fr. mecanicien, it. mecanico, gr. mehanikos, rus. mahanik, skr. mehaničar;*
b) *shq. teknik, gjerm. Techniker, angl. Technician (technist), fr. technicien, it. tecnico, gr. tehnikos, rus. tehnik, skr. tehničar.*
- 7) a) *shq. elektricist, gjerm. Elektriiker, angl. electrician, fr. electricien, it. elettricista, rus. elektrotehnik, gr. elektrollogos (elektrotehnikos), skr. električar;*

b) *shq. fizarmonicist (harmonicist), gjerm. Harnospieler, angl. accordionist, fr. accordeoniste, rus. garmonist, skr. harmonikaš, it. fizarmonicista (fisarmonista) etj.*

Lidhur me lëndën e sipërshtuar para se të jap disa konstatime të veçanta, nga të cilat do të rezultonte qëllimi i këtij punimi, ma merr mendja se është me interes të cekën gjëra të përgjithshme që kanë të bëjnë me grupet përkatëse si më sipër.

II. KONSTATIME TË PËRGJITHSHME

a. Si në grupin I kanë gjetur zgjidhje a përdorim edhe disa ndërkombëtarizma të tjerë, që nuk janë përfshirë në FGJSSH, si p.sh. akrobat (akrobatikë), enigmat (enigmatikë), kozmonaut (kozmonautikë) etj. dhe për "shtetësinë" e tyre në gjuhën tonë nuk duhet shprehur rezervë. Gjithsesi emërtimet e tilla mund të konsiderohen si ndërkombëtarizma të mirëfilltë.

b. Ashtu si në grupin 2) kanë gjetur përdorim edhe një sërë emërtimesh si: arkivist (arkivistikë), albanist (albanistikë), ballkanist (ballkanistikë), filigranist (filigranistikë) etj. Edhe për këtë nëntip emërtimesh vlen konstatimi si në pikën e mësipërme, mirëpo këtu lypset theksuar fakti se edhe pse për emërtimet me -IST ekzistojnë tema të qarta motivuese fjalëformuese, të cilave u është shtuar prapashitesa -IST si p.sh: alban + ist albanist, helen + ist helenist etj. kuptimi i emërtimeve të tilla më fort lidhet me degën e caktuar të veprimtarisë: albanistikë, helenistikë sesa me emrin temë prodhues alban ose helen.

c. Si karakteristikë e emërtimeve të grupi 3) mund të veçohet fakti se sikurse emërtimet e veprimtarisë, ashtu edhe emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë kanë si bazë mbështetjeje temë të njëjtë prodhuese, e cila mund të jetë edhe emër a fjalë me kuptim të qartë si simbol/ist e metod/ist, por edhe me temë prodhuese semantikisht jo të qartë për gjuhën shqipe, siç janë shembujt e tjerë. Vlen të theksohet fakti se edhe në rastet kur tema prodhuese është e qartë semantikisht, si në rastin metod(ë) + ist metodist, përkatësisht metodë) + ikë metodikë, atëherë lidhja kuptimore e të dyja emërtimeve të prejardhura është më e fortë sesa kuptimi që i lidh ato me fjalën temëprodhuese të përbashkët. Kjo mënyrë fjalëformimi nuk respektohet njësoj në gjuhë të ndryshme. Shumica e tyre e ruajnë elementin

-IK(Ë) të ndërkombëtarizmit brenda temës prodhuese, siç do të theksohet edhe më poshtë te konstatimet e veçanta.

ç. Emërtimet e grupeve 4), 5) dhe 7)-a me prapashtesat e qarta: -AN, -ANT, përkatësisht -C/IST në krahasim me gjuhët e tjera, në shqipe paraqiten mjaft të komplikuar dhe në këtë kontekst kërkojnë sqarimin e caktuar, siç do të përpigemi ta bëjmë në analizën përkatëse.

d. Edhe grupi 6) i emërtimeve zgjon interes të veçantë, ngase është mënyrë tjetër fjalëformimi kundrejt grupeve të tjera të sipërcekura. Këtu kemi të bëjmë me dukurinë e krijimeve (të prejardhjes) pa ndajshtesë, përkatësisht të përfutimit me konversion a me emërzimin e mbiemrave apo me një proces të ndërsjellë. Edhe kjo çështje do të trajtohet më në hollësi më poshtë. Këtu është me rëndësi të ceket fakti se një dukuri e tillë është e pranishme edhe në gjuhë të tjera, prandaj kjo mund të cilësohet si një dukuri e përbashkët universale e disa gjuhëve.

Këto ishin disa nga karakteristikat që i quajta të përgjithshme dhe që kishin të bënin lidhur me grupet e veçanta të emërtimeve në shqyrtim. Për të gjitha këto grupe mund të thuhet edhe një karakteristikë tjetër e përgjithshme. Të gjitha këto (pos rasteve të grupit: 7)-b, 7)-c dhe 7)-ç) në gjuhën tonë janë reflektuar në ndikimin e gjuhëve të huaja dhe pothuajse të gjitha këto mund të cilësohen si huazime transfer.

Siç e pamë nga shembujt më sipër në gjuhë të ndryshme, veç ndonjë veçorie dalluese të formanteve fjalëformuese, kishte edhe veçori të përbashkëta. Lidhur me trajtat në gjuhën shqipe, pa marrë parasysh ndonjë vërejtje parimore që mund të jepet në vazhdim të këtij punimi gjatë analizës në përpjekje për ravigëzimin e modelit përkatës, duhet pasur kujdes që trajtat drejtshkrimore, ashtu siç janë të shënuara në FGJSSH ashtu edhe duhet të respektohen si në të shkruar ashtu edhe në të folur. Tërheqja e vëmendjes lidhur me këtë del e nevojshme të bëhet pasi që në realitetin tonë ndeshim mjaft trajta që nuk përdoren në përputhje me normën drejtshkrimore. Sigurisht lajthitjet e tilla ndodhin edhe për shkak a në ndikimin e fjalorëve të ndryshëm si dhe të burimeve të tjera përkatëse që s'kanë mundur të konsolidohen. Këtu po i shënoj vetëm disa nga format lajthitëse që i ndeshim në burime të caktuara, të cilat nuk janë përdorur në përputhje me normën e sotme letrare. P.sh:

*kronikist, kronik, polemist, fizikant, fonetist, gramatikan,
matematikant, electrocist, elektrikan, muzikan, praktikan,*

matematicient, fizicient, muzicient, foneticien, polemist, hidraulikist, hidraulist etj. etj.

Gjithashtu duhet pasur kujdes edhe sa i përket shumësit të emrit politikan, të përdoret politikanë/t e jo politikajt, siç po ngjan jo rrallë të dëgjojmë a të lexojmë, qoftë në emisionet e RTP, qoftë në mjetet tona të tjera të informacionit.

Nuk është pa rëndësi dhe pa interes të ritheksojmë vërejtjen që e dhamë më sipër, sidomos kërkesa që ka të bëjë me respektimin e drejtshkrimit të emërtimeve në fjalë, ashtu siç është rekomanduar nga burimet e caktuara, përkatësisht si i ndeshim në FGJSSH, në mënyrë që të mos bëhen lajthitje, mirëpo çështja nuk qëndron vetëm me kaq. Ç'është e vërteta, para nesh shtrohet edhe një problem tjetër edhe më i madh dhe më i ndërlikuar. Është fjala për faktin sesi duhet shkruar apo si duhen përdorur ato emërtime të këtij lloji, të cilat nuk janë përfshirë në Fjalorin në fjalë dhe që imponohen të përdoren domosdo në jetën tonë të përditshme? Siç dihet numri i fjalëve të tilla nuk është i vogël, madje është në rritje e sipër. Rritja e numrit të emërtimeve të tilla vjen si rezultat i nevojës që shtron jeta për të shprehur koncepte të reja nga fusha të ndryshme të veprimtarisë së njeriut si rrjedhojë e zhvillimit të kulturës, teknikës, shkencës dhe të bazës materiale që është karakteristikë e botës bashkëkohore sot. Vetëm në Fjalorin e ndërkombëtarizmave të Aleksiqit i ndeshëm mbi 20 shembuj, përkthimi i të cilëve në gjuhën tonë paraqitet problemor. Në të vërtetë numri i tyre në jetën tonë të përditshme është shumë më i madh. Më poshtë po i shënoj disa emërtime të tilla në gjuhën serbokroate, pasi që në atë gjuhë si në disa gjuhë të tjera trajtat dalin të konsoliduara. Kështu që lidhur me këtë shtrohet detyrë konkrete se si duhet shënuar barasvlerësit përkatës më të parapëlqyeshëm në gjuhën tonë, siç janë shembujt:

analitičar, elektroničar, energetičar, etičar, eugeničar, epileptičar, erotičar, dijagnostičar, dijalektičar, grafičar, idiličar, kibernetičar, klasičar, keramičar, komičar, kozmetičar, logičar, metričar, mističar, sinoptičar sintetičar, sistemičar, termičar, tragičar, taktičar etj.

Sigurisht e kemi të qartë funksionin e ndërkombëtarizmës në veprimtarinë përkatëse për secilin emërtim të mësipër, si p.sh. *analitikë analitika, qeramikë qeramika* etj. dhe menjëherë mund të nënkuptohet se këto emërtime nuk kanë të bëjnë me grupet I dhe II, por me grupet e tjera të

sipërcekura, nga të cilat emërtimet e njëjërzve sipas veprimtarisë dalin të formuara zakonisht me prejardhje prapashtesore.

Në jetën tonë të përditshme, sipas rastit edhe jemi duke i përdorur edhe emërtimet e sipërcekura, qoftë sipas rastit qoftë edhe për arsye të përditshmërisë, sepse nuk janë të rralla te ne edhe institucionet a organizatat punonjëse që kanë të bëjnë me veprimtari të caktuara siç janë b. f.:

dijagnostika, kozmetika, grafika, plastika, qeramika, kibernetika, statistika etj.

Ja si dalin “*të zgjidhura*” në dukumente a burime të caktuara emërtimet e imponuara të këtij tipi, si më poshtë:

- *logjist, retorist, semantist, semiotist, elektronist, grafist, kozmetist, termist, plastist, qeramist, sintetist, dialektist;*

- *logjicist, takticist, plasticist, qeramicist;*

- *metodikan, taktikan, statistikan;*

- *statisticien, plasticien, takticien, tematicien;*

- *qeramiqist;*

- *statistikant, grafikant, analitikant;*

- *analitik, grafik, statistik, qeramik...*

etj.

Mirëpo, si zgjidhje të rastësishme, përveç këtyre shtatë mënyrave që i identifikua ndeshim edhe trajta të tjera, çka dëshmon se drejt-fjalëformimi a formëzimi i tyre i grupve etë këtij tipi emërtuimesh nuk është i kristalizuar aspak në gjuhën tonë, madje ndodh që i njëjti person të përdorë herë një trajtë e herë një tjetër.

Para se të jap listën e trajtave të variacioneve të mundshme, të cilat edhe i ndeshim në jetën tonë të përditshme, e shoh të arsyeshme të nxjerrë dy shembuj nga grupi e emërtimeve të papërfshira në FGJSSH dhe t'i shënojmë ashtu si kanë gjetur *zgjidhje* emërtimet e tilla në disa gjuhë të huaja. E kam fjalën për dy ndërkombëtarizmat: **statistikë** dhe **analitikë**:

a) *skr. statističar, gjerm. Statistiker, angl. statistician, fr. statisticien, it. studioso di statistica, rus. statistik;*

b) *skr. analitičar analizator, gjerm. Analytiker, angl. analyst (analyzer), fr. analyste, it. analista, rus. analitik.*

Të vihen re karakteristikat e veçanta fjalëformuese në secilën gjuhë.

Në shqipe shembujt e tillë mund të dalin në afro 20 e më tepër trajta, siç do të ilustruhet në listën e mëposhtme.

Lista e variacioneve në përdorim:

- 1) *punëtor (inxhinier, ekonomist, piktor, mësues, studiues ...) i statistikës, analitikës, plastikës etj.;*
- 2) *punëtor (...) statistike (analitike, plastike etj);*
- 3) *punëtor -statistik, punëtor - analitik, punëtor – plastik(?);*
- 4) *statistik, analitik, plastik (si teknik, mekanik);*
- 5) *statistikës, analitikës, plastikës (si automatikës, pikës);*
- 6) *statistikues, analitikues, plastikues (sikurse kritikues, fabrikues);*
- 7) *statistizues, plastizues, analizues (si polemizues);*
- 8) *statistiktar, analiktar, plastiktar (sikurse muziktar);*
- 9) *statistikan, plastikan, analitikan (si fizikan, matematikan);*
- 10) *statistikant, analitikant, plastikant (sikurse fabrikant, muzikant);*
- 11) *statist (statistist), analist, grafist (sikurse botanist, kronist);*
- 12) *staticist (statisticist), analicist (analyticist), plasticist (si electricist);*
- 13) *statistiqist, analitiqist, platiqist (sikurse qeramiqist) (!);*
- 14) *statistikist, analitikist, plastikist (si qeramikist);*
- 15) *statisticien, plasticien (si teoricien) (!);*
- 16) *statisticient, analiticiënt, plasticient (si muziciënt!);*
- 17) *statistiqar, analitiqar, platiqar (sikurse hyzmeqar);*
- 18) *statistician, analitician, plastician (sikurse logjician) (!);*
- 19) *statistiker, analitiker, plastiker (si kombanjer) (!).*

Mund të ndeshet edhe ndonjë "zgjidhje" tjetër si me -UER (-OR) apo -TUER (A/TOR) si muzikuer (muzikor), analizator, kritizer etj., por mjaftojnë e nuk teprojnë këto që u paraqiten këtu, sa për të alarmuar te standardologët tanë që të përpiqen për zgjidhjen sa më parë të çështjes në shqyrtim.

Gjithsesi, kjo shumësi formash nga aspekti terminologjik nuk mund të cilësohet si një begati e mirëpritur për shqipen, kur dihet fakti se për kuptimin bazë të një termi do të mjaftonte vetëm një formë. Patjetër lypset thjeshtësuar trajtat e tilla dhe për këtë çështje duhet të angazhohet shkenca jonë e standardëzuar mbi gjuhën për ta gjetur trajtën, më të natyrshme, më të pranueshme dhe më të drejtë, e cila do të plotësonte si anën semantike, ashtu edhe anën formale gjuhësore d m.th. duhet të jetë në përputhje me rregullat e fjalëformimit dhe të formëzimit të gjuhës sonë. Me një fjalë, edhe pse kjo çështje del mjaft e ndërlikuar, ajo nuk duhet të jetë e pazgjidhshme a

e paarritshme, madje po të shikohet nga pikëpamja praktike zgjidhja mund të jetë e thjeshtë fare. Këtë e synojmë ne. Atëherë me të drejtë shtrohet pyetja: cila mënyrë fjalëformuese a formëzuese duhet të parapëlqehet?

Natyrisht kjo çështje nuk duhet lënë stihisë a spontanitetit. Nuk do të gabohej nëse për këtë çështje do të konsultohesh ndonjë gjuhë e huaj e zhvilluar, por kjo nuk do të thotë se duhet të "kopjohet" zgjidhjet nga ajo gjuhë.

Gjuha jonë letrare sot nuk është në ditë si dikur, kur i mungonin kuadrot dhe përgjithësisht nuk kishte mundësi të zhvillimit normal, kur detyrohej vetëm të marrë gjithçka pa kriter nga gjuhët e huaja. Me fjalë të tjera stihia kurr nuk i zgjidh çështjet si duhet e drejt, ndërsa gjuhët e huaja mund të konsultohen, por ndikimi i tyre nuk duhet të jetë parësor dhe i plotëfuqishëm.

Gjuha shqipe ka karakteristikat e veta të cilat duhen respektuar, respekt ky që vlen edhe për këtë pikë të hapur. Për të zgjidhur sa më drejt këtë çështje mendoj se duhen pasur parasysh edhe disa karakteristika të veçanta që mund të jenë të dallueshme lidhur me grupet e sipërpërmendura, të cilat do të ndihmonin zgjidhjen e problemit në shqyrtim, pothuaj në mënyrë normale.

III. KONSTATIME TË VEÇANTA

1. Lidhur me tri pikat e para, 1), 2) dhe 3), që dalin si variacione të mundshme të zgjidhjes duhet konstatuar se ato janë togfjalësha a forma perifrastike dhe se nga kjo mënyrë shkallë-shkallë kalohet në termin përkatës njëfjalësh a njëgjymtyrësh. Pra, kur kemi të bëjmë me paraqitjen e nocionit fillestar përkatës të emërtimit të caktuar që të tria format në fjalë janë të lejueshme, por është karakteristikë e terminologjisë që kërkon që termi përgjithësues të jetë njëfjalësh (njëgjymtyrësh si fjalë e përbërë ose si kompozitë)), ndërsa emërtimet e profileve të profesioneve apo profesionet e profiluara mund të jenë perifrastike për nevojë të përcaktimit sa më të qartë të profesionit të ngushtë. Është interesant të ceket fakti se për nëntipin e emërtimeve që e kemi në shqyrtim nuk ndeshëm asnjë rast që emërtimi të kishte kaluar në emër të përbërë (kompozitë) të tipit si p.sh. statistikënxjerrës, plastikëpunues, analitikëhartues etj., edhe pse një mënyrë e tillë e zgjidhjes paraqet model të favorizuar aktualisht dhe s'ka kurrfarë

arsyeje që kjo mënyrë mos të favorizohet në shqipen e sotme letrare, mirëpo dihet fakti që pas emërimit bazë për nevoja profilimi mund të vijë fjalë plotësuese përkatëse si p.sh. grafik a grafikan - punëtor i kualifikuar për (...), grafikan - piktor, grafikan - inxhinier i (...) etj.

Të dihet gjithashtu fakti që b.f. nga trajtat e emërtimeve nëntipeve: punëtor i analitikës, punëtor analitike a punëtor-analitik nuk duhet kërkuar që patjetër të zhvillohen a të kalojnë në emërtime njëfjalëshe (njëgjymtyrëshe), mirëpo gjithashtu dihet se emërtimet njëgjymtyrëshe mund të dalin edhe pa kaluar nëpër shkallët a fazat e cekura p.sh. termi **teknik**, mund të jetë përfutur drejtpërdrejt në trajtë njëfjalëshe (njëgjymtyrëshe), qoftë nën ndikimin e gjuhëve të huaja, qoftë edhe nga vetë konteksti i caktuar, dukuri kjo që do të preket kalimthi në vazhdim të këtij punimi.

2. Konversioni, përkatësisht emërimi i mbiemrave a formimi pa ndajshesë është dukuri universale e disa gjuhëve, ashtu edhe e gjuhës sonë. Në rastet që po trajtohen këtu kemi të bëjmë edhe me krijimin e fjalës me prejardhje si ta quaj, **paravajtëse**, pasi që duke i hequr fjalës Ë-në fundore krijojmë emrin e veprimtarit si nga *teknikë teknik*, *mekanikë mekanik*, e kështu me radhë. Këtu nuk preket çështja se cila mënyrë mund a duhet të jetë parësore a mbizotëruese, prejardhja prapavajtëse me rënien e Ë-së apo fonomeni i konversionit d.m.th. i emërimit të mbiemrit si p.sh. *punëtor teknik* - **teknik tekniku** etj.

Pavarësisht nga konstatimet e mësipërme mendoj se të gjitha rastet e papërfshira në FGJSSH kanë mundësi të gjejnë zgjidhje në këtë mënyrë dhe se teorikisht një mundësi e tillë mund të jetë e parapëlqyeshme, por lidhur me këtë ndoshta duhet të ketë nevojë për një propagandim më të organizuar e bindës. Si pengesë kryesore lidhur me aplikimin e një mënyre të tillë mund të dalë dukuria e homonimisë me mbiemrin përkatës. Megjithatë, siç e pamë nga pasqyra e numrit të emërtimeve të tilla sipas grupeve, kjo mënyrë fjalëformimi prin sa i përket shumimit në krahasim me mënyrat e tjera, gjithsej janë 10 sosh që do të thotë se për 4 shembuj prin kjo mënyrë kundrejt grupit 3) dhe 4). Pra edhe pse është një rritje simbolike e kësaj mënyre, prapëprap në krahasim me mënyrat e tjera, kjo mund të tregojë vetëm njëfarë shenjëzimi të prirjes që mund të përthithë edhe emërtime të tjera të pa përfshira në FGJSSH, siç janë edhe trajtat: *statistik*, *analitik*, *grafik*, *lirik*, *poetik*, *romantik* etj., trajta këto që ndeshen mjaft shpesh në realitetin tonë gjuhësor. Kjo mënyrë fjalëformimi do të shërbente gjithsesi

vetëm si një mundësi e parë e pëlqyeshme, mirëpo, siç u cek, pasi homonimisht përkon me konceptin e mbiemrit, atëherë paraqet vështirësi. Përimtimi i mëtejshëm në këtë çështje do të sillte gjithsesi rezultate konkrete më të qarta. Madje pos homonimisë me mbiemrin përkatës homoform që del në raport konversional ka raste të paraqitet edhe një homonimi tjetër brenda vetë kategorisë emërore. Është fjala për përfitimn e disa emrave të sendeve konkrete që s' kanë të bëjnë me emrin e njeriut (të frymorit), por që shprehin një mjet, një substancë a gjësend konkret përgjithësisht. Si p.sh: automatik (mjet), elektrik (mjet), grafik (mjet - vizatim), kozmetik (substancë), narkotik (mjet, substancë) etj. Prandaj vetvetiu s' ka si mos të shfaqet njëfarë paqartësie a njëfarë rëndimi semantik në raportin e temave homoforme në nënfusha të ndryshme semantike. Ndoshta pikërisht një dukuri e tillë ka ndikuar që të kërkohen rrugë të tjera të zgjidhjes jashtë dukurisë homonimike, si p.sh: *automatikës, elektrikist, grafikist a grafikan, kozmetist a kozmetikan, narkotikan a narkoman* etj.

Është interesant se në 5 rastet e sipërcekura (hiq prapashtesën -AN), asnjëri formant nuk ngjan me tjetrin, dëshmi kjo që tregon se ende nuk kemi zgjidhje sistimore në gjuhën tonë për këtë çështje. Mbase duke e parë në gjerësinë e merituar të kësaj mënyrë të fjalëformimit në gramatikën tonë normative theksohet: *"prejardhja pa ndajshitesë nuk është mënyrë prodhimore në sistemin e sotëm të fjalëformimit të shqipes"*.

3. Lidhur me zgjidhjen e çështjes sipas modelit të shembullit **automatikës**, d.m.th. me prapashtesën -S mbi bazë të temës prodhuese (trajtës së ndërkombëtarizmes me -IK(Ë) fundore) dalin mjaft çështje të diskutueshme. Është e vërtetë, se deri më tash asnjë shembull tjetër nuk del i zgjidhur në këtë mënyrë, veç atij *automatikës*, por edhe ky ka për bazë një send konkret automatikun e jo automatikën si degë të veprimtarisë, mirëpo është e vërtetë se formanti -S në gjuhën shqipe paraqitet si një formant special për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit, sidomos mbi temë foljore, por edhe mbi temë emërore. Studuesit tanë Xhuvani - Çabej theksojnë se me prapashtesën -(Ë)S *"formohen emra prej emrash e foljesh"* dhe se *"një nëndarje e kësaj kategorie janë disa emra prej emrash që tregojnë ushtruesin e një mjeshtërie"* dhe për ilustrim shënojnë shembujt: *"derës, gjykatës, fikës, pikës"* etj. Prandaj edhe kjo mënyrë fjalëformimi me mjete të shqipes është e mundshme të zbatohet, prandaj nuk është keq që të kihet në konsideratë. Po të parapëlqehet një mënyrë e tillë, atëherë emërtimi i njeriut sipas veprimtarisë do të dilte mbi bazë të temës së qartë motivuese

fjalëformuese, kështu do të dilnin zgjidhjet: elektrikës, grafikës, kozmetikës, narkotikës, d. m. th. me prapashtesën -Ë/S, ose do të përligjej edhe si rregull edhe emërtimi i ndërkombëtarizmes me -IK(Ë) fundore që do të thotë se do të përdoret prapashtesa -S si p. sh. kozmetikë + S kozmetikës etj. Nëse do të parapëlqehet a favorizohet një mënyrë e tillë. Po përsëris, atëherë do t'i ikej çfarëdo homonimie dhe se në gjuhën tonë do të ofrohet një zgjidhje jashtëzakonisht e lehtë. Në të vërtetë, emërtimet me prapashtesën -(Ë)S në kohën tonë kanë pasur rritje të konsiderueshme, p.sh. në krahasim me FGJSH 1954 në FGJSSH 1980 numri i emërtimeve të tilla është 5 fishuar, kurse varianti me -UE/S është 10 fishuar. Në një farë mënyre mund të themi se një zgjidhje e tillë ka ekzistuar edhe më përpara, këtë e dëshmojnë shembujt e shënuar në burime të caktuara, siç janë shembujt lirikës, botanikës që i ndeshim në Fjalorin e Bariqit edhe në ndonjë burim tjetër. Lidhur me këtë lypset gjurmuar pse kjo mënyrë nuk del gjalluese në praktikë, Sidoqoftë, lypset gjurmuar, mos del ndonjë model tjetër më përthithës se ky, apo jo?! Po vijojmë analizën më tej dhe të shohim se çfarë zgjidhje të tjera na oftohen.

4. Për mënyrën e formimit të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë me prapashtesën -UE/S vlen të konstatohet se kjo mënyrë aspak nuk kontestohet. Forma e tillë, në të vërtetë, del si emër prejpjesor d.m.th. del nga folja dhe natyrisht së pari i referohet kuptimit foljor e pastaj në mënyrë të tërthortë mund të lidhet edhe me emërtimin e veprimtarisë së caktuar. Në rastet që po shqyrtohen këtu kjo mënyrë fjalëformimi doli dytrajtësore d.m.th. edhe në mbështetje të foljes më -O/j si dhe në mbështetje të foljes më --I/ZO/j, gjithnjë e kemi fjalën pra për emërtimet lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore. Edhe pse nuk ka dallime të mëdha në procesin e përfutimit më poshtë do të japin ndonjë konstatim për të dyja nëngrupet e sapocekura.

a) Nga foljet e caktuara si *kritikoj, fabrikoj, muzikoj* (krahaso ndërkombëtarizmat përkatëse: kritikë, fabrikë, muzikë) mund të dalin normalisht emrat prejfoljorë me prapashtesën -UE/S: kritikues, fabrikues, muzikues. Këto trajta në të vërtetë nuk e rrezikojnë përdorimin e emërtimeve që lidheshin drejtpërdrejt me ndërkombëtarizmen përkatëse si p.sh. *kritikan a kritizer, fabrikant a fabrikan, muzikant a muzikan*, sepse kanë kuptim të diferencuar apo të nuancuar, mirëpo për koncepte të caktuara qëndrojnë në konkurrencë. Meqenëse folja nuk ka mundur të zhvillohet nga

emërtimet e caktuara përkatëse, atëherë emërtimet me –UE/S nuk mund të zbatohen edhe për raste të tjera. Pra, si me thënë, emërtimet e tilla janë të kushtëzuara me foljen përkatëse.

b) Konstatimi që u tha pak më sipër për emërtimet me prapashtesën -UE/S vlen edhe për emërtimet me prapashtesën -I/ZUE/S, përkatësisht për foljet me zgjerim me -ëZO/j apo -IZO/j.

Po sqarojmë se foljet më ëZO, përkatësisht -IZO emërtohen procese të caktuara teknologjike, për çka këtu nuk do të zgjatemi.

Nga ky nëntip polemikë përmendim emrin *polemizues*, i cili mbështetet në foljen *polemizoj* jo aq në ndërkombëtarizmen *polemikë* po ashtu sikurse folja *analizoj* normalisht del emri prejpjesor *analizues*, i cili mbështetet në foljemn *analizoj* jo aq në vbetë fjalë[termin *analizë*, Pra siç u tha pak më sipër, emrat e tillë kuptimisht më fort lidhen me foljen se sa me ndërkombëtarizmen përkatëse, prandaj krahas a paralelisht përdoren edhe emërtimet mbi bazë emërore ose të huazuara si p.sh. *analitik* e *analizues*, *polemik* a *polemikan* e *polemizues* etj.

Krahaso:

a. *shq. analizoj (me analizue): gjerm. analysieren, fr. analyser, rus. analizirovatj, angl. to analyse, it. analizzare, skr. analizirati (analizovati)* etj.

b. *shq. polemizoj (me polemizue): gjerm. polemisieren, fr. polémiser, angl. to polimize, rus. polemizirovatj, it. polemizzare, skr. polemizirati (polemisati)* etj

Lidhur me këtë do konstatuar se mënyra e zgjerimit të prapashtesës foljore -O- në -I/ZO- është bërë në sajë të zhvillimit të brendshëm të gjuhës sonë, por njëherazi mund të jetë edhe përfitim a formëzim i bërë nën ndikimin e trajtave të gjuhëve të huaja. Si duket në rastet e tilla që po i shqyrtojmë mund të kenë hise të dyja dukuritë e sipërcekura. Për të dëshmuar këtë mjafton të krahasohen format e gjuhës shqipe me format e disa gjuhëve të huaja, siç u dhanë më lartë.

Së këtëjmi, gjithsesi duhet të kihet parasysh fakti se emërtimi që për nga forma është më e afërt me ndërkombëtarizmen ai edhe semantikisht i përgjigjet më mirë konceptit që lidhet me atë ndërkombëtarizëm. Kështu pra emërtimet me -I/ZUE/S mbulojnë konceptet që kanë të bëjnë më fort me foljen, ndërsa trajtat e tjera më tepër lidhen me konceptin e

ndërkombëtarizmes, prandaj edhe në jetën praktike ndeshen trajtat paralele si p. sh.

a) analizues, por edhe analitikan (analist analitik, analitikës);

b) polemizues, por edhe polemikan (polemikës, polemik)

e kështu me radhë, por gjithsesi me mundësi për të shprehur nuanca kuptimore të nevojshme sipas kërkesave të ndryshme.

5. Edhe mënyra e ndërtimit me prapashtesën -TAR, e cila është prapashtesë e mirëfilltë e gjuhës sonë, siç është rasti muziktar, duhet të përmendet si mundësi që synohet të vijë në konsideratë. Është interesant fakti se trajta muziktar, e cila del që në Fjalorin e "Bashkimit" si barasvlerës për musicanto të italishtes, ajo nuk mundi ta mënjanojë huazimin muzikant. Por për emërtimet në shqyrtim as trajta muzikant me elementin -ANT nuk mundi të tërheqë pas vetes shumë shembuj të tjerë. Në të vërtetë, prapashtesa -TAR si prapashtesë speciale, e cila shërben për të emërtuar njerëzit sipas profesionit a veprimtarisë së tyre, sikurse prapashtesa -S, ka arritur në disa raste ta fitojë konkurrencën ndaj prapashtesës -S si p.sh. te fjala furrës furrëtar (nga furrë) apo si e tillë ajo bashkëjeton me të si p.sh., te shembujt lajmës e lajmëtar, mjekës e mjektar, derës e derëtar etj., natyrisht në këto raste jepet mundësi të bëhet diferencimi i nuancave të caktuara kuptimore. Këtë fakt e ceka me qëllim që mos të nxirret gjykim i padrejtë ndaj cilësdo prapashtese përkatëse. Është e vërtetë se në kohën tonë edhe disa emra me -TAR janë goditur për koncepte të caktuara nga format sinonimike me prapashtesën -Ë/S, përkatësisht -UE/S si dhe nga trajtat kompozita të tipit *bukëpjekës për furrëtar* etj.

Prapashtesa -TAR, siç doli nga analiza e mësipërme, edhe pse nuk ka pengesa parimore, nuk ka arritur të ketë shtrirje për emërtime të tjera lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore.

6. Është e vërtetë se gjuha jonë e ka prapashtesën -AN, e cila siç e kanë konstatuar Xhuvani - Çabej "*u ngjitet emrave e mbiemrave duke treguar një cilësi të fjalës rrënjë ose duke i dhënë kësaj fjale një kuptim pejorativ*", përdoret gjithashtu sipas tyre, për ndonjë emër topik, etnik a personal. Edhe pse nuk është theksuar nga Xhuvani -Çabej, besoj se nuk gabohet nëse shtohet e dhëna se kjo prapashtesë përdoret edhe për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë së tyre mbi bazë të ndërkombëtarizmave me -IK(Ë) fundore si dhe për ndonjë nëntip tjetër, siç është nëntipi *historian, komedian, gardian*. Në krahasim me FGJSH 1954 në FGJSSH numri i emërtimeve në shqyrtim është shtuar për tri raste: *fizikan,*

fonetikan dhe gramatikan, por këtu është lënë pa u përfshirë trajta *kritikan*, s'di për çfarë arsye, dhe në vend të konceptit të tillë ka dalë trajta *kritizer*. Prirja për futjen në përdorim edhe për emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë të prapashtesës -AN shihet që në fazën ndërmjet dy luftrave botërore, hetohet kjo prirje në veprat e A. Xhuvanit dhe të K. Cipos, në Fjalorin anglisht - shqip të S. Mannit etj, por një nevojë a prirje e tillë del sheshit edhe në kohën tonë, siç e tregon në njëfarë mënyre edhe rritja e numrit të emërtimeve të tilla në FGJSSH. Kështu aktualisht nuk janë të rralla rastet që numri i emërtimeve të tilla të rritet, siç janë b.f. shembujt:

fonetikan, statistikan, aritmetikan, kronikan analitikan, metodikan etj.

Lidhur me këtë formant dalin dy çështje që kërkojnë sqarim: e para, ka të bëjë me faktin se prapashtesa e tillë për këtë nëntip emërtimelesh sa është rezultat i funksionit të prapashtesës së mirëfilltë të shqipes dhe e dyta, ky formant sa është refleksi i ndonjë gjuhe të huaj, prej kah edhe mund të jetë huazuar bashkë me tërë fjalën e caktuar? Si duket që të dyja këto komponente janë të pranishme në procesin e aktivizimit të formantit -AN për këtë nëntip emërtimelesh. Pra nuk është i pa bazë supozimi se format si *politikan, republikan, matematikan* etj. janë ndërndikime nga gjuhët e huaja konkretisht nga forma e anlishtes me -/CI/AN fundor, përkatësisht italishtja me -AN/T pa T-në fundore. Ç' është e vërteta, të gjitha rastet e shqipes me prapashtesën -AN në anglishte i gjeta po ashtu me -AN fundor. Ma merr mendja se ky formant bashkë me krejt emërtimin në fillim ishte refleksi i gjuhës së huaj, kurse konsolidimi i këtij fundori është bërë nën ndikimin e trajtës së mirëfilltë të shqipes. Dhe pikërisht këtu qëndron arsyeja që formanti -AN pothuajse e ka fituar konkurrencën ndaj formanteve të tjera me origjinë të huaj, siç janë trajtat -ANT, -IST, -CIEN, -CIENT etj., kështu që norma sot njeh vetëm **trajtën fizikan** jo *fizikant, fizicien a fizicient; fonetikan*, jo *fonetist, foneticist, fonetikant* etj. Mirëpo s'di sa do të ketë pengesa në favorizim e zgjerim për shembuj të tjerë formanti i tillë, kur dihet fakti, siç u tha pak përpara, se formanti i tillë pothuajse del i specializuar për të treguar "cilësinë" e fjalës temëprodhuese, përkatësisht për dhënien e kuptimit keqësues "pejorativ" të fjalës së caktuar. Mbase vetvetiu prania e kuptimit keqësues në ndërgjegjen e shqipfolësit mund të ketë ndikuar që kjo mënyrë mos të përfshijë pa rezervë edhe grupet e tjera në shqyrtim. Nuk është vështirë të dallohet kuptimi homonimik i prapashtesës si b.f. te shembulli keqan me atë lirikan a kritikan. Sidoqoftë rritja e numrit të emërtimeve mbi këtë bazë ka mundësi të arsyetohet, përkundër shkaqeve

që u thanë më sipër. Patjetër edhe kjo mënyrë fjalëformuese duhet të kihet në konsideratë. Gjithsesi, kjo mënyrë qëndron në përparësi ndaj formave të tjera, ngase për nga forma ka ngjashmëri me zgjidhjet e caktuara në gjuhët e huaja (p. sh. anglishtja) në njërin anë dhe nga ana tjetër sa i përket kërkesës që ka të bëjë me mbështetjen në elementet vendëse edhe në këtë rrafsh e plotëson kriterin formal, por jo atë sipas fushës semantike, sepse, siç u tha në shqipe ekziston modeli i formimit të klasës së emrave me prapashtesën – AN, zakonisht për një nënfushë jo aq përfshirëse të emërimit të njerëzve sipas prejardhjes, si shkodran, dibran.

7. Për rastin me prapashtesën -QAR duhet të konstatohet fakti se nuk është përfitim vetëm nga ndikimi i formantit -ČAR (-ÇAR) të serbokroatishtes, por vjen edhe nga forma e gjuhës turke -QAR, siç ndeshet te shembujt: *gjynahqar, zullumqar, hyzmetqar* etj., por gjithnjë mund të jetë edhe në ndikim të formave të shqipe, siç janë shembujt analogë nga forma si p.sh. *grabitqar, mundqar, mllefqar* etj. Në bazë të shembujve konkretë nga praktika mund të konstatohet se një reflektim i tillë nuk qëndron për emërtimet e profesioneve, përkatësisht të ushtruesve të profesioneve, pasi që në gjuhën tonë emërtimet e tillë me origjinë a nën ndikimin e formave turke nuk kanë gjetur përdorim me prapashtesën mbiemërore -QAR, për me prapashtesën speciale emërore turke: -XHI (-ÇI), e cila në raste të caktuara është e gjallë në përdorim edhe sot e kësaj dite, edhe pse është në goditje të përhershme, si të thuash, nga konkurrueset me origjinë shqipe -TAR, -S (-Ë)S a -UE/S). Trajta -QAR u përmend këtu më tepër për të tërhequr vëmendjen se ky element që paraqitet në raste të caktuara, mbart cilësinë e barbarizmes dhe si e tillë as që është e nevojshëm për t'u përdorur për emërtimet në shqyrtim, sidomos në stilin asnjans.

8. Me prapashtesën e gjuhës frënge -CI/EN (frëngjisht lexohet -SJE(n)) në gjuhën tonë e kemi të reflektuar (pranuar), sipas FGJSSH, vetëm një emërtim të ushtruesit të veprimtarisë së caktuar e ky është emërtimi **teoricien** dhe asnjë tjetër. Madje sipas mendimit tim edhe kjo trajtë e vetme si rast i vetmuar pa nevojë është pranuar, pasi që lidhur me këtë kemi trajta të tjera më të përdorshme si p.sh. *teorik, teorist, teorizues*. Duhet konsideruar jashtë norme të gjitha trajtat që mund të ndeshen aty - këtu në burime të ndryshme si matematicien, fizicien. Ma merr mendja se kjo prapashtesë frënge nuk duhet kurrsesi të aktivizohet në gjuhën tonë. Madje jo vetëm kjo por edhe më keq, siç po ndodh jo rrallë, kur kësaj po i shtohet

edhe një -T, si p. sh. *muzicjent, fizicjent, matematicjent (!!!)* etj. Është e vërtetë që forma e formantit -CIENT nuk ekziston as në gjuhën frënge, madje as në ndonjë gjuhë tjetër, prandaj një shpifje e tillë në gjuhën tonë mund të shpjegohet si një trill a refleksi i prapashtesës tjetër të huaj -ENT të tipit referent, e cila është prapashtesë më vete dhe nuk ka arsye të ngjizet me prapashtesën -CI/EN të frëngjishtes. Prandaj formanti -CIENT si dhe ajo -CIEN nuk duhen përdorur në asnjë rast për emërtimet në shqyrtim, ngase për to nuk paraqitet kurrfarë nevoje.

9. Nën ndikimin e gjuhës gjermane, por edhe të formave të ndonjë gjuhe tjetër, ndeshim në realitetin tonë gjuhësor në raste që dalin edhe me prapashtesën -ER, siç është p.sh. shembulli *kombajner* (kombajnë) ai *veteriner* (veterinë) e ndonjë tjetër. Ç' është e vërteta, në gjuhën tonë mbizotërojnë trajtat me variantin -IER të tipit *magaziniër, portier* etj, megjithatë për emërtimet në shqyrtim mund të ndeshim edhe në formën me -ER si p.sh. *analitiker, statistiker*. Po theksoj se rastet me -ER (e natyrës gjermane) si dhe të variantit -IER të gjuhës italian, as që duhet të na shkojë mendja t'i përdorim për rastet në shqyrtim, pasi që për to tashpërtash nuk del kurrfarë nevoje as jashtëgjuhësore dhe as brendagjuhësore.

10. Është e vërtetë se prapashtesa -IST në gjuhën tonë, edhe pse me origjinë të huaj "*është bërë mjaft produktive për formimin e emrave që emërtojnë një person sipas mjeshtërie a punës që kryen*". Kjo dëshmohet edhe me faktin se në FGJSSH numri i emërtimeve të tilla në krahasim me FGJSH dyfish është më i madh. Sa i përket lëndës që po trajtohet këtu lidhur me këtë prapashtesë kemi disa vërejtje a konstatime. Për disa formime siç janë ato të grupit 2) të tipit *stilstilistikë, albanist albanistikë* etj. as që shprehet farë rezerve, mirëpo lidhur me nëntipat e tjerë siç janë shembujt në grupet e tjera në pika të caktuara lidhur me këtë prapashtesë dalin disa gjëra që meritojnë sqarim. Kjo prapashtesë paraqitet në katër variante përdorimi: -IST, -K/IST, Q/IST dhe C/IST. Për secilin variant të diskutueshëm do të jap më poshtë mendime e konstatime nga të cilat, në njëfarë mënyre, goditet qëndrueshmëria e tyre.

a) U tha më sipër lidhur me nëntipin *botanist, metodist* etj. edhe pse lidhen kuptimisht me ndërkombëtarizmën me -IK(Ë) fundore përkatëse emërtimet e tilla nuk ndërtohen mbi temën e emrit përkatës me -IKË, por kanë temën e përbashkët fjalëformuese mbi bazë të cilës shtohet edhe prapashtesa -IKË e ndërkombëtarizmës edhe prapashtesa -IST e emërtimit të

njeriut sipas veprimtarisë. Këtu do veçuar fakti disa tema prodhuese mund të jenë fjalë të qarta motivuese, por shumica e tyre në rastet tona që i kemi në shqyrtim dalin me temë jo të qartë motivuese. Në grupin përkatës të këtij nënllloji është numri i kufizuar prej 6 rastesh. Në krahasim me FGJSH në FGJSSH janë shtuar 3 emra të rinj: *dogmatist, harmonist dhe metodist*, mirëpo kur kemi parasysh një numër të konsiderueshëm të emërtimeve të tjera që po i hasim në realitetin tonë gjuhësor dhe që del e nevojshme disi të integrohen, problemi i tillë del mjaft i mprehtë dhe kërkon zgjidhje. Është e vërtetë se formanti -IST del eddhe te disa shembuj, të cilët janë të regjistruar në FGJSSH po pësojnë goditje nga formantet e tjera rivale. P.sh. nuk janë të rralla rastet kur në vend *botanist* të dalë trajta *botanik* e *botanikës*, për *dogmatist* të dalë *dogmatik, dogmatikan*, e kështu me radhë dhe sipas mendimit tim trajtat e fundit dalin më të kuptueshme pikërisht për arsye të temës së qartë motivuese në të cilën edhe mbështetet kuptimi i prejardhurme prapashtesën përkatëse. Ky gjykim duhet të përforcohet dhe të sqarohet paksa edhe nga pikëpamja teorike e ana praktike. Thashë se format e tilla po goditen nga format a modelet e tjera më të qarta dhe e kanë vështirë të mbrohen gjatë procesit të përdorimit. Dhe këtë po e them për arsye që, siç e thashë më përpara, kuptimi i tyre lidhet me ndërkombëtarizmin përkatëse: *dogmatikë, botanikë, kronikë* e jo me temën mbështetëse prodhuese: *dogmat-, botan-, kron-*, leksema këto që në gjuhë tonë nuk kanë kurrfarë kuptimi, prandaj si të tilla as që mund të shërbejnë si tema motivuese. Ky fakt nuk është i parëndësishëm dhe i pa peshë. Nisur nga ky gjykim më duket pa vend lakmia e atyre që pa kriter po e favorizojnë këtë mënyrë fjalëformimi për emërtimet në fjalë, edhe pse si mbështetje kanë format e caktuara të gjuhëve të huaja. Këtë gjykim nuk e mbështesim vetëm për shkakun e mungesës së temës motivuese në gjuhën tonë, por edhe për një arsye tjetër, sepse duke e shkurtuar leksemën -IKË hapet shteg për ngatërresë kuptimore homonimike pa kurrfarë nevoje. Këtë po e ilustruj me dy tre shembuj që kanë të bëjnë me ndërkombëtarizmat përkatëse, së pari po e përmend emërtimin që lidhet me ndërkombëtarizmin **analitikë**. Në shqipe, sipas rregullit të formimit të emërtimeve të njerëzve të këtij grupi del trajta e huazuar: *analist*. Në disa gjuhë të huaja, për kuptimin që lidhet me ndërkombëtarizmin në fjalë emërtimi i njeriut del kështu:

it. **analista**, fr. *analyste*, angl. *analyst*, gjerm. *Analytiker*, ndërsa për kuptimin tjetër që lidhet me **anale** "përmbledhje të ngjarjeve kryesore" emërtimi përkatës i njeriut del kështu:

it. **annalista**, fr. *annaliste*, gjerm. *Annalist*, angl. *annalist*.

Ndërkaq në shqipe sipas drejtshkrimit a praktikës së tashme për të dyja kuptimet del trajta: **analist**, mirëpo për t'i ikur homonimisë përdoret ndonjë sinonim tjetër. Sipas kësaj ecurie edhe më keq do të dilte trajta *statist* (që i referohet ndërkombëtarizms **statistikë**), sepse ndeshet në homonimi me kuptimin e figurantit në teatër a film. Edhe në raste të tjera, po të vazhdohet me këtë mënyrë fjalëformimi, do të krijoheshin (siç janë krijuar në të vërtetë) keqkuptime a ngatërresa të panevojshme kuptimore, siç është rasti p.sh. *dialektist* (!!!) (ndeshet në FTSSH), pasi është fjala për *dialektikë* (filozofi) e jo për *dialekt* (gjuhësi). Ngatërresë e ngjashme mund të dalë edhe me trajtën *grafist*, kur është fjala për degën e *grafikës* e jo për *grafinë* (shkrimin), pastaj me *elektronist*, kur është fjala për *elektronikë* e jo për *elektronin* si grimcë të atomit, *polem+IST* ngatërrohet me *popullist*, *harmoni+IST* me *harmoni* (marrëdhënie shoqërore) etj. Format a praktika e gjuhëve të tjera nuk duhet të na hutojnë. Të vihet re rasti i sipërcekur: *analist* (*analitik a analitikan*) dhe *analist* (analeshkruer) se si bëhen dallimet e nevojshme në gjuhë të huaja, qoftë me dyfishishim e n-së, qoftë me grafën Y/I. Gjithsesi emërtimet e këtij grupi në shqipe janë në goditje nga format e tjera, për këtë arsye nuk del e nevojshme të favorizohet shtimi i numrit të këtij grupi, sipas kësaj zgjidhjeje.

b) Trajtat me -K/IST na tërheqin vëmendjen. Këto janë ndërtuar sipas rregullit që ka të bëjë me konstatimin se prapashtesa -IST mund t'i shtohet temës emërore për të formuar kështu emërtimin e njeriut sipas profesionit. Mirëpo ç'është e vërteta, asnjë shembull mbi bazë të kësaj mënyre nuk e ndeshim të regjistruar në fjalorët tanë normativë përkatës. Këtë trajtë e kam hasur në regjistrat e emërtimeve të profesioneve të botuar te ne. Një mënyrë e tillë fjalëformuese del me njëfarë rezistence brenda vetvetes, pasi që në asnjë gjuhë ku ruhet shqiptimi i K-së nuk ndërtohen emërtime me prapashtesën -IST dhe njëherazi aty ku përdoret kjo prapashtesë ndryshon edhe shqiptimi i K-së fundore. Ky fenomen do të ceket paksa edhe në një tjetër vend po në këtë punim. Për mosfavorozimin e kësaj mënyre fjalëformuese ndikon edhe një fakt tjetër që lidhet me ndërrijen e folësit, pasi që në emërtimet e profesioneve përdoret edhe formanti i veçantë -IK (Krahaso: tekne+ik teknik), kështu te rastet IK + IST bëhet njëfarë dyfishimi i formanteve që në raste të tjera mund të dalin në rivalitet ndërmjet tyre. Sidoqoftë po të mos kishte forma të tjera më të kapshme, edhe kjo mënyrë mund të vinte në konsideratë, pasi ndërtohet mbi temën e qartë fjalëformuese.

c) Trajta me -Q/IST që i ndeshim si raste në regjistrat e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit të botuar te ne, ku K-ja fundore shndërrohet në Q, nuk duhet përkrahur, meqë një mënyrë e tillë fjalëformuese del e paqëndrueshme. Dihet se procesi i shndërrimit të K-së në Q, si ligj fonetik që shpjegohet historikisht, tashmë ka përfunduar së vepruari, sidomos kur është fjala te emërtimet e reja apo ato të huazuara. Është e vërtetë se nga mik në shumës del miq etj, por te fjala teknik, çernik, mekanik etj. shumësi nuk del me Q, por me -Ë. Për paqëndrueshmërinë e kësaj mënyrë fjalëformuese as që ka nevojë të bindemi me më shumë fjalë.

ç) Trajta -C/IST, ku K-ja është reflektuar në C- në shqip është rezultat i huazimit nga gjuhët e huaja. Sipas shembujve konkretë duket se është huazuar nga italishtja. Në shqipe dukuria e kalimit të K-së në C nuk është i pranishëm as aktualisht, madje s'di edhe historikisht do të ketë ndodhur, apo jo?! Nga rastet në shqyrtim kemi vetëm dy emërtime: elektrikist dhe fisarmonicist. S'do mend se trajtat e tilla janë kopjim i grafisë së italishtes me ndonjë ndryshim të vogël: elettricisto e fisarmonicisto. Them të grafisë, pasi që në atë gjuhë C-ja përpara I-së lexohet (shqiptohet) Ç. Ndoshta për leximin e tillë në shqipe do të ketë ndikuar, pos alfabetit tonë edhe leximi nga alfabeti i latinishtës, pasi që në atë gjuhë klasike shkronja C para I-së lexohet C, siç veprohet edhe në shqipe. Gjithsesi mendoj se reflektimi i tingullit a i grafit C nga gjuhët e huaja në shqipe meriton trajtim të veçantë, kurse për rastet të mëtejshme të këtij punimi, pos këtyre dy fjalëve, të cilat edhe mund të korrigjohen, për raste të tjera mendoj se nuk duhet të favorizohet. S'kemi kurrfarë nevoje të kopjojmë grafinë e gjuhës italiane me -C/IST apo të huazojmë tërë fjalën e huaj, kur kemi mundësi më të përshtatshme për përfitim të fjalëve të caktuara, madje duke u mbështetur në modelet ekzistuese të strukturës së brendshme të gjuhës sonë. Gjithashtu lidhur me këtë pikë e shoh të nevojshme të theksoj se nëse del e nevojshme për qëllime sinonimike e të tjera mund të përdoren edhe trajta të tjera përveç trajtës elektrikist si p sh. elektrikës elektrikues a elektrikan e të ngjashme.

Këtë fakt e shoh të arsyeshme ta përmend i shtyrë nga përvoja se nga jeta po shtrohen nevoja të reja për të shprehur koncepte të ndryshme, sidomos asosh që kanë të bëjnë veç me elektrikun, veçmas me energjetikën, me elektroteknikën a elektronikën etj.

Në fund në përmbyllje të kësaj pikë mund të nxirret konkluzioni se veç rasteve kur trajta me -IST del si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë, nga i cili në njëfarë dore del edhe ndërkombëtarizma me -IK(Ë) fundore, për raste të

reja nuk duhet të favorizohet, jo vetëm -IST, por asnjëra nga trajtat përkatëse: -K/IST, Q/IST e C/IST.

11. Me prapashtesën -ANT në FGJSH dalin vetëm tri raste, të cilat edhe ishin në FGJSH, çka do të thotë se në gjuhën e sotme letrare nuk kemi rritje të numrit të emërtimeve të këtij nënloji. Prapashtesa -ANT e burimit të huaj, si duket në gjuhën tonë është reflektuar kryesisht nga italishtja. Krahaso: *fabrikant* : *fabricante*, *muzikant*: *musicante*, *praktikant* : *praticante*. Është interesant se këto trajta goditen nga forma të tjera si p.sh. *fabrikues e fabrikën*, *miziktar muzikues e muzikan*, *praktikan (fillestar, gatimtar)*, megjithatë format me -ANT për këta tre shembuj konsiderohen si të qëndrueshme. Por prirja për zëvendësimin e tyre nuk duhet përçmuar. Lidhur me këtë formant vlen të vihet në pah, pra edhe më mirë, konkurrenca që ka ky rast, jo vetëm me trajtat që i përmenda kalimthi më sipër, por edhe me prapashtesën vendëse -UE/S, siç mund të vërehet te emrat a mbiemrat me -ANT të tipit: *diskutant*, *simpatizant* e të ngjashëm të cilët në shqipe priren të dalin: *diskutues simpatizues* etj.

12. Formanti C/IAN siç doli te shembulli logjician (pika 18), edhe pse nuk ka përdorim të gjerë, vlen të diskutohet. Në të vërtetë ky formant duhet të konsiderohet si huazim nga anglishtja, përkatësisht tërë fjala konsiderohet si huazim i mirëfilltë. Trajatat e tilla edhe në qofshin të huazuara për arsye të forta stilistike, për kuptimin neutral nuk duhet dhe as që ka nevojë të favorizohen.

* * *

Para se të mbyllet kjo pikë po e cek edhe një herë reflektimin e K-së fundore të emërtimeve në shqyrtim në gjuhë të ndryshme, ashtu siç dalin në emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë mbi këtë bazë, me interes kjo për tërë temën që u trajtua në këtë punim:

anlisht:	-CI/AN		lexo: c = sh	- shën ,
frëngjisht:	-CI/EN		" c = s	- sje(n) ,
italisht:	-C/IST		" c = ç	- çist ,
serbokr.:	-Č/AR	"	č = ç	- çar ,
latinisht:	-C/US		" c = k	- kus ,
gjermanisht:	-K/ER/	"	k = k	- ker ,
greqisht:	-K/OS		" k = k	- kos .

Shqip -K/AN “ k = k - kan

Pasqyrëzën e mësipërme duhet ta kemi parasysh për të veçuar sadokudo formantet karakterstike të gjuhëve të caktuara dhe t'i kemi parasysh edhe veçoritë grafike dhe ato shqiptimore të gjuhëve pëkatëse, në mënyrë që shqipja në këtë kontekst duhet ta zgjedhë ose më mirë ta kristalizojë mënyrën e vet të fjalëformimit a të formëzimit –**K/AN**, edhe për këtë tip emërtimeve që u trajtua në këtë punim. Si duhet të vepohet pra konkretisht do të përpiqem tash në fund ta rumbullakësoj me pak fjalë.

P ë r f u n d i m

Emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë që dalin mbi bazë të ndërkombëtarizmave me -IK(Ë) fundore nga pikëpamja e fjalëformimit a e formëzimit në shqipe dalin mjaft të ndërlikuara. Numri i tyre i përfshirë në FGJSSH, që u merendua në 7 grupe, është i vogël në krahasim me numrin e tyre që përdoret a që ofrohet,ose,më mire me thënë, po imponohet për përdorim në jetën tonë të përditshme. Emërtimet e tilla janë veçori e jetës modern, mirëpo për përdorimin ose zgjidhjen e formës shkrimore të tyre në gjuhën shqipe lidhur me to shtrohen disa kërkesa, ndër të cilat po theksojmë:

E para, për trajtat e regjistruara në FGJSSH, përkundër ndonjë përjashtimi, duhet të respektohet norma drejtshkrimore a drejtfjalëformuese, ndërsa për rastet e tjera lind nevojë e ngutshme që të zgjidhet edhe çështja e tyre në mbështetje të modeleve të ravijëzuara të fjalëformimit në gjuhën shqipe.

E dyta, meqenëse, në gjuhën shqipe për këtë tip emërtimeve nuk ekziston një model mbizotërues që do të përthithte rastet që ende nuk janë normëzuar, propozohet që në radhë të parë të shfrytëzohen modelet e mundshme që ekzistojnë edhe për tipa të tjerë të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit, siç janë:

a) emërtimet perifrastike të tipit: *punëtor i analitikës, punëtor analitike a punëtor - analitik*;

b) emërtimet pa ndajshesë të tipit *teknik, mekanik* etj.

c) emërtimet me prapashtesat e mirëfillta a speciale për nënfushën e tillë semantike siç janë prapashtesat: (Ë)S, -UE/S, -TAR si dhe ajo -AN dhe në raste të caktuara edhe prapashtesa -IST, siç janë shembujt: *automatikës(!), kritikues, analizues, muziktar, përkatësisht fizikan, matematikan, albanist* etj.

ç) për këtë tip emërtimeve si dhe në përgjithësi në gjuhën shqipe assesi nuk duhet favorizuar formantet e huazuara nga gjuhët e huaja siç janë trajtat: *CI/AN, -ANT, CI/EN, CI/ENT, -C/IST*, madje as edhe *-ER e -IST* në raste të caktuara.

E treta, mbase, hëpërhë, nuk është keq të favorizohet prirja për aktivizimin e prapashtesës -AN (-K/AN), e cila del me mundësi për të përthithur numrin më të madh të emërtimeve të cilat ende nuk janë regjistruar në burimet e caktuara normative dhe kështu kjo të bëhet mënyrë mbizotëruese për tipin e emërtimeve në shqyrtim të ndërkombëtarizmave me IK/ë fundore.

Gjithsesi çështja e shtruar në këtë punim duhet të trajtohet me kompetencën e duhur nga kuadrot përkatës. Kjo çështje nuk duhet lënë stihisë, siç ka mbetur deri më tash. Besoj se lënda e parashtruar si dhe sugjerimet që u dhanë këtu po të kihen në konsideratë do të ndihmojnë jo pak në zgjidhjen përfundimtare të çështjes në shqyrtim.

Rezy me

Në kontekst të çështjeve të mprehta të shqipes standarde në fushën e leksikut dhe të fjalëformimit, në kuadër të klasës së emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit që ushtrojnë, shtrohet edhe çështja e emërimit të njerëzve aipas veprimtarisë lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(ë) fundore. Numri i emrave të tillë në fjalorin normativ përshkrues të gjuhës sonë (FGJSSH) arrin në 45 sosh, kurse numri i ndërkombëtarizmave me -IK(ë) fundore është dyfish më i madh. Kërkesa për përdorimin e ndërkombëtarizmave me -IK(ë) fundore e sidomos për emërtimet e njerëzve mbi këtë bazë, si në çdo gjuhë moderne edhe në shqipe është në rritje e sipër. Emërtimet e njerëzve mbi këtë bazë në gjuhën shqipe, siç del nga lënda e konsultuar, janë përfutur si huazime nga gjuhë të ndryshme. Kjo dëshkohet me faktin se ato nga aspekti fjalëformues e formëzues dalin në forma mjaft heterogjene.

Sipas mënyrës së zgjidhjes së tyre sipas FGJSSH ato u merenduan në 7 grupe, ndërsa format e paregjistruara paraqiten a mund të paraqiten deri në afro 20 variacione. Sipas gjendjes së sotme mund të thuhet se asnjëra nga mënyrat fjalëformuese nuk mund të cilësohet si gjedhe mbizotëruese, e cila do të përthithte a do të integronte të gjitha të tjerat, sidomos ato që ende nuk janë përfshirë në burimet tona normative. Prandaj në kërkim të zgjidhjes sa më të mirë të çështjes nga analiza doli që përveç formave perifrastike të emërtimeve të tipit: *punëtor i mekanikës (analitikës)*, *punëtor mekanike (analitike)*, *punëtor - mekanik (punëtor - analitik)* si dhe mënyrës së formimit me konversion (pa ndajshitesë) të tipit: *mekanik, analitik* etj., për zgjidhjen me prejardhje me prapashtesim) në shqipe për emra si emërtim e të njerëzve sipas veprimtarisë për nëntipa të tjerë emërtime ekziston modeli i formimeve me prapashtesën -(Ë)S, tipi: *matës pikës*, por edhe: *automatikës, analitikës, lirikës* (edhe pse ky është tip joprodhimtar); me prapashtesën -UE/S, tipi: *mësues, dërgues*, por edhe *muzikues fabrikues*; me prapashtesën -TAR, tipi: *muziktar, mendimtar, mishtar* etj., por për nëntipin e emërtimeve në shqyrtim më praktike dhe me prirje shtrirjeje u tregua prapashtesa -AN (-K/AN) e tipit: *fizikan analitikan, matermatikan*, ndajshitesë kjo e shqipes, por që asociativisht lidhet me fundorin -I/AN të anglishtes. Prapashtesa -IST, e cila nuk kontestohet për raste të caktuara, bashkë me formantet si: -C/IST, -Q/IST, -K/IST; -CI/EN, -CI/ENT, -CI/AN, -K/ER, -ANT, -OR ndeshen aty - këtu, për rastet në shqyrtim, nuk ia vlen të favorizohen, pasi që për to nuk paraqitet kurrfarë nevoje, kur dalin ofertat

me prapashtesat vendëse: **-AN** dhe **(Ë)S** që dalin më të përshtatshme.

Gjithsesi procesi i konsolidimit të formimimeve me prapashtesën **-AN**, përkatësisht **-(Ë)S** duhet të ndiqet dhe të favorizohet.

Shënimet:

1) Rastet janë shënuar sipas burimeve të caktuara të botuara në Kosovë si p. sh. në vend kronist : kronicist (revista "Koha" 2/86 f.217; "Zëri i rinisë", 31.V. 1986 f. 24 etj.), kronik ((Rilindja, 30. IV. 1985 f. 7; "Bota e re", 15. VI. 1986 f. 13), matematikan : matematikant (libri "Logjika", Prishtinë 1984 f. 268; Bujku, 33. II. 1981 f. 5; FLSH etj.) matematicien ("Shkëndija", 8/85 f. 16) matematicient (Rilindja, 13.VI. 1985 f. 4; 21.IX. 1985; 7. IV. 1984 f. 12; "Shkëndija" 8/85 f. 16 etj.), rfizikan : fizikant (FSHS (1976), FSSH, Rilindja, 4. III. 1985 etj.) fizicient ("Bota e re", 15.IX. 1985 f. 2; Rilindja, 13. VI. 1985 f.4 etj.), praktikant : praktikan ("Shkëndija" 3/84 f. 9), elektricist : elektrocist (Rilindja, 29. X. 1984 f. 18) elektrikan (Rilindja, 21. VI. 1986; 24.VIII. 1986; 12. IX. 1985 f. 12), hidraulik : hidraulikist hidraulist (REP), muzikant : muzicient (Rilindja, 27.IV. 1985 f.15; 10. xi. 1984 f. 17 etj.) Po kështu veprohet edhe me shembuj të tjerë siç janë rastet: fonetikan foneticien etj.

2) Për këtë mjafton të përmend një emision të TVP, 16. II. 1985; "Bota e re", 15.IX. 85 f. 2, "Shëndeti" 10/85 f. II.

3) R. Aleksić, Rečnik stranih reči i izraza, Beograd 1978.

4) Sa për të ilustruar dukurinë e tillë do të mjaftohem vetëm me këto të dhëna: FFSH (M. Bejta): dialekticist (dialektikë). clinicist (klinikë), logjicent (logjikë), statisticien (statistikë); FESH: retorist e retorik(retorikë), logjician e logjist (logjikë), semantist (semantikë), semiotist (semiotikë); FSHS (1981): elektronist (elektronikë), grafist (grafikë), kozmetist (kozmetikë); REP: termist (termikë), plastist plasticien, plasticient plasticist (plastikë), qeramist qeramik (qeramikë);sintesist (sintetikë), por: statistikan e statisticien FSHS (1981), dialektikan "Shkëndija" 3/84 f. 9, taktikan FTSSH takticist e takticien FSSH (1974), logjicist e logjicien libri "Logjika" (1984) etj.

5) Për këto dhe probleme të ngjashme më gjerësisht në disertacionin "Struktura fjalëformuese e mërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe" të N. Veselajt(dorëshkrim), Prishtinë 1992.

6) Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976 f. 43.

7) A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 478.

8) N. Veselaj, "Çështje rreth emërimit të njerëzve sipas profesionit", Seminari ndërkombëtar për gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare, nr 9/84.

9) H. Barić, Rečnik srpskoga ili hrvatskoga i albanskog jezika, Zagreb 1950.

10) Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976.

2) ÇËSHITJE RRETH EMËRTIMIT TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT

(kumtesë)

Në kuadër të çështjeve të terminologjisë tekniko-shkencore vend të caktuar zë edhe çështja e emërtimit të njerëzve sipas profesionit.

Një çështje e tillë nuk mund të themi se nuk është zënë në gojë nga studiuesit e gjuhës sonë, qoftë në kuadër të fjalëformimit në përgjithësi, qoftë në punime të veçanta, por këto të fundit janë të pakta. Meriton të veçohet artikulli i Vaskë Milkanit "Vëzhgime mbi emërtimin e njerëzve sipas profesionit" (Studime mbi leksikon, Tiranë 1972). Kjo paraqitje jona është përpjekje e parë në Kosovë, megjithatë materialet e shtruara deri më tash në mënyrë të ndryshme na japin mundësi që çështja të vëzhgohet e studiohet, sadokudo në mënyrë më të thelluar, qoftë nga pikëpamja teorike, qoftë, aq më tepër nga pikëpamja praktike e shoqërore.

Dihet se profesioni bën pjesë në veprimtarinë e përgjithshme të njeriut dhe në kuadër të kësaj paraqitet si vështirësi përcaktimi i kufirit se kur mund të cilësohet një veprimtari e punë e personit si profesion e kur jo. Ne kryesisht jemi mbështetur në emërtimin e atyre profesioneve që kanë të bëjnë me punët dhe detyrat e caktuara në punën e bashkuar, sipas sistematizimeve përkatëse të organizatave punonjëse, përkatësisht sipas doracakëve zyrtarë lidhur me këtë.

Mendoj se nuk është e tepërt të përmend se të gjitha profesionet në Jugosllavi (sipas doracakut "Klasifikimi standard unik i profesioneve", Enti Federativ i Statistikës, Beograd 1981) janë klasifikuar në 9 grupe të mëdha që ndahen në 58 lloje e këto në 228 nënllloje dhe këto në 1.004 bashkënjësi a grupe profesionale të shifruara (pa u përfshirë këtu grupi i punëtorëve pa profesion që klasifikohet në 4 bashkënjësi. Në doracakun e Bashkësisë Krahinore në Punëzënies "Udhëzim"..(1981), sipas profilit të kualifikimit shkollor profesional janë dhënë 6 grupe profesionale, të ndara në 14 nëngrupe dhe këto pastaj në 1225 bashkënjësi a grupe profesionale.

Konsiderohet se në Jugosllavi ndoshta janë mbi 10.000 lloje profilesh të ngushta profesionale. Vetëm në doracakun "Lista alfabetike e profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar" EFS, BG. 1981, teksti në gjuhën serbokroate, janë gjithsej 1654 profesione, kurse në tekstin identik në gjuhën shqipe janë 154 emërtime profesionale më pak! Ja ku qet krye problemi i barasvlerësve adekuatë që imponohet si çështje e hapur për gjuhën tonë. Po në këtë tekst kemi rastin kur një emërtim i gjuhës shqipe jepet për dy apo tri emërtime të gjuhës serbokroate p.sh. **axhustator** për "adjuster" dhe "mashinbravar" e "bravar" apo **bojaxhi** për "bojadiser", "farbar" dhe "liçilac", edhe pse dihet se në gjuhën tonë kemi edhe disa terma të tjerë adekuatë, por që na duhet një përcaktim me marrëveshje për përdorimin e tyre.

Krejt kjo u tha sa për të tërhequr vëmendjen për ndërlikueshmërië e kësaj çështjeje.

Emërtimet e profesioneve siç dihet, bëhen kryesisht në këto mënyra:

1. sipas operacionit të punës,
2. sipas mjetit, makinës a veglës së punës,
3. sipas mënyrës së punës,
4. sipas lëndës a objektit të punës,
5. sipas vendit të punës dhe 6. sipas degës së ekonomisë së caktuar.

Procesi i formimit të emërtimeve mbi këtë bazë vazhdon edhe për këtë prin mënyra e emërtimeve sipas procesit të punës.

Nga pikëpamja strukturore fjalëformuese, emërtimet e profesioneve klasifikohen në këto katër mënyra:

1. emërtime, fjalë të parme,
2. emërtime, fjalë të prejardhura kryesisht me prapashtesim,
3. emërtime, fjalë të përbëra (me kompozim) dhe
4. emërtime, togfjalësha a perifrastike.

I. Në grupin e parë hyjnë emërtimet, emra të parmë, me origjinë të gjuhës shqipe si bujk, bari, rojë etj. si dhe emrat, terma ndërkombëtrë, si: teknik, mekanik, milic, profesor, teknolog, frezator etj.

II. Interes të jashtëzakonshëm paraqet formimi i emërtimeve të emrave me prejardhje që bëhet kryesisht me prapashtesim.

Si prapashtesa të ngulitura speciale për këtë qëllim, ato të gjuhës sonë janë :-S (-S, -UE/S, -Ë/S), -TAR, -AR; -TOR, -OR; e ndonjë tjetër si: -IK, -AK etj., fare pak të përdorura dhe ato me burim të huaj si më të përdorura: -IST, -XHI, -IER/-ER dhe të tjera më pak të përdorura si -AN, -ANT, -ENT, -IEN, -AT e ndonjë tjetër.

Për të pasur një ide më të qartë lidhur me këtë po japim më poshtë paqyrën e numrit të emërtimeve dhe përqindjen e përdorimit të tyre sipas prapashtesve më të përdorura speciale, sipas fjalorëve përkatës:

TABELA E SHEMBUJVE

Prapashtesat FGJSH 1954 FSHSK 1976 FGJSSH 1980 FSHSK 1981

	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
-UE/S	8	5	30	10	70	17	83	19
-Ë/S	21	12	64	22	70	17	96	22
-TAR	37	21	58	20	88	21	58	13
-AR	31	18	20	7	34	8	26	6
-TOR	21	12	14	5	25	6	27	6
-OR	7	4	3	1	13	3	6	1
-IST	28	16	53	18	72	17	71	16
-XHI	30	17	39	13	30	7	37	8
-IER/ER	10	6	9	3	20	5	30	7
Gjithsej	173		290		422		432	

Këtu janë përfshirë vetëm emërtimet me kuptim të mirëfilltë profesioni e jo të gjitha, por për të gjithë fjalorët është respektuar kriter i njëjtë.

Nga pasqyra e mësipërme shihet se numri i emërtimeve me -UE/s është 9-fishuar, përkatësisht 10-fishuar në krahasim me FGJSH-1954, ato me prapashteën -Ë/S janë 4 -fishuar a 5 fishuar, ato me -TAR, tre apo dyfishuar, me -AR janë pothuajse me numër të njëjtë, ashtu si emërtimet me -TOR, kurse me -OR janë me pak ose me numër të njëjtë.

Pothuajse me përqindje të niveluar janë shtyllat me -IST dhe me -IER/-ER, të cilat kanë një shtim të konsiderueshëm, ndërsa emërtimet me prapashtesën -XHI si dhe ato me -TOR kanë pakësim numri, sipas përqindjes për dy herë, duke mbetur pothuajse në numër të njëjtë.

Në kuadër të kësaj mund të bien në sy një sërë çështjesh, por po përmend vetëm çështjen e konkurrencës mes këtyre prapashtesave.

Në këtë kontekst prin prapashtesa -UE/S, e cila në kohën tonë është më prodhimtarja, mirëpo kemi raste kur në kolonën e krijimeve të kësaj prapashtese të rradhiten edhe krijimet që nuk duhet, siç janë shembujt e mëposhtëm që i nxora nga doracakët në fjalë:

hekurues (peglaç), metalgrihues (metalobrusaç), fotografues (slikar), shankues (shankash), fonderues (livaç) etj.

Emërtimet e tilla të krijuara në bazë të analogjisë nuk qëndrojnë, sepse për krijimin e emërtimeve me -UE/S, tema e fjalës duhet të jetë pjesorja e variantit verior e foljes së tipit më -OJ, kurse tema e emërtimeve të mësipërme është emër dhe për formime të tilla ka tjetër zgjidhje, siç do të shohim më poshtë.

Prapashtesa -UE/s u konkurrin më së shumti prapashtesave -IST, -TOR, -ENT, -TAR etj., si p.sh..

normist (normues), kopist (kopjues), montator (montues), saldator (saldues), dirigjent (dirigjues), referent (referues), valltar (vallëzues), diskutant (diskutues) etj.

Lidhur me këtë konstatojmë se emërtimet me prapashtesat e tjera do të jenë formuar më herët e me sforcimin e foljes që emërton procesin e punës, atëherë në saje të modelit fort të kapshëm dalin emërtimet e formës së re me prapashtesën -UE/S. Në të shumtën e rasteve procesi i zëvendësimit a i këmbimit vazhdon ende. Ndodh që edhe të mbeten të dy format si emërtime me përcaktime të veçanta. P.sh. Në OP "Rilindja": *redaktor* dhe *redaktues*.

Bien në sy edhe krijimet - emërtime të reja, pra gjithnjë nga procesi teknologjik, si:

trajtësues (former), kripëzues (solar), finalizues (finalizer), kromizues (hromer), metalizues (metalizer), karbonizues (karbonizer), elektrizues (elektrizer), planizues (planer) etj.

Edhe prapashtesa -Ë/S i shtohet pjesores së ish variantit verior, por të foljeve të tipit me bashkëtingëllore -IT,-OS që përkon me trajtat e kohes së tashme njëjës, p.sh. *përgatitës, shitës, majmës* etj. si dhe të tipit të foljeve me -YE/J, -Y/j por për këtë tash merret pjesorja normative p. sh. *fryrës, fshirës, grirës, kryerës* etj. që do të thotë se trajtat *frys, gris, fshis, kryes*, sipas praktikës, për të njëjtin koncept, ua lëshuan vendin trajtave si më sipër.

Kjo prapashtesë (-S) u shtohet edhe emrave si p.sh. mullis, furrës, grihës, vorbës etj, por është më pak e përdorshme në konkurrencë me të tjera.

Emërtimet e profesioneve me -TOR si punëtor, murator e ndonjë tjetër kanë mbetur të vetmuara, duke mos paraqitur më model. Edhe huazimet frezator, axhustator, montator, tornitor etj. siç u konstatua më sipër, kur hyjnë në strukturën e ligjërimit aktiv, po pësojnë ndryshimin e prapashtesës.

Në vazhdë të kësaj duhet konsideruar jashtë norme apo që meritojnë rivlerësim krijimet si këto që i hasim në doracakët në fjalë:

përgatitor (pripremač), qumështor (mlekar), rrojtor brijač), shkrinjëtor (topioničar), destilator (destilater), veglator (OP "Rilindja") etj.

Në vend të trajtave të mësipërme tashti dalin trajtat e drejta si: **përgatitës, qumështar, rrojtar, shkrirës, vegëltar** e kështu me radhë.

Lidhur me këtë duhet pasur parasysh edhe një fakt jo me pak rëndësi: Krijimet me prapashtën -TOR nuk e kanë aftësinë fjalëformuse të mëtejshme, siç e kanë ato me -TAR, krahaso: qumësht - qumështore - qumështar - qumështari ose vegël - vëgëltore - vegëltar - vëgëltari. Po në vazhdë të kësaj nuk duhet mënjanuar zëvendësuar plotësisht trajtat me -TAR nga konkurrenca e atyre me -UE/S a Ë/S si p.sh. llogaritar - llogaritës (edhe emër i makinës llogaritëse) apo ndërtimtar - ndërtues etj. duke pasur parasysh emërtimet mbi bazat e trajtës me -TAR si llogaritari, ndërtimtari etj., duke i përqafuar të dy format si të drejta kur emërtojnë veprimtari a nocione të nuancuara.

Me të drejtë është vënë re se prapashtesa -TAR ka zëvendësuar me sukses prapashtesën me origjinë turke -XHI dhe tash mund të konstatohet se të gjitha emërtimet e reja s'kanë nevojë të formohen me -XHI, madje edhe ato të traditës mund të zëvendësohen me -TAR dhe në mënyrë të tjera madje pa e lënduar kuptimin neutral të emërtimeve të tilla, p.sh.

bojaxhi - *bojëtar, ngjyrëtar, ngjyes, ngjyerës, ngjyrues, ngjyrosës, ngjyrës, bojëpunues, bojëbërës, ngjyrëvënës* etj.

kallajxhi - *kallajtar, remtar, kallajpunues, kallajshitës* etj.

sharraxhi - *sharrtar, sharritës, sharrues, sharrës, sharrist* etj.

Nga një vëzhgim më i thelluar në procesin fjalëformues lidhur me prapashtest -AR e -TAR kemi përshtypjen se një çështje e tillë meriton rivlerësim, sidomos kur kemi të bëjmë me parapëlqimin e trajtave drejtshkrimore duke përfshirë këtu edhe trajtat si *këpucar/këpucëtar* e

ndonjë tjetër. Edhe sa i përket rolit fjalëformues të emërtimeve në fjalë, raporti në mes të këtyre prapashtesave duhet rishikuar. Ma merr mendja se më i natyrshëm del përdorimi i emërtimeve me prapashtesën -TAR. Këtu kam parasysh edhe ngjizjen e mundshme të bashkëtingëlloreve t + t tek emrat që mbarojnë me t si p.sh. *kopsht(ë)tar* (kopshtar), *ushtëtar* (ushtar), po ashtu *det(ë)tar* det + tar –**dettar**, e kështu me radhë. Kështu pra, një proces i tillë është fare i mundshëm edhe tek emërtimet e tjera. Këto përmenden vetëm si një mundësi zhvillimi e jo si problem drejtshkrimor (fjalëformues).

Nisur nga kriteret dhe prirjet e sotme fjalëformuese, mendoj se dalin të çoroditura krijimet e mëposhtme që i gjeta në doracakët në fjalë:

formar (former) në vend **formëtar**, **formësues** a **trajtësues**; *kripar* (solar) për **kripëtar**, **kripënxjerrës** a **kripëzues**; *finar* (cedlji) për **finjëtar**, **finjosës** a **finjësuës**; *kallëpar* (kalupar) për **kallëptar** a **kallëpist**, *qelqurinar* (staklar) për **qelqëtar**, **xhamtar**, **xhamprerës** etj.

Kur parapëlqehet trajta me -TAR, aspak nuk nënvlerësohet prapashtesa -AR, e cila pa sishoqen -TAR shërben për emërtimin e banorëve si kosovar, gjakovar, tetovar etj. si dhe për emërtimin e mjeteve si vjetar, ditar, shifrar, formular etj. që është dukuri e gjallë e kohës sonë.

Sa i përket prapashtesës -OR mund të konstatohet se ka përdorim gjithnjë e më të vogël për emërtimet në shqyrtim. Kemi vetëm ndonjë emërtim si drejtor, që është kryqëzim (sipas Xhuvanit e Çabejt) i ndajfoljes drejt- dhe prapashtesës italiane -TORE (direttore), pastaj emërtimet edukator, kontrollor, korrektor, lektor, e ndërkombëtarizma të tjerë, për të cilat vlejnë konstatimet që u dhanë më sipër për emërtimet me prapashtesën -TOR. Edhe kjo prapashtesë (-OR) përdoret shumë për emërtimin e mjeteve e aparateve teknike dhe është shumë prodhimtare e aktive tek formimi i mbiemrave. Po konstatojmë dukurinë, e cila është mjaft e përhapur në gjuhën tonë. Zakonisht emërtime me -OR tregojnë një mjet, aparat teknik, kurse ato me të njëjtën temë e me -UE/S tregojnë emërtim profesioni duke iu shmangur ngatërresave të mundshme homonimike p.sh. zbulor (aparat), zbulues (ai që zbulon) ose kontrollor (pajisje teknike), ndërsa kontrollues (përsoni që kontrollon etj.

Prapashtesa -IST që u shtohet zakonisht emrave të huaj ka përdorim gjithnjë më të madh. Kjo ka filluar të depërtojë edhe te fjalët me origjinë shqipe apo të fondit aktiv të shqipes, si p.sh.: *sharrist*, *kazanist*, *kallëpist*, *skelist* e ndonjë tjetër, por nuk duhet nxituar në këtë drejtim, së pari duhet shfrytëzuar mundësitë a modelet me prapashtesat e ngulitura që më parë në

gjuhën shqipe. Ka raste që kjo prapashtesë t'u shtohet emrave, emërtime profesionale, pa kurrfarë nevoje si p. sh.: burizantist, fotografist, hidraulikist etj.

III. Në kuadër të emërtimeve të përbëra, me kompozim të profesioneve dallohen këta tipa fjalëformues:

a) tema emërore + emër foljor i vepruesit, si p.sh. oxhakfshirës, bravëpunues, zjarrfikës, xhamprerës etj., që në shumë raste zëvendësojnë emërtimet adekuate njëgjymtyrëshe. Emërtimet e tilla përherë nuk janë sinonime të emërtimeve njëgjymtyrëshe, p.sh. mishtar (personi që ka dyqanin, ther apo u shet mishin të tjerëve), mishshitës (personi që vetëm e shet mishin) etj.

b) emërtime me dy a më shumë tema si p.sh. kryepunëtor, kryeinxhinier, kryemakinist, parapunëtor endës, elektromontues, etj. Këtu duhet shqyrtuar përshtatshmëria apo cila është trajtë e më e drejtë si në rastet kryeinxhinier dhe inxhinier kryesor, kryeteknolog e teknolog kryesor etj.

c) emërtime dy- a trigjymtyrëshe me gërshetim profesionale apo me përforsim përcaktimi, si p.sh. kryeinxhinier - teknolog, mekanik - montues, mekanik - axhustator, autoelektricitist - specialist etj.

Edhe sa i përket raportit të emërtimeve me kompozim a perifrastikë dalin mjaft çështje që kërkojnë zgjidhje. Është veçori e stilit teknik që emërtimet perifrastike t'i kthejë në emërtime me kompozim p.sh. mekanik automjetesh - automekanik apo mirëmbajtës objekti - objektmirëmbajtës ose mirëmbajtës rruge - rrugëmirëmbajtës etj., por gjithsesi duhet pasur parasysh që në stilin zyrtar, në vendimet e punëtorëve, diplomat, konkurset etj. emërtimet e tillë duhet të shkruhen të plota e jo me një fjalë si p.sh. mekanik ose mirëmbajtës, pa përcaktimin tjetër të domosdoshëm, i cili në ndërmarrje, përkatësisht në organizatat e punës së bashkuar për nevoja interne mund të mjaftojë për emërtimet e tilla.

Edhe kuptimet logjike të shumë emërtimeve duhen të shqyrtohen, si p. sh. termat: axhustator, qostërues, metalgdhendës, etj. që nuk po përdoren njësoj, madje as në të njëjtën ndërmarrje, shkollë apo nga i njëjti autor.

IV. Lidhur me emërtimet perifrastike të profesioneve nuk do të ndalem shumë, edhe pse ka edhe më shumë çështje madje edhe të natyrës edhe më të nduarnduarta, se ato që u cekën më sipër. Ç'është e vërteta, edhe

ato çështje hyjnë në kuadër të emërtimeve togfjalëshore, pasi secili emërtim fillon apo ka të bëjë me një fjalë a objekt të caktuar e pastaj bëhen formulimet adekuate të nevojshme. Në "Listën alfabetike të profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar" që u përmend në fillim të kumtesës, sipas përqindjes emërtimet togfjalëshore perifrastike marrin pjesë 71.40% në numrin e tërësishëm prej 2500 profesioneve, ato me kompozim 21.80%, me prejardhje (prapashtesore) 6.40% dhe emërtimet fjalë të parme me vetëm 0.16%, prandaj vetvetiu kuptohet se sa del e nevojshme të bëhet shqyrtimi i problemeve të tilla, sidomos kur të krahasohen formulimet me ato të barasvlerësve të gjuhës serbokroate dhe të gjuhëve të tejsira.

Nga vështrimi që u bëra doracakëve në fjalë si dhe ca sistematizimeve të vendeve të punës të organizatave të ndryshme punonjëse më ranë në sy me dhjetra e dhjetra lëshime, për mendimin tim të rënda, që për paraqitjen e tyre nuk do të mjaftonin ndoshta as me dhjetra artikuj.

Nga krejt kjo që u shtrua në këtë kumtesë mund të nxjerrim përfundimin se një çështje të tillë duhet shqyrtuar në mënyrë të organizuar nga gjuhëtarë e specialistë se të degëve të caktuara të të gjitha qendrave shqipfolëse dhe pas një analizë të gjithanshme e pas diskutimit publik të jepen zgjidhjet adekuate, prandaj organet a institucionet kompetente shoqërore si dhe institutet, jo vetëm ai albanologjik duhet të ndërmarrin masa në këtë drejtim.

Një ndihmesë të konsiderueshme mund ta japin lidhur me këtë temë edhe studiuesit e huaj me punime të veçanta ose duke na ofruar material të natyrës së tillë që ne për shkaqe objektive dhe subjektive nuk kemi mundësi t'i kemi në dorë për t'i konsultuar.

Prishtinë, maj 1983.

3. ÇËSHTJE RRETH EMËRTIMIT TË PROFESIONEVE NË SHKOLLAT TONA TË MESME

(kumtesë)

Rreth emërtimit të profesioneve paraqiten probleme, madje të niveleve të ndryshme, jo vetëm ndër ne, por edhe më gjerë si në vend ashtu edhe në botë. Problemet dalin qoftë në raportet e barasvlerësisë ndëgjyhesore në suaza ndërkombëtare, qoftë edhe si probleme brendapërbrenda të së njëjtës gjuhë. Edhe për ne vlejné këto dy segmente që kanë të bëjnë lidhur me gjetjen e barasvlerësve adekuatë me gjuhë të tjera në njërën anë si dhe me harmonizimin e emërtimeve të caktuara si dhe me krijimin e termave të rinj në anën tjetër brenda gjuhës sonë.

Në një informatë të *Tanjug*-ut që u botua në gazetën "*Rilindja*", më 14.I.1987, thuhet se në Jugosllavi konsiderohet se janë nja 10 mijë profesione, si të thuash, aktive, dhe se ato më tepër për nevoja praktike me "Ujdinë e re" në mes të republikave dhe krahinave është dashur të reduktohen a të harmonizohen dhe, ç'është e vërteta, prej 4150 sosh për të cilat është zhvilluar diskutimi kanë arritur të harmizohen vetëm 1982 emërtime profesionesh, kurse për harmonizimin e emërtimeve të tjera vazhdon puna e komisioneve të caktuara të republikave dhe të krahinave. Këtu është fjala për trevën e gjuhës serbokroate, kurse për trevën e gjuhës shqipe ndër ne nuk dimë, ekziston apo jo ndonjë komision i tillë.

Në vazhdim po sjell edhe këto të dhëna që kanë të bëjnë me numrin e emërtimeve në shqyrtim. Në një doracak të Entit Federativ të Statistikës "Abecedni spisak zanimanja" Beograd 1986 /Lista alfabetika e profesioneve/ janë shënuar mbi 21 mijë emërtime profesionesh të profiluara të të gjitha sferave të punës dhe të veprimtarisë, të ndara në 10 grupe, 58 lloje, 227 nënloje dhe 1023 bashkënjësi profesionesh.

Në realitet duke pasur parasysh specifikat e vendeve të punës si dhe dinamikën e proceseve të caktuara tekniko-teknologjike numri i emërtimeve të profesioneve është shumë më i madh, mirëpo për nevoja praktike jetësore e shoqërore kërkohet që emërtimet të jenë më të përkufizuara në mënyrë që

të jenë sa më të kapshme dhe konvecionalisht më të përdorshme. Thjeshtësimin e tillë të emërtimeve e imponon edhe nevoja rreth përgatitjes së kuadrit profesional në shkollat profesionale përkatëse si dhe mënyrat e tjera të arsimit në punën e bashkuar.

Në një doracak zyrtar "Lista alfabetike e profesioneve në AMO", teksti në gjuhën serbokroate në botim të EFS, Beograd 1981 (që është përkthyer edhe në gjuhën shqipe), janë regjistruar 2654 emërtime profesionale të profilizuara të shifruara, emërtime këto me të cilat është duke u ballafaquar edhe shkolla jonë, por sidomos puna e bashkuar.

Lidhur me aktualitetin tonë në Kosovë po cek faktin se prej 560 profesioneve që përfshihen në 37 degë sa kishte para këtij viti (Shih: "Rilindja", dt. 2.III.1987, f. 6) tashti ato, d.m.th. në vitin e ri shkollor 1987/88 u reduktuan, përkatësisht u "integruan" në 25 degë dhe në 296 profesione, prej të cilave 177 d.m.th. shkolla të mesme profesionale trivjeçare e katërvjeçare.

Pasi që koha dhe natyra e këshillimit nuk lejon për një analizë me të gjerë për gjëra të ndryshme lidhur me shkollimin e mesëm të ne, unë këtu do të paraqit vetëm disa vërejtje rreth emërtimeve të profesioneve, konkretisht në mbështetje të dokumentit zyrtar që është: "Konkursi për regjistrimin e nxënësve në kl. I dhe III të AMO të KSA të Kosovës për vitin shkollor 1987/88", të botuar në gazetat: "Rilindja" dhe "Jedinstvo" në maj të këtij viti, në të dy versionet shqip e serbokroatisht.

Për të dyja versionet së bashku e veç e veç po japim disa vërejtje së pari të përgjithshme dhe pastaj të veçanta:

a) Vërejtje të përgjithshme

Si vërejtje të përgjithshme mund të jepen këto:

E para, bie në sy fakti se emërtimet e profesioneve nuk janë shënuar të gjitha në trajtat e plota, gjë që në të ardhshmen nuk duhet vepruar kështu. Dihet, për shumë arsye që trajtat e emërtimeve, sidomos në stilin zyrtar: në dokumente, në diploma, por edhe në konkurse duhet të jenë të shënuara patjetër në përbërje të plotë.

E dyta, gabimet e shtypit si dhe gabimet e tjera gjuhësore e drejtshkrimore janë të shumta në të dy versionet, por sidomos në versionin në gjuhën shqipe. Sa për ilustrim po shënoj disa shembuj që gjithsesi është dashur të korrigjohen, sepse kështu si janë sjellin tek opinioni ngatërresa

drejtshkrimore apo edhe kuptimore. P.sh.: prodhues i pyjeve në vend: **prodhues i pijeve**; kuzhiner në vend **kuzhinier**; farkatar në vend **farkëtar**; tapisier në vend **tapicier**; saldator gasi në vend **saldues me gaz**; teknik dizajni (...) në vend **teknik disenji** a **disenjator**; elektroiinstalues në vend **elektroiinstalues**, metalmbrehës në vend **metalmprehës** etj, pastaj metaloglodar në vend **metaloglođač**, armirač-betonlivac në vend armirač-betonirac, pasi që nuk është fjala për betonderdhës (betonlivac), por për emërtimin e profesionit të betonuesit etj.

Gjithsesi gabimet të përmirësohen menjëherë dhe në të ardhmen duhet pasur kujdes që mos të përsëriten si dhe harmonizimi ndërghjuhësor duhet të jetë më i përkujdesshëm.

E treta, kemi raste kur barasvlerësia nuk përputhet në të dyja gjuhët si dhe raste kur ka nevojë për përcaktim më të hollësishëm dhe të saktë të profesionit. Ja disa shembuj:

- Në një QAMO (Mitrovicë) lexojmë: përpunues i metaleve me ngjyrë për "obradjivač plementih metala në vend "obradjivač obojenih metala", sepse togfjalëshi **plementiti metali** në shqipe ka barasvlerësin **metalet fisnike**. Këtu është fjala për dy profesione të ndryshme të profiluara.

- Në QAMO të Malishevës në versionin shqip kemi emërtimin "blegtor, teknik blegtor", kurse në versionin serbokroatisht del barasvlerësi "pčelar, pčelarski tehničar". Sigurisht vetëm njëri emërtim është i drejtë kur dihet së "pčelar, pčelarski tehničar" në shqipe do të thotë **bletar, teknik i bletarisë**, kurse blegtor (blegtar), teknik i bletarisë në serbokroatoshte do të thotë "stočar, stočarski tehničar.

- Në njërën nga QAMO-t e Mitrovicës ngatërrohet barasvlerësia e emërtimeve axhustator- montues" e tornitor, për metaloglođač e mašinbravar të serbokroartishtes, ngase aty nuk është identifikuar sinonimia e emërtimeve tornitor e metalgdhendës, fakt ky që do të sqarohet më poshtë në këtë kumtesë si pikë të veçantë.

- Po e cek edhe dukurinë e pranishme, kur në vend që të shënohet profesioni i degës së caktuar, shënohet vetë dega apo drejtimi si p.sh. "orientimi pedagogjik" në serbokroatishte "pedagoško usmerenje" ose "pedagoški odsek" ose edhe vetëm pedagog. Sigurisht më drejt do ishte po të shënohej profesioni: mësues - učitelj ose edukator - vaspitač, emërtime këto që i përgjigjen drejtimit pedagogjik.

b) Vërejtje të veçanta

Në vazhdim do të paraqit edhe një sërë vërejtjesh të veçanta, shumica e të cilave janë të natyrës së diskutueshme, qoftë nga aspekti fjalëformues, qoftë edhe nga aspekti i paraqitjes së vërtetësisë objektive të realitetit gjuhësor.

1. Në disa shkolla (Vuçitern, Dragash etj.) është dhënë emërtimi teknik i veterinës (veterniraski tehničar) në vend **teknik i veterinarisë**, pasi që fjalën veterinar i kemi të regjistruar në FGJSSH. Madje del e diskutueshme edhe trajta veterinar përkrah trajtës veteriner, që të dyja në gjuhën shqipe.

2. Po ashtu në disa QAMO (Pejë, Deçan etj.) ndeshim një emërtim të ri të diskutueshëm. Fjala është për emërtimin "inokorrespondent bashkëpunëtor" (inokorespondent saradnik). Në të vërtetë, këtu del i diskutueshëm prefiksoidi (siparashtesa) **ino-**, leksemë kjo që nuk është ndërkombëtarizëm, por është shkurtesë e fjalës serbokroate **inostrano** (i huaj, i jashtëm), prandaj shqip më drejt do të ishte: **korrespondent i jashtëm** a korrespondent i gjuhës së huaj, apo i veprimtarisë së caktuar, madje në konkurs është e nevojshme të ceket se për cilën gjuhë të huaj apo veprimtari është fjala.

3. Në QAMO-n e Deçanit për metalobrusaç të serbokroatishtes në shqipe kemi përgjegjësin frezator e që në të vërtetë për frezator në serbokroatishte del barasvlerësi glodač ose frezač. Ndërkaq në gjuhën shqipe për **metalobrusaç** kemi barasvlerësin **metalgrihës** (qostërues ose retifikues a retifikator). Gjithashtu tërhiqet vërejtja që për metalobrusaç nuk qëndron as përgjegjësi metalmprehës, siç është në QAMO-n e Leposaviqit, sepse fjala **mprehës**, si term ka barasvlerësi me të plotë me fjalën **oštrač** të serbokroatishtes (Krahaso emërtimet: oštrač alata - mprehës i veglave, oštrač noževa - mprehës i thikave etj.).

4. Në një shkollë të Gjilanit si barasvlerës i emërtimit **metalostrugar** të serbokroatishtes në shqipe është shënuar neologjizmi metalgrryes, i cili gjithsesi nuk qëndron, pasi që tashmë e kemi mjaft të stabilizuar emërtimin **tornitor** a **metaltornues**.

Është i paqëndrueshëm për këtë koncept gjithashtu edhe emërtimi "**metagdhendës**" që haset në disa shkolla të tjera (Leposaviq, Mitrovicë, Rahovec), pasi që siç u tha më sipër ne e kemi të pranuar që me kohë trajtën **tornitor** a **metaltornues**.

5. Tërhiqet vërejtje edhe rreth barasvlerësit **autolimar** të serbokroatishtes që në një shkollë të Mitrovicës (por edhe gjetiu) doli në trajtën autollamarist. Në gjuhën tonë është reflektuar trajta autollamarinist (krahaso: lim - llamarinë), madje termi **llamarinist** është më i parapëlqyer për këtë rast sesa trajta fjalë e përbërë: teneqepunues.

6. Në vazhdim do të bëj pak fjalë edhe rreth barasvlerësisë së një pjese përcaktuese të emërimit perifrastik a togfjalësh, siç janë emërtimet me termin **pogon**, si:

- 1) **pogonski nehaničar**,
- 2) **pogonski elektromehaničar**,
- 3) **pogonski elektrotehničar** etj.

që ndër ne zakonisht janë "përkthyer" keq : mekanik reparti (a i repartit), elektromekanim reparti, elektroteknik reparti.

Këtu, në të vërtetë, kontestohet përgjegjësi i mbiemrit "pogonski", i cili nuk përkon me fjalën shqipe "reparti" a "i repartit", për nga ana e barasvlerësisë kuptimore lesikore.

Në gjuhën serbokroate ekziston kundërvënia e dallimi i qartë në mes të termave **pogonske mašine** (**makina me ngasje elektrike** a makina propulsore - motorët) dhe **radne mašine** ose mašine radilice (**makina pune**) (Shih edhe te Mala enciklopedija, Prosveta, Beograd 1958).

Ekspertët i dallojnë qartë makinat e tilla e natyrisht edhe emërtimet e profesioneve që lidhen me to.

Është interesant se në tekstin e "Konkursit" në shqyrtim shihet se nga trajtat në gjuhën shqipe janë modifikuar a ndikuar edhe trajtat në gjuhën serbokroate si p.sh. elektromehaničar pogona (Krahaso" elektroteknik reparti(!) etj. gjë që në asnjërin nga doracakët zyrtarë të serbokroatishtes nuk haset ashtu, por vetëm në trajtën pogonski... (**pogonski elektromehaničar**) që në shqipe duhet të kuptohet se ka të bëjë me "ngasje a me rendtim" e jo me rapart, si emërtim vendi. Në shqipe baravlerësit e tillë mund të jenë:

- 1) **mekanik i makinave propulsore** ose i makinave me ngasje elektrike, *jo mekanik reparti(!)*
- 2) **elektromekanik i propulsorave** *jo elektromekanik reparti(!)*,
- 3) **elektroteknik i propulsorave** *jo elektroteknik reparti(!)*

Kjo çështje lypset rishikuar urgjentisht, përkatësisht duhet shqyrtuar edhe më në hollësi, vetëm se një gjë vlen të dihet: fjala repart vetëm te ne, jo

edhe në Shqipëri) për këtë koncept ka pësuar zgjerim të tillë kuptimor, të cilin nuk e ka as në italishte (*riparto*) prej nga është importuar në gjuhën tonë (!).

7. Ka njëfarë ngjashmërie me dukurinë e sipërcekur edhe shpifja e fjalës **stabiliment** ndër ne që del si barasvlerës e fjalë-termit **uredjaj** e ndonjëherë edhe *postrojenje* të serbokroatishtes që del gjithashtu si fjalë përcaktuese në emërtimin perifrastik. P.sh. elektrotehničar medicinskih uredjaja - elektrotehnik i stabilimenteve(!) medicinale në vend: elektrotehnik i pajisjeve në mjekësi (a i pajisjeve medicinale); elektromonter mreža i postrojenja za (...) elektromontues i rrjetit dhe stabilimenteve (!) për)... në vend: **elektromontues i rrjetit dhe intalimeve për** (...).

Pra si barasvlerës i termit **uredjaj** sipas shembullit të mësipërm, në shqipe del më mirë termi **pajisje**, kurse për **postrojenje** del emërtimi **instalim**.

Edhe zgjerimi i kuptimit (përdorimit) të fjalës stabiliment për konceptin e sipërcekur është veçori vetëm e shqipes ndër ne(!?).

8. Në mënyrë të veçantë vlen të aktualizohet çështja e barasvlerësisë së termave **bravar** dhe **mašinbravar** të serbokroatishtes në gjuhën shqipe, pra, jo vetëm ndër ne. Sidoqoftë, ç'është e vërteta, në disa shkolla (Viti, Rahovec, Vuçitërn, Podujevë etj) për *bravar* në shqipe është dhënë përgjegjësi *axhustator*, ndërsa në tri QAMO (Lipjan, Klinë e Prishtinë) ashtu siç është në disa fjalorë e burime të tjera të botuara te ne, emërtimi **axhustator** përdoret si barasvlerës për termin **mašinbravar** të serbokroatishtes. Edhe në Konkursin për regjistrimin e studentëve të rinj për vitin shkollor 1987/88 në Qendrën për shkollimin e lartë në Ferizaj, ku përgatiten kuadro me **kualifikim të lartë** profesional të degës së metalpërpunimit hasim trajtën **axhustator** me barasvlerësi të plotë me fjalën **mašinbravar** (*sa vishom spremom*) të serbokroatishtes.

Lidhur me përdorimin e fjalës **axhustator** në gjuhën shqipe del çështja mjaft e ndërlikuar. Ç'është e vërteta, edhe në gjuhën serbokroate, ashtu si edhe në disa gjuhë të tjera, është reflektuar emërtimi i profesionit në trajtën **adjuster, adjustater a adjustator** që është fjalë e të njëjtin burim dhe pothuajse e të njëjtit kuptim që e ka fjala **axhustator** a **axhustues** zyrtarisht e shqipe, e cila në shqipe ka hyrë nga italishtja.

Me të vërtetë, shtrohet çështja sa mund të qëndrojë në gjuhën shqipe (te ne) fjala **axhustator** për të tre termat: **adjuster** (axhustator), **bravar** dhe **mašinbravar** të serbokroatishtes? Si quhen barasvlerësit përkatës në gjuhë të tjera që mbulojnë konceptet përkatëse ? Dalin edhe pyetje të tjera që

kërkojnë shpjegim. Pikërisht për këtë temë kam shkruar një punim të veçantë mjaft të hollësishëm.

Këtu po shtoj edhe këtë të dhënë se në gjuhën serbokroate me fjalë-termin **adjuster** (axhustator) dalin të shënuar 6 emërtime profesionale të profilizuara, me fjalë-termin **bravar** 120 emërtime të profilizuara, kurse më fjalën **mašinbravar** afro 50 emërtime perifrastike të profilizuara dhe që të gjitha këto (për të tre fjalë-termat e cekur) për nevoja statistikore, dalin të shifruara ndryshe–ndryshe që do të thotë se janë përgjithësisht në përdorim e sipër si profesione të veçanta.

Domosdo del e nevojshme që edhe ndër ne të bëhen diferencimet e nevojshme të emërtimeve në fjalë, ashtu siç janë bërë edhe në gjuhë të tjera. Po theksoj faktin se ekzistojnë planprograme të posaçme për punët dhe detyrat e profesioneve të caktuara të sipërcekura.

Një mungesë e tillë diferencimi është parë e hetuar, sidomos në punën e bashkuar e në shkolla, ngase punët dhe detyrat e kryerësve me profesionet e tilla përkatëse dallohen madje edhe ndryshe paguhen. Së këtejmi titulli:

- **adjuster** (axhustator) mund të merret me një kurs të kryer,
- **bravar** me 3 vjet shkollë të rregullt, ndërsa
- **mašinbravar** me 4 vjet shkollë të rregullt.

Në realitetin tonë gjuhësor tashmë për bravar dhe mašinbravar janë "farkëtuar" disa trajta emërtimeve sinonimike. Po e cek zgjidhjen që është dhënë në gazetën "Shkëndija" nr. 5/87, ku për bravar është dhënë përgjegjësi **mekanik axhustimi**, kurse për mašinbravar **mekanik i makinave** (axhustator i makinave). Gjithsesi rreth kësaj çështjeje të diskutueshme lypset marrë qëndrim.

9. Edhe pse në njërin shkollë ndeshim emërtimin në trajtën *vodointalater* e në trajtën *instalater vodovoda* në versionin shqip është reflektuar barasvlerësi **instalues uji** në vend **instalues ujësjellësi**, edhe pse duhet se uji nuk instalohet.

Në shqipe për vodointalater kemi edhe emërtimin **hidraulik** me kuptimin **instalues ujësjellësi**.

10. Në gjuhën serbokroate dalin disa emërtime në lëmin e punimit a të përpunimit të lëndës së parë si p.sh.: *obradjivač* (...), *preradjivač* (...), *izradjivač* ..., *doradjivač* (...) dhe pothuajse të gjithë këto fjalë-terma në shqipe po përkthehen me fjalën *përpunues* (i ...), edhe pse në bazë të kontekstit edhe në shqipe mund të dalin a duhet të dalin edhe trajta të tjera si p. sh. *punues*, *ripunues*, *përkryerës* e ndonjë tjetër. P.sh.:

- obradjiuač plementih metala - përpunues i metaleve fisnike;
- preradjiuač kože i krzna - përpunues (a punues) i lëkurës dhe i peliqeve (lëkurjeve);
- izradjiuač rukavica - punues i dorezave;
- doradjiuač grafičkih proizvodova - përkryerës i prodhimeve të grafikës etj.

Gjithsesi rreth kësaj dukurie lypset hulumtuare gjetur "shtegdalje" sa më të mbështetura.

11. Për të gjitha emërtimet e profesioneve nga ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore konstatojmë se nuk kemi një dorë fjalëformimi, prandaj edhe në dokumentin në fjalë hasim trajta të ndryshme d.m.th. pa formant prapashtesor të përcaktuar: *qeramist e qeramikist* për keramiçar, *plasticist plastik* për plastiçar etj.

Gjithsesi kjo mbetet çështje e hapur. Unë në një punim kam shprehur mendimi se mbase zgjidhja më e mirë do të ishte që për këtë nëntip emërtimeve të përdoret prapashtesa -AN, mbi bazë të emrit përkatës të prodhuesit si p.sh.

statistikan, qeramikan, plastikan sikurse matematikan, fizikan etj.

Sidoqoftë, kjo çështje duhet të shqyrtohet dhe të gjejë zgjidhje si duhet urgjentisht.

12. Në një QAMO të Pejës del emërtimi në trajtën armirues - betonier (armiraç-betonirac). Në këtë gërshetim profesioni nuk del aq kontestuese trajta **betonirac / betonier**, e cila në shqipe zakonisht është stabilizuar në trajtën **betonues**, por e diskutueshme dhe e pambështetur del trajta **armirues**, ngase është formuar mbi bazë të foljes armiroj, e cila nuk qëndron në shqipe për shkak të infiksit -IR. Ç'është e vërteta foljet e sllavishtes (rusisht e serbisht), infiksin -IR e kanë marrë nga trajta e gjuhës gjermane -IER. Në shqipe trajta e drejtë mbi temën **arm** (armaturë) del **armoj**, përkatësisht prejppjesori **armues**. Prandaj emërtimi në fjalë duhet të dalë në trajtën: **armues-betonues**.

13. Në një QAMO të Prizrenit doli emërtimi *ëmbëltorist(!)*. Kontestuese del këtë rast prapashtesa shtuese pa nevojë -IST. Trajta e drejtë e konceptit të tillë është: **ëmbëltar**, pa e përjashtuar edhe mundësinë e kompozitës për profilizime të caktuara si: *ëmbëlsiragatues, ëmbëlsirabërës, ëmbëlsirashitës* etj.

14. Në një shkollë të Ferizajt për *nanosilac zastitnih prevlaka* në shqipe doli barasvlerësi *bartës i shtresave mbrojtëse* që mbase më drejtë do

të ishte **vënës i këllëfave mbrojtës**. Sidoqoftë, në parim emërtimi i përdorur prej nesh del më i pranuar, ngase është farkëtuar në mbështetje të logjikës që del nga procesi teknologjik që kryhet.

15. Në shkollat e mesme të mjekësisë në serbokroatishte dalin emërtimet: *medicinska sestra* - tehnicar, me drejtimet: pediatrik, akusherik, stomatologjik etj. Në shqipe te ne emërtimi i parë *medicinska sestra* është kalkëzuar në : *motër medicinale* ose *motër mjekësore*, duke cekur edhe profilimin e ngushtë.

Kontestuese del se në vend të togfjalëshit **motër medicinale** shpesh përdoret emërtimi i njohur **infermiere** plus profilimi përkatës, përkatësisht po përdoret termi i përgjithshëm që përdoret për nxënësit e gjinisë mashkullore **teknik i mjekësisë**, për femra **teknike e mjekësisë**. Duhet sqaruar edhe emërtimin **akusherik**, i cili përdoret në serbishte nën ndikimin e frengjishtes, ndërsa në shqipe kjo fjalë del sipas formës italiane **obstetrik**.

Sidoqoftë, edhe kjo çështje mbetet e hapur në kuadër të harmonizimit të emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe.

16. Në një shkollë të Prizrenit për termin **magaciner** të serbokroatishtes doli barasvlerësi **deponues**(!). S'do mend se barasvlerësi i tillë nuk ka kurrfarë kuptimi, ngase, siç dihet në shqipe barasvlerës për termin e cekur të serbokroatishtes del emërtimi **magazinier** ose **depoist**.

17. Në disa shkolla për emërtimin **konfeksinar** të serbokroatishtes në shqipe kanë dalë trajtat *konfeksioner* e *konfeksinar*, të cilat nuk qëndrojnë. Në shqipe për këtë nëntip profesioni më tepër se prapashtesat -ER e -AR parapëlqehet prapashtesa -IST. Pra si trajtë më e drejtë mund të quhet trajta **konfeksionist**.

18. Në disa shkolla (Deçan, Klinë), në serbishte del emërtimi **knjigovodstveni tehnicar** e në disa të tjera (Kaçanik, Gjakovë, Pejë, Suharekë) del emërtimi **računovodstveni tehnicar**. Për të dyja këto emërtime në versionin shqip jepet barasvlerësi **teknik i kontabilitetit**. Kur kemi parasysh faktin se me **knjigovodja** kuptohet **kontabilisti**, ndërsa me **računovodja llogaritari**, atëherë për barasvlerësin **racunovodtveni tehnicar** në shqipe mund të dalë më drejtë termi barasvlerës: **teknik i llogaritjes** a **i llogaritarisë**.

* * *

Për të gjitha këto që u thanë më sipër si dhe për disa gjëra të tjera që nuk u cekën këtu ka vend për diskutim, po ne po mbyllim këto vërejtje të

veçanta duke shprehur keqardhje se si kanë mundur të "përbirohen" kaq shumë lëshime a gjëra të diskutueshme në "Konkursin" në fjalë, kur dihet fakti se materiali në shqyrtim është përgatitur nga organet zyrtare e profesionale të shkollave përkatëse, pastaj ka kaluar edhe nëpër duart e personave të autorizuar (shqipnjohës) të Bashkësisë Krahinore të Arsimit etj., madje edhe nëpër fltrin e personave të caktuar të gazetës "Rilindja" dhe të asaj "Jedinstvo" dhe se nga askush nuk është tërhequr vërejtje rreth këtyre lëshimeve, së paku atyre drejtshkrimore që janë aq të nëpërdukshme ?!

Do të ishim fatlum që lëshimet, të cilat u vunë në shënjestër këtu të jenë rast i vetmuar në realitetin tonë gjuhësor, por mjerisht gjendja nuk është aspak lavdëruese as premtuese. Madje as që duken shenja që të përmirësohen, përkundrazi ka shenja që gjendja mund të keqësohet edhe më. Kjo ndodh edhe për arsye se, me sa duket, emërtimi i profesioneve sidomos në gjuhën shqipe lihet nën mëshirën e kuadrove gjuhësisht e profesonisht jokompetentë. Lihen në dorë të ndonjë kujdestari të klasës, arsimtari të lëndës apo të ndonjë përkthyesi a referenti të papërvojë, pa parapërgatje gjuhësore e profesionale për punë të tilla me përgjegjësi.

Duke parë çështjen e tillë në gjendje alarmante kërkojmë me ngulm që çështja e emërtimit të profesioneve të merret në dorë nga organet kompetente të të gjitha niveleve dhe të zgjidhet nën patronazhin e organeve përkatëse me seriozitetin e duhur.

Propozojmë që Shoqata e gjuhësisë zbatimore e KSA e Kosovës të marrë nismën që në bashkëpunim me BVI-në Krahinore për Arsim dhe Edukim të organizojë një këshillim shkencor vetëm me këtë pike shqyrtimi: **"Çështja e emërtimit të profesioneve në shkollat tona"** dhe për këtë këshillim të ftohen ekspertët e profesionistët e gjuhës dhe të shkencës, të teknikës e të teknologjisë si nga nga OPB ashtu edhe nga shkollat, fakultetet e institutet përkatëse Kështuqë, së paku njëherë mirë e mbarë të analizohen çështjet e grumbulluara në këtë nënfushë, të bëhet harmonizimi i emërtimeve ku ka mundësi dhe të jepen edhe propozimet kompetente lidhur me zgjidhjen a farkëtimin e emërtimeve të reja.

Është e domosdoshme që pas një analize të materialit përkatës nga komisioni i autorizuar të hartohet fjalori i emërtimeve të profesioneve për të gjitha 11 shkallët e kualifikimeve që egzistojnë ndër ne (Jugosllavi) dhe të jepen në diskutim publik dhe pas miratimit të kërkohet që zbatimi të jetë sa më rigoroz.

Sigurisht duke i harmonizuar emërtimet eksistuese dhe duke i propozuar dhe zbatuar emërtimet e reja në mbështetje të ligjësive drejtshkrimore e drejtfjalëformuese dhe në përputhje me praktikën e tillë si brenda si jashtë vendit ne do të japim ndihmesën që emërtimet e qëndrueshme të gjejnë shtrirje në mbarë truallin e gjuhës përkatëse apo së paku do të konkurrojnë në mënyrë kompetente për njësimin, harmonizimin dhe konsolidimin e terminologjisë unike teknike shqipe dhe në këtë nënfushë të leksikografisë si janë emërtimet e njerëzve sipas profesionit.

P ë r f u n d i m

Pas disa të dhënave statistikore rreth numrit të profesioneve në kuadër të Jugosllavisë dhe në veçanti në shkollat e mesme të Kosovës u mor në shqyrtim qëndrueshmëria e disa emërtimeve të publikuara në "Konkursin për regjistrimin e nxënësve të klasës I dhe III të AMO të Kosovës në vitin shkollor 1987/88", të botuar në muajin maj (1987) në dy versione në shqip në gazetën "Rilindja" dhe në serbokroarisht në gazetën "Jedinstvo" të Prishtinës.

Lidhur me tekstet e caktuara janë dhënë vërejtje të përgjithshme dhe vërejtje të veçanta.

a) Vërejtjet e përgjithshme mund të përmbliidhen në këto tri pika:

E para, tërhiqet vërejtje që emërtimet duhet të shënohen në përbërje të plotë, jo me shkurtime, ngase emërtimet zyrtare gjithnjë duhet praktikuar të shënohen në përbërje të plotë.

E dyta, cekën disa gabime të rënda shtypi si dhe lëshimet me pasoja të natyrës drejtshkrimore, sidomos në gjuhën shqipe.

E treta, cekën raste kur përkthimi nuk është bërë si duhet ngase kuptimisht, sipas fushave polisemntike që mbulojnë, nuk përputhen barasvlerësit e emërtimeve të caktuara në gjuhët përkatëse.

b) Vërejtjet e veçanta u përmlodhën në 18 pika, duke dhënë mendimin për raste konkrete se si duhet vepruar në mënyrë që lëshimet e caktuara terminologjike të përmirësohen dhe mos të përsëriten më.

Në mënyrë që të mos ndodhin në të ardhmen lëshime të tilla që disa prej tyre konsiderohen tejet të rënda propozohet që Shoqata e gjuhësisë zbatimore të Kosovës të marrë nismën dhe në bashkëpunim me Bashkësinë

Krahinore të për Arsim e Edukim të organizojë një këshillim shkencor kushtuar nergut çështjes së emërimit të profesioneve në shkollat tona të mesme, me qëllim që së paku nga pikëpamja terminologjike të gjinden zgjidhjet e drejta dhe të gjithësi të bëhet harmonizimi i tyre, jo vetëm brenda shkollave shqipe të Kosovës, të Maqedonisë etj., por edhe në plan më të gjerë.

Për një veprim të tillë me interes shoqëror e shkencor sa më parë duhet të angazhohen kuadrot përkatëse të të gjitha profileve, duke përfshirë edhe organet e organsizmat shtetëroë dhe kjo të bëhet sidomos para se të fillojnë të lëshohen diplomat.

Prishtinë, 22 nëntor 1987

4) MË DREJT KRYERËS I PUNËVE SESA EKZEKUTUES

Në gazetën "Bujku", më 15. IX. 1994, f. 11, u publikua një konkurs me të cilin kërkohet plotësimi i këtyre punëve e detyrave:

1. shitës mobiliesh -katër **ekzekutues(!)**;
2. montues - shërbyes - dy **ekzekutues(!)**" dhe
3. kontabilist i kontabilitetit material - një **ekzekutues(!)**".

Nga ky fragment-teksti gjejmë mjaft shkas për të veçuar dhe diskutuar përshtatshmërinë semantike të fjalë-termi: **ekzekutues** (që unë i vura pikëçuditjen), ngase është përdorur për aso koncepti, për të cilin nuk njihet në gjuhën tonë letrare. Për të vërtetuar këtë mjafton të konsultohet kuptimi leksikor që ka, në shqipen e sotme letrare, folja **ekzekutoj**, prej kah ka dalë edhe prejpjesori: *ekzekutues*. Sipas fjalorit tonë normativ shpjegues folja **ekzekutoj** përdoret për këto nënfusha semantike a stile funksionale:

1. libr. zbattoj, përmbush, vë në jetë diçka (një ligj, një vendim, një urdhër etj.);
2. drejt. zbattoj dënimin me vdekje të dikujt, pushkatoj, var etj. një të dënuar;
3. muz. luaj, interpretoj një vepër muzikore;
4. sp. ekzekutoj një ushtrim gjimnastikor".

Ndërsa vetë emri ekzekutues, sipas këtij burimi, del i zhvilluar vetëm për dy kuptimet e para:

1. "ai që zbaton, përmbush a vë në jetë diçka (një ligj, një vendim, një urdhër, një marrëveshje etj." dhe
2. "ai që merr pjesë drejtpërdrejt në një vepër penale" (Shih: FGJSSH f. 422).

Pra siç del nga konteksti fjala **ekzekutues** e përdorur te shembujt nga konkursi nuk ka të bëjë fare me asnjërin nga konceptet për të cilat del e

ngarkuar folja **ekzekutoj**, përkatësisht emri **ekzekutues**, por kemi të bëjmë me një koncept të një natyre krejt tjetër.

Prandaj lidhur me këtë me të drejtë, shtrohen për trajtim, këto dy çështje:

e para, si dhe pse u përftua te ne dukuria e tillë dhe e dyta, a ka barasvlerës tjetër më të përshtatshëm për të shprehur konceptin në fjalë?

Në vazhdim do të përiqem të jap përgjigje në të dyja këto pyetje: Së pari, s' do mend se mënyra e tillë e të shprehurit, përkatësisht togfjalëshi i tipit: numri (i të kërkuarve për punësim) + (emërtimi plotësues) **ekzekutues**, është përftuar te ne nën ndikimin e drejtpërdrejtë të barasvlerësit përkatës të serbishtes: numër + (emërtimi) **izvršilac** d.m. th., fjala ekzekutues është përdorur si barasvlerës i përgjegjës *izvršilac* të serbishtes, barasvlerësi kjo e cila, edhe pse si e tillë del e shënuar në të gjitha burimet normative leksikografiker shqip - serbokroatisht e anasjelltas të botuara te ne, nuk qëndron plotësisht. Për të kuptuar më me lehtësi se si qëndron, qoftë përkimi, qoftë ndryshimi në mes të këtyre dy fjalë-termave: **izvršilac/ekzekutues**, po jap edhe përkufizimin e fjalës **izvršilac** të serbishtes. Sipas fjalorit përkatës të asaj gjuhe me fjalën **izvršilac** kuptohet:

"onaj koji što izvršuje, onaj koji sprovodi, izvršava kakav postupak, kakvu odluku nadležnog organa" - që do të thotë: "ai që kryen (bën) dëkda, ai që vë në jetë, që zbaton ndonjë veprim (procedurë), ndonjë vendim të organit kompetent". (Shih: RSHKJ 2 f. 377.)

Siç po shihet në serbishte me fjalën **izvršilac** parësisht kuptohet ai që kryen një punë, një veprim (procedurë), si të thuash, në proces e sipër, pa e përjashtuar edhe kuptimin që lidhet me zbatimin e një vendimi etj., ndërsa në shqipe me fjalën **ekzekutues** kryekëput kuptohet vetëm ai që zbaton një vendim a akt nënligjor gjithsesi të parapërgatitur, koncept ky që përkon vetëm me pjesën e dytë të përkufizimit që u dha për fjalën **izvršilac**. Po shtoj edhe këtë se edhe në serbishte po për konceptin e pjesës së dytë të përkufizimit, si sinonim i fjalës *izvršilac* (*izvršitelj*) përdoret ndërkom-bëtarizma: *egzekutor* (shq. ekzekutor, ekzekutues) (Shih: RSHKJ 1 f. 831). Pra dallimi në raportin *ekzekutues/izvršilac* del mjaft i madh sa i përket nënfushës semantike. Me një fjalë, në shqipe me termin **ekzekutues** nënkuptohet nocioni që ka të bëjë me zbatimin e një akti nënligjor si ligj, vendim, urdhër, marrëveshje etj., ndërsa me atë *izvršilac*, edhe pse

përfshihet edhe kuptimi i sapocekur, në radhë të parë kuptohet të ushtruarit a të kryerët e një pune a të një veprimi në proces e sipër, siç janë b.f. edhe punët dhe detyrat të cilat lypset kryer në bazë të konkursit të shpallur, siç janë emërtuar ato konkretisht në shembullin e shënuar prej meje në fillim të këtij artikulli. Pra këtu qëndron arsyeja pse del e diskutueshme qëndrueshmëria e fjalë-termit *ekzekutues* për konceptin e zënë ngoje më sipër.

Së dyti, bëhet me dije opinioni apo më mirë me thënë, rikujtoj lexuesit e të interesuarit se me dukurinë e sipërcekur ne kemi qenë të ballafaquar më herët, qysh në periudhën e viteve '70 e më përpara, kur te ne u bënë përpjekje joformale për zbatimin sa më me konsekuencë të administratës dygjuhësore në të gjitha fushat e jetës, porse kjo çështje më tepër doli e theksuar lidhur me a pas miratimit të të ashtuquajturit "Ligj për punën e bashkuar". Sipas këtij ligji termi "*vendi i punës*" në shumë dispozita del identik ose zëvendësohet me emërtimin tashti më të favorizuar "*grupi i punëve*", përkatësisht "*punët dhe detyrat*" e si rrjedhojë doli edhe emërtimi togfjalësh në serbishte "**izvršilac poslova i radnih zadataka**" (Shih: Pravna enciklopedija, Beograd 1985, f. 1373). Kur është çështja te përkthimi i emërtimit **izvršilac**, përkatësisht **izvršilac poslova i radnih zadataka**, njohësit e mirë të gjuhës shqipe nuk u mjaftuan me trajtat ekuivalente që ofroheshin nga fjalorët përkatës si p.sh. *ekzekutues, zbatues, përmbartues, ushtrues* e ndonjë tjetër, por kërkuan zgjidhje më të mirë. Në këtë përpëlitse, si të thuash, nga procesi i punës, doli edhe emërtimi **kryerës** (kryes) **i punëve dhe detyrave**, si barasvlerësi më i përshtatshëm. Dhe vërtet, vula e përgjigjes iu dha termit **kryerës** nga vetë folja **kryej**, ngase njëri nga kuptimet kryesore të kësaj fjale del e përkufizuar kështu: "**kryej - bëj një punë a një detyrë që më është ngarkuar**" (Shih: FGJSSH f. 894). Kështu pra emërtimi **kryerës**, përkatësisht i termit togfjalësh: **kryerës i punëve dhe detyrave** si barasvlerës i fjalës **izvršilac**, përkatësisht termit: **izvršilac poslova i radnih zadataka**, edhe pse nuk arriti të regjistrohet në burimet leksikografike të kohës, për konceptin në shqyrtim, për arsye jo të panjohura për opinionin tonë, mund të themi se implicitivisht e pati të fituar konkurrencën kundrejt barasvlerësve të tjerë sinonimikë, të cilët vërtet ishin të zënë pakashumë për koncepte të tjera (Shih: "Fjala, 15. IV. 1987 f. 17.), fakt ky që duhet të kihet në konsideratë jo vetëm sot për sot, por edhe në të ardhmen.

Kur kemi parasysh faktin se sistemet shoqërore - politike ndërrohen, ndryshojnë, ndërsa gjuha, njerëzit mbesin, mendoj se trajta **kryerës** duhet të

vazhdojë të përdoret në mbarë truallin shqipfolës duke e zënë vendin e merituar në fondin aktiv të fjalësit të shqipes sonë standarde kombëtare. Emërtimi i tillë mbase mund të hyjë në punë, sidomos tashti, kur edhe në Shqipëri ka filluar të aktualizohet institucioni i konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës, edhe pse shpalljet mund të formulohen edhe në versionin tjetër d.m.th. pa e cekur skemën e tipit: numër + kryerës, por drejtpërdrejt: numër + emërtimi i profilit të ngushtë të profesionit, i cili përkon plotësisht me emërtimin përkatës të njeriut sipas profesionit të profiluar.

5. RRETH PAQËNDRUESHMËRISË SË FORMANTIT -CIENT NË SHQIPE

Kemi pasur raste të dëgjojmë, madje edhe të lexojmë në shtyp që ndonjë emërtim i ushtruesit të veprimtarisë lidhur me ndërkombëtarizmat e caktuar me -IK(Ë) fundore të tipit **matematikë, fizikë, praktikë** etj. të dalë me formantin apo trajtën -CIENT fundore si:

matematicient ("Rilindja", 7. IV. 1985, f. 12; 21. IX. 1985, f. 11; 23. IX. 1985 f. 16); fizicient (Fjalori frëngjisht shqip 1978, 548, "Fjala" nr. 14/85 f. 12; "Rilindja", 13. VI. 19985 f. 4; 21. IX. 1985 f. 11; 23. IX. 1985 f. 16; takticient (FF 1978 f. 548); muzicient ("Rilindja" 10. XI. 1984 f. 17) etj.

Pasi që trajta e tillë shkrimore nuk është huazim, sepse një trajtë të tillë – *cient(!)* nuk e ndeshim kështu në asnjë gjuhë të huaj për emërtimet në fjalë dhe se njëherazi një prapashtesë të tillë nuk e njeh gjuha jonë letrare (standarde) as në planin diakronik dhe as në atë sinkronik, mund të konstatojmë, pa hamendje, se një trajtë e tillë tejet e paqëndrueshme del *gafë e shpifur*, mjerisht, vetëm në gjuhën tonë.

Është për t'u habitur se si ka mundur trajta e tillë të depërtojë edhe në shtyp, kur dihet se në institucionet e tilla materiali kalon nëpër duar të disa profesionistëve (gazetarit (përkthyesit), lektorit, korrektorit, redaktorit) dhe që të gjithë pa tjetër janë (ose patjetër duhet të jenë) të formuar edhe gjuhësisht.

Formanti -CIENT mbase do të jetë refleks a përngjizje "*allainteletualçe*" te ne ose më gjerë, i prapashtesës -CI/EN te frëngjishtes me prapashtesën tjetër, po ashtu me burim të huaj: -ENT (si te tipi i emërtimit *referent*), prej nga mund të jetë shpifur përkatësisht T-ja fundore apo -CI-ja nistore.

Sido që të ketë ndodhur përngjizja e tillë nuk qëndron, sepse një element si ky është fare i panevojshëm në strukturën fjalëformuese të emërtimeve të tipit në fjalë në gjuhën tonë.

Jo vetëm trajtat me prapashtesën -CIENT, por as ato me -CIEN (sipas modelit të gjuhës frënge) si matematicien, fizicien etj. (Shih: "Rilindja", 25. IX. 1985 f. 15) nuk qëndrojnë, sepse për emërtimet në fjalë kemi trajtat tashmë të normëzuara: **matematikan, fizikan**, ashtu siç porosit *Fjalori drejtshkrimor i gjuhë shqipe* (1976) dhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980) dhe neve na mbetet vetëm ta zbatojmë atë porosi. Dihet se për ndonjë "thyerje" të normës për nevoja të nuancimit të kuptimeve leksikore (sinonimike) duhet të ketë arsye të forta stilistike ose logjike, kurse rastet që po trajtohen këtu nuk janë të një natyre të tillë. Pra muk kemi të bëjmë as me ndonjë arsye stilistike as logjike.

Është e vërtetë se pikërisht për emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore ende kemi çështje të pazgjidhura në gjuhën tonë, ngase asnjëra nga 10 mënyrat fjalëformuese që aplikohen për rastet e papërfshira në FGJSSH nuk paraqitet si model mbizotërues për përthithjen e rasteve të tjera të papërfshira, përkatësisht mungon rregulli i caktuar në burimet përkatëse të gjuhës sonë letrare që të na rekomandonte mënyrën më të pëlqyeshme sesi zgjidhen emërtimet që kanë të bëjnë me ndërkombëtarizmat si b.f. **elektronikë, energjetikë, statistikë, kibernetikë, robotikë** etj. etj. e që numri i tyre i regjistruar ose në përdorim aktiv, në realitetin tonë gjuhësor kalon 40-shin dhe se është në rritje e sipër, mirëpo mbi bazë të një analizë që i është bërë kësaj çështjeje, në asnjë rast nuk del e nevojshme të futet në përdorim formanti -CIENT, madje as -CIEN, por për këtë aktivizohen mënyrat a prapashtesat e specializuara të gjuhës sonë, të cilat edhe ashtu përdoren për emërtimet e tipit të cekur e ndër to mbase më e parapëlqyer del prapashtesa -AN, por për këtë nuk është vendi këtu të zgjatem. Kjo çështje është trajtuar më gjerësisht në një punim të veçantë studimor. Gjithsesi edhe trajta praktikant duhet të rishikohet, kurse si trajtë e normuar është **praktikan**, ashtu si edhe për trajtën **muzikant**, mund të jetë më pak e qortueshme trajta **muzikan**, por kurrsesi *muzicist* apo **muzicien**, ndërkaq trajta **muzicient**, del jashtë çdo logjike.

Besoj se kjo vërejtje që u dha lidhur me formantin -CIENT do të mjaftojë sa për të tërhequr vëmendjen dhe të kuptohen drejt në mënyrë që lajthitjet e tilla të mënjanohen madje edhe para se të dalin në shtyp, ngase, siç dihet, autoriteti i shtypit duhet të shfrytëzohet edhe për përhapjen e

trajtave të normëzuara e jo për ato trajta, të cilat nuk i ka rëndë vetëm gjuha e veshi, por edhe letra.

Gëzon fakti se në gazetën "Rilindja" (dt. 28.IX.1985 f.11) emërtimet në fjalë dolën në trajtat e drejta: **matematikan, fizikan**, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet tërhequr vërejtja për përgjegjësinë e kujdesin në mënyrë që të mos përsëriten më trajtat e tilla të gabuara me -CIENT e -CIEN.

Prishtinë, më 28.IX.1985

6. RRETH TRAJTËS TEORICIEN SI RAST I VETMUAR

Në kuadër të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë (profesionit) në gjuhën tonë letrare kemi vetëm emërtimin **teoricien** (Shih FGJSSH f. 1984) që mbaron me formantin -CIEN e asnjë tjetër. Një rast i tillë nuk zgjon kërshërinë vetëm pse është i vetëm, por për arsye se rreth formantit -CIEN dallohen dy tendenca, të cilat në mënyrë të ndjeshme veprojnë në drejtime të kundërta:

E para ka të bëjë me shtrirjen e këtij elementi fjalëformues edhe në fjalë të tjera dhe

E dyta, ka të bëjë me goditjen që po i bëhet nga prapashtesat e mënyrat e tjera këtij formanti të huaj duke e vënë në dyshim edhe vetë trajtën **teoricien**.

Para se të ndalem më në hollësi rreth këtyre dy tendencave po cek se fjala **teoricien** lidhet apo mbështetet kuptimisht në ndërkombëtarizmin **teori teoria** (gr. *theorija*) dhe ka kuptimin "ai që merret me përgjithësimin teorik në një fushë të caktuar të shkencës, ai që përpunon, shpjegon ose zgjidh çështje teorike të një shkence, të një mjeshtërie, të një arti etj." (FSHS 1984.)

Ja si del emërtimi i tillë në disa gjuhë:

- gr. **theoretikos** (theorija),
- gjerm. **Theoretiker** (Theorie),
- angl. **theorician** (theory),
- rus. **teoretik** (teorija),
- serb. **teoretičar, teoretik** (teorija),
- it. **teorico** (teoria),
- fr. **théoricien** (théorie), dhe
- shq. **teoricien, teorizues** (teori/a).

Siç mund të shihet nga ndërkombëtarizmi mbështetës (i shënuar në kllapa) del se emërtimi i ushtruesit të veprimtarisë është përhapur në gjuhë të ndryshme pavarësisht, megjithatë si duket trajta greke **theoretikos**, sigurisht do të ketë ndikuar në të gjitha trajtat e gjuhëve të tjera. Siç po shihet bëjnë

përrjashtim paksa vetëm trajtat në gjuhën italiane dhe në atë frënge, por edhe te këto ruhet elementi -c- (k) që nuk e ka ndërkombëtarizmi i mirëfilltë teori (teorija).

E kemi lehtë të konstatojmë se shqipja e ka huazuar trajtën e gjuhës frënge me -CI/EN fundore.

Në gjuhën frënge prapashtesa -CI/EN që nuk është e vetme është si leksemë speciale për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë, sidomos është e preferueshme për ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore, si p.sh. metematikë, fizikë, muzikë etj., kështu që edhe te ne duke qenë i pranishëm autoriteti i gjuhë frënge, përkatësisht i formave të shkrimit të saj për emërtime të tilla, shpesh ndodh të dëgjojmë e të lexojmë trajta si p.sh. matematicien ("Rilindja", 25.IX.19985 f. 15); "Shkëndija" (nr. 8/84 f. 16, nr 15/85 f. 1); fizicien "Rilindja" (15.IX.1985 f. 15); "Shkëndija" (nr. 15/85, f. 1); foneticien (FFSH 1978 f. 1417), pastaj statisticien (FSHSK 1981, f. 865) takticien (FSKSH 1974, f. 864), logjicien (DL 1977, f. 76) etj.

Një dukurie të tillë ndër ne duhet vënë ledh, sepse gjuha jonë nuk ndjen kurrfarë nevojë për një huazim të tillë grafik, ngase i ka mjetet e veta më të përshtatshme dhe tashme të normëzuara për shumicën e rasteve të cekura, si p.sh. matematikan, fizikan, fonetikan etj. Është e vërtetë se për disa emërtime që kanë të bëjnë me ndonjë ndërkombëtarizëm si *statistikë, taktikë, logjikë* etj. ende nuk i kemi trajtat e përcaktuara, por gjithsesi për zgjidhjen e tyre nuk do të kemi nevojë të kopjomë grafisë e gjuhës frënge -CI/EN, përkatësisht të huazojmë tërë trajtën e termit të caktuar nga ajo gjuhë. Po them grafisë se formanti -CIEN në frëngjishte lexohet (shqiptohet) -SJEn e jo -CIEN, siç po lexohet te ne sipas alfabetit tonë. Prandaj pa kurrfarë rezerve mund të themi se formanti -CIEN në gjuhën tonë është një prapashtesë artificiale, është një trill, që nuk duhet favorizuar në asnjë rast tjetër, madje edhe vetë rasti, **teoricien**, mbase do rishikuar për arsytet që po shtrohen këtu.

Ç'është e vërteta, në realitetin tonë vetë trajta **teoricien**, përkatësisht formanti -CIEN, po u ekspozohet goditjeve që po i bëhen nga trajtat e tjera jo normëzuese, si, p.sh.:

- CEN: *teoricen* ("Rilindja për fëmijë", 6.VIII.1985 f. 2),
- CIEN *teoriticient* ("Rilindja", 17.IV.1985 f. 9),
- ETIK *teoretik* (FSKSH 1974 f. 870),
- ECIEN: *teorecien* (DL 1977 f. 342), ECIEN por edhe
- TICIEN: *teoreticien* (FSKSH 1961 f. 645),

Në të vërtetë, trajtat po ceken si raste jo të përgjithësuara, të cilat edhe mund të korrigjohen lehtë, por edhe këto, për mendimin tim, dëshmojnë se trajta e tillë, **teoricien**, si formë shkrimore fundorja –CIEN nuk del motivuese, ngase kuptimisht si prapashtesë emërformuese nuk ka shtrirje, është pa traditë përdorimi. Ndërkaq goditje më të forta dhe mbase me vend trajta **teoricien** po merr nga trajtat, ku tema e qartë prodhuese opo merr edhe prapashtesë të qartë fjalëformuese, siç janë rastet: **teorik (teori+IK)**, **theorist (teori +IST)** dhe **teorizues (teori+ZOJ – teorizoj – teorizues**.

Trajta **teorik** ishte e parapëlqyer në FGJSH 1954 dhe në fjalorë të tjerë. Kjo edhe pse e mënjanuar në FGJSSH 1980 nga trajta **teoricien** edhe sot e kësaj dite vazhdon të përdoret mjaft dendur, si p.sh.:

te "Gjurmime albanologjike - studime filologjike" nr. 14/84 f. 116, 131; "Shkëndija" nr. 3/84 f. 9, "Rilindja", 6.IV. 1985 f. 13, FESHL 1984 f. 146, 211, 219, 313, 362 etj.

Trajta **teorik**, siç mund të shihet nga pasqyra e reflektimit të emërtimit në fjalë ngjan më tepër nga grafia e shqiptimi me trajtën **teorico** (teorik/o) të italishtes, por një trajtë e tillë në gjuhën tonë mund të arsyetohet edhe si emërzimi i mbiemrit **teorik** me anë të konversionit dhe se raste të tillë fjalëformimi hasim edhe në gjuhë të tjera.

Ne nuk dime pse hartuesit e FGJSSH-së parapëlqyen trajtën **teoricien** në vend të asaj **teorik**, por sigurisht një veprim i tillë do të ketë ndikuar që trajta **teorik** të mos ngulitet si trajtë e vetme e qëndrueshme, siç janë b.f. emërtimet **teknik**, **mekanik** etj.

Në kohë të fundit ndër ne vërehet se ka filluar t`u bëjë konkurrencë trajtave **teorik** e **teoricien** trajta **teorist**, e cila sa ka filluar të lëshojë shtat (ende nuk është regjistruar në asnjërin fjalor përkatës), po ka mbështetje më tepër se dy të parat në strukturën fjalëformuese apo në ligjësitë që janë të gjalla dhe veprojnë në gjuhën tonë, pikërisht për emërtimet e tipit të emrave në shqyrtim. Kështu që nga ndërkombëtarizmi a tema e qartë motivuese **teori- +IST** doli trajta **teorist**. (Shih edhe anglisht **Theorist**, FASH 1957, f. 888, PPTR 1973, f. 846; serbokroatisht **teoričar** e **teoretik**, ERSHN 1963, 493 që lë shtegun hapur drejt emërtimit të degës shkencore **teoristikë/a**). Modelin me -IST mbi temë me fundoren –I në gjuhën tonë kemi të gatshëm, si p.sh.: **kimist** (kimi+IST), **akademist**, **telegrafist**, **ekonomist**, **enciklopedist** etj., andaj edhe **teori+IST teorist** hyn në këtë grup zgjidhjeje.

Kur kemi parasysh faktin se prapashtesa -IST edhe pse "me origjinë të huaj është bërë mjaft produktive për formimin e emrave që emërtojnë personin sipas mjeshtërie a punës që kryen" (GJLSH f. 216), atëherë trajta

teorist del më e pranueshme se ato *teoricien* apo *teorik*. Por edhe kjo për këtë pikë nuk ka shterirje të gjerë, megjithatë, nëse nuk qortohet institucionalisht, kjo trajtë mund ta zëvendësojë pa pasoja trajtën me –CIEN ose me -IK fundore, apo jo?

Jo vetëm kaq. Në gjuhën tonë edhe një trajtë tjetër ka hyrë në konkurrencë për nocionin në fjalë e kjo është trajta **teorizues**, e cila është shënuar si sinonim i trajtës *teoricien* edhe në FGJSSH f. 1984. Trajta **teorizues** është krijuar mbi foljen **teorizoj** me prapashtesën -UE/S ose më drejt mbi pjesoren e asaj foljeje **teorizue** (me teorizue) + S dhe ky përfitim është në pajtim me rregullsitë e fjalëformimit të sotëm që veprojnë për emërtime të tilla. Me sa pamë edhe në gjuhë të tjera të zhvilluara rreth konceptit të kësaj fjalë ndërkombëtare **teori** janë reflektuar folje, si:

angl. (to) theorize, gjerm. theoretisieren, fr. theoriser, it. teorizzare, sll. teoretizirati, së këtejmi edhe shqip: **teorizoj**.

Siç po shihet edhe pse prapashtesa e foljes së shqipes del pjesërisht e huazuar –IZ+Oj teorizoj, ajo në shqipë del si folje e pavarur dhe nga tema e saj legjitimisht dalin prejfoljorët si teorizim, teorizues etj., andaj trajta **teorizues** ofrohet si zgjidhja më e mire për zëvendësimin e trajtës së huazuar **teoricien**.

Mirëpo pikërisht për **teoricienët** ose **teorizuesit** çështja pse emërtimi i ri është mbështetur në foljen e jo në emrin, përkatësisht ndërkombëtarizmin drejtpërdrejt lihet shteg për diskutim apo jo, kur kemi parasysh edhe konceptin që shprehej nga gjuhë të huaja? Sigurisht, trajta **teorizues** assesi nuk del e paqëndrueshme, gjë që në asnjë mënyrë nuk mund të vihet në dyshim, por pse në këtë kontekst dallohet një ngjyrim kuptimor i ndryshëm i emërtimit të profesionit që krijohet mbi bazën e emrit nga ai që krijohet mbi foljen a procesin e punës mund të ketë dalime në hijesat kuptimore. Shpeshherë konteksti i dallon fare qartë kuptimet e tilla. Për këtë mjafton t'i kujtojmë shëmbujt: këshilltar - këshillues, kryetar - kryesues, fabrikant - fabrikues, edukator - edukues, analitik - analizues, sinjalist - sinjalizues etj. Prandaj duke mos u mohuar qëndrueshmëria e trajtës *teorizues* ndihet nevoja që të qëndrojë edhe trajta tjetër që ka mbështetje emrin temë-fjalëformues si në rastin tonë: **teorist**, *teoricien* apo *teorik*?

Nuk patëm për qëllim të vëmë në dyshim me çdo kusht qëndrueshmërinë e trajtës **teoricien**, por të vëmë në dukje çështjen lidhur formantin -CIEN, i cili për mendimin tim nuk del i nevojshëm me u favorizue domosdo as për këtë rast, kur ka mundësi me u zëvendësue me

formantin –IST (teorist) ose -UES (teorizues) e aq më tepër të shpifet për ndonjë rast tjetër, apo jo?

Edhe njëhere po përsërisim goditjet e paqortueshme që po i bëhen aktualisht trajtës së tillë **teoricien** nga trajta **teorik**, si trajtë ish e normëzuar si dhe nga kjo aktualja **teorist**, dhe aq më tepër nga prejfoljori **teorizues**, trajtë kjo e cila në të vërtetë del si trajtë me model të favorizuar për raste të ngjashme duke tërhequr vëmëndjen rreth prirjes që vepron në strukturën e formimit të fjalëve të emërtimeve të tilla nga prejpjesoret, gjë që kuadrot tanë profesionistë e sidomos standardolëgët tanë, të cilët duhet ta kenë parasysh faktin se në gjuhën tonë në mënyrë të ndërgjegjshme po i jepet apo duhet t'i jepet përparësi pikërisht strukturës vetjake fjalëformuese me elemente vendëse, por pa e dëmtuar kuptimësinë që lidhet edhe me ndërkombëtarizmat e caktuar.

Prishtinë, më 1. X. 1985.

7. INSTALUES UJËSJELLËSI A HIDRAULIK E JO UJËINSTALUES

Për ushtruesin e profesionit **vodointalater** ose **vodovodni instalater** të serbokroatishtes në gjuhën shqipe, sidomos në stilin bisedor në rrethe të caktuara ndër ne ndodh të dëgjohet emërtimi **ujinstalues** a **instalues i ujit**, madje një barasvlerësi e tillë ndodh të gjejë vend si emërtim zyrtar edhe në "organika", përkatësisht *sistematizimet e punëve dhe të detyrave* të organizatave të ndryshme të punës së bashkuar te ne, madje të shënohet në diploma, përkatësisht në vendimet (aktvendimet) lëshuar punëtorëve sipas vendit të punës, madje edhe të kërkohen punëtorë për zënie pune me një kualifikim të tillë, siç është rasti në shpalljet e publikuar, Shih:

"Rilindja", më 13. II. 1983, 27. II. 1983 f. 19, 13. VIII. 1984 f. 7, 14. XI. 1984 f. 19 (dy raste), 17. IV. 1995, f. 13, 18. IV. 1985 f. 19 (dy raste); në normativin zyrtar "Nevojat vjetore për punëtorë për vitin 1985 të BKVIP- Prishtinë, f. 5 etj.

Me qëllim që mos të përsëriten gabimet e tilla apo për mos me lëshue rrënjë lajthitje të reja një emërtim i tillë në atë trajtë që nuk ka kurrfarë mbështetje logjike e kontekstore, më poshtë po i paraqit disa konstatime sqaruese lidhur me emërtimin e ushtruesit të profesionit në fjalë duke theksuar edhe krahasimin edhe me trajtën e plotë përkatëse kontaminuese të gjuhës serbokroate, nën ndikimin e së cilës edhe u përftua kjo trillë kësisoji te ne.

E para, në dokumentet zyrtare (regjistrat e nomenklaturës së profesioneve) të botuar te ne që do të ceken më poshtë sipas rendit kronologjik në të dyja gjuhët (viti i botimit është shënuar në kllapa) emërtimi i ushtruesit të profesionit në fjalë del kështu:

- monter vodovodnih uredjaja (vodoinstalater) shifra 215.o5 /montator i aparateve të ujësjellësit/ (1969);

- vodointalater (monter) vodovodnih uredjaja, shifra 215.o5 /montues i stabilimenteve të ujësjellësit/ (1972);

- instalater vodovoda i kanalizacije /instalues i ujësjellësit dhe i kanalizimit/ (1980);
- vodovodni instalater (monter vodovodnih uredjaja) /instalues i ujësjellësit (montues i stabilimenteve të ujit)/ (1981);
- vodovodni instalater, shifra 08.1 /instalues i gypsjellësit/ (1981);
- hidrauličar, shifra 505 /hidraulikist, hidraulist/ (1981).

Pra është fjala për të njëjtin profesion (nacion) që fjala e parë e emërimit perifrastik del: montues a instalues, por si emërtim njëgjymtyrësh në shqipe ka barasvlerësin: hidraulik.

Po e cek pa u zgjatur që si emërtime më të drejta në gjuhën tonë letrare janë trajtat: **montues ...**, **instalues...** e **hidraulik** ndaj trajtave: *montator*, *instalator*, *hidraulikist* a *hidraulist*. Gjithashtu tërheq vërejtjen se barasvlerësi adekuat për fjalën **uredjaj** të serbokroartishtes në shqipe nuk është *stabiliment* as *apar*, por është **pajisje** (ose instalim), çështje kjo që është trajtuar më gjerësisht në tjetër vend, në një trajtëse të veçantë.

Këtu ç'është e vërteta, paraqitet e nevojshme të bëhet njëfarë përcaktimi se cila nga trajtë-termat sinonimikë: **montues i pajisjeve të ujësjellësit**, **instalues ujësjellësi** a **hidraulik** është më i përshtatshëm në gjuhën tonë.

Që të tria fjalët në shqyrtim: montues (montator), instalues (instalator) e hidraulik janë emërtime me bazë ndërkombëtarizmi, edhe pse dy trajtat e para në shqipe janë prejpesorë mbi bazë të foljes së shqipes më -OJ. Trajtat në kllapa më -ATOR janë huazime nga gjuha italiane, kurse në frëngjisht dalin kështu: *monteur*, *installateur*. Trajta e tretë hidraulik sipas etimonit ka prejardhje greke: hidraulik (ὁ υδραυλικός), sipas ndërkombëtarizmit *hidraulika*, shkencë kjo që "studion ligjet e lëvizjes së ujrave" (FGJSSH f. 626).

Fjala **montues** në gjuhën e sotme shqipe (sipas FGJSSH-së) ka kuptim më të gjerë se trajta **hidraulik**. Kjo ka mundësi që të përfshijë në kuadër të vet edhe kuptimin e emrit *hidraulik*, madje edhe të atij **instalues (ujësjellësi)**, trajtë kjo, e cila nuk del e shënuar në fjalorin në fjalë. Përparësi të tillë trajta **montues** ndaj **instalues** ka edhe në gjuhë të tjera si p.sh. në rusishte, b.f., për *instalues* del trajta *montazhnik*, ndërsa për montues

montrioshqik, pra me favorizim të temës mont-, por në gjuhën frënge dhe atë gjermane dallimi i trajtave të tilla del edhe më qartë.

Sidoqoftë pasi që te ne është fjala vetëm për një koncept e jo për nuancime të ndryshme polisemantike dhe se në FGJSSH del e shenuar vetëm trajta **montues** mendoj se trajta **montues ujësjellësi** do të mjaftonte të përliqjet si trajtë e normëzuar. Megjithatë del e nevojshme të sqarohet kuptimi më përcaktues i fjalës **instalues** që del nga folja *instaloj* si dhe i fjalës *hidraulik* që del si huazim transfer.

Me fjalë të tjera me emërtimin **montues** kuptohet mjeshtri specialist, i cili monton diçka, përkatësisht "monton makina, makineri etj." apo më saktë "bashkon duke i lidhur a duke i mbërthyer pjesët e veçanta të një makine, të një pajisjeje, të një aparati etj. për t'i vënë në punë" (FGJSSH f.1165), ndërsa me emërtimin **instalues**, që del sipas kuptimit të fjalës *instaloj* nënkuptohet personi, i cili "vendos pajisjet teknike, aparatet, mjetet, makineritë etj. aty ku ato duhet të punojnë" siç janë p.sh. instalimi i rrjetit elektrik dhe në rastin tonë konkret "pajisjet hidraulike në një ndërtesë" (FGJSSH f.723) e që pikërisht për një profesion të tillë në gjuhën shqipe përdoret termi **hidraulik** me të cilin kuptohet profesioni i punëtorit, i cili "merret me vendosjen e ndreqjen e pajisjeve e të gypave të ujit nëpër banesa, ndërtesa industriale etj." (FGJSSH f.676.)

Prandaj në rastet e caktuara krahas emërtimit perifrastik **montues i ujësjellësit** mund të qëndrojë edhe termi **instalues i ujësjellësit** ose edhe vetëm fjala njëgjymtyrëshe **hidraulik**.

Edhe në gjuhën sebokroate, siç e pamë më sipër, del emërtimi hidraulicar (hidraulik), por në emërtimet zyrtare parapëlqehet trajta **vodovodni instalater**, por edhe trajta e shkurtër vodni instalater ose *vodoinstalater*. Nga trajta e fundit **vodoinstalater** në rreth të caktuara tek ne doli a u "përkthye" trajta **ujëinstalues** ose **instalues uji**, duke u bërë kështu gjoja përkthimi i *fjalëpërfjalshëm* i emërtimit në fjalë. Këtu te shqipfolësi kemi të bëjmë me një lapsus të rëndë. Ç'është e vërteta, është ngatërruar te përdoruesi shqipfolës barasvlerësi **voda** (uji) i serbishtes me fjalën tjetër **vod** po të asaj gjuhe. Sipas kuptimit leksikor që ka fjala **vod** në serbishte ka sinonimi me fjalët: *sprava (cev, žica, kabal i sl.)* *kojom se nešto provodi* që d.m.th. **pajisje (gyp, tel, kablo etj.) me të cilët përcillet (përçohet) a sillat**

diçka (RSHKJ II f.952), me fjalë të tjera me fjalën **vod** (në serbishte) kuptohet:

rrjeti a vija e ujësjellësit, elektrikut, e kanalizimit, e nxehjes qendore etj,

që në rastin tonë në shqyrtim kurrësi kjo fjalë nuk mund të përkthehet me fjalën **ujë** (!), po me *pajisje hidraulike* apo me *pajisje të ujësjellësit*, siç janë: gypat, unazat lidhëse, degëzorët etj., të cilat i vendos apo i ndreq mjeshtri i profesionit të tillë – montuesi i rrjetit të ujësjellësit.

Në të vërtetë, paqartësi mund të ketë edhe te ndonjë folës i serbokroatishtes, i cili nuk e ka të qartë se "vod" quhet "*vodeći sistem koji se sastoji od dva ili više provodnika*" /quhet **vod - (një linjë) sistemi përcjellës i përbërë prej dy a më shumë përqesish/** (Shih: Dr. B. Popović, Elektromagnetika, Beograd 1980, f. 320). Dihet gjithashtu se në atë gjuhë kurrë nuk thuhet instalater *vode* (uji) por **instalater voda** më drejtë **vodovoda** (*instalues i pajisjeve të ujësjellësit*) që nënkupton *voda za vodu* (*rrjetin për ujë*). Prandaj në emërtimin zyrtar trajta e rregullt del në atë gjuhë: **instalater vodovoda** ose **vodovodni instalater**.

Gjithsesi, pamëdyshje, në shqipe emërtimi *ujëinstalues(!)* nuk qëndron, ngase nuk instalohet uji, por instalohen "pajisjet teknike, aparatet, veglat etj.". Këtu nuk mund të bëhet fjalë për kurrfarë metonimie, por është fjala për një shkarje të vrazhdë rreth një lapsusi semantik. Shqipfolësit e sidomos përkthyesit duhet të kenë kujdes të mos bëjnë gabime të tilla kaq të rënda dhe jo pa rrjedhoja.

Supozimi që thjeshtësimi a elipsi i fjalës *vodovod* i serbokroatishtes në *vod(o)* që është bërë nën procesin e haphologjisë dhe se këtë rast e kemi të ruajtur fjalën *vod* e jo atë *voda* e nxjerrim të drejtë edhe në krahasim me shembujt si:

dalekovod (largpërçues), parovod (avullsjellës), plinovod a gasovod (gazsjellës), naftovod (naftësjellës), talasovod (valëpërcjellës), elektrovod a električnivod (instalim elektrik), dovodni cev (gyp a përçues përcjellës), dovodnivod (kabllo rrymësjellës) a furnizuese rryme, etj.

Pra, ta kemi të qartë që edhe **vodovod** është baras me barasvlerësin **ujësjellës**.

Duhet ta dimë edhe këtë fakt se në gjuhën serbokroate (sidomos në stilin e lirë bisedor shpeshherë në vend të emërtimit të plotë togfjalësh ose

kompozitës, thuhet elementi i dytë a i fundit p.sh. në fjalinë "pad napona u vodu" nuk kemi të bëjmë me fjalën voda (ujë) por me fjalën (elektricni vod), pra fjalia e tillë duhet të përkthehet jo rënia e tensionit në ujë(!), që do të ishte gabim i pafalshëm, por rënia e tensionit në linjën a vijën (instalimin) e rrjetit elektrik.

Termin vod të serbokroatishtes e kemi të përkthyer me barasvlerësin **linjë** a **vijë** në dhjetë shembuj në dispencën "fjalorth doracak terminologjik serbokroatisht - shqip" të Jusuf Gacaferrit (Prishtinë 1967) edhe me fjalën **instalim**, po ashtu në nja dhjetë shembuj (në Fjalorin e terminologjisë tekniko-shkencore (9) -terminologjia e elektroteknikës (Beograd 1970).

Në fund të kësaj trajtесе e shoh të nevojshme të theksoj që është mirë dhe e domosdoshme që në fjalorët tanë normativë dygjuhësh të zë vendin e duhur termi **instalater**, përkatësisht **vodovodni instalater** me barasvlerësin përkatës në shqipe : **instalues**, përkatësisht **instalues ujësjellësi** (hidraulik) ashtu si edhe fjala **vod** me barasvlerësit përkatës : **vijë (linjë), instalim, tel;** (rrymë,... ujësjellës, rrymëpërçues etj. siç e pamë edhe në shembujt si më sipër.

"Shkëndija" nr. 15 1985, f. 13

8. RRETH PËRCAKTIMIT TË KUPTIMIT LEKSIKOR TË TERMIT AXHUSTATOR NDËR NE DHE PËRGJITHËSISHT

Në vistrën e emërtimeve të profesioneve që paraqitet si çështje e hapur lidhur me përcaktimin e kuptimit leksikor në gjuhën shqipe përgjithësisht dhe ndër ne në veçanti zë vend parësor edhe termi **axhustator**.

Fjala **axhustator** është huazim transfer nga italishtja. Etimologjikisht vjen nga fjala latine *adjustare* (axhustoj, me axhus]tue), e cila tashti si ndërkombëtarizëm, pothuajse në të gjitha gjuhët, ka hyrë me kuptimin kryesor (strumbullar) *"përshatje (ndreqje, rregullim, përgatitje, lëmim, riparim a përpunim) i pjesëve të punuara për ndonjë makinë a instrument me qëllim puthitjeje a qitjeje në vend"*, formulim ky që përafërsisht kështu del i formuluar edhe në burimet e mëposhtme, siç janë:

- 1) Fjalorët përkatës të fjalëve ndërkombëtare të autorëve: Aleksiq, Vujaklija, B, Klaiqi etj.;
- 2) Fjalori i gjuhës letrare të serbokroatishtes (RSHKJ)
- 3) Fjalorit të fjalëve dhe shprehjeve të huaja (ndërkombëtare) të M. Ndreçës si dhe
- 4) sipas Larouss-it etj.,

formulim ky që përputhet, por jo plotësisht me përkufizimin e dhënë në FGJSSH (1980) për termin axhustator, përkatësisht për punën e axhustatorit si *"punëtor me përgatitje të posaçme që lëmon a përpunon me dorë veglat dhe pjesët e ndryshme të makinave, të pajisjeve, në mënyrë që të vihet në vendin e caktuar"*, d m.th. personi i cili kryen *"punët mekanike të lëmimit, përpunimit etj."*, kështu që fitohet bindja se kemi të bëjmë me një nga profilet e profesionit të një *mekaniku* a të një *metalpunuesi manual*.

Një përkufizim i tillë që lidhet me fushën e përpunimit të metaleve vetëm pjesërisht del i drejtë, kur kemi parasysh kuptimin leksikor që ka ky term në gjuhë të huaja. Për këtë do të mjaftohem me sjelljen vetëm të disa

shembujve që i ndeshëm në burime të caktuara lidhur me emërtimin e profesioneve përkatëse që janë në përdorim e sipër te ne:

1. adjuster, shifra 503 - /axhustator/;
2. adjuster valjanih proizvoda (sipas B. Klaiqit) - /axhustator i prodhimeve të petëzuara/;
3. adjuster tkanina, shifra 125.57 - /axhustator i pëlhurave/;
4. adjuster čarapa, shifra 15.69 - /axhustator i çorapave/;
5. adjuster kratke konfeksije, shifra 15.69 - /axhustator i konfeksionit të shkurtër/;
6. adjuster metalurških fabrikata, shifra 127.33 - /axhustator i fabrikatave metalurgjike/;
7. adjuster gumenih proizvoda, shifra 127.33 - /axhustator i prodhimeve të gomës/;
8. adjuster gumenih fabrikata, shifra 20.14 - /axhustator i fabrikatave të gomës/;
9. adjustirer vezica, shifra 15.71 - /axhustator i lidhësave/.

Pra, siç po shihet nga shembujt e mësipërm që i nxora kryesisht nga doracaku "Abecedni spisak zanimanja", SZS, Beograd 1986 dhe nga dokumenta të tjerë përkatës zyrtarë, me këtë emërtim nuk kemi të bëjmë vetëm me profesionin e punëtorit që "lëmon a përpunon me dorë pjesët e makinave a të pajisjeve" por që ka të bëjë edhe me punët rreth axhustimit të metaleve, por edhe të fabrikateve të gomës, prodhimeve të pëlhurave etj, prandaj përkufizimi i mësipër i dhënë në FGJSSH kërkon riformulim, përkatësisht zgjerim a përplotësim, kur kemi parasysh shembujt e mësipërm si dhe kur dihet fakti se ky emërtim si fjalë ndërkombëtare, po në këtë formë (rrënjor) përdoret edhe në gjuhë të tjera, prandaj harmonizimi i këtij termi në plan ndërkombëtar del i domosdoshëm.

Kjo që sapo u tha nuk është e parëndësishme për mbarëvajtjen e gjuhës sonë përgjithësisht, por ne na shtyn diçka tjetër të shkoqisin dhe ta shohitim edhe më në hollësi këtë problem, ngase te ne çështja del edhe më e ndërlikuar. E themi që del më e ndërlikuar se në vendin amë (Shqipëri), ngase ky term te ne po përdoret po në këtë trajtë shkrimore jo vetëm si barasvlerës për trajtën **adjuster** (adjustirer, adjustater) të serbokroatishtes dhe të gjuhëve të tjera, por edhe për dy terma të tjerë të serbokroarishtes, për **bravar** dhe për atë **mašinbravar**. Do me thënë po me këtë barasvlerësi trefishe e ndeshim të përdorur trajtën **axhustator** pothuajse në të gjitha

burimet zyrtare te ne, gjë që, vërtet, shtrirja enorm e një përdorimi të tillë mjerisht del tejet e paqëndrueshme dhe e padurueshme.

Për të qenë më i kapshëm dhe më i qartë problemi temë e kësaj trajtëse, më poshtë po japim pasqyrën e termave të posacekur të gjuhës jo vetëm të gjuhës shqipe, por edhe të disa gjuhëve të zhvilluara, si gjermanisht, anglisht, rusisht, italisht, frëngjisht.

Pasqyra e barasvlerësve përkatës për profesionet adjuster, bravar dhe mashinbravar

1. serbokr. adjuster (adjustater) (adjustirer) (podešavač, (obradjivač) (opremač)	bravar (mehaničar)), (mašinski mehaničar);	mašinbravar (strojobravar)
2. gjerm. Abrichter (?)	Schlosser	Machinschlosser;
3. angl. adjuster (fitter)	lock-smith	engine fitter;
4. rus. ?	slesarj	slesarj-mehanik;
5. it. aggiustatore	fabbro ferrario	fabbro meccanico;
6. fr. ajusteur	serrurier	ajuster de machines;
7. shq. axhustator	axhustator(?)	axhustator (!)

Ç`është e vërteta, si barasvlerës për termat bravar dhe mašinbravar ndër ne dhe përgjithësisht dalin edhe trajta të tjera, siç do të shohim më hollësisht në vazhdim të kësaj trajtëse, por unë diskutimin tim e mbështeta në lëndën që e ndesha në disa burime relevante zyrtare të përkthyer shqip, siç janë:

1. Lista alfabetike e profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar, EFS Beograd 1981 (doracak);
2. Klasifikimi standard i profesioneve, EFS, Beograd 1981 (doracak);

3. Konkursi për regjistrimin e studentëve të UP të Prishtinës i publikuar në gazetat tona që përsëritet çdo vit shkollor;
4. Shkresë e QAE "Shtjefën Gjeçovi" për publikimin e konkursit për vitin shkollor 1983/84;
- 5 Konkurset e shpallura çdo vit shkollor për regjistrimin e nxënësve në shkollat tona të mesme;
6. Fjalori shqip-serbokroatisht, IA, Prishtinë 1981;
7. Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike shqip-serbokroatisht i H. Goranit, Prishtinë 1985;
8. Regjistri i personelit të inkuadruar, EFS, Beograd 1977 (doracak).

Së këtejmi më duket se nuk del e nevojshme të cek edhe konkurset e caktuara që shpallin organizatat e caktuara punonjëse për punësimin e kuadrit përkatës, ku gjithashtu nuk dihet se për cilin kualifikim është fjala të adjuster-it (axhustatorit), bravar-it (bravapunuesit) a mašinbravar-it (mekanikut të makinave) (!?).

Pra mos përcaktimi si duhet i emërtimit të caktuar paraqitet edhe si problem i punës së bashkuar. Po e cek edhe këtë të dhënë se në tri shkolla të mesme në tri komuna të Kosovës, sipas Konkursit të shpallur për vitin shkollor 1987/88, termi axhustator përdoret si barasvlerës i termit **bravar** të serbokrostishtes, ndërsa në shkolla të tjerë përdoret në vend të termit **mašinbravar**. Kjo aq më tepër del e diskutueshme, ngase shkolla për bravar zgjat tri vjet, ndërsa ajo për **mašinbravar** katër vjet. S`do mend se diferencimi i emërtimeve për profesionet e ndryshme del i domosdoshëm, ngase paraqet ngatërresa të mëdha qoftë në punën e bashkuar lidhur me punësimin, lëshimin e vendimeve, pagesën etj, qoftë në shkolla lidhur me planprograme të punës, plotësimin e diplomave etj. etj.

Gjithsesi mendoj se të dhënat e mësipërme që u përpoqa t`i paraqit sa më shkurt mjaftojnë sa për të vënë në dukje problemin e madh që ekziston lidhur me këtë çështje, e cila imponon nevojën për të kërkuar zgjidhje sa më të shpejtë dhe me kompetencë.

Lidhur me përdorimin e emërtimit *axhustator* mendoj se duhet tërhequr vëmendjen në këto çështje:

E para, sa i përket çështjes drejtshkrimore e do puna të tërhiqet vërejtja se në shqipe si trajtë e normëzuar, prandaj edhe e drejtë del vetëm trajta **axhustator** e jo trajtat e tjera që i ndeshim jo rrallë në jetën tonë publike si: *agjyster, agjystater, agjystator, axhusterues* e ndonjë tjetër.

E dyta, nëse edhe në gjuhën tonë del e nevojshme të dalë në përdorim aktiv folja axhustoj, siç del e shënuar në Fjalorin shqip-serbokroatisht 1981, atëherë normalisht mund të dalë prejpjesori **axhustues**, qoftë si sinonim, qoftë me kuptim tjetër që lidhet krykëput me kuptimin e foljes. Është e vërtetë, se trajta axhustator edhe sa i përket formantit prapashtesor ka fytyrën e trajtës së gjuhën italiane.

E treta, sipas përkufizimit që ka në gjuhën tonë fjala axhustator shihet njëfarë afërsie e madhe jo me termat **bravar** e **mašinbravar** të serbokroatishtes por me termin "**obradjivač (metala) ručnim radom**" /**përpunues i metalit me dorë**" (Shih: Pasqyra e profileve arsimore sipas degëve të shkallës së përgatitjes profesionale" të EKA të Kosovës, nën numrin rendor **1.a/IV-4** në degën "Makineri e përgjithshme" që u botua në gazetën "Shkëndija" nr. 5/87, f. 8.

Pra në bazë të përkufizimit të dhënë për fjalën axhustator në FGJSSH formulimi, përkatësish emërtimi **përpunues i metalit me dorë**, prandaj ekspertët këtë dukuri duhet ta kenë parasysh.

E katërta, siç u tha më përpara trajtat *adjuster (ajuster)*, *adjustater* të gjuhëve të huaja mund të përkthehen pa druajtje në shqipe me barasvlerësin axhustator (axhustues), por pa e mohuar të drejtën që në kontekste të caktuara në shqipe fjala e tillë të mund të zevëndësohet me trajta të tjera sinonimike si p.sh.: *ndreqës, rregullues, përshtatës, lëmues, përgatitës, riparues*, e të ngjashme dhe sidomos **përpunues** me dorë i metalit (lëkurës, stof-pëlhurave etj.), duke marrë edhe emërtimin përkatës togfjalësh.

E pesta, lidhur me pikën e mësipërme nuk duhet harruar faktin se termi axhustator nuk mbetet i rezervuar vetëm në fushën e përpunimit të metalit, po ai kalon edhe në fusha të tjera si p.sh. *axhustator i prodhimeve të gomës, axhustator i çorapave* etj., edhe pse në raste të tilla nuk është keq të shikohet mundësia e zëvendësimit të kësaj fjale të huaj me fjalë adekuate të shqipe, natyrisht vetëm në ato raste sa herë që këtë e lejon konteksti.

E gjashta, patjetër lypset rishikuar, më drejt duhet korrigjuar barasvlerësinë e trajtës **axhustator** për konceptet **bravar** e **mašinbravar** të serbokroatishtes duke gjetur në shqipe përgjegjësit adekuatë për nocionet në fjalë, ngase për të mbuluar nocionet e fjalëve të tilla të serbokroatishtes në shqipe fjala e huaj *axhustator* as që ka aftësi as mundësi, ngase mirëfilli, siç e pamë, shpreh diçka tjetër. Fundi i fundit as në FGJSSH përmbajtja e fjalës axhustator nuk përfshin konceptet e fjalëve **bravar** e **mašinbravar** të serbokroatishtes.

Gjithsesi për emërtimet **bravar** dhe **mašinbravar** të serbokroatishtes në shqipe duhet gjetur ose krijuar e parapëlqyer trajta të tjera më të përshtatshme e jo trajtën e vetme **axhustator**, siç po përdoret te ne.

Në të vërtetë, termi *axhustator* është plasuar gabim për termin **bravar** të serbokroatishtes, madje po bëhet gabim edhe më i madh, nëse këmbëngulet që edhe më të vazhdojë barasvlersia e tillë si një lajthitje patologjike. Në vend të trajtës **axhustator**, për **bravar** ndër ne janë përfutuar aty këtu edhe trajta të tjera si:

bravapunues, bravandreqës, çelësar, çelësabërës, bravar, drynar, kyçëtar, punonjës bravash, mjeshtër bravash, bravëtar, axhustomekanik

e ndonjë tjetër si dhe mekanik, mirëpo edhe pse cilido prtej tyre del më i drejtë se emri axhustator, deri më tash askush nuk ka kërkuar zëvendësimin e tillë të plotë (zyrtarisht).

Ç'është e vërteta, në gjuhën serbokroate, ashtu si në gjermanisht e frëngjisht, emërtimi i profesionit në fjalë është bërë duke u bazuar në mjetin (veglën) që punon punëtori i profesionit të tillë bravën (serbokr. brava (FSSH), por që si emërtim profesioni nuk mbetet vetëm në kuadër të kësaj vegle, por edhe të tjera të ngjashme. K. Kristoforidhi fjalën **bravë** e shënon si bullgarizëm, kurse Mikel Ndreca (FFSHH) e quan serbokroatizëm (në rusishte i thonë zamok).

Nëse ndiqet e njëjta rrugë e fjalëformimit në gjuhën shqipe d.m.th. formimi mbi bazë të mjetit konkret, atëherë termi edhe në shqipe mund të dalë **bravëtar** (bravë+tar) ose do të dilte edhe më përshtatshëm kompozita: **bravëpunues**. Ç'është e vërteta një mënyrë e tillë fjalëformimi në shqipe është fare normale dhe përkon me modelet e gjalla emërformuese që veprojnë në letrarishten e sotme, por siç del nga FGJSSH një formëzim i tillë nuk është bërë më përpara, përkatësisht forma e tilla nuk del e formëzuar ashtu në cilësinë e emërtimit të njeriut sipas profesionit, siç ka ndodhur b.f. me termin **bravar** të serbokroatishtes e në ndonjë gjuhë tjetër.

U tha më sipër se me termin **bravar** nuk kuptohet vetëm ai që punon bravat, por me të kuptohet "zejtari që punon brava, çelëse e të ngjashme" apo me të kuptohet ekskluzivisht "**zeja e mekanikut**" (Shih RSHKJ 1 f.257).

Ndër ne në rrethe të caktuara më tepër konkurren trajta **drynar** si barasvlerës për **bravar** të serbishtes, sesa ajo *bravar* a *bravëtar*, edhe pse fjala bravë si në serbokroatishte është fjalë aktive e fjalësit të gjuhës sonë.

Për të pasur një ide më të qartë lidhur me nocionin e këtij profesioni të emërtuar **bravar** konsultuam plan-programin përkatës "*Plani dhe programi mësimor i shkollave për kualifikimin e punëtorëve të degës metalike për të rritur të papunë*", EKSPA, Prishtinë 1973. Nga ai program mësuam se ky profesion nuk ka të bëjë vetëm me axhustimin e pjesëve të makinave, por i kalon caqet e "përpunimit a të lëmimit me dorë" të materialit metalik, duke mos u ndalur sigurisht vetëm në përpunimin e "bravave", por zgjerohet edhe me punimin e veglave të tjera, madje me anë të "shkrirjes e kalitjes me ujë e vajra" deri në "punimin e rrethimit në kulme e ballkone" të metalta, konstruktimin e tyre etj. duke kaluar kështu në profesionin e mirëfilltë të mekanikut.

Edhe në revistën "BAT" nr. 6/84 f.15 për termin axhustator thuhet se axhustatori (serb. bravar) duhet të ketë njohuri nga makineria dhe nga përpunimi komplet i metalit me dorë dhe me makinë" (Po aty f.15).

Sigurisht sipas shkallës kualifikuese punëtori i përgatitur për këtë profesion do të zgjerojë njohuritë në përputhje me planprogramet e caktuara të parapapërë për punëtorë të gjysmëkualifikuar, punëtorë të kualifikuar etj.

Sipas shkallës së përgatitjes profesionale profili i bravar-it (bravëtarit) cilësohet "punëtor i kualifikuar i profilit të gjerë, ose shkalla III e përgatitjes profesionale sipas ndërlikueshmërisë në punë, ndërsa profili i **mašinbravar**-it (mekanik i makinave) cilësohet "punëtor i profilit "**teknik**" me përgatitje të mesme profesionale ose shkalla IV e përgatitjes profesionale të ndërlikueshmërisë së punëve dhe detyrave.

Ç'është e vërteta emri *bravar* në serbokroatishte është një kalk i termit të gjermanishtes *Schlosser* (krahaso Schloss - brava, shqip bravë, dry), prandaj te Hajrullah Gorani e kemi të reflektuar *drynar - bravar, shloser* (FTSHE SHS f.75).

Gjithsesi këtu është fjala për profesionin e mekanikut që zgjat 3 vjet në sistemin aktual shkollor te ne kundrejt profesionit *mašinbravar* që zgjat katër vjet. Edhe në gjuhën serbokroate në burimet e caktuara normative, pranë trajtës bravar qëndron trajta sinonimike mehničar (mekanik), gjithashtu edhe në fjalorët përkatës të gjermanishtes për *Schlosser* në shqipe del barasvlerësi *mekanik* (Shih. FGJSH i Simonit f.348), mirëpo në gjuhën serbokroate, siç u tha më sipër trajta *bravar* tashmë del e formëzuar me "qytetari" të fituar si emërtim i profesionit të caktuar, madje me profilizime të ndryshme në numër mjaft të madh profilesh të ngushta.

Sa për ilustrim po cek në doracakun "Abecedni spisak zanimanja", SZS, Beograd 1986, janë shënuar mbi 120 emërtime perifrastike përfaqësuese si profesione të profilit të ngushtë me emrin *bravar*. Kjo tregon për zgjerimin që ka fituar kjo fjalë-term në gjuhën serbokroate.

Para se të shpreh mendimin se cili nga barasvlerësit e gjuhës shqipe mund të qëndrojë a duhet të favorizohet ndërgegjësisht, sipas mendimit tim, si përgjegjës ndaj trajtës *bravar* të serbokroatishtes, po them disa fjalë rreth kuptimit leksikor të termit tjetër **mašinbravar** të serbokroatishtes, pasi që fusha e kuptimit të këtyre dy termave si edhe e termit mehaniçar (mekanik) nuk ka aq kufi të prerë. Në të vërtetë, që të tre këta terma: **mehaniçar/bravar/mashinbravar** ndërkëmbehen a përkojnë në raste të caktuara, sidomos në stilin bisedor, pasi që lidhen me degën metalpërpunuese.

Edhe për termin **mašinbravar** (kroatisht: **strojobravar**) që është sinonim i togfjalëshit "**mašinski mehaniçar**" të serbokroatishtes në gjuhën shqipe ndër ne përveç trajtës shpifëse axhustator, siç e kemi cekur në një vend tjetër ndeshim aty-këtu edhe barasvlerës të tjerë (jo të zyrtarizuar), si:

makinëbravëpunues - mekanik, makinodrynar, drynar-mekanik, axhustator - mekanik, axhustator - makinerik si dhe mekanik i makinave, mekanik i makinerisë, axhustator-makinerie, mekanik makinash e ndonjë tjetër.

Nga plan-programi shkollor për kualifikimin e punëtorëve të degës metalike, konstatojmë se me profesionin e **mašinbravar**-it, nuk kemi të bëjmë assesi me profesionin e axhustatorit, sipas përkufizimit të dhënë në FGJSSH 1981, por është fjala për profesionin e një mekaniku të specializuar, i cili jo vetëm punon me "limë", por edhe "skicon, pret e sharrit" (...) "lakon e mbështjell", përdor "vidorët", kryen punë të ndryshme "qostëruese (grihëse), brejtëse, zdrukthime" e të tjera të metaleve, pastaj aftësohet për punë në të gjitha llojet e makinave "brejtëse, mprehëse" e të tjera duke arritur që të jetë i aftë deri edhe në "mirëmbajtjen dhe konservimin" e makinave të ndryshme.

Edhe në revistën "BAT", nr. 6/84 f. 15 lexojmë: puna kryesore e kësaj zeje (është fjala për *axhustator*(!) që në serbokroatishte i referohet barasvlerësit *mašinbravar* të serbokroatishtes), siç thuhet aty "*është montimi i makinave dhe i mjeteve si mirëmbajtja dhe riparimi i tyre*".

Sa për ilustrim po cek faktin se në në doracakun "Abecedni spisak zanimanja" që u cek më sipër ndeshen të regjistruara 43 emërtime përfaqësuese profesionesh me emrin *mašinbravar*.

Është e vërtetë se para se të lancohej termi **axhustator** te ne për termat **bravar**, përkatësisht **mašinbravar** është përdorur termi **mekanik**, si emërtim i zejes së punëtorit të përgatitur të profesionit metalik, i cili "ngre në këmbë ose ndreq makina, aparate e pajisje të ndryshme, teknik që mirëmban një makinë (FGJSSH f. 1106) përkatësisht *"punëtori teknik që ndërron dhe ndreq pjesë makinash e veglash dhe bën punë që kërkojnë përpikni të veçantë"* (FGJSH f. 303) dhe aspak nuk është gabuar, mirëpo për shkak se një term i tillë është shumë i përgjithësuar, dolën emërtime të tjera. Madje në gjuhën serbokroate me termin **mehaničar** përveç *"stručni radnik" a "stručni majstor", koji sklapa i popravlja mašine" /punëtor profesional a mjeshtër profesional, i cili monton dhe ndreq makina/, ka edhe kuptimin "stručnjak za primenjenu mehaniku" apo "naučnik koji se bavi primenjenom mehanikom" /ekspert për mekanikën zbatimore apo shkencëtar që merret me mekanikën zbatimore/ (Shih RSHKJ 3 N. Sad 1969 dhe MEP, Beograd 1978, f. 75), kështu që në serbokroatishte, ashtu si edhe në gjuhë të tjera për emërtimet që po trajtohen **bravar** dhe **mašinbravar** dolën emërtime të tjera, por që gjithnjë mbesin në kuadër të bashkësisë së profesioneve të profilit të gjerë "**mekanik**".*

Prandaj edhe në gjuhën tonë u reflektuan terma përkatës, për nocionet e caktuara të diferencuara, por që në mjaft raste ende nuk i kemi të konsoliduar, madje as të harmonizuar institucionalisht.

Nga sa u shtrua këtu del se edhe në gjuhën tonë është e nevojshme dhe e domosdoshme që të bëhet diferencimi i kuptimeve leksikore të termave: **adjuster**, **bravar**, dhe **mašinbravar** të serbokroatishtes, ashtu siç është bërë diferencimi në realitetin objektiv nga vetë degëzimi a profilimi i profesionit të *metalpunuesit* a të termit **mekanik**.

Kështu pra, gjithnjë duke i pasur parasysh shtrirjen e përdorimit të deritashëm të termave të caktuar në gjuhën shqipe në krahasim me termat adekuatë në gjuhë të huaja, natyrisht edhe të gjuhës serbokroate, ngase një kërkesë e tillë na imponohet, më poshtë po e propozojmë këtë zgjidhje:

1. Për temin **adjuster** të gjuhës serbokroate, përkatësisht të gjuhëve të tjera edhe në shqipe të përdoret termi **axhustator** (ose axhustues).

2. Për termin **bravar** në shqipe të konkurrojnë trajtat **mekanik bravapunues**.
3. Për termin **mašinbravar** në gjuhën tonë të përdoret termi **mekanik makinash** (makinomekanik).

U përcaktuam për trajtën **mekanik** plus fjala përcaktuese, sepse në gjuhën tonë fjala mekanik është më e kapshme dhe e përgjithësuar, madje siç u tha më sipër me emërtimin *mekanik* si hiperonim mbulohet, sipas FGJSSH edhe emërtimi **bravar** si dhe **mašinbravar** të serbokroatishtes.

Edhe në gjuhën serbokroate trajta *mehaničar* (mekanik) del si sinonim i fjalës *bravar* në doracakët e caktuar të emërtimit të profesioneve, kurse për *mašinbravar* del e shënuar trajta *mašinski mehaničar* (mekanik makinash).

Po ashtu edhe vetë fakti se në doracakun "Lista sistematike e profesioneve" (Sistematski spisak zanimanja, Beograd 1981) të dy termat *bravar* dhe *mašinbravar* bëjnë pjesë në kuadër të bashknjesisë së profesionit "mehaničari..." (mekanikët) flet në dobi të zgjidhjes që bëjnë lidhur me përcaktimin e mundshëm analogjikisht edhe në gjuhën shqipe.

Po shtoj edhe këtë se vetëm me emrin *mehaničar* + pjesë tjetër përcaktuese sqaruese në doracakun në fjalë janë mbi 150 emërtime profesionesh profilesh të ngushta të metalpunuesve.

Trajtat që ndeshen si axhustomekanik dhe makinomekanik janë përfitime të rastit dhe se në bazë të prirjes që është e pranishme në gjuhën tonë për këtë tip emërtimesh mbase edhe ato mund të arsyetohen, përkatësisht nuk shkojnë në dëm të emërtimeve të deritashme dhe gjuhësisht mund të përlligjen (krahaso: elektromekanik (elektromehaničar) -mekanik-elektricit-, hidromekanik (hidromehaničar - mekanik hidraulik, automekanik (automehaničar-mekanik automjetesh) etj., sidomos kur kemi parasysh prirjen e "gjuhës teknike" që termat që tregojnë bashkënjësi profesioni të përafërt të njëfjalëzohen. Si rast të ngjashëm po përmend trajtën makinodrynar (si barasvlerës të nocionit mašinbravar) siç doli në gazetën "Rilindja" të dt. 16.IV.1986 f.7.

Gjithsesi mendoj se një prirje e tillë trajtat **adjuster – axhustator, bravar – bravapunues** dhe mashinbravar - **mekanik makinash**, duhet të sforcohen barasvlerësisht.

Imponohet si nevojë e domosdoshme dhe e ngutshme që shkollat e mesme profesionale të ne si dhe Qendra për shkollimin e lartë në Ferizaj, e cila aftëson kuadro të këtij profili të punëtorëve me kualifikim të lartë, patjetër duhet të përcaktojnë emërtimet përkatëse dhe t'i harmonizojnë ato duke pasur parasysh edhe zgjidhjet eventuale në vendin amë, pasi që siç u tha në këtë trajtesë nuk i kanë termat e harmonizuar.

Jam i vetëdijshëm se tema e shtruar është mjaft komplekse dhe se në fund të fundit mendimet e mia janë vetëm propozime, të cilat duhet të shqyrtohen nga organet kompetente dhe së andejmi të jepen zgjidhjet përkatëse nga kuadrot e autorizuar.

Po përsëris, gjithsesi emërtimet shqipe duhet të harmonizohen në kuadër të trullit mbarëshqiptar dhe të sanksionohen me aktet përkatëse shoqërore e shtetërore.

9. RRETH TERMAVE DOKUMENTIST E DOKUMENTARIST

Lidhur me termat e profesioneve **dokumentist** dhe **dokumentarist** dalin dy çështje që kërkojnë sqarim, e para ka të bëjë me përcaktimin kuptimor të tyre dhe e dyta ka të bëjë me zbërthimin fjalëformues të tyre.

Meqenëse në asnjërin nga fjalorët tanë normativë dhe as në ata profesionalë (të fjalëve ndërkombëtare) nuk i ndeshim të regjistruar dhe së këtejmi as të shpjeguar kuptimin leksikor të fjalë-termave **dokumentist** e **dokumentarist**, edhe pse janë fjalë që po përdoren jo rrallë në realitetin tonë gjuhësor, sidomos në punën e bashkuar, për përkufizimin e tyre do të shërbehemi nga burime të gjuhëve të tjera, por edhe në mbështetje të përkufizimit që kanë ndërkombëtarizmat: **dokument** dhe **dokumentar** në shqipe.

a) Në bazë të fjalorëve shpjegues të gjuhëve të huaja, ku janë precizuar profesionet në fjalë dhe në bazë të përshkrimit të vendeve të punës për punët dhe detyrat e caktuara në organizatat punonjëse del fare qartë dallimi në mes të këtyre dy termave.

Me profesionin **dokumentist** kuptohet personi profesionist, i cili "hulumton, seleksionon, klasifikon, përdoron dhe shpërndan dokumenta" (Shih: *Nouveau petit LAROUSSE*, Paris 1972, f. 328), d.m.th. ai punonjës që vë në rregull materialin dokumentar, përkatësisht kështu quhet "eksperti i cili grumbullon, zgjedh dhe ruan dokumentat (RSHKJ 1, N. Sad 1967, f. 723), materiale këto që janë "të shkruara" dhe vlejné si dëshmi për qëllime të caktuara.

Me profesionin tjetër **dokumentarist** kemi të bëjmë me punonjësion profesionist a gazetarin filmor, i cili si "autor ose regjisor përgatit filma dokumentarë" a dokumentarët, me të cilët paraqiten "ngjarje a fakte të vërteta nga jeta a nga veprimtaria e përditshme" (FGJSSH 1980 f. 356), përkatësisht kështu quhet "reporteri filmik, i cili bën zgjedhjen e lëndës për filmin dokumentar" (RSHKJ 1, N. Sad 1967 f. 723).

Sidoqoftë, mendoj se po për këto kuptime fjalë-termat e mësipërm: dokumentist e dokumentarist duhet të kenë vend në burimet normative të gjuhës sonë.

b) Edhepse, siç mund të shihet nga zgjidhjet ose përkufizimet e mësipërme në aspektin fjalëformues nuk duhet të ketë paqartësi, pasi për emërtimin e njeriut sipas profesionit mbi temën e qartë fjalëformuese aktivizohet prapashtesa e specializuar -IST, megjithatë del e nevojshme të jepen shpjegime më të hollësishme, pasi që në burime të caktuara te ne po ndodhin shkelje të rregullës së tillë, sigurisht nën ndikimin e trajtave të caktuara të gjuhëve të huaja.

Në shqipe mënyra fjalëformuese del fare e qartë:

a) profesioni i parë dokumentist, si fjalë e prejardhur është formuar mbi bazë të fjalë-temës së parme dokument + prapashtesa -IST: **dokumentist**, ndërsa

b) profesioni i dytë dokumentarist është formuar mbi bazë të emër-temës së prejardhur dokumentar + prapashtesa -IST: **dokumentarist**.

Por meqenëse në gjuhën frënge profesioni i parë del në trajtën *dokumentalist* (d.m.th. nga mbiemri: dokumental + IST : documentaliste (Shih: Nouveao petit Larousse, Paris 1972, f. 328) edhe te ne si dhe në gjuhën serbokroate ndodh që emërtimi i tillë të shënohet: *dokumentalist*, siç ka dalë b.f. edhe në doracakun "Nomenklatura e profesioneve" të BVI për Punësim të KSA të Kosovës (1981), nën shifrën 591.21, për ekuivalencën dokumentarist të serbokroatishtes. Por edhe në serbokroatishte ndodh të dalë e regjistruar trajta *dokumentalist(a)*, siç e ndeshim të regjistruar nën shifrën 0323.05 të shfrytëzuar nga organizata punonjëse, siç është edhe në Sistematizimin e BP të Uzinës së Amortizatorëve të Prishtinës (1983 f. 24).

Në gjuhën serbokroate gjithashtu për nocionin e profesionit *dokumentarist(a)* përdoret edhe trajta *dokumentarac*, shih RSHKJ 1 N. Sad 1967 f. 723 që jepet nën 2., sepse kuptimi nën 1. është rezervuar për kuptimin e fjalës dokumentar d.m.th. me kuptimin *dokumentar filmi*. Kështu që në gjuhën serbokroate si sinonim i fjalës *dokumentarac* referohet edhe trajta *dokumentarist(a)*, pra duke mos i dalluar qartë këta dy terma në gjuhën e shkruar. Për këtë pasaktësi shih edhe shembullin **muzejski dokumentarista**, shifra 567, në doracakun "Lista alfabetike e profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar", EFS, Beograd 1961, f. 10 që në shqipe është përkthyer *dokumentarist* muzeumi , në vend **dokumentist mezeu**.

Lidhur me profesionin e dytë gjendja del më stabile, ngase edhe në frëngjishte del documentariste, it. documentariste etj., madje kjo trajtë del e regjistruar si ndërkombëtarizëm në fjalorët përkatës të fjalëve ndërkombëtare, shih edhe të "Rječnik stranik riječi" (B. Klaić, Zagreb, f. 317). Edhe në gjuhën shqipe profesioni në fjalë del i shënuar **dokumentarist**. Shih edhe të Lista alfabetike e profesioneve (...) nën shifrën 5577, f. 10.

Në fund po këmbëngul në kërkesën që në gjuhën tonë duhet të përdoret termi **dokumentist** (jo dokumentarist a dokumentalist), kur kemi të bëjmë me dokumenta, ndersa **dokumetarist**, kur kemi të bëjmë me dokumentarë filmikë.

Gjithsesi këta dy terma duhet të zënë vend së paku në fjalorët përkatës të fjalëve ndërkombëtare.

Prishtinë, qershor 1985.

10. ZDRUGUES APO RENDIST?

Për termin **rendisač** ose **metalorendisač** të serbokroatishtes në gjuhën tonë ende nuk e kemi të kristalizuar barasvlerësin adekuat. Është fjala për emërtimin e profesionit të caktuar në kuadër të degës metalike, por jo vetëm të kësaj dege dhe që lidhet me emrin përkatës të një vegël-pajisjeje që në serbishte quhet "mašina alatljika" ("vegël-makinë") me të cilën "punohet, zdrugohet a përpunohet metali" (Shih: "Prosvetni glasnik", nr. 9/80, Beograd, f. 862 -863), e cila në serbishte quhet rende a rendisaljka (që referohet si fjalë turke). Në praktikë dalin disa lloje të këtyre makinave.

Në serbokroatishte si sinonim i fjalës **rende** jepen edhe fjalët: **blanjača** dhe **strug**. Siç dihet nga emri strug (torno) në serbokroatishte del emërtimi i njëriut sipas profesionit: **strugar**, **metalostrugar** që në shqipe ka barasvlerësin **tornitor**, **metaltornues**, ndërsa nga **rende**, përkatësisht blanjača dalin termat e profesioneve **rendisač**, **metalorendisač**, përkatësisht **blanjač**, **metaloblanjač** që në shqipe ende nuk e ka të kristalizuar barasvlerësin gjegjëse. Në praktikën e derisotme, me sa di, sipas dokumentave përkatëse (të emërtesave të profesioneve) termi **rendisač** (metalorendisač, shifra 124.43, është përkthyer kështu: grirës (metalesh) (1979), rendisist (1972), zdruckthëtar (metalesh) (1981), renditës (radhitës) (!) (1981) si dhe **zdrugues**, shifra 505 (1981) /Viti i botimit është shënuar në kllapa/. Ndër këto trajta vetëm ajo e fundit, për mendimin tim mund të konsiderohet e qëlluar. Në organizatat e punës së bashkuar te ne një emërtim të tillë e ndeshim edhe në trajtën **pjalist**, sipas termit italian **pjala** (**zdrug**) dhe **rendist**, nga fjala **rende**, me elidimin e E-së fundore dhe me shtimin e prapashtesës -IST. Por që të dy këto trajta si dhe ato që u cekën më sipër mbetën me përhapje të kufizuar, ngase më tepër u parapëlqye në praktikë termi **zdrugues**, **metalzdrugues**, siç doli edhe në një konkurs të publikuar në gazetën "Rilindja", më 23. XI. 1983.

Termi **metalzdrugues** (nga zdrugues metali) është neologjizëm, për mendimin tim, pra, i qëlluar, pasi që është farkëtuar sipas natyrës së gjuhës

shqipe, d.m.th. nga fjalë-mjeti **zdrug** doli folja **zdrugoj** e së këtejmi prejpratori **zdrugues**, prandaj trajta **zdrugues**, përkatësisht **metalzdrugues** në krahasim me trajtat e tjera që u cekën më sipër del më e pranueshme.

Çështë e vërteta, fjalën **rendisaç** e ndeshim të përkthyer në shqipe me barasvlerësin **zdrugues** edhe në doracakun "Nomenklatura e profesioneve", Beograd 1972, f. 41 për emërtimin **rendisaç drveta - zdrugues i drurit**.

Sa është i drejtë dhe i vetëmjaftueshëm si barasvlerës fjala **zdrug** e shqipes për fjalën **rende** (rendisaljka, blanja, blanjalica, blanjača) të serbokroatishtes është çështje jo e parëndësishme dhe lidhur me këtë duhet ta thonë fjalën e vet ekspertët e caktuar, por në saje të konsultimit që kam bërë me personelin profesional tekniko-makinerik të degës së metalpunuesve kam fituar bindjen se një zgjidhje tillë është e qëndrueshme, ngase, me sa e di, në rrethe të caktuara te ne është duke u zbatuar dhe i plotëson parakushtet për zgjerim.

Pa marrë parasysh faktin se në FGJSSH për fjalën **zdrug** nuk është dhënë edhe kuptimi i vegël-pajisjes që e ka fjala **rende** në serbokroatishte, siç u cek këtu, kuptim ky që nuk e ka as fjala **zdrug**, që është "një vegël dore" e **zdrugthëtarit** (serb. stolasko orudje), nën hijen e së cilës qëndron edhe fjala **zdrug**, mendoj që duhet përkrahur zgjerimin kuptimor të fjalës **zdrug**, përkatësisht formëzimin e termit **zdrug** (**zdrugoj**, me **zdrugue** **zdrugues**) si barasvlerës për termin **rende** (rendisati, **rendisaç**) të serbokroatishtes, por edhe të veglave të ngjashme me të.

Nga sa u tha mendoj se mjafton sa për të paraqitur çështjen që është qëllimi ynë kryesor dhe njëherazi në nëntekst duam t'u tërheqim vëmendjen ekspertëve që çështjet si kjo nuk duhet lënë stihisë, por administrate, instituicioni, duhet me marrë zgjidhjen në duart e veta, kur dihet fakti që kuadro të tillë tashmë kemi të arrirë dhe se ka mundësi të konsultohen jo vetëm në punën e bashkuar dhe në realitetin tonë gjuhësor anembanë, por edhe më gjerë.

(Prishtinë, 14. III. 1984)

11. RRETH KRISTALIZIMIT TË TERMAVE TORNITOR DHE FREZATOR

Në kuadër të nomenklaturës së profesioneve të ne del e nevojshme të diskutohet edhe çështje e kristalizimit të termave tornitor dhe frezator, edhe pse këta dy terma nuk ndërkëmbëhen njëri me tjetrin dhe nuk paraqesin probleme të aspektit drejtshkrimor apo fjalëformues, por problemet rreth kristalizimit të tyre paraqiten të natyrës, pothuajse, të ngjashme. Kjo është edhe arsyeja që këta dy terma po trajtohen së bashku në këtë artikull.

Që të dy termat i takojnë të ashtuquajturit huazim transfer nga italishtja, përkatësisht sa i përket mënyrës fjalëformuese i takojnë tipit kuptimor që mbështetet mbi bazë të një emri konkret, mjetit të punës, ngase **tornitor** quhet "punëtori i përgatitur që punon me torno", ndërsa **frezator** quhet "punëtori i përgatitur që punon me frezë". (Shih FGJSSH f. 2009, 503.) Me një fjalë edhe emrat e veglave janë të njohura në përdorim e sipër edhe në realitetin tonë.

Siç dihet, **tornoja** është një "makinë e ndërlikuar me pajisje të nevojshme për prerje, për gdhendje. për shpime etj., që përdoret për të bërë pjesë këmbimi e punime të tjera me faqe zakonisht të rumbullakta nga copat e metalit, prej drurit e prej lëndës tjetër" (Aty f. 2009), ndërsa **freza** po ashtu është një makinë e posaçme e pajisur me një thikë e me një vegël prerëse me thëmbëza, e cila lëviz duke e rrotulluar për t'i dhënë trajta të ndryshme sipërfaqes së një sendi prej metali a prej druri ... (Po aty f. 503).

Edhe në gjuhën serbokroate emërtimet barasvlerëse kanë mbështetje fjalëformimi mjetet a pajisjet e punës p.sh. *strug strugar* (torno tornitor), përkatësisht *gloda-(glodača, glodalica) glodač* (frezë frezator).

Ç'është e vërteta, në gjuhën serbokroate sidomos në stilin administrativ tekniko-teknologjik (Shih për këtë edhe te "Prosvetni glasnik" nr. 9, Beograd 1980) emërtimet e tilla të metalpunuesit precizohen si **metalostrugar**, përkatësisht **metaloglodač**. Termave në fjalë u është shtuar

gjymtyra e parë metalo-, sigurisht nga nevoja për t'i dalluar mjeshtrin që punon me mjetin në fjalë vetëm metale, ngase me këtë makinë mund të punohet edhe druri, edhe plastika, madje edhe ndonjë material tjetër.

Edhe në gjuhën tonë lindi nevoja që me rastin e përimtimeve të profesioneve të dalin a të farkëtohen edhe emërtime të modifikuara si në serbokroatishte e në gjuhë të tjera, por që ende në truallin shqipfolës nuk dalin plotësisht të kristalizuar. Them janë të pakristalizuar termat e tillë, sepse emërtimet në fjalë dalin shumë trajtash për të njëjtin koncept, sidomos te ne.

Sa për ilustrim, më poshtë po i paraqit barasvlerësit përkatës që janë shënuar në burime të caktuara përballë emërtimeve në serbokroatishte:

1. **metalostrugar** (strugar) - *zdrukthëtar* (1969), shifra 214.41; *zdrukthëtar* (1972), shifra 114.21; *metalgdhendës* (1981), shifra 0614; *zdrukthëtar* (1981), shifra 214.41; *metalogdhëndës* (1981), shifra 505; *tornitor* (FSSH 1976); *tajar* (tornitor) (FSHS 1976); *metalprerës* (*metalgdhendës*), *tornitor* (*tajar*) (FSHS 1981).

Përveç emërtimeve të sipërshënuara të nxjerra nga burimet tona "zyrtare" normative në rrethe të caktuara ndeshim edhe trajtat si: *tornitor metali*, *tornitor metalik* si dhe *metaltornues*.

2. **metaloglodač** (glodač, frezač, frezer) – *brejtës* (*frezer*)(1969), shifra 214.42, *brejtës* (1972), shifra 114.22; *frezator* (*brerës*) (1981) shifra 114.42; *frezator* (FSHS 1976), *frezator* (FSHS 1981).

Edhe për këtë profesion, pos trajtave të cekura më sipër, ndeshim edhe trajta të tjera si p. sh.: *metalfrezer* ("Rilindja", 12.V. 1984 f. 17), *brejtës metalik* (26. IV. 1985), *metalfrezues* (13. V. 1984 f. 15) etj. (Viti i botimit është shënuar në kllapa).

Kështu për dy termat në shqyrtim u cekën burimet "zyrtare" me qëllim që jo vetëm të konstatohet fakti se nuk e kemi një dorë lidhur me barasvlerësin përkatës në fjalë, por edhe të tërhiqet vërejtja se në të ardhshmen nuk duhet të mbështetemi në burimet e tilla dhe si rrjedhojë, nëse janë shënuar jo si duhet duhet të korrigjohen, qoftë në dokumentat në

punën e bashkuar, qoftë në shkollat ku përgatiten kuadrot përkatëse. Sigurisht kjo vërejtje del edhe më e qartë pasi të japim mendimin se cila trajtë duhet parapëlqyer a që duhen favorizuar sidomos në rast të ribotimit të burimeve përkatëse.

Me qëllim që ta kemi edhe më të qartë problemin në trajtim, në vazhdim po japim pasqyrën e termave barasvlerës në fjalë në disa gjuhë dhe pastaj do të nxjerrim më lehtë konkluzionin.

Pasqyra e emërtimeve në shqyrtim:

Gjuha	E m ë r t i m i p ë r k a t ë s	
	1	2
serbokr.	strugar, tokar	frezer, frezaç, glodaç
rus.	tokar	frezer;
gjerm.	Dreher	Fräser;
angl.	turner	freser;
fr.	tourneur	fraiseur;
greq.	(ó) tornadoros	(ó) fresadoros;
it.	tornitore	fresatore;
shq.	tornitor (metaltornues?)	frezator. (metalfrezues?)

Pra siç po shihet nga pasqyra e mësipërme trajtat në shqipe, siç u tha, padyshim mund të konsiderohen si huazime transfer nga italishtja, megjithatë tema mbështetëse e të dy termave mund të cilësohet si fjalë ndërkombëtare, e cila si fjalë aktive del edhe në shqipe.

Kur kemi parasysh trajtën **tornitor** tashmë të konsoliduar në gjuhën shqipe, ma merr mendja se "shqipërimi" me trajtat zdrukthëtar, metalgdhendës, metalprerës etj. assesi nuk më duket me vend.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për trajtën **frezator**, prandaj "shqipërimet" si brejtës e brerës nuk më duken të mbështetura.

Ç'është e vërteta, duke mos i trandur trajtat e ngulitura **tornitor** e **frezator** neologjizmat e sipërcekura mund të përdoren për ndonjë profesion tjetër të profileve më të ngushta po në kuadër të profesionit të metalpunuesit si p.sh. **metalprerës** për **metalosekaç** të serbokroatishtes, **metalgdhendës** për **metalorezaç** etj.

Mirëpo kur themi se qëndrueshmëria e trajtave: *tornitor e frezator* nuk sillen në dyshim, nuk përjashtojmë mundësinë që këto trajta të goditen nga brenda, d.m.th. nga emri prejfoljor përkatës, siç janë foljet *tornoj* dhe *frezoj*, përkatësisht nga prejpjesorët: **tornues** **frezues**, prandaj në situata të caktuara dalin të qëndrueshme, madje edhe më të qëndrueshme trajtat si: **metaltornues**, **metalfrezues** si barasvlerës të mirëfilltë të trajtave **metalostrugar** e **metaloglodač** të serbokroatishtes.

Siç dihet trajtat: **metaltornues** e **metalfrezues** kanë model fort të kapshëm në shqipe siç janë edhe shembujt e tipit të njëjtë: *metalpunues*, *hekurpunues*, *metalsaldues* etj. Duke përcaktuar gjymtyrën e parë të kompozitës *metal-*, *hekur-* etj. lihet shtegu hapur që të farkëtohen edhe emërtime të tjera po mbi bazë të emrit te pajisjes së caktuar si p.sh. *dru-*, *plastikë-* etj.

Një qëndrim i drejtë rreth zgjidhjes së kësaj çështjeje do të ishte tejet i nevojshëm, jo vetëm për shkollat tona, por edhe për organizatat punonjëse, ku dihet se gjendja e terminologjisë tekniko-shkencore në shqipe del mjaft alarmante, ku bëjnë pjesë edhe emërtimet e caktuara të njerëzve sipas profesionit.

Gjithsesi në fjalorët tanë përkatës si dhe në burimet e tjera duhet të shënohen barasvlerësit përkatës si p.sh.:

1. serb. *strugar*, *metalostrugar* - shq. *tornitor* (*tornues*)- *metaltornues*),
2. serb. *glodač*, *metaloglodač* - shq. *frezator* (*frezues*), - *metalfrezues*.

Me parapëlqimin e zgjidhjes së mësipërme nënkuptohet fakti se kur është fjala për të njëjtin koncept emërtimet e tjera sinonime që u cekën më sipër nuk duhet të përdoren fare.

Sido që të jetë, edhe kjo çështje terminologjike duhet zgjidhur në raport ndërkombëtar e kombëtar në fushë të shqipes.

Prishtinë, 1985

12. RRETH PAPERSHTATSHMËRISË SË TERMIT PARAPUNËTOR

Në doracakun zyrtar të nomenklaturës së profesioneve të Byrosë Federale për Punët e Punësimit, "Udhëzim", Beograd 1969 (teksti në gjuhën shqipe), në mbi njëzet raste, si gjymtyrë e parë e togfjalëshit të profesionit të caktuar është shënuar fjala **parapunëtor** për barasvlerësin e gjuhës serbokroate *predradnik*. Kështu është vepruar edhe në doracakun e vitit 1972 të Entit Krahinor për Inkuadrim - Prishtinë, ndërsa në doracakun (fomularin) e Bashkësisë Krahinore për Punësim të vitit 1980 për termin **predradnik** të serbokroatishtes është dhënë ekuivalenca **ripunëtor**.

Mendoj se të dy trajtat **parapunëtor** dhe **ripunëtor** janë krijime të paqëndrueshme, por kjo e dyta *ripunëtor* është tejet e paqëlluar dhe nuk besoj se do të ketë pasur jetë as deri te dyert e organizatave gjegjëse prodhuese të punës së bashkuar, ndërsa trajta tjetër **parapunëtor** ka arritur të gjejë strehim në zyret e disa referentëve, në dosjet personale, përkatësisht në sistematizimet e punëve dhe të detyrave të organizatave punonjëse si p.sh. në TC "Kosova" të Obiliqit, "Feronikeli" të Gllogocit, "INKOS" Prishtinë, siç doli edhe në gazetën "Rilindja" më 18.VI.1984, f.17; 22.IX.1984, f.19; 14.V.1986, f.18; 4.I.1987, f.19; 9.IX.1985 f.19 etj.

Trajta **parapunëtor** është një kalk i krijuar sipas modelit të gjuhës serbokroate *predradnik*: *pred* + *radnik* = *para* + *punëtor*, nga parashtesa *para* - (pred) dhe emri *punëtor* (*radnik*) dhe nuk qëndron, sepse nuk ka mbështetje pikërisht sa i përket kriterit semantik që është kriter i domosdoshëm lidhur me formimin e fjalëve të reja në gjuhën tone mbasi me prapashtesën *para*- në gjuhën shqipe nuk duket që krijohen fjalë të kësaj fushe semantike, andaj me një veprim të tillë është bërë shkelje e rëndë e strukturës termformuese të gjuhës sonë.

Ç'është e vërteta, edhe në gjuhën shqipe si në atë serbokroate formohen emra të prejardhur prej emrash me prapashtesën *para*- si p.sh.:

pararojë - prethodnica, parapërgatitje - predsprema, parashtesë - predmetak (prefiks), parashikim - predvidjanje, parathënie - predgovor etj.

dhe krijimet e tilla janë të qëndrueshme, sepse në të dyja gjuhët përputhet roli a funksioni fjalëformues i parashtesës së caktuar *para/pred* që "jep idenë e një gjëje të një gjendje a të një veprimi që gjindet a kryhet para një tjetri" (shiko: Xhuvani - Çabej "*Parashtesat e gjuhës shqipe*", E, Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë 1976 f.171), ndërkaq tek shembulli konkret *predradnik* - **parapunëtor** nuk kemi të bëjmë me një kuptim të tillë që të mund të përputhet, por kemi të bëjmë me një kuptim tjetër jashtë fushës kuptimore ku do të hynte në punë parashtesa **para-** e shqipes, por që në gjuhën serbokroate përshtat, pasi që në atë gjuhë krijohen fjalë, emra njerëzish, prej emrash me parashtesën **pred-**, të cilët tregojnë "një pozitë më të lartë, eprorësi" (vishi položaj, starešinstvo - Rečnik srpskohrvatskoga književnoga jezika, 4, N.Sad 1971 f.889.) në krahasim me njerëzit e tjerë si p.sh. predvodnik (udhëheqës, prijatar), predsednik (kryetar), prestojnik (epror, drejtor) si dhe predradnik që do të thotë "*punëtor i aftë(suar) a i zoti dhe me përvojë, i cili kryen punë përgatitore dhe udhëheq (drejton) në kryerjen e punëve*" (*vešt i iskusan radnik koji vrši pripreme radove i predvodi u poslu*) -RSHKJ f. 10), përkatësisht është punëtor - drejtues i punëve të një grupi punëtorësh, ndërsa në gjuhën tonë emërtimet e tilla që tregojnë një funksion a "pozitë më të lartë" nga të tjerët nuk marrin parashtesën para-, siç u pa në shembujt e mësipërm, por këtë e bëjnë në mënyrë e mjete të tjera. Pra këtu qëndron dallimi i këtyre parashtesave dhe këtë duhet ta kemi patjetër parasysht.

Është e vërtetë se në Fjalorin shqip - serbokroatisht të IA, Prishtinë 1981, është shënuar neologjizmi pararojës (që nuk e ka FGJSSH) për barasvlerësin e gjuhës serbokroate izvidnik, predvodnik, por këtë rast prapashtesa -S i është shtuar tërë fjalës kompozitë pararojës si temë prodhuese, madje këtu nuk është fjala për vend udhëheqës pune, prandaj pa mëdyshje mund të konstatohet se trajta *parapunëtor* është rast i veçuar në gjuhën tonë dhe se është krijuar në kundërshtim me kriterin semantik fjalëformues të gjuhës sonë dhe për këtë shkak duhet të hiqet nga përdorimi.

Në organizatat e punës së bashkuar te ne si p.sh. në Uzinën e Amortizatorëve të Prishtinës nuk përdoret termi *predradnik* (parapunëtor) dhe për një kuptim të ngjashëm përdoret termi **regler** (në të dy gjuhët), në OP "Ballkan" të Suharekës (sipas një dokumenti që më ra në dorë) praktikohet termi **brigadier** (brigadir), madje ka raste në organizata të

ndryshme për vende të ngjashme pune të përdoren termat **kryemjesh tër** (glavni majstor), **grupdrejtues** (grupovodja) e ndonjë tjetër, por kjo nuk do të thotë se kuptimi i fjalës **predradnik** është i mbuluar (zëvendësuar) me terma të tillë, të cilët mund të kenë fusha të tjera të nuancuara semantike, prandaj gjithsesi mbetet çështja e hapur e problemore gjetja a përcaktimi i barasvlerësit adekuat në gjuhën tonë për termin *predradnik*.

Është me interes të ceket fakti dhe të dihet arsyeja pse kjo fjalë nuk është përfshirë në asnjërin nga fjalorët serbokroatisht - shqip e anasjelltas të hartuar te ne, çka do të thotë se kjo është hera e parë që trajtohet një term i tillë, përkatësisht kërkohet mënyrë kompetente që të gjindet barasvlerësi përkatës për termin *predradnik* në gjuhën tonë.

Në bazë të përkufizimit që jepet në gjuhën serbokroate për fjalën *predradnik* dhe në bazë të funksionit konkret që kryen personi i caktuar në organizatat tona prodhuese mund të nxjerrim si përfundim që kësaj fjale në gjuhën tonë më së miri i përgjigjet termi **kryepunëtor** d.m.th. "ai që drejton punën që bëjnë një grup punëtorësh" (FGJSH 1954 f.242) pa marrë parasysh se në FGJSSH 1980 fjala *kryepunëtor* shënohet si fjalë e vjetëruar "mjesh tër a dikush me përvojë që drejonte, organizonte e kontrollonte punën e një grupi punëtorësh.." (Aty f.896) Ç'është e vërteta, sipas FGJSSH më të rekomandueshëm do të dilnin termat: **përgjegjës** (i grupit) a **udhëheqës** (i grupit) apo edhe termi **brigadier** "drejtues i një brigade prodhimi, ai që është në krye të një brigade prodhimi" (Po aty f.179).

Nuk di sa është me vend favorizimi i fjalës *brigadier*, por duke pasur parasysh kushtet tona, shtytësit jashtëgjuhësorë dhe brendagjuhësorë, më duket se më e arsyeshme është të parapëlqehet trajta **kryepunëtor**, sesa ajo **brigadier**, kur dihet se edhe në gjuhën frënge a italiane (prej nga ka ardhur një fjalë e tillë *brigadiere*) nuk e ka kuptimin parësor siç po kërkohet këtu, por për profesionin (funksionin) e tillë kanë terma të tjerë, siç do të shohim më poshtë.

Mirëpo, për përqafimin e termit **kryepunëtor** te ne paraqitet një vështirësi, sepse me këtë trajtë në fjalorët e caktuar te ne është shënuar barasvlerësi i gjuhës serbokroate **poslovodja** dhe për këtë duhet dhënë sqarimet e duhura në mënyrë që të kuptohet mirë e drejtë ajo që synohet.

Me termin **poslovodja** në serbokroatishite kuptohet "një person zyrtar që udhëheq punët e zyrës" ("službeno lice koji vodi kancelarijske poslove"), përkatësisht "ai që drejton (administron) ose udhëheq anën teknike të

punëve të caktuara të ndërmarrjes etj." ("onaj koji upravlja ili rukovodi tehničkom stranom kakvoga posla produzeće i sl." (RSHKJ 4, f. 752) që është i një rangu më të lartë në "hierarkinë udhëheqëse" në krahasim me termin **predradnik**.

Fjala **poslovodja** është përfshirë në fjalorët e caktuar serbokroatisht-shqip e anasjelltas të hartuar e të botuar te ne dhe për këtë kryesisht janë dhënë barasvlerësit:

drejtues pune, udhëheqës (FSSH 1947), **punëdrejtues, përgjegjës** (i njëj pune) (FSSH 1953), **punëdrejtues, gjerent, shef punëtorie** (FTSSH 1961, f.268), **kryepunëtor, punëdrejtues, udhëheqës pune** (i punës), **përgjegjës pune, drejtues i oficinës, udhëheqës fabrike** (FSSH 1974, f. 585), **kryepunëtor** (FTE SSH 1973; FSHS 1976, ETJ SSH 1979) dhe **punëdrejtues, kryepunëtor** (FSHS 1981).

Pra kryesisht mbizotërojnë barasvlerësit **punëdrejtues** dhe **kryepunëtor**. Në doracakun regjistrat e nomenklaturës së profesioneve që nga viti 1972 për **poslovodja** jepet barasvlerësi **kryepunëtor**, ndërsa në doracakun "Terma nga LPB" (projekt), Prishtinë 1977, f. 53 jepet vetëm trajta **punëdrejtues**.

Nuk e kam të qartë pse qenë aq dorëlibër hartuesit e fjalorëve kur si barasvlerës të termit *poslovodja* përdorën fjalën *kryepunëtor*, që siç shihet nga përkufizimi nuk mbulon një kuptim të tillë dhe hoqën dorë nga fjala **punëdrejtues**, e cila i përgjigjet më mirë a plotësisht kuptimit të termit të tillë.

Është e vërtetë se në FGJSSH asnjëri nga termat në fjalë (as *kryepunëtor* dhe as *punëdrejtues*) nuk rekomandohen, por në saje të nevojës së domosdoshme që paraqitet si dhe në mbështetje të shtytësve jashtëgjuhësorë e brendagjuhësorë dhe në dritën e parimeve të shtruara për krijimin ekompletimin e terminologjisë tekniko-shkencore etj., mendoj se termat e caktuar mund të qëndrojnë e sidomos kur kemi parasysh barasvlerësit e caktuar jo vetëm të gjuhës serbokroate, por edhe të gjuhëve të tjera, siç do të shihet në pasqyrën e më poshtme.

Pasqyra e barasvlerësve në disa gjuhë

serbokr. gjerm.	predradnik Vorarbeiter	poslovodja; Betriebsleiter, Polier, Geschäftsführer, Produktionsbiter;
angl. fr.	foreman contraimetre	menager, head - worker; gérant (chef de la peoduction);
it. shq.	primolavorante kryepunëtor	gerente (gestore); punëdrejtues (përgjegjës prodhimi, pune).

Siç po shihet **predradnik** është krijuar sipas modelit të gjuhës gjermane, ndërsa trajtat e gjuhës shqipe kanë modelet në strukturën fjalëformuese të vetë gjuhës sonë, edhe pse mund të jenë të motivuar nga gjuhët tjera.

Në fund e shoh të arsyeshme që sa për orientim të shënoj disa terma të kësaj natyre në të dy gjuhët sipas rangimit që dalin sipas punëve e detyrave me përgjegjësi e autorizime të posaçme:

predradnik - kryepunëtor,
nadzornik mbikqyrës,
poslovodja - punëdrejtues,
upravnik - drejtues,
rukovodilac - udhëheqës,
direktor - drejtor,
generalni direktor - drejtor i përgjithshëm
(inokosniposlovodni organ)- (organ i vetëm punëdrejtues).

Gjithsesi trajta *parapunëtor* dhe ajo *ripunëtor* nuk qëndrojnë e për barasvlerësit adekuatë, siç u përmendën këtu duhet të kihen parasysh faktet që u shtruan më sipër.

13. LAJMËRUESE APO PARAQITËSE E PROGRAMIT TË TV-SË?

Në listën e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit me gjini përfaqësuese femërore, me moshë relativisht të re, si çështje e diskutueshme, paraqitet edhe problemi i barasvlerësisë ndaj emërtimeve **najavljivačica TV programa** të serbokroatishtes, e cila te ne është përkthyer në trajtën **lajmëruese e programit të TV-së**, por edhe në trajtën **paraqitëse e programit të TV-së**, e cila ka përdorim më të gjerë në shqipe.

Meqenëse të dy termat e shqipes kanë të bëjnë me konceptin e njëjtë, në këtë trajtesë do të bëjmë fjalë rrerth përgjigjesh në pyetjen: cila nga këto dy fjalë-terma ka më shumë gjasa për t'u favorizuar.

Në Kosovë, siç është vënë re edhe nga studiues të tjerë, shihet një tendencë që folja lajmëroj (me derivatet e saja përkatëse) të përdoret e formëzuar si term me kuptim të zgjeruar, madje edhe më tepër se që i takon, ngase me një zgjerim të tillë cenon sadopak autonominë kuptimore të trajtave të tjera sinonimike si b.f.: njoftoj, informoj, kumtoj, njoh, paraqit, bëj me dije etj.

Një zgjerim a favorizim i tillë vihet re edhe lidhur me përdorimin e fjalë-termit lajmëruese, në termin togfjalësh: "**lajmëruese e programit televiziv**" ndaj trajtës tjetër kundërvënëse: **paraqitëse e programit televiziv**.

Nga përshkrimi i punëve dhe detyrave, sipas Rregullores mbi sistematizimin e punëve dhe të detyrave të TV të Prishtinës (1983) mësojmë se punëtorja e caktuar në vendin e punës, siç figuron aty "**lajmëruese e programit të TV-së**, përkatësisht **najavljivačica TV programa**, ka për detyrë të njohë shikuesit (telespektatorët) me programin e emisioneve, në fillin (në hapje) me programin ditë të emisioneve, pastaj herë pas herë dhe në rast nevojë bën me dije për ndryshimet e eventuale, kërkon ndjesë (falje) për pengesat a ndërprerjet e rastit në program etj. dhe në mbyllje i njej

shikuesit me programit e TV-së për ditën e nesërme apo për emisionet që do t'i shikojnë në të ardhshmen në terminet e caktuara.

Punonjësja e caktuar që gjithsesi është femër relativisht në moshë të re duhet t'i plotësojë, pos kushteve të përgjithshme edhe disa kushte të veçanta, siç është b.f. leximi i bukur ku nënkuptohet diksioni letrar etj., por duhet të jetë në rregull edhe nga pamja e jashtme fizike, ku merret parasysh fytyra, kraharori, qafa, buzët e dhëmbët etj., pasi që me paraqitjen e programit ajo në të vërtetë paraqitet edhe vetë fizikisht në ekranin televiziv dhe për këtë arsye sjellja e saj duhet të jetë e kujdeshme, në mënyrë që paraqitja ose pamja e saj të jetë jo vetëm sa më e kulturuar, dhe joshëse, por, me fjalë të tjera, të shërbejë në njëfarë mënyre edhe si "element" freskues për shikuesit, prandaj kërkohet që ajo të jetë e bukur dhe fotogjene. Për dallim nga spikerët (folësit) e tjerë, sipas rregullit, ajo nuk lexon lajme, siç janë ditarët televizivë si dhe emisionet e tjera informative, pakashumë të natyrës serioze, por, siç u tha bën paraqitje të rastit etj.

Lexuesi i kujdesshëm, nga sa u tha më lartë, ka mundur të vërejë dy gjera: e para, *paraqitësja e emërtuar*, me paraqitjen e programit *paraqitet* edhe vetë dhe e dyta, nuk lexon lajme e lajmërimet zyrtare të natyrës serioze, por vetëm bën paraqitje të rastit, prandaj në bazë të këtyre dy tipareve mund të thuhet me plot gojë se nocionit të tillë më tepër i përgjigjet në shqipe termi togfjalësh: **paraqitëse e programit** sesa **lajmëruese e programit**.

Folja *lajmëroj*, në mbështetje të së cilës ka dalë edhe emri i vepruesit **lajmërues lajmëruese** si dhe emri i veprimit **lajmërim**, sipas FGJSSH-së, nuk përfshin në kuptimin e vet leksikor si kuptim të mirëfilltë konceptin që u cek më sipër, sipas organikës së caktuar. Si sinonim i parë më i përafërt i fjalës **lajmëroj** vjen folja **njoftoj** (njoftim) e jo folja **njoh** dhe as ajo **paraqit**, të cilat edhe u përmenden në përshkrimin e vendit të punës të *paraqitëses* ... , siç e pamë më sipër.

Me foljet **lajmëroj** e **njoftoj** zakonisht, në stilin administrativo-juridik (informativ), pak a shumë i takojnë, si të thuash, natyrës serioze thjesht zyrtare, ndërsa me foljen **njoh** a **paraqit** vihet në dijeni apo "bëhet me dije lidhur me "programin e emisioneve", siç thuhet në FGJSSH 1980 f. 1294, përkatësisht shikuesve, u bëhet e njohur me pak fjalë përmbajtja e programit, që do të shohin në ekranin televiziv (Po aty f. 1365.)

Me fjalë të tjera, termi togfjalësh **paraqitëse e programit TV** parapëlqehet jo vetëm pse i përgjigjet më së mirë nocionit në shqyrtim, pasi që me paraqitjen e programit bëhet edhe paraqitje fizike e paraqitëses,

kryeses së punëve dhe detyrave nga vendi i punës, por edhe pse ka praktikë më të gjatë përdorimi ndaj neologjizmës **lajmëruese programit TV**.

Nga sa u tha më lartë del se më natyrshëm është të përdoret termi **paraqitëse e programit** sesa **lajmëruese e programit** dhe me një përqafim të tillë te ne do të bënim edhe një hap të nevojshëm drejt harmonizimit ose njëzimit të emërtimeve të caktuara në kuadër të emërtesave të profesioneve në gjuhën shqipe në shkallë kombëtare, që sigurisht është edhe qëllimi programor i TV Prishtinës në gjuhën shqipe.

14. RRETH PROFILIMIT TË EMËRTIMEVE GRIHËS DHE MPREHËS

Edhe rreth profilimit të emërtimeve të profesioneve **grihës** dhe **mprehës** në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhës serbokroate **brusač** dhe **oštrač**, sidomos te ne, del e nevojshme të jepen sqarimet e duhura, pasi që në praktikë paraqiten inkonsekuenca të dukshme, ngase në fjalorët tanë dygjuhësh, por edhe në burime të tjera nuk janë dhënë zgjidhje të kënaqshme.

Në Fjalorin serbokroatisht shqip (1974) nuk është përfshirë fare fjala **oštrač** e serbokroatishtes, ndërsa për termin **brusač** janë dhënë të dy sinonimet barasvlerëse: **grihës** dhe **mprehës**. Ndërkaq, në fjalorin shqip - serbokroatisht (1981) si barasvlerës i termit **grihës** në serbokroatishte veç termit barasvlerës **brusač** është dhënë edhe ai **mprehës**, ndërsa si barasvlerës për fjalë-termin **mprehës** në serbishte janë dhënë edhe dy barasvlerës të tjerë: *oštrač*, *brusač*, *glača*, *brusilac*. Pra edhe këtu si barasvlerës i parë është shënuar trajta **oštrač**.

Sidoqoftë në vijim do të bëjmë fjalë më në hollësi rreth të dy fjalë-termave në shqyrtim: **mprehës** e **grihës**.

1) Rreth fjalë-termit **mprehës**

Në stilin bisedor mbase këta dy terma mund të kenë qenë të këmbyeshëm, madje në rrethe të caktuara mund të jenë të tillë edhe sot. Si duket këtu qëndron edhe arsyeja që edhe në fjalorët përkatës i ndeshim të regjistruar termat në fjalë pa dallime të qarta semantike. Por kur është fjala te emërtimet e caktuara të profesioneve të profiluara, kur dihet se nevoja e profilimit ka ardhur më vonë d.m.th. ndërkohë me zgjerimin e nevojave teknologjike, kështu që sot për sot në stilin zyrtar këmbyeshmëria e tyre assesi nuk mund të jetë e tolerueshme, sepse kemi të bëjmë me profesione a bashkënjësi profesionesh të ndryshme, siç do të shohim më poshtë.

Edhe në dokumentat zyrtarë të botuar te ne dalin mjaft paqartësi. Kështu, në doracakun "Udhëzim për plotësimin e "Deklaratës" së nevojës për punëtorë...", Beograd 1969, për **oštrač** është shënuar në shqipe barasvlerësi **mprehës** ashtu si edhe për **brusač**. Nga kjo del se te ne më i njohur del emërtimi **mprehës** se ai **grihës**.

Në doracakun tjetër "*Paraqitja e nevojave për punëtorë*" (EKP), Beograd 1972, zgjidhja del "disi edhe më e çoroditur. Aty për **oštrač** jepet në gjuhën tonë përgjegjësi **prefës mprefës** (!), ndërsa për **brusač** del **mprehës**(!). Në të vërtetë për **brusač** në shembuj të veçantë jepen edhe përgjegjësit: **lëmues** dhe **brushtar**(!).

Në doracakun "Lista alfabetike e profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar" (EFS), Beograd 1981 për **oštrač** është dhënë fjala **mprehës**, ndërsa për **brusač** **qostër (toçillë!)** që do të thotë se nuk është përthyer fare. Mbase përkthyesi nuk kishte njohuri për barasvlerësin **grihës** e ndonjë tjetër. Ndoshta ky fakt ka ndikuar që te ne në rrethe të caktuara dëgjohet herë-herë përgjegjësi **qoster qosteri**, trajtë kjo që për **brusač**, vërtet, s'ka kurrfarë mbështetje.

Në "Formularin mbi nevojat afatmesme për kuadro deri në vitin 1985" të EKP-së te dy termat e serbokroatishtes në shqipe, si në disa burime të tjera, përkthehen njësoj, vetëm me emërtimin: **mprehës** edhe në togfjalësja, si p. sh:

1. **mprehës** - **brusač**, shifra 214.47; ndihmës **mprehës**- pomočni **brusač**, shifra 114.24;

2. **mprehës** i veglave - **oštrač** alata, shifra 214.45; ndihmës **mprehës** - pomočni **oštrač**, shifra 114, 26.

Në organizatat e punës së bashkuar gabimet e tilla kaq të rënda besoj se nuk janë lejuar, ngase në praktikë profesionet e caktuara dallohen qartë, mbasi dihet se kemi të bëjmë me profesione a punë a detyrime të diferencuara, por gjithsesi problemi i tillë është i hapur dhe i pazgjidhur jo vetëm në shkresa e regjistra, e shkaktuar nga pa aftësia e përkthyesve. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia, që në ndonjë organizatë mund të ketë edhe zgjidhje parciale.

Me sa di unë, në organizatat e punës së bashkuar dhe në shkolla që merren me veprimtari të profesioneve të tilla për emërtimin **brusač** të serbokroatishtes në shqipe përdoren edhe këta terma gjoja "standard": **retifikator (retifikues)**, **qostërues** dhe **grihës (grihues)** që siç u pa më

sipër asnjëri nga këta nuk është përfshirë në dokumentet zyrtare të cekura më sipër.

Para se të jap mendimin se nga këta tre barasvlerës cilit duhet dhënë përparësi si ekuivalent i vetëm i termit **brusač** të serbokroatishtes dhe i barasvlerësve përkatës të gjuhëve të tjera po për këtë koncept, po i them sa fjalë rreth emërimit **mprehës**, i cili mendoj se rri mirëfilli për ballë termit **oštrač** të serbokroatishtes.

Termi **mprehës** është krijuar sipas procesit të punës d.m.th. mbi bazë foljore, që si emër prejfoljor ka për temë foljen **mpreh** (me mprehë) dhe prapashtesën -(ë)S.

Me termin **mprehës**:

(gjerm. Abzieher, anglisht grinder, frengjisht aiguseur, rusisht točilshqik, serbokroatisht oštrač)

kuptojmë "punëtorin që mpreh përdorëse të ndryshme" (FGJSSH-1980) ose "mjeshtrin që mpreh përdorëse për prerje" (*zanatlija koji oštri naprave za sečenje*) (RSHKJ - N.Sad 1976.) dhe si emërtim zyrtar i profesioneve përveç emërimit **mprehës** (shifra 114-26) del edhe togfjalësi: **mprehës i veglave**, serb. **oštrač alata**, shifra 214-45, por që mund të ketë edhe emërtime të tjera perifrastike të rastit a të profiluara si veglamprehës-specialist (shifra 505) etj.

Në "*Programin mësimor për shkollat teknike profesionale*" (Shih: Prosvetni glasnik, Beograd -1930 nr.9.) për profesionin **mprehës i veglave** (**oštrač alata**) që fillon të mësohet në klasën e tretë (III) të AMO-s të degës metalike, përcaktohet se punëtori i tillë duhet të aftësohet për mprehjen e veglave, përkatësisht të dijë të përdorë qostrat (tocilat) për të mprehur thikat e zdrugave a të tornove (serb. strugarskih noževa), turjelat (burgije), frezat (glodala), madrovidet meshkuj e femra (ureznice i nareznice) si dhe përshkuesat a makinat përshkuese (povlakače).

Pra **mprehësi** përdor qostrat, makinat mprehëse e të ngjashme ku bën pjesë edhe **griha** a **grihësja**.

U tha më sipër se në rrethe të caktuara tek ne po përdoret termi siç është në FSHSK (1981) f799) **retifikator** a retifikues për **brusač** dhe **oštrač**, gjë që nuk është mirë të përgjithësohet si barasvlerës i vetëm, jo pse është fjalë e huaj e huazuar, por pse kemi të bëjmë me dy koncepte profesionesh, të cilat më mirë mbulohen me trajtat e tjera: **grihës** dhe **mprehës**, të cilat, siç u tha më sipër, qoftë në shkolla profesionale, qoftë në punën praktike në organizata prodhuese profesionet e tilla dalin të diferencuara qartë, sipas proceseve teknologjike. Ndërkaq, trajta **retifikator**

është huazim nga italishtja (Krahaso foljen it. *retificare* - retifikoj, ndreq, drejtoj, korrigoj). Në FSHSK-1981 është dhënë emri i makinës retifikë-a për brusionica, brusilica, apo oštrica, mašina (sprava za oštrenje) si dhe folja retifikoj për oštriti, brusiti, glačati bashkë me termin retifikator.

Ç'është e vërteta, nga dy fjalorët që konsultova të gjuhës italiane doli se *rettificatore* (në stilin elektr.) ka sinonimi me fjalë-termin komutator, raddrizzator (rrymë), përkatësisht në gjuhën italiane për këtë koncept parapëlqehet raddrizzatore d.m.th. ka kuptimin e një makine rrafshuese që në serbokroatishte quhet **ravnalica** e jo **brusilica**, siç do të duhej të dilte në bazë të kuptimit që ka fjala retifikë në gjuhën shqipe si një italianizëm i kulluar.

Në gjuhën frënge për brusalica përdoret barasvlerësi *rectifieuse*. Por do ditur se secila gjuhë ka përdorimin specifik të termave të caktuar. Nga krahasimi i lëndës së shënuar në një nga fjalorët përkatës të terminologjisë teknike dygjuhëshe frëngjisht - serbokroatisht doli se në 28 shembuj të përdorimit të fjalës **brusilica** të serbokroatishtes në gjuhën frënge si term adekuat del e shënuar trajta *retifieuse* vetëm në 11 raste.

Si përfundim mund të nxjerrim se ky term i huaj retifikator për emërtimin e profesionit në fjalë nuk duhet parapëlqyer për arsye edhe të vetë mjetit, i cili nuk është gjithëpërfshirës për profesionin në shqyrtim.

Sa i përket emërtimit të termit **qostërues** konstatohet lehtë se është emër vepruesi i formuar mbi bazë të foljes *qostëroj* e kjo nga fjalë-tema *qostër*. U tha më sipër se trajta **qoster** si emërtim i njeriut sipas profesionit, vërtet, nuk ka karrfarë mbështetjeje, aq më tepër kur edhe trajta *qostërues* nuk del fort e favorizuar.

Fjala *qostër* në gjuhën shqipe ka kuptimin "makinë që shërben për të mprehur thika, brisqe, sëpata etj" (FGJSSH 1954) ose "rrotë guri që rrotullohet me anë të një këmbëze për të mprehur thika,, sëpata etj." (FGJSSH 1980) dhe duke u bazuar në këto përkufizime mund të quhet i drejtë barasvlerësi që është dhënë në gjuhën serbokroate *tocil, tocilo* - stroj za brušenje" (FSHS 1981 që ka ngjashmëri me përkufizimin "brus u obliku točka koji se okreće oko svoje osovine" /grihës(e) në formë rrote që sillet (rrotullohet) rreth boshtit (aksit) të vet/. (Shih: RSHKJ, N. Sad 1976.)

Pra këtu do theksuar barasvlerësia e këtyre dy termave por sa u përket krijimeve *qostërues qostëroj, qostërim*, mbetet konstatimi se formimet e tilla kanë përhapje të kufizuar.

2) Rreth fjalë-termimit grihë grihës

Fjala **grihë** si njësi leksikore me derivatet e saj është e pranishme në të gjithë fjalorët normativë të gjuhës sonë. E hasim edhe në Fjalorin e K. Kristoforidhit (1904) si dhe në Fjalorin e Bashkimit (1908), fakte këto që dëshmojnë se kjo fjalë i takon fondit aktiv themelor të gjuhës sonë që moti, edhe pse në disa vise të Kosovës në të folmet popullore nuk del fare ose aq e njohur.

Në FSKSH 1974 mjaft gjerësisht është përfaqësuar fjala **grihë** me rrjedhojat e saja si barasvlerës i fjalës **brus** të serbokroarishtes në funksion të disa kategorive leksiko-gramatikore si: të emrit, të foljes dhe të togfjalëshit, p.sh.:

1. Emra:

brus, brusiona - grihë;
brusač, brusilac - grihës;
brusar - grihëbërës;
brusić - grihëz, grihë e vogël;
brušenje - grihje (të grihurit).

2. Folje:

brusiti, bruscati - grih, grihoj (me grihë, me grihue)

3. Togfjalësha:

brusači kamen - gur grihës;
brusara, brusalo, brušljača - këllef grihe;
brusni kamen, brusnik - lloji guri për grihje;
brusiona, brusionica - dyqan i grihëbërësit, grihëtorja

por:

brušeno staklo - qelq i lëmuar;
bruisilica - qostër, toçillë.

Në FSHSK 1981 nuk ka një shumësi të tillë shembujsh, por del e shënuarfolja **grih** për **oštriti**, **zašiljiti** të serbokroatishtes si dhe **grihoj** për

oštriti brusom, **brusiti** d.m.th. me njëfarë nuancimi tjetër semantik, si dhe janë shënuar emrat: **grihë** për **brus** dhe **oštrica** (alat za oštrenje), **oštrilo**

si dhe emërtimi i profesionit: **grihës** si barasvlerës i termave: **brusač**, **oštrac** të serbokroatishtes.

Në FGJSSH 1980 për emërtimin **grihës** jepet përkufizimi: "ai që mpreh thika, brisqe, sëpata etj.", pa u precizuar se kemu të bëjmë me profesionin e mirëfilltë që parakupton edhe përgatitjen e caktuar shkollore.

Në "Plan-programin mësimor të shkollave të arsimit të mesëm të orientuar" (Prosvetni pregled nr. 9, Beograd 1980) sa i përket profesionit **metalo-brusač (metalgrihës)** që mësohet në klasën III dhe IV del se punëtori i tillë duhet të fitojë njohuri lidhur me këtë profesion d.m.th. duhet të "aftësohet për matje me nonius, me mikrometra e komparatora të ndryshëm", Ai duhet të aftësohet gjithashtu për të përdorur makinat grihëse (brusilice) llojesh të ndryshme me grihje të rrafshët (ravno brušenje), me grihje të jashtme rrethore (spoljno okruglo brušenje), grihje të brendshme rrethore (unutrašnje okruglo brušenje) si dhe të përdorë edhe makinat speciale grihëse dhe të tjera me honim (honovanje), lapim a lëmim (lepovanje), luçidim a shkëlqimim (glačanje) dhe polirim (poliranje).

Nga kjo sa u tha del qartë dallimi sa i përket kuptimit leksikor të termit **mprehës** ndaj atij **grihës**.

Do theksuar gjithashtu se në kuadër të termit grihës:

(serbokr. *brusač* gjerm. *Schleifer*, angl. *grinder cutter*, frengj. *aifuteur*, *affileur*, rus. *shlivovshqik*),

emërtim ky që mund të dalë qoftë në mbështetje të një vegle a mjeti konkret, qoftë në mbështetje të procesit të punës d.m.th. të një foljeje dalin edhe terma të tjerë, ndër të cilët më i dalluari është termi *polirue*:

(serbokr. *polir*, *polirac*; gjerm. *Polieren*; angl *polisher*, *burnisher*; fr. *polisseur*).

Për krejt sa u paraqit këtu mund të nxjerrim si përfundim se dallimi i termave **grihës** dhe **mprehës** është i domosdoshëm në praktikën tonë shkollore ashtu si edhe në ndërmarrjet prodhuese metalpërpunuese.

Në krahasim me emërtimet e gjuhës serbokroate, siç u pa në këtë trajtësë, mund të qëndrojnë barasvlerësit si vijon:

mprehës - oštrač dhe grihës – brusač.

Sa u përket trajtave retifikator (retifikues) dhe atij qostërues, lëmues etj. mendoj se nuk duhet përdorur për të njëjtin koncept, pasi që një hapësirë

e tillë semantike del e mbuluar plotësisht me termat e sipërcekur: **mprehës e grihës**.

Nga sa u tha më lartë mendoj se në burimet tona normative dhe në dokumentat zyrtarë barasvlerësia e emërtimeve në shqyrtim duhet të dalë kështu:

- a) - mprehës , shifra 114.26 - oštrač;
 - mprehës i veglave (veglamprehës), shifra 214.45 oštrač alata;
 - veglamprehës specialist, shifra 505 - oštrač alata specialista
- b) - grihës, shifra 214.47 - brusač;
 - metalgrihës - metalobrusač;
 - furrës (pjekës) i grihave, shifra 120.42 – pekar brusova;
 - (për)punues i grihave, shifra 120.43 – obradjivač brusova;
 - qelqgrihës (xhamgrihës), shifra 120.44. – staklobrusač;
 - drugrihës (grihës druri), shifra 122.14 - brusač drveta etj.

Edhe pse në këtë trajtesë nuk janë përfshirë të gjitha çështjet që dalin lidhur me këtë temë, besoj se edhe kjo sa u tha mjafton sa për të pasur të qartë problemin, në mënyrë që mos të ngatërrohen emërtimet e profesioneve të caktuara siç u cekën këtu.

15. RRETH FAVORIZIMIT TË TRAJTËS OFERTUES KUNDREJT OFRUES LIDHUR ME TERMIN OFERTË

Me termin ofertë (gjerm. Offerte, angl. offer, fr. offre, it. offerta, serbokr. ofert(a)/ponuda/, si në gjuhë të tjera edhe në gjuhën tonë kuptohet "nxjerrja e një malli në treg për ta shitur" apo "propozimi për çmimin e mallit që shitet" (FGJSSH f. 299), përkatësisht "të dalët e mallit në treg" apo propozim-çmimi për një mall që shitet në ankand" (FGJSH f. 359). Gjithashtu me këtë term kuptohet edhe dokumenti (konkursi publik) në të cilin shënohen kushtet për kryerjen e punëve të caktuara, të cilat nxirren në ankand". (RSHKJ 3 f. 698.)

Sigurisht në mbështetje të kësaj fjale në gjuhën tonë është përfutur trajta **ofertues**, si emërtim për personin "që bën një ofertë" (FGJSH f.359). Së kendejmi, pra nën ndikimin e FGJSH 1954, por edhe nga nevoja për një përdorim të tillë, ky term u përfshi edhe në fjalorët e tjerë si p.sh. në FSSH 1974, FSHS 1976, FTJ 1979 si dhe në FSHS 1981 për barasvlerësin e gjuhës serbokroate *punudjač*, *punudilac*, *nudilac*, por edhe në burime të tjera si barasvlerës i termit përkatës të gjuhëve të tjera.

Mirëpo pasi që në gjuhën shqipe përveç emrit ofertë u reflektua edhe trajta foljore **ofroj** (FGJSH f. 359, FLSH f. 343 etj.) që ka origjinë të njëjtë latine nga trajta *offerre* (offerro) "vë përballë, shfaq, paraqes, kundërshtoj, sjell, jap" (FLSH f. 343), atëherë në mënyrë të ligjshme nga folja ofroj doli edhe emërtimi i kryerësit të veprimit të tillë në trajtën **ofrues**, siç është shënuar edhe në FTE të H. Goranit 1973 f. 90 për termin *ponudjač* të serbokroatishtes, në FFSH të M. Bejtës f. 382 si barasvlerës për termin *ofrant* të frëngjishtes si dhe në FISH të H. Vocit 1980, f. 233 për barasvlerësin *offerent* të italishtes.

Ç'është e vërteta, edhe në ligjërimin tonë të përditshëm si dhe në gjuhë të shkrimit po përdoren të dyja trajtat: **ofertues** edhe **ofrues**. Kështu mund të ndodhë që në të njëjtin tekst të përdoren edhe njëra edhe trajta tjetër, për të njëjtin koncept(!), siç ngjau edhe në gazetën "Rilindja" të datës 12.XII.1983, 10.IV.1984, 26.IV. 1984 etj. Po kështu dolën që të dy termat

edhe në doracakun e shaptilografuar "*Terma nga LPB*" (projekt), Prishtinë 1977, f. 50. duke u imponuar që të dy si trajta sinonimike të barasvlershme dhe njëherazi duke u paraqitur edhe si çështje e diskutueshme që lypset vlerësuar dhe sqaruar edhe nga ana gjuhësore.

Diskutimi i dukurisë së tillë del i nevojshëm aq më tepër pasi që asnjëra nga trajtat e sipërcekura (pos fjalës ofertë) nuk del e shënuar në FGJSSH. Prandaj me të drejtë shtrohet pyetja, cilën trajtë lypset favorizuar si emër vepruesi, e cila ndërlidhet burimisht me termin ofertë? Cila është më e drejtë **ofrues** apo **ofertues**? Madje a mund të qëndrojnë të dyja apo as njëra as tjetra?!

Dihet mirëfilli se kur huazohet një fjalë ndërkombëtare nga nevoja, siç është edhe rasti ndërkombëtarizmit **ofertë**, atëherë ajo konsiderohet si fjalë aktive e fjalësit të gjuhës marrëse, prandaj mbi bazë të saj mund të krijohen edhe fjalë të tjera të prejardhura. Kështu ndodhi edhe me fjalën *ofertë* në gjuhën tonë, nga e cila u reflektua emri i vepruesit **ofertues** (që nënkupton edhe foljen **ofertoj (me ofertue)**, e ndërtuar kjo mbi bazë të fjalë-temës prodhuese fjalëformuese ofertë). Për konceptin **ofertues** teorikisht mund të dilnin normalisht edhe trajta të tjera si: *ofertist, afertës, ofertëparaqitës, ofertëbërës, ofertdhënës* (Shih: edhe te "Rilindja" 6. III. 1986 f. 12) e ndonjë tjetër, por duke pasur parasysh modelin fort të kapshëm fjalëformues që mbizotëron në gjuhën tonë, pra pikërisht formimi i emrave të vepruesit mbi bazë të temës prodhuese foljore (pjesores së shkurtë të ish shqipes letrare mbi bazë të gegnishtes), atëherë s'ka arsye të mos dalë e parapëlqyer përgjithësisht trajta prejfoljore, më drejt prejpjesorja **ofertues**.

Këtë mënyrë fjalëformimi e ndeshim të përqaftuar edhe në doracakun "*E drejta e detyrimeve*" (të A. Alishanit), Prishtinë 1975 f. 16, ku ndeshim prejfoljorët: *ofertues, ofertim, i ofertuari* etj., edhe pse foljen *ofertoj* nuk e ndeshim të shënuar në asnjërin nga fjalorët që konsultuam.

Mendimi se folja **ofertoj** mbase nuk do të jetë e nevojshme në shqipe dhe se në rast nevoje do të mjaftonte trajta foljore **ofroj** e formuar kjo mbi të njëjtën bazë si edhe emri ofertë, e cila edhe ka dalje në gjuhën tonë, ngase del e shënuar në disa burime si trajtë më e përafërt ndaj trajtës foljore etimologjike (offerro):

Krahaso,shq. Ofroj me ofrue):

it offriri (ofro), fr. offriri, angl. (to) offer, gjerm offerieren serb. oferirati (nuditi) etj.,

për mendimin tim një arsyetim i tillë nuk qëndron, ngase trajta foljore *ofroj*, edhe pse e ka, pra, të njëjtin etimon a vatër fjalëformuese si edhe fjalë-termi

ofertë, nuk mjafton, andaj përftimi i foljes **ofertoj** ka ligjshmërinë e vet si arsyetim të mbështetur edhe në semantikë edhe modelin fjalëformues.

Sidoqoftë, rreth emërimit të trajtës **ofroj** në shqipe çështja del paksa më e ndërlikuar se përftrimi i trajtës **ofertoj**. Lidhur me këtë po cekim dy gjëra a dukuri:

e para, trajta **ofroj** ka kuptim më të përgjithësuar sesa e ka termi **ofertë**, prandaj semantikisht prejfoljori që del nga kjo trajtë nuk lidhet semantikisht me fjalë-termin ofertë;

e dyta, trajta ofroj edhe pse nuk del e shënuar në FGJSSH ajo në praktikën tonë gjuhësore shpeshherë ndërkëmbehet asociacionisht, por pa mbështetje semantike me foljen *afroj* (me afrue) të shqipes.

Pasi që për dukurinë e parë do të bëhet fjalë më poshtë nga ka lidhje të drejtpërdrejta me objektivin e kësaj teme, më poshtë po them ca fjalë rreth dukurisë së dytë, e cila për mos me thënë shqetësuese del mjaft problemore dhe sigurisht tejet e diskutueshme, sidomos te ne.

Është e vërtetë se nuk janë raste të rralla që në shtypin tonë të ndeshim ndërkëmbimin e foljeve **ofroj** dhe të asaj **afroj**. E para fjalë e huazuar që i referohet lat. *offero*, përkatësisht italishtes *offrire*, e dyta është trajtë e mirëfilltë e gjuhës shqipe e formuar mbi bazë të temës motivuese ndajfoles "**afër**". E para ka kuptimin: *ofroj*: "i nxjerr tjetrit përpara një send që ta marrë" (FGJSH f. 359), kurse tjetra: **afroj** - "sjell diçka pranë". Kuptimet që mbulojnë këto dy fjalë kanë njëfarë përafërsie vendi, por nuk janë identike. Siç po shihet edhe nga përkufizimi i dhënë semantika që ato mbulojnë është mjaft e largët.

Që nuk kemi të bëjmë për koncepte të njëjta po sjell konstatimin se as në Fjalorin latinisht - shqip të F. Fishtes dhe H. Lacajt si dhe në fjalorët frëngjisht - shqip të M. Bejtës dhe të V. Kokonës për *offero*, përkatësisht *offrir* nuk shënohet si barasvlerës sinonimik fjala **afroj**. Së këtejmi, mund të konstatohet pa mëdyshje se ndërkëmbimet e caktuara **ofroj /afroj** kanë si mbështetje asociacionore vetëm anën fomale a analogjinë e përafërt grafike e shqiptimore e jo anën semantike dhe prejardhjen ndërtimore të tyre.

Që nuk kemi të bëjmë me gabime shtypi a lëshime të rastit, më poshtë lidhur me këtë dukuri, ku janë mbështjelluar e ngatërruar pa vetëdije edhe disa intelektualë e penda me emër të mirë në letrat tona, po i japim disa shembuj që i nxorra nga shtypi ynë i përditshëm, por jo vetëm nga ai, pasi që qëmtimi nuk është shterues:

1) Ja disa shembuj:

a) Nga gazeta "Rilindja": (...)janë munduar t'i ofrojnë Irakun me Iranin (8. VIII. 84 f. 11),(...)ato pika që na ofrojnë e na lidhin më ngushtë (15. IX. 84 f. 11), (...) fuqitë detare dhe ato ajrore amerikane iu ofruan ujrave të territorit të Libisë (8. II. 85 f. 1) (...) me të ndalur të automjetit i është ofruar milici (16. IV. 85 f. 1), (...) vetëm që shkolla t'i ofrohet fshatares (18. IV. 85 f. 2), (...) veprat e këtyre na ofrojnë me Evropën (24. IX. 84, f. 15), (...) Kryengritësit i ofrohen Kampales (24. IX. 1985 f. 2), (...) kukullën ma ofroje pranë (14. V. 95), (...) etj.

b) Nga burime të tjera: (...) dorë e artë don njerëzit t'i ofrojë ("Fatosi" nr. 12/85 f. 22),(...) e ofroi shumë gegërishten me toskërishtën në të shkruar (FFB f. 38), (...) e pret dimrin që ofron ("Pionieri" nr 7/86 f. 2) etj. Në të gjitha rastet e mësipërme në vend të foljes **ofroj** (me ofrue) duhet të përdorej trajta **afroj** (me afrue).

2) Më poshtë po i shënoj sa për ilustrim edhe ndonjë rast kur në vend të trajtës së shënuar **afroj** do të duhej përdorur trajta **ofroj** ose ndonjë tjetër:

a) Nga gazeta "Rilindja": (...) ato forca afrojnë zgjidhjet e veta(27. X. 1984 f. 13), (...) këshillat dhe dashurinë që na e afrove do të mbeten përherë në zemrat tona (21. IX. 84, f. 15), (...) afrojt shtëpi me qira (një shpallje e botuar në gazetën Rilindja), (...) afron këmisha te mashkujve me kreacion më modern" (reklamë që përsëritet në gazetën "Rilindja" edhe më 5. V. 84 - 28. V. 84) etj.

b) në burime të tjera: (...) disa zgjidhje na i afroji ("Fjala" nr. 9/85 f. 6) etj.; është vërejtur edhe në disa shpallje interne të OPB-ve.

Sido që të jetë, folja **ofroj** nuk duhet ndërkëmbyer me foljen **afroj**, madje folja **ofroj** nuk duhet favorizuar aq tepër edhe në vend të trajtave të tjera foljore që janë në përdorim e sipër në gjuhën tonë letrare. Ç'është e vërteta, trajta ofroj del mjaft e theksuar në Fjalorin serbokroatisht - shqip (1974) si dhe në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981), botime këto të Institutit Albanologjik të Prishtinës), d.m.th. konsiderohen me të drejtë si burime normative. Folja në këto burime nuk del e favorizuar vetëm për kuptimin e foljes oferirati (nuditi, ponuditi) të serbokroatishtes, por edhe për:

podneti (paraqit), podneti ponudu (paraqit ofertën), madje fjala ofroj kalon si barasvlerës edhe për përgjegjëset si p.sh. predložiti (propozoj), preporučiti (porosit, rekomandoj) si dhe për prihvati

(pranoj), pružiti (shtrij, zgjas, paravë, parashtroj), dati (jap), izraziti spremnost (shpreh gatishmëri) etj.

Pra, siç po shihet nga të dhënat e mësipërme kjo fjalë duke rënduar dhe anuar si trajtë e vetme gjithnjë si barasvlerës për fjalën nuditi, ponuditi të serbokroatishtes ndër ne ka pësuar zgjerim enorm kuptimi dhe si rrjedhojë nuk është e çuditshme që kjo ka dalë e shprehur edhe në gjuhën e shkrimeve tona edhe për ato nënfusha semantike që nuk i takojnë, duke u zënë vendin pa nevojë edhe trajtave si:

propozoj, paraqit, pranoj, rekomandoj, parashtroj, jap, për afroj etj, madje të përdoret edhe në vend të togflashave foljorë si: bëj ofertë, jap propozim etj.

Gjithsesi, siç u pa nga shembujt e mësipërm kuptimi foljes **ofroj** del i larguar nga kuptimi fillestar i togfjalëshit **bëj ofertë**, edhe pse edhe për këtë koncept del e regjistruar në FGJSH 1954, kështu, sot për sot sipas kuptimit të përgjithshëm që ka folja **ofroj**, assesi asaj nuk i imponohet semantika që ka të bëjë rreth ofertës, por kemi të bëjmë më një kuptim tjetër më të reduktuar.

Në fushën e terminologjisë ekonomike, në lëmin e tregtisë etj. si barasvlerës i togfjalëshit "bëj ofertë" normalisht nuk del më trajta **ofroj**, por del trajta "**ofertoj**" e së ketejmi edhe emërtimet: **ofertues**, *ofertim*, *ofertuari* e kështu me radhë, shembuj këta që janë të pranishëm, pra, të pranueshëm dhe të kuptueshëm në çdo pikëpamje në mbarë truallin shqipfolës.

Pra, shpreh mendimin se folja **ofertoj** duhet të përdoret pa druajtje lidhur me kuptimin e ndërkombëtarizmit **ofertë**, qoftë si term ekonomik, qoftë me kuptim të përgjithshëm që ka ndërlidhur me nocionin e kasaj ndërkombëtarizme, pra edhe si barasvlerës i foljes *oferirati* të serbokroatishtes, përkatësisht për trajtat *nuditi*, *ponuditi*, sipas kuptimeve që kanë këto folje nën 3 dhe 4-a. e b. sipas HSHKJ 3 f. 825, pra me kuptim nga fusha e ekonomisë (tregtisë), siç u përmend në këtë trajtesë.

Por kur është fjala për kuptimet e tjera të fjalës *nuditi*, *ponuditi* të serbokroatishtes mendoj se duhet të përdoren barasvlerës të tjerë të shqipes, siç u tha më sipër lidhur me lëndën e shtruar në *Fjalorin serbokroatisht shqip* i viti 1974, përkatësisht *Fjalorin shqip-serbokroarisht* (1981).

Pra jo vetëm për fjalën **poslužiti**, e cila pa diskutim duhet të përkthehet me barasvlerësin **shërbej** e jo *ofroj*, por edhe sa u përket fjalëve të tjera si *predložiti*, *ponuditi*, *podneti*, *preporučiti* etj., prandaj mos të

thuhet "po të ofroj që ... (predlažem ti da ..., por "po të propozoj që ...), madje edhe në vend "i ofrova një cigare" - "ponudih ga cigaretom" (Shih FSHS 1981 f. 650), mund të dalë : "i zgjata (ia qita, e gostita me ..., e nderova (e ndera) me ..., e qerasa me ...) një cigare etj., pa e përjashtuar edhe trajtën ofroj. Gjithashtu në vend të shembullit: "më ofroi nëpunësim" (ponudi mi zapošljenje), mund të dalë më mirë "më gjeti, më propozoi, më rekomandoi, më për Afroi) punësim (punë) e jo nëpunësim, sepse fjala nëpunësoj nëpunësim më fort ka të ngjarë të lidhet kuptimisht me punë administrative, nëpunësore. Krahaso barasvlerësit: *nëpunës, nëpunësi - činovnik, činovništvo* (FSSH f. 93).

Me fjalë të tjera, nuk do të quhet gabim nëse përdoret edhe folja ofroj kur kemi të bëjmë me foljen *nuditi* të serbokroatishtes që lidhet me kuptimin "*pružiti*" d.m.th. i nxjerr tjetrit përpara një send për ta marrë" apo "ta pranojë", qoftë edhe me kuptim figurativ.

Sidoqoftë, nga sa u tha del se te ne patjetër duhet reduktuar përdorimin e foljes *ofroj*, edhe pse në gjuhë të tjera trajtat foljore mbi bazë të latinishtes "offro" mund të kenë shtrirje më të përgjithësuar.

Supozojmë që me aktivizimin e trajtës **ofertoj** për nocionin që lidhet kryekëput me fjalën **ofertë**, si term ekonomik (në stilin tregtar) dhe me përdorimin e trajtave të tjera sinonimike, siç u cekën në këtë trajtesë, përdorimi i trajtës **ofroj** do të stabilizohej përfaqësisht si barasvlerës i trajtës **nuditi (pružiti)** të serbokroatishtes e jo edhe për barasvlerës të tjerë.

Del e nevojshme të ceket këtë rast gjithashtu prirja e formimit të foljeve në gjuhën tonë mbi bazë të një **emri**, qoftë ky edhe i huazuar dhe mos të huazohen pa nevojë veç e veç nga trajtat e kategorive të tjera leksikogramatikore si plus edhe mbiemri, edhe ndajfolja etj. Me fjalë të tjera nëse kemi qenë dhe jemi të detyruar të huazojmë nga italishtja b.f. emrin **ofertë**, nuk jemi të detyruar të huazojmë edhe foljen *offrire (ofroj)*, kur në shqipe kemi trajta të gatuar për konceptet e tilla dhe se mbi bazë të fjalë-emrit të huazuar me cilësi të ndërkombëtarizmës **ofertë**, tashti mbi fjalë-temë të qartë mortivuese fjalëformuese mund të dalë normalisht folja **ofertoj** si dhe derivatat mbi bazë të saj, si b.f.: emrat prejpjesorë ofertim, ofertues, të ofertuarët, mbimri: i(e) ofertuar, ndajfolja: ofertisht etj.

Po e shtoj edhe këtë të dhënë se prof. H. Gorani në fjalorët e tij nga fusha e terminologjisë ekonomike, bën njëfarë diferencimi të emërtimeve në fjalë **ofrues** dhe **ofertues**. Ai për **ofertues** shënon barasvlerësit **ponudjač, ponudilac**, ndërsa për **ofrues** shënon vetëm **nudilac** (Shih FTESH SHS f. 211 dhe FTESH SSH f. 141, 180).

Përmbyllje

Pikësnyimi i analizës së kësaj teme mund të përmbillet në këto katër pika:

1. Përkufizimi i dhënë në FGJSH dhe në FGJSSH "nxjerrja e një malli në treg që shitet" etj. për termin ofertë duhet të plotësohet edhe me tekstin: "dokument (konkurs publik) në të cilin shënohen kushtet për kryerjen e punëve të caktuara, të cilat nxirren në ankand".

2. Lidhur me procesin e punës që lidhet me konceptin e ofertës mendoj se lypset përkrahur dhe favorizuar dalja ose përftimi i foljes **ofertoj** si dhe të prejfoljorit **afertues** si emërtim i njeriut sipas veprimtarisë lidhur me këtë koncept, ngase edhe aktualisht ka përdorim mjaft të gjerë, fakt ky që imponon nevojën që bashkë me foljen **ofertoj** të zërë vend në fjalorët tanë normative edhe emri i vepruesit **ofertues**, ai i veprimit **ofertim** etj.

3. Folja **ofroj** (huazim mbi bazë të trajtës latine offero), edhe pse nuk del e regjistruar në FGJSSH, e cila po përdoret me intensitet të shtuar te ne, mendoj se mund të përdoret në mënyrë të reduktuar vetëm në raste të caktuara, por kurrësi në ndërkëmbim me trajtën foljore të mirëfilltë **afroj** të shqipes, pasi që nuk kanë ndërlidhshmëri kuptimore njëra me tjetrën.

4. Gjithsesi del e nevojshme që në fjalorët tanë përkatës dygjuhësh të saktësohet më mirë barasvlerësia e termave **ofertë**, **ofertoj** e **ofroj** në krahasim me termat përgjegjës të serbokroatishtes e të gjuhëve të tjera.

Në fund, si barasvlerësit më të përafërt në raportin shqip-serbokroatisht, për mendimin tim, janë:

ofertë - ponuda,
ofertoj, me ofertue - ponuditi, ofertirati,
ofroj, me ofrue - nuditi (pružiti),
ofertues - ponudjač, punudilac dhe
ofrues - nudilac.

Gjithsesi vëretjet e dhëna në këtë trajtesë mund të shërbejnë edhe për harmonizimin e termave të tjerë të shqipes, por edhe në raport me gjuhë të tjera të huaja, prandaj ekspertët dhe të interesuarit duhet t'i kenë parasysh konstatimet e vënerimet tona nga ky artikull, apo jo?!

Prishtinë, më 17. XII. 1986.

16) INSTRUMENTIST, JO INSTRUMENTALIST

Edhe për emërtimin e interpretuesit të ndonjë vegle muzikore në gjuhën shqipe paraqitet çështje që kërkon sqarim, pasi që emërtimi i profesionit të tillë në gjuhën e shkrimeve tona del dy trajtash: *instrumentalist dhe instrumentist*.

Trajtën *instrumentalist* e gjejmë më të përhapur në shkrimet e deritashme, kështu, në mos qoftë gabim shtypi!, na rekomandojnë *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe* 1979 (ribot. Prishtinë 1983) si dhe *Fjalori shqip - serbokroatisht*, IA, Prishtinë 1981, madje po këtë formë na imponojnë pothuajse të gjithë doracakët përkatës të nomenklaturës së profesioneve të botuar tek ne, prandaj s'është çudi që një trajtë e tillë të dëgjohet e të shkruhet edhe në shkolla e gjetiu, të haset në shpallje e artikuj edhe në faqet e shtypit si p.sh. në revisten > "Bota e re", nr. 17/83 f.10; "GEP" - "gazeta e pionierëve " 19/83, f.7; "Kosovarja" nr. 3/83, f.15 etj., prandaj është e nevojshme të tërhiqet vërejtje lidhur me këtë dhe të propagandohet përdorimi i trajtës së drejtë **instrumentist**, siç na rekomandon *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* 1980, f.725.

Siç dihet njëra nga mënyrat e krijimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit është ajo që bëhet sipas mjetit të caktuar, përkatësisht kur emrit të mjetit të caktuar i shtohet prapashtesa përkatëse dhe kështu emri paraqet emërtimin e personit të caktuar sipas profesionit që ka të bëjë me temën fjalëformuese. Kështu është vepruar edhe lidhur me emërtimin e trajtës: *instrument+IST - instrumentist*.

Pra emrit (temë fjalëformuese) **instrument-** (lat. instrumentum) që ka kuptimin: 1. vegël (përdorëse); 2. vegël muzikore, që është ndërkombëtarizëm, i është shtuar prapashtesa -IST: instrument+ IST **instrumentist** dhe në këtë mënyrë është formëzuar emërtimi i njeriut, i cili "luan një vegël muzikore" (FGJSSH 1980, 725), pra kështu quhet personi që i bie një instrumenti muzikor, ndërsa me trajtën *intrumentalist* nuk është vepruar kështu.

Trajta instrumentalist do të jetë e importuar nga gjuhët e huaja, si duket prapashtesa -IST i është shtuar mbiemrit më -AL intrumental-, që në gjuhën tonë, shikuar globalisht, konsiderohet si fjalë e parme, sepse nëse e zbërthejmë sipas modelit fjalëformues të gjuhës sonë do të na dalin vështirësi, pasi që në gjuhën tonë nuk kemi prapashtesë të huaj dyfishe – AL+IST -ALIST që do t'i shtohet temës së qartë fjalëformuese instrument-, madje edhe nëse duam të marrim si temë fjalëformuese mbiemrin instrument- do të vepronim jashtë natyrës së gjuhës lidhur me sistemin e formimit të fjalëve me prejardhje në gjuhën tonë.

Prandaj me plotë të drejtë dhe pa kurrfarë ngurrimi duhet ta flakim jashtë përdorimit trajtën *instrumentalist* dhe në vend të saj të jetësojmë në shkrimet tona trajtën **instrumentist**, e cila ka përparësi në saje të vetë sistemit të formimit të fjalëve në gjuhën tonë.

Këtë rast e shoh të arsyeshme të cek kalimthi një çështje që ka të bëjë me lëndën e shtruar këtu. Është fjala për profesionin e një vegëltari, i cili instrumenton, manipulon, ndreq ose kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin e instrumentave të caktuar në fushën e mjekësisë, të teknologjisë etj. dhe lidhur me këtë sa për ilustrim po përmend dy raste ku përmendet trajta **instrumentist** për fushë tjetër semantike, jashtë fushës së muzikës.

Së pari, në gazetën "Rilindja" të datës 11.III.1984, f. 19, përmendet termi **instrumentist** si profesion që ekziston në organikën e Klinikës ORL të FM të Prishtinës.

Së dyti, po në këtë gazetë më 29. II. 1984 f. 14 del emërtimi: "instrumentist për punë në shërbimin e elektros".

Dihet se nga vetë konteksti homonimia me konteptin e emërtuesit të rënësit të veglës muzikore nuk del aq e fortë, por në rastet kur termi *instrumentist* mund të shkaktojë ngatërresë kuptimore hominimike, atëherë pos emërtimeve të mundshme si:

instrumentndreqës, instrumentruajtës, instrumentbartës etj.

mund të përdoret (krijohet) edhe trajtë-termi *intrumentues* (instrumentar), përkatësisht *instrumentuese* (instrumentare - (serb. instrumentarka) në gjininë femërore, por jo instrumentalist(e) apo instrumentarist(e), siç doli në gazetën "Rilindja" më 14. III. 1984 f. 11.

Në të vërtetë, nuk duhet të na hutojë termi *muzikë instrumentale* me cilësi ndërkombëtarizmi, ngase secili pjesëmarrës në orkestrimin e tillë zakonisht bart emërtimin mbi bazë të instrumentit që e përdor, madje në serbisht sipas asaj që konsultuam, ndeshëm këtë emërtim profesioni:

instrumentalni mehaniçar za hidroloshku opremu i instrumente -
mekanik instrumental për pajisje hidrologjike edhe instrumenta
ndërsa ndeshim 14 emërtime mbi bazë të emërtimit **instrumentar** + -
instrumentues + p.sh.: **instrumentar elektroniçar - instrumentues elektronikan** etj.

Me fjalë të tjera, në asnjë rast emërtimi i njeriut nuk del me fundoren -ALIST

Gjithsesi lidhur me këtë fjalën kompetente mund ta thonë kuadrot që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me punët dhe proceset e tilla të punës. Qëllimi im ishte më tepër të shtrojmë problemin për ta zgjidhur institucionalisht sesa vetëm të tërheqim vërejtje sa me thënë.

(Prishtinë, 15. III. 1984)

17. RRETH BARASVLERËSIT TERMINOLOGJIK PËR SHPREHJEN "NJERIU QË EDUKOHET"

Reagim lidhur me artikullin e dr. Hajrullah Koliqit "Perifraza "personi që edukohet" dhe ekuivalenti i saj terminologjik", i botuar në gazetën "Rilindja", më 9. I. 1989, f. 15.

Dr. Hajrullah Koliqi tashmë ka bërë emër në fushën e shkencës, sidomos në lëmin e shkencave pedagogjike. Edhe artikulli i tij: *Perifraza "personi që edukohet" dhe ekuivalenti i saj terminologjik*, mund të cilësohet si dëshmi e seriozitetit të interesimeve të tij, ndonëse rreth formulimit a zgjidhjes që propozon ai mund të shprehet ndonjë rezervë.

Çështje e vërteta, H. Koliqi me kompetencë bën paraqitjen e çështjes. Ai duke e ndjekur parimin "nga e njohura tek e panjohura" na njeh me nocionet kundërvënëse "personi që edukon" dhe "personi që edukohet".

Ndërsa për nocionin e parë në leksikon e gjuhës sonë që me kohë është "futur thellë", fjalë-termi **edukator**, për nocionin e dytë "personi që edukohet" mbetet çështja e hapur, pasi që ende nuk e kemi termin përkatës njëfjalësh të përcaktuar me kompetencë. Emërtimi i një koncepti të tillë del i domosdoshëm si për shkaqe praktike ashtu edhe për shkaqe teorike, aq më tepër kur dihet se gjuhët e tjera më të zhvilluara e në kontakt me shqipen një çështje të tillë tashmë e kanë të zgjidhur, si p.sh. angl. *educand* ose *aducatte*, gjerm. *Edukand*, pastaj rus. *vospitaniik*, serbokr. *vaspitanik* si dhe fr. *enseigné* ose *élève*.

Ndër ne sigurisht edhe për nevoja të përkthimit si barasvlerës të termit **vaspitanik** të serbokroatishtes kanë zënë të përdoren sipas rastit ekuivalentët e pakonsoliduar: *i edukuari*, *i përedukuari* si dhe *edukatëmarrësi*, trajta këto që sipas autorit nuk qëndrojnë, edhe pse fjalën e fundit (edukatëmarrës) në mënyrë implicite nuk e mohon. Ai në të vërtetë, siç del nga konteksti qëllimin kryesor e ka të ngrë çështjen për diskutim, por megjithatë propozon edhe zgjidhjen konkrete për rastin në shqyrtim duke e parapëlqyer fjalën e huaj "edukant", siç thotë ai "fjalë-termin neolatin edukand të huazuar nga gjuha angleze e gjermane".

Kështu autori duke e pasur parasysh zgjidhjen e mëparshme rreth fjalë-termi edukator si dhe faktin se fjala është për një koncept të ri ende të paemërtuar në gjuhën tonë, jo pa arsye, u deklarua për fjalën e huaj "neolatine" edukant, mirëpo formulimi si dhe trajta shkrimore që propozohet nga ai lënë shteg për diskutim.

Së pari, djepi i trajtës "edukant" (edukand) edhe sipas përdorimit, nuk i takon gjuhës angleze apo asaj gjermane, edhe pse në artikull shënohet vetëm në këto gjuhë, por pikërisht i takon gjuhës italiane (trajtë kjo e trashëguar nga gjerundivi i latinishtes *educandus* "ai që duhet të edukohet". Kjo që nuk thuhet qartë në artikull argumentohet bindshëm me faktin se vetëm në italishte fjala *educando* (m.), *aducanda* (f.) del si fjalë aktive me përdorim të gjerë. Në gjuhën serbokroate për fjalën *educando* të italishtes dalin këta barasvlerës: *gojenac*, *pitomac*, *odgojnik*, *vaspitanik* - madje edhe *učenik*, terma këta që padyshim shprehin nocionin: "*personi që edukohet*".

Prej kësaj del se trajta e propozuar "edukant" nuk është fjalë neolatine, por është një huazim i modifikuar apo "shqipërim" i autorit në frymën e tipit të emrave më -ANT fundor të shqipes me burim të huaj, kryesisht neolatin.

Përveç formulimit jo të qartë që u cek më sipër, të diskutueshme dalin edhe dy çështje të tjera:

e para, në cilën trajtë është dashur të huazohet fjala, ashtu siç është në gjuhën dhënëse **edukand**, apo në trajtën e modifikuar prej tij **edukant** dhe

e dyta, mos vallë, bashkë me huazimin e tillë të ri, është dashur të jepet menjëherë edhe nisma për zëvendësimin e tij me mjete të shqipes?

Mendimin tonë po e shprehim më poshtë po në dy pika:

Së pari, supozojmë se trajta edukant (më -ANT fundor) ka më tepër mbështetje formale psiko-linguistike sesa aso logjike-semantike, kurse trajta **edukand** (me -AND fundor) më tepër i përgjigjet autenticitetit burimor (Krahaso it. *educando* si dhe përfitimet në anglisht e gjermanisht).

Rreth parapëlqimit të njëjës apo të trajtës tjetër janë me interes të dihen edhe këto fakte:

a) Vërtet, në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhë të tjera kryesisht nga gjuhët neolatine (romane), sidomos nga italishtja (me burim nga latinishtja) i kemi të huazuar disa emra më -ANT fundor rreth tipit: muzikant (it. *musicante*), të cilët nga analiza fjalëformuese mund të zbërthehen edhe mbi temë të qartë motivuesetë shqipes, si b.f. muzik(ë)- dhe formantin

modifikues kategorizues -ANT, prej kah edhe është përftuar në vetëdijen e shqipfolësve ideja për formantin -ANT si prapashtesë, mirëpo këta emra më -ANT tregojnë zakonisht njëriun sipas profesionit a veprimtarisë që ushtron, prandaj trajta *edukant* në këtë formë vetvetiu te shqipfolësi perceptohet në kuadër të kuptimit që në të vërtetë e ka një emër vepruesi, pra në rastin konkret trajta *edukant* perceptohet në shqip si një sinonim i termit edukator (ashtu siç është përftuar edhe trajta *edukues*) e jo me kuptim tjetër kundërvënës "pësues", pasi që është fjala për "personin që edukohet" e jo për "atë që edukon".

b) Pothuajse të gjitha enërtimeve me -ANT fundor, edhe pse konsiderohen si huazime të rrënjësura, u goditet pikërisht formanti prapashtesor -ANT, nga format a prapashtesat e tjera përkatëse të gjuhës shqipe, si p.sh.: *fabrikant/fabrikues, muzikant/muziktar* e *muzikues, demonstrant/demonstrues, ofertant/ofertues, diskutant/ diskutues* etj. duke e zëvendësuar plotësisht ose pjesërisht kuptimin leksikor të emrit përkatës me -ANT fundore.

c) Edhe disa emra, gjithashtu me prejardhje të huaj, që në burime të caktuara shënoheshin me -ANT fundor si *matematikant, fizikant, politikant* etj. tashmë me drejtshkrimin e miratuar të gjuhës sonë janë stabilizuar jo me formantin -ANT, por me -AN fundore: **matematikan, fizikan, politikan**, fakt ky që tregon se formanti -ANT në gjuhën tonë të sotme nuk është i favorizuar.

ç) Si trajta *edukant* edhe ajo *edukand* janë fjalë të parme në gjuhën tonë, sepse nuk kanë temë të qartë prodhuese, prandaj nga ky aspekt s'mund të arsyetohet perceptimi i elementit -ANT si prapashtesë e mirëfilltë te trajta *edukant*.

Prandaj, duke i pasur parasysh faktet e mësipërme, mendoj se më drejt do të ishte që emri në fjalë të shënohet vetëm e vetëm në trajtën **edukand** (më -AND fundor), ashtu siç është edhe në gjuhën dhënëse, përkatësisht ashtu siç del edhe emri doktorand (lat. *doctorandus*) (Shih te Fjalori i fjalëve të huaja, Prishtinë 188, f. 149), pasi që edhe në gjuhë të tjera është reflektuar po ashtu.

Së dyti, meqenëse fjala **edukand** është fjalë e re e huazuar, ende e parrënjosur dhe pa cilësi të ndërkombëtarizmit të mirëfilltë, del e nevojshme që menjëherë pranë saj të shënohet në kllapa barasvlerësi më i përfaqësues i burimit të shqipes, ekuivalent sinonimik ky që me kohë jo vetëm do të mund të dalë nga kllapat e ta ndërrojë vendin me fjalën e huaj, por edhe ta zëvendësojë plotësisht atë.

Këtë që po e theksoj është plotësisht në frymën e kërkesës aktuale si dhe të prirjeve ekzistuese të gjuhës sonë që sa më shumë fjalë të krijohen me brumin e shqipes, madje është me interes të zëvendësohen edhe fjalët e huaja apo të modifikohen trajtat e caktuara me elemente autoktone të gjuhës sonë. Kështu mund të veprohet edhe me trajtën në shqyrtim.

Ç` është e vërteta, çështja e emërtimeve të termave profesionalë dhe pranimi i tyre është një çështje konvencionale, mirëpo "konventa" a marrëveshja e tillë për të qenë e qëndrueshme lypset të jetë e mbështetur në ligjshmëritë e caktuara fjalëformuese, rregullsi këto që i karakterizon aktiviteti dhe prodhimtaria e modeleve të caktuara në sistemin e fjalëformimit. Pikërisht në mbështetje të këtyre ligjësisve (modeleve) edhe për rastin në shqyrtim mund të dalë ndonjë neologjizëm i krijuar ad hoc që do të mund të mbulonte fushën kuptimore të nocionit në fjalë si p.sh. *edukatës, përedukues, adukimtar...*, mirëpo hëpërhë si zgjidhje më e përshatshme mund të qëndrojë pikërisht fjala **edukatëmarrës**, të cilën, siç e thamë më sipër, në mënyrë implicite, e parapëlqen edhe H. Koliqi, sepse siç thotë ai "sajimi i saj u bë në frymën e ligjeve të fjalëformimit të shqipes (...) është mjaft e qartë dhe mund të kuptohet lehtë nga shqipfolësit". Ne këtij konstatimi të drejtë të Koliqit do t'i shtonim sa për ilustrim barasvlerësit e mundshëm sinonimikë të njësisve lesikore - semantike për të dy termat edukator e edukand:

- **edukator**: ai që edukon - ai që jep edukatë - dhënëse
edukate - **edukatëdhënëse** (edukator);

- **edukand**: ai që edukohet - ai që merr edukatë -
marrëse edukate - **edukatëmarrës** (edukand).

Përshtatshmëria e fjalës **edukatëmarrës** është aq e më e pranueshme nga fakti se kemi të bëjmë me një hiperonim (term me kuptim të gjerë) që

ngërthen ne vete kuptimin lesikor të fjalë-termave: fëmijë (të kopshtit), nxënës, vijues (të shkollës), kadetë, konviktorë, studentë etj., me një fjalë persona këta që edukohen (a riedukohen) në institucione të caktuara.

Pasi që në gjuhën tonë nuk kemi prapashtesa a forma speciale me anën e të cilave do të mund të shprehim kuptimet kundërvënëse nga tema e njëjtë prodhuese, siç është rasti b.f. në italishte: edukatore/educando, angl. Educator/edukand, madje serbokroatisht: vasipitač/ vaspitanik, ne një funksion të tillë e shprehim zakonisht me një fjalë të përbërë, si janë b.f. kompozitat: adukatëdhënës/edukatëmarrës. Në të vërtetë, gjymtyra e dytë e kompozitës shpreh plotësisht funksionin e prapashtesës a të siprapshtesës speciale, madje bën përcaktim edhe më të saktë.

Ndonëse mbetet edhe ndonjë çështje për t`u sqaruar mendoj se për nocionin në shqyrtim zgjidhja më e drejtë, hëpërhë, do të ishte që fjalë-termi i huazuar të shënohet në trajtën **edukand** e pranë saj në kllapa të shënohet kompozita **edukatëmarrës**, e cila me kohë, sa ta marrë pak veten, njëherë pjesërisht e pastaj plotësisht do ta zëvendësonte fjalën e huaj, pa mohuar edhe zgjidhje të tjera që mund të dalin nga konteksti.

Gjithsesi për zgjidhjen e çështjeve si kjo është e domosdoshme që me ekspertët e degëve profesionale të bashkëpunojnë edhe gjuhëtarët, njohës të fjalëformimit.

(Prishtinë, 16. I. 1989)

18. RRETH BARASVLERËSIT “MARINES” TË ANLISHTES NË SHQIPE

Në shtypin tonë dhe në mjete të tjera të informimit mjaft shpesh kemi rastin ta lexojmë dhe të dëgjojmë për formacionet e caktuara të ushtrisë amerikane, të cilat po kryejnë intervenime përkatëse në vise të ndryshme të botës, forca këto që në gjuhën angleze quhen *marines* – termi *marin* *marines*, i cili për këtë koncept zakonisht përdoret në shumës dhe shqiptohet përafërsisht **mërinz** edhe pse ka prejardhje nga emri marinë (marine) me kuptimin *flotë detare*. Për për konceptin që shpreh semantikisht formacioni në fjalë nuk është i lidhur gjithaq me Marinën (flotën ushtarake detare), d.m.th. me veprime në det, por ka të bëjë kyesisht me veprime në tokë. Me fjalë të tjera me termin **marines**, përgjithësisht kuptohen “*ushtarët e këmbësorisë detare*”(Fjalori anglisht-shqip, Tiranë 1966, f.188.) apo veçantisht “*ushtarët e Këmbësorisë së Marinës së SHBA*” që është “*njëra nga katër fuqitë e armatosura të SH.B.A*”. (Shih Kici-Aliko, *Fjalor anglisht – shqip*, Romë 1969, f. 291.) Siç po shihet kemi të bëjmë me një njësi të madhe themelore të Ushtrisë së SHBA-ve, e cila për nga funksioni a raporti kicarkik është ndarë nga “Marina” (navy) si dhe nga “Këmbësoria”(infantry), si fuqi ushtarake më vete, përkatësisht trupa e tillë ushtarake është e stërvitur për *luftë amfibie*, d.m.th. edhe në tokë edhe në det. (Shih: Dictionary of current English, Ljubljana 1986 f. 520.)

Së kërtejmi ky term i fushës së terminologjisë ushtarake anglofone ka fituar një autonomi autenciteti dhe si i tillë, qoftë si trajtë shkrimore, qoftë si trajtë shqiptimore (e transkriptuar) ka depërtuar edhe në gjuhë të tjera. Në frëngjishte p.sh. me fjalën *marine* *marines*, kuptohet “*ushtari i këmbësorisë detare amerikane*”.(V. Kokona, *Fjalor frëngjisht – shqip*, Prishtën 1990, f. 629.), përkatësisht “*këmbësorët e marines së armatave angleze e amerikane*”. (N.Petit Larousse, Paris 1972, f.627.) Kurse në serbokroatishte del në trajtën **marin(a)c marinci**, fjalë ndërkombëtare kjo, e cila përkufizohet “Pjesëtarë të këmbësorisë së marines në disa ushtri”.

(Klaiç, Rječnik stranih rječi f.848.) Trajta marinci e serbishtes më tepër ka ngjashmëri me atë të shqiptimit “mërinz” se me atë të shkrimit marines.

Po në shqipe si qëndron puna?

Siç del nga shtypi ynë për konceptin në fjalë ne ende nuk e kemi barasvlerësin përkatës të konsoliduar. Nuk e ndeshim të regjistruar në asnjërin burim normativ. Kështu, si me thënë, për fjalë-konceptin në shqyrtim konkurrojnë këta katër barasvlerës njëfjalësha:

marinar, marin, marinc dhe marines.

Sa për ilustrim, tash fill, po jap nga dy shembuj për secilën trajtë, që i shkëputa nga shtypi ynë i ditës:

- a) 1) 20.000 marinarë amerikanë zbritën në Kuvajt. (Shklëndija 10/ 1992, f. 8.),
2) Marinarët e pare kanë filluar ta lëshojnë Haitin. (Bujku, 5ë10. 1994, f. 2.);
- b) 1) Divizioni 1 dhe 2 i marinëve amerikanë... (Bujku 19.11.1991, f.11.),
2) Marinët në Maqedoni... (Shkëndija, 14.VI.1993);
- c) 1) Marincët amerikanë... (Bujku, 6.IX.1994 f.2.),
2) Edhe katër mijë marina amerikanë në Kuvajt. (Bujku, 10.X.1994, f. 1.);
- ç) 1) Marinësit amerikanë - vërejtje për Serbinë. (Shkëndija, 14.VI. 1992, f.2.)
2) Marinësit amerikanë .. (Bujku, 6.IX. 1993) .

Meqenëse asnjëra nga trajtat e mësipërme nuk del e favorizuar në burimet përkatëse normative të gjuhës sonë, e shoh të nevojshme që kët çështje ta shtroj për diskutim dhe duke u bazuar në logjikën gjuhësore që nënkuprton arsyet semantike si dhe prirjen drejt-fjalëformuese e formëzuese të fjalëve të sipërcekura në shqipe, marr guximin të jap vlerësimin tim rreth përshtatshmërisë së tyre lidhur me barasvlerësin **marinës** të anglishtes.

Së pari, fjala marinar nuk i përgjigjet konceptit, të cilin e shpreh fjalë-termi *marines*, sepse me fjala *marinar* si term ushtarak ka barsvlerësi me këta përgjegjës të fjalëve të huaja:

fr. marin, gjerm, Mariner, (Matrose), sp. marinero, rus. morjajk serbokr. mornar (pomorac), it. marinio (marinero) si dhe në angl. mariner.

Termi i tillë del me kuptimin "ushtari që kryen shërbimin në flotën detare". FGJSSH f. 317.) Prandaj fjala e tillë e shqipes **marinar**, e cila, siç po shihet, ka barasvlerësi me fjalën mariner mariners të anglishtes, së këtejmi s'ka arsye as mundësi që të ngarkohet edhe me konceptin marines po të anglishtes.

Së dyti, edhe trajta **marin marinët** e shpifur për konceptin në shqyrtim nuk ka asnjë mbështetje. Në të vërtetë, për nga forma shkrimore trajta e tillë përngjan me formën e gjuhës fringe **marin marins** (lexo: mare), por siç u pa në pasqyrën e mësipërme, kjo fjalë në atë gjuhë përdoret po për atë nocion që ka fjala marinar (detar) në shqipe, përkatësisht ajo mariner në anglishte e jo edhe për fjalë-konceptin **marines**, siç e pamë më sipër. S'do mend se trajta *marin marinët* (amerikanë) s'ka kurrfarë arsye të përdoret në gjuhën tonë.

Së treti, trajta marinc, që në shumës del me mbaresë—A **marinca** (sikurse princ **princa** ose princër) dhe here here me —Ë **marincë-t** (në analogji me policë-t, milicë-t) ka përdorim mjaft të gjerë, edhe pse nuk del e regjistruar kështu në asnjërin nga burimet e caktuara normative të gjuhës sonë, madje as në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare. Pasiqë trajtat të ngjashme si kjo , d.m.th.me fundoren —C e ndeshim në gjuhën serbokroate dhe te ndonjë gjuhë tjetër, kemi bindjen se trajta e tillë, jo vetëm në interference të gjuhës i fjalës angleze "**marinz**" edhe shqiptimisht, do të jetë ushqyese e tërthortë e trajtës së tillë, qoftë në serbokroatishte, qoftë edhe në gjuhë të tjera dhe në shqipe, kur dihet fakti se shkronja fundore —Z (**marinZ**) në italishte dhe në gjermanisht lexohet —C (si c-ja e shqipes). Krahaso marinz – marinc. Sidoqoftë, trajta **marinc marincat** ose **marincët**, e cila, nga pikëpamja e fjalëformimit, del paksa ngjashëm me trajtën e serbishtes marin(a)c - marinci, në shqipe del si një rast i vetmuar, pa model.

Së katërti, trajta a versioni: **marinës marinësit**, e cila edhe pse aktualisht nuk ka përhapje aq të madhe përdorimi, pa përjashtuar ngjashmërinë e trajtave **marinc marincët**, në krhasim me milic milicët, polic policët, si trajtë me —ËS fundore, ka disa përparësi, si p.sh.:

e para, asociacionisht, edhe pse pëson ndonjë ndyshim a përshtatje të vogël sipas natyrës së shqipes, në krakasim me tri trajtat e sipërcekura, qëndron më afër trajtës shkrimore **marines** dhe të asaj shqiptimore marinz të anlishtes.

E dyta, del e regjistruar në fjalorin e Ilo Stefanllarit, jo para trajtës *marinar*, po pikërisht si barasvlerës i trajtës *marine marines* (Shih. I. S., Fjalor anglisht–shqip, Prishtinë 1988,237.)

E treta, fjala e tillë del e ndërtuar me elemente të shqipes, ngase prapashtesa –S, siç dihet del si ndajshitesë e specializuar në shqipe për formimin e njeriut sipas prifesionit a veprimtarisë, ku bën pjesë edhe emërtimi **marinës**, sipas skemës: temë-emërore + plus prapashtesë emërformuese: **marinë +S**.

Siç dihet prapashtesa –Ë/S e shqipes vlen edhe për njëjësin dhe për shumësin e trajtës së pashquar.

E katërta, emërtimi në trajtën **marinës marinësit**, del si trajtë më e përligjur nga pikëpamja e fjalëformimit, kundër trajtave të sipërcekura rivale dhe si e tillë ka mundësi implementimi më shumë në një kuptimësi të tillë dhe së andejmi ka mundësi të shktrihet si e gatuar në emërtimin e formacioneve të ngjashme në Armatën shqiptare. Me një fjalë s’ka arsye, po qese paraqitet nevoja, të mos quhen b.f. ashtu: **Ushtarët e këmbësoresë detare të Ushtrisë shqiptare: marinësit shqiptarë** ose **marinësit e forcave tona ushtarake**, në analogji me forcat e tillë të armatosura në ushtritë e botës, siç janë **marines -it amerikanë** ose **Marinsoldaten-ët gjermanë** etj.

Përveç kësaj, trajta **marinës marinësit** ka përparësi edhe kundrejt trajtës gjoja të shqipëruar **marins marinsat**, sepse në shembullin e fundit dalin të diskutueshëm edhe njëjësi edhe shumësi i këtij emërtimi. Njëjësi del i diskutueshëm në shqipe kur kemi të bëjmë me temën e qartë fjalëformuese emërtimin **marinë marina** (marinë+S marinës), ndërsa –A-ja me fundore, e specializuar për shumësin e gjinisë femërore nuk del aspak e pranueshme për formimin e shumësit të emrave të njerëzve të gjinisë mashkullore në trajtës e pashquar dhe të shquar.

Krahaso:

nj. **marins- marnësi** sh. marinsa marinsat (!???)

ndaj

nj. **marinës- marinësi** sh. **marinës marinësit**

Gjithsesi për konceptin **marine marines** të anglishtes, trajtat *marinar* e *marin* në shqipe nuk qëndrojnë, ajo *marinc marinca* si dhe ajo *marins marinsa* del e diskutueshme, ndërsa trajta **marinës marinësit**, për arsye që ka modelin e gatshëm, del sigurisht më e parapëlqyer, madje edhe duket si barasvlerësi edhe më me perspektivë.

19. RRETH SPECIFIKIMIT TË PRAPASHTESAVE NË EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT NË SHQIPE SIPAS TIPAVE KUPTIMORË

Me sa dihet në trajtimin e strukturës së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në shkallë ndërkombëtare kihen parasysh këto komponente: *niveli i strukturës kualifikuese, ndërlikueshmëria përmbajtësore e punëve si dhe profilimi i profesioneve*, madje organizimi kërkon me numrin e përafërt të profesioneve të shifruara sipas niveleve përkatëse, ilustron me një kështu skemë piramidore¹:

*
* *

10 grupe

* 58 lloje *

* 127 nënlloje . *
*

* 1021 bashkënjësi . *

mbi 21000 profesione të veçanta

* a) me profilim të gjerë *

* b) pa profilim të ngushtë . *

* dhe c) me profilim të ngushtë *

¹Shih për këtë edhe te *Abecedni spisak zanimanja*, Savezni zavod za statistiku, Beograd 1986.

Skema piramidë e numrit të profesioneve sipas rrafsheve kiearkike

Këto qasje, ç'është e vërteta, ne i kemi shfrytëzuar në punimin tonë monografik *Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe* (të mbrojtur si tezë doktrate në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të kaluar prej nga, ndonëse fragmentarisht, është nxjerrë edhe lënda e temës sonë të sotme, e cila ka të bëjë kryesisht me çështje nga rrafshi i fundit nga skema, duke vënë në pah pikërisht specifikimin e prapashtesave në formimin e emërtimeve në fjalë në gjuhën shqipe sipas tipave kuptimorë që motivohen nga temat fjalëformuese sipas 6 nënfushave përkatëse semantike, siç po i paraqitim në skemën vijuese:

Skema e tipave kuptimorë dhe zbërthimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit mbi këtë bazë

r. rend.	Tipi kuptimor a nënfusha semantike sipas	Zbërthimi	Prapashtesa e specifikuar	Shembuj
.	procesit të punës	ai që... (+ folja e procesit përkatës)	- S -TAR	punues, mbathës mbathtar
.	mjetit të punës	ai që punon me ... (+ emri i veglës)	-AR -TAR -ATORE -XHI -IST -IER -ER	sëpatar sharrëtar furkatore sharrëxhi shaptilografist gondolier komanjer

·	produktit të punës	ai që bën, prodhon ... (+ emri i produktit)	-TAR -AR -ATORE -XHI	fshesëtar fshesar fshesatore fshesaxhi
·	lëndës objektit punës	a të ai që përpunon, kultivon, përdoron ... (+ emri i lëndës a i objektit)	-TAR, -AR -XHI -IST	artar argjendar kallajxhi metalist
·	vendit a lokalit të punës	ai që punon në ... (+ emri i lokalit)	-TAR -AR -S -XHI -IST -ER -IER	zyrtar bujtnar mullis furrxhi depoist fermer doganier
·	degës veprimtarisë	a ai që merret me ... (+ emri i degës a veprimtarisë)	-ZERO -TAR -AR -AN -TOR -OR -ER -IST -IER	bujk dijetar pleqnar matematik punëtor drejtor togër albanist boksier

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, prapashtesat përkatëse vendëse dhe të huazuara (gjithsej 11 të identifikuara këtu), përveç prapashtesës -TAR që ka shtrirje në të gjashtë nënfushat përkatëse dhe prapashtesës -AR në pesë, prapashtesat e tjera ndeshen në më pak nënfusha. Kështu prapashtesa -S, b.f., del e specifikuar vetëm për nënfushën e parë sipas procesit të punës, d.m.th. mbi temë foljore, por ka shtrirje edhe në nënfushën sipas vendit a lokalit të punës, ku nuk del aq prodhimtare. Prapashtesa -ATORE, karakteristikë e emërtimeve me gjini përfaqësuese femërore, del kryesisht në dy nënfusha semantike, ndërsa prapashtesat -OR,

-TOR dhe -AN, vetëm në nga një, ashtu si edhe prapashtesa -ZERO. Të vihet re, gjithashtu, se prapashtesat e përvetësuara -XHI dhe -IST dalin në nga katër nënfusha semantike, por nuk përputhen plotësisht, kështu që prapashtesa -XHI nuk del në nënfushën e gjashtë, ndërsa ajo -IST në nënfushën e tretë. Prapashtesat -ER dhe -IER dalin bashkë në tri nënfusha, por kryesisht sipas huazimeve transfer dhe nuk dalin prodhimtare mbi fjalëtema të brumit të shqipes. Ngase çështje të tilla, janë trajtuar e do të sheshohen më në hollësi në analiza a punime të tjera, megjithatë diçka, sadopak, do të ceket edhe tashti fill, pasi të konsultojmë të dhënat nga numri i tërësishëm i emrave me prapashtesat e specifikuar sipas burimeve përkatëse që po i paraqitim në pasqyrën e mëposhtme:

Pasqyra e numrit të emrave të njerëzve sipas profesionit me prapashtesim sipas fjalorëve përkatës²

Prapashtesa	FGJSH 1954		FSHSK 1976		FGJSSH 1980		FSHSK 1981		FSHS 1984	
	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
-S	29	17	94	32	140	35	179	41	390	52
-TAR	37	21	58	20	88	21	58	13	120	16
-AR	31	18	20	7	34	8	26	6	73	9
-TOR	21	12	14	5	25	6	27	6	13	2
-OR	7	4	3	1	13	3	6	1	6	1
-IST	28	16	53	18	72	17	71	16	89	12
-XHI	30	17	39	13	30	7	37	8	29	4
-IER/-ER	10	6	9	3	20	5	30	7	32	4
Gjithsej:		183	290	422		432		752		

Nga krahasimi i të dhënave nga tabela e mësipërme mund të nxirren konstatime të ndryshme jo me pak interes, mirëpo ne për hirë të kohës dhe përmasave që ka kjo paraqitje, duke rishënuar pjesërisht, do të krahasojmë vetëm numrin e emërtimeve në mes të dy burimeve: FGJSH 1954 dhe FSHS

² Burimet e konsultuara janë: *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954; *Fjalori shqip-serbokroatisht* i M. Ndreçës, Prishtinë 1976; *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980, *Fjalori shqip-serbokroatisht* (IA), Prishtinë 1981 dhe *Fjalori i shqipes së sotme* Tiranë 1984 (përkatësisht 2002)

1984 (2002), d.m.th. të një periudhë 30-50 vjeçare, për të vënë në pah prirjen rreth shumësisë si dhe përqindjes dhe ja si del rezultati:

Pasqyra krahasuese e shumësisë FGJSH 1954 – FSHSs 1984

Prapashtesa	FGJSH 1954		FSHS 1984		Raporti + ose -	
-S	29	ose 17%	390	ose 52%	+361	ose +32%
-TAR	37	“ 21%	120	“ 16%	+83	“ - 5%
-AR	31	“ 18%	73	“ 9%	+42	“ - 9%
-TOR	21	“ 12%	13	“ 2%	- 8	“ -10%
-OR	7	“ 4%	6	“ 1%	- 1	“ -3%
-IST	28	“ 16%	89	“ 12%	+61	“ -4
-XHI	30	“ 17%	29	“ 4%	- 1	“ -2%
-IER/-ER	10	“ 6%	32	“ 4%	+22	“ -2%

Siç po shihet nga treguesit plus / minus, numër më të madh plus shënojnë shembujt me -S për 361 raste, më -TAR 83, më -IST 61, më -AR 42, dhe me -ER/IER 22 që gjithsej bëjnë 569 emërtime të shtuara, t’i quajmë *të reja*. Ndërsa në minus janë emërtimet më -TOR - 8 ose 10%, ato më -OR dhe më -XHI me nga 1% minus, mirëpo sa i përket përqindjes vetëm emërtimet më -S e kanë treguesin pozitiv (32% plus), ndërsa të gjithë të tjerët minus, ndër më të dalluarit janë emrat më -XHI minus 13%, ata më -TOR minus 10% dhe më -AR minus 9% e kështu me radhë

Është e vërtetë se formantet e caktuara në të njëjtën nënfushë semantike mund të jenë në marrëdhënie të qëndrueshme bashkekzistence, por edhe në raporte konkurrence. Lidhur me këto çështje këtu nuk do të ndalemi në hollësi, por s’mund të lëmë pa përmendur kalimthi bashkëjetesën dhe njëkohësisht edhe konkurrencën në mes të prapashtesave -S, -TAR dhe -AR, prapashtesa këto më vepruese e prodhimtare të burimit vendës për këtë klasë emërtime.

Prapashtesa -S (-UE/S, -YE/S, -Ë/S), edhe pse ndeshet në homonimi me klasën e emërtimeve të mjeteve a të sendeve konkrete, del vepruese dhe prodhimtare për emërtimet në shqyrtim, jo vetëm në emrat e prejardhur mbi temë foljore, por ajo del shumë prodhimtare dhe vepruese edhe në emrat e

përbërë (zakonisht emër + emër foljor më -S) dhe pikërisht në këtë pikë krijon sinonimi me diferencim kuptimësie me emërtimet e prejardhura më -TAR, siç do të shohim në vazhdim.

Në raportin në mes të prapashtesave -TAR dhe -AR dalin çështje që zgjojnë interes të posaçëm, ngase nga një analizë e tillë mund të nxirren rezultate që plotësojnë, por edhe që ndryshojnë ndonjërin nga konstatimet e njohura më parë.

Së pari, ndërsa në FGJSH 1954 raporti numerik ishte pothuajse i përafërt, në burimet e tjera ky raport ndryshon shumë në dobi të prapashtesës -TAR, kështu në FSHS 1984, përkatësisht 2002 emërtimet më -TAR dalin gjysmëpërgjysmë më shumë kundrejt atyre më -AR. Po rikujtojmë faktin se edhe te vepra e Buzukut raporti numerik del pak më i dalluar, 10 me 7 ose 3 me 1, ndërsa te Fjalori i F. Bardhit, 28 me 6, afro 5 me 1, gjithnjë në favor të prapashtesës -TAR, pa përmendur Fjalorin e “Bashkimit”, ku trajtat më -TAR ndaj atyre më -AR, si me thënë, subjektivisht dalin më të favorizuara.

Së dyti, kur është fjala te shumësia e numrit, po në këtë vazhdë, po përmendim edhe një fakt tjetër, si të themi, hipotetik. Mëse çereku i emrave më -AR si temë fjalëformuese kanë një fjalë me -T fundore, tipi: *detar, kopështar, bletar*, andaj mund të sugjerohet se në rastet e tilla ka mundur me pasë dorë procesi i njëfarë haphologjie formale në dëm të prapashtesës -TAR, pra sipas veprimit të njohur: det+tar det(ë)-tar a dettar de/tar detar, e kështu me radhë, ngase kështu më -TAR (detëtar, kopshtëtar etj.) i ndeshim, edhe sot e kësaj dite në mjaft burime. Sidoqoftë, kjo çështje, për mendimin tonë, që nuk paraqet, sot për sot, problem drejtshkrimor a fjalëformues, duhet të kihet parasysh së paku nga studiuesit, kur kemi të bëjmë me përzgjedhjen e formës së caktuar, qoftë te rastet e reja, qoftë te rastet konkurruese edhe me formante të tjera (krahaso: i shenjtë shenjtor, shenjtërues, shenjtëtar, jo shenjtari).

Së treti, edhe në rastet kur dalin të shënuara paronimisht në burimet tona normative trajtat mbi temë të njëjtë fjalëformuese si:

vorbar e vorbëtar, vegshar vegshëtar, lundrar e lundërtar, fshesar fshesëtar, cergar, cergëtar etj.

dhe është fjala për të njëjtin koncept, ma merr mendja se pa ngurrim duhen përligjur trajtat më -TAR. Kjo dukuri me dysorë (-AR/-TAR) del më e shfaqur dhe mund të diskutohet te nënfushat semantike *sipas veglës së punës, sipas produktit të punës dhe sipas lëndës a objektit përpunues*, por jo

te disa raste nga nënfusha *sipas lokalit a vendit të punës* si p.sh.bujtnar, bashtinar etj. dhe sidomos *sipas veprimtarisë shoqërore-politike* si p.sh.

vendar, familjar, pleqnar, kuvendar, titullar etj.,

ku prapashtesa -AR del pa konkurrencë, andaj ky fakt duhet pasur parasysh.

Së katërti, gjithsesi shikuar në tërësi, prapashtesa -TAR del më e specifikuar për emërtimet në shqyrtim kundrejt prapashtesës -AR, sepse formanti -TAR nuk është i zënë për nënfusha të tjera semantike si prapashtesa -AR, e cila pos në emra të huazuar, tipi: funksionar, komandar, bibliotekar, aksionar etj. del e angazhuar edhe në:

a) emërtime të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes, si p.sh.: gjakovar, tetovar, bregdetar etj.;

b) emërtime të vendbanimeve si Gjinar, Vegshar, Lugar, Kuqar etj. dhe

c) emërtime të veglave a sendeve konkrete si p.sh. ditar, ngjeshar, drithar, sqepar, kulmar etj., nënfusha këto, me të cilat nuk del e ballafaquar prapashtesa -TAR.

Së pesti, si përparësi dalluese e prapashtesës -TAR ndaj -AR po ritheksojmë edhe vetë faktin se prapashtesa -TAR jo vetëm del më e specifikuar në formimin e fjalëve mbi temë emërore, po ajo si e vetme, në letrarishten e sotme, del edhe në bashkëjetesë sinonimike me prapashtesën -S, në emra të përbërë, pra, edhe mbi temë foljore, madje duke formësuar fizionomi gjithnjë e më të qartë semantike, gjë që do të vërehet, në tri nënfusha semantike, siç do të shihet në skemën e vargut fjalëformues që po e paraqitim tani:

Skema e vargut fjalëformues të shkallëzuar pa e me profilim të ngushtë profesioni

Emërtimi i vendshërbesës	Emërtimi i njeriut pa profilim të ngushtë profesioni	Emërtimet e njeriut me profilim të ngushtë profesioni
1. mëso(n)jtore (shkollë)	mësues	mësues në çerdhën e fëmijëve; mësues i gjuhës shqipe në tetëvjeçare; mësues i kimisë në shkollë të mesme, mësues i <u>kibernetikës etj.</u>
2. vegëltore	vegëltar	vegëlgrihës, vegëlmprehës, vegëlsaldues, vegëlpunues,

		<u>vegëlpaketues, vegëlshitës etj.</u>
3. ëmbëltores	ëmbëltar	ëmbëlsiqegatues, ëmbëlsirashitës, ëmbëlsiqebërës, ëmbëlsiraservues etj.
4. çajtores	çajtar	çajbërës, çajshitës, çajqitës, çajshpërndarës, çajblerës etj.
5. punishte metali (hekurtores)	metalist (mekanik) (hekurtar	metalpunes, metalshkrirës metalshpues, metalgdhëndës; axhustator-mekanik, hekurkthyes, hekurpunes etj.
6. mishtores	mishtar	mishshitës, mishcoptues <u>mishtharës</u> etj.
7. gëzoftores	gëzoftar	gëzofpunes, gëzofshitës gëzofarnues, gëzofqepës etj
8. lëkurëtore /lëkurëtari/	lëkurëtar /lëkurës/	lëkurëmbledhës, lëkurëpunes, lëkurëregjës, lëkurëshitës, lëkurëterës etj.
9. blegtori/a	bari (blegtar)	bari (blegtor, çoban) lopësh, bari dhensh (dhenruajtës), bari dhish etj.
10. ngrohtores	ngrohtar	ngrohës i kazanave me avull, ngrohës i zyreve të punës, mirëmbajtës i ngrohjes qendrore etj
11. këmbimtores(!) /bankë kursimtores/	këmbimtar	këmbyes-nëpunës i të hollave me çeqe, këmbyes zyrtar i valutave, përcjellës bursës këmbyes etj.

Pa hyrë në hollësi të tjera tërheq vëmendjen në dy sirregulla që dalin nga shembujt e të dy rubrikave të fundit nga skema e mësipërme:

e para, ka të bëjë me faktin se emërtimet e rubrikës së tretë më -TAR janë profesione pa profilim të ngushtë, konstatim që vlen edhe për të gjitha nënfushat e tjera semantike, andaj edhe del e nevojshme të shënohen si të tillë në burimet përkatëse, sepse këta emra shprehin koncept më të gjerë (hiperonimik) ndaj emrave në rubrikën e katërt, ku shembujt dalin me profilim të ngushtë (hiponimik) të profesionit. Andaj këto gjëra duhen dalluar aty ku natyra e kontekstit e kërkon, ngase kemi të bëjmë me nocione të diferencuara, që mbulojnë, po përsëris, nocione të ndryshme: *pa profilim të ngushtë / me profilim të ngushtë*;

e dyta, lidhet me zhvillimin që merr emërtimi i caktuar sipas nënfushave semantike, kështu emërtimet e njerëzve sipas profesionit me profilim të ngushtë *sipas mjetit të punës, sipas produktit të punës dhe sipas lëndës a objektit të punës*, profilimin e bëjnë zakonisht me **kompozitë**, siç po shihet nga shembujt e mësipërm, ndërsa emërtimet e njerëzve sipas tri nënfushave të tjera: *sipas procesit të punës, sipas vendit të punës dhe sipas degës a veprimtarisë së punës* profilimin e ngushtë të profesionit e bëjnë me **togfjalësh** ose me gërshetim a plotësim profesioni.

P ë r f u n d i m

Të gjitha emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe sipas tipave kuptimorë u merenduan në këto 6 nënfusha semantike: *sipas procesit të punës, sipas mjetit të punës, sipas produktit të punës, sipas lëndës a objektit që për/punohet, sipas vendit të punës dhe sipas degës a veprimtarisë së caktuar* dhe për të gjitha këto nënfusha si rregull del zbërthimi përkatës i emrit me prapashtesën përkatëse. Në skemë u dhanë shembuj me 11 prapashtesa të identifikuara vendëse: -S, -TAR, -AR, -ATORE, -TOR, -OR, -AN, -ZERO dhe të përvetësuarra (të huazuara): -XHI, -IST, -ER/IER

Emrat me prapashtesën -S mbi temë foljore dalin shumë veprues e prodhimtarë. Prapashtesa -TAR ka shtrirje në të gjitha nënfushat semantike dhe marrë në përgjithësi, kjo prapashtesë është specifike me mundësi specializimi për emërtimet në shqyrtim, sidomos mbi temë emërore, por ka prirje shumimi edhe mbi temë foljore(pjesore). Prapashtesa -AR, edhe pse del e shtrirë në pesë nënfusha semantike, ajo vetëm për ndonjë pjesë të nënfushës së caktuar del me specifikim të qartë, sidomos në nënfushën *sipas degës a veprimtarisë*. Ndër prapashtesat e huazuara më aktive del prapashtesa -IST e në raste edhe ajo -IER/ER, të tjerat tregojnë se mbulojnë ose pjesë të nënfushës së caktuar semantike (-ATORE, -AN, -ZERO) ose tregojnë pasivizim (-XHI, -OR dhe -TOR).

Emërtimet sipas nënfushave semantike: *sipas mjetit të punës, sipas produktit të punës dhe sipas lëndës a objektit që për/punohet* profilimin e ngushtë e bëjnë zakonisht **me kompozim**, ndërsa në tri nënfushat e tjera, d.m.th. *sipas procesit të punës, sipas vendit të punës dhe sipas degës a veprimtarisë*, profilimi i ngushtë shprehet **me togfjalësh**.ose me gërshetim a plotësim profesioni.

Prishtinë, korrik 2003

20. EMËRTESTAT E GUIDAVE TË SOTME ZYRTARE TË PROFESIONEVE ME SHQIPE TË PËRDËSHIRUAR

(Në prag të regjistrimit të popullsisë 2010)

H y r j e

Siç mësojmë nga masmedia dhe nga burime të tjera në muajt e parë të vitit të ardhshëm (2011) është planifikuar të bëhet **Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave**, duke përfshirë pothuajse të gjitha shtetet ose trojet ku jeton e ngulitur edhe popullata shqiptare. Pra, ky regjistrim i popullsisë nuk do të përfshijë vetëm Shqipërinë e Kosovën, por edhe Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi, mbase edhe më gjerë, duke mos e lënë jashtë edhe tërë diasporën e mërgatën shqiptare. Pa dyshim, ngjarje kjo me rëndësi të shumanshme për shqiptarët kudo që janë.

Gëzon fakti, se në të gjitha këto treva (shtete), por sidomos në Kosovë, pohohet, se qenkan bërë të gjitha (para)përgatitjet e duhura për këtë *eveniment* të rëndësishëm “konform standardeve dhe kritereve të KB-së e BE-së (UNESCO-s)”, përgatitje këto që, siç thuhet, “garantojnë një regjistrim rezultativ”. (Zëri, Prishtinë, 26.05.’10, f. 1.)

Dhe vërtet, me sa bëhet me dije, e kemi fjalën kryesisht për Kosovën, pasi, para disa viteve me bekimin e organizmave të BE-së, qenka miratuar nisma për regjistrim, qenkan siguruar edhe mjetet për këtë punë, jo vetëm mjetet materiale, por bashkë me to edhe mjetet e tjera të domosdoshme teknike e ato byroteknike përcjellëse, siç janë: *guidat* ose doracakët e udhëzuesit bashkë me formularët përkatës, duke u siguruar deri edhe “hartat e nevojshme (të hartuara e të incizuara) që nevojiten për “regjistrimin e banorëve dhe të pasurisë të tyre”, madje qenkan trajnuar edhe kuadrot e nevojshëm për regjistrim etj.

Ne nuk jemi kompetent dhe as që duam të sjellim në dyshim përgatitjet e tilla, por kur është fjala rreth problemit të teksteve a të *guidave* përkatëse në gjuhën tonë, sidomos në trevat ku përdoret a duhet të

implementohet gjuha shqipe, shprehim rezervë të ligjshme se kjo punë do të jetë kryer kënaqshëm. Kur themi kështu mbështetemi në faktin se jo të gjitha punët gjuhësisht mund të jenë kryer, si thuhet, *okej*, sepse, ç'është e vërteta, edhe pse, në të gjitha trevat shqiptare, e ndeshim të përfaquar një gjuhë standarde shkrimi, ajo, sidomos në aspektin e njëzimit të terminologjisë, por edhe përgjithësisht, me sa dimë, prej treve në trevë nuk del dhe aq e njëzuar, madje edhe brenda vendit amë hetohen mangësi. Pse qëndron një gjendje e tillë? S'është vendi as nevoja ta shpjegojmë këtu. Dihet shkaqet objektive, por edhe ato subjekto-objektive. Ne, pa zënë në gojë probleme të njohura gjuhësore të kësaj natyre që nuk janë të pakta, do të ndalemi vetëm në një çështje: në segmentin **rreth përgatitjes dhe qëndrueshmërisë** lidhur me **guidat (doracakët) e profesioneve në gjuhën shqipe**, ngase klasifikimi **dhe formulim-përcaktimi i profesioneve**, siç dihet, është "**standard i obligueshëm**" në çdo administratë shtetërore dhe kjo implementohet sidomos në **institucionin e regjistrimit të popullsisë** dhe së këtejmi në formularët përkatës të regjistrimit qenka paraparë me u shënue edhe profesioni i personit të regjistruar.

Sidoqoftë, siç u paracek, ne pikërisht lidhur me këtë temë, d.m.th. rreth gjuhës së profesioneve, emërtimit të tyre, se çfarë parapërgatitjesh janë bërë në këtë drejtim dhe cilat probleme mbesin të hapura dhe çfarë duhet bërë aktualisht e në të ardhmen, veç tjerash, si më të ditës, konsultuam këto tri burime (guida) zyrtare:

- 1) **Klasifikimi i profesioneve në Kosovë** (botim i Prishtinës 2006), hartuar dhe miratuar nga UNMIK-u dhe pesë institucione profesionale shtetërore të Kosovës;
- 2) **Standardi ndërkombëtar i nomenklaturës së profesioneve sipas ISCO-88** (publikim i Tiranës nga fillimi i dekadës së parë të 2000-shit) dhe
- 3) **Lista kombëtare e profesioneve** (publikim i Tiranës në internet), miratuar nga Qeveria dhe Parlamenti i Shqipërisë, qershor-gusht 2009.

Në të vërtetë, para se të paraqitin vëzhgimet tona, për gjuhën e tri *guidave* të sipërsënuara, fillimisht do të japim disa sqarime praprake dhe më pastaj, duke u mbështetur në lëndën e shtruar po në të tri burimet e sipërsënuara, do të japim konstatimet me vërejtje të përgjithshme e të

veçanta, ku shqipja standarde sipas nesh, del e përdëshiruar e vende - vende mbase, mund të thuhet, se del edhe si e dështuar(!) dhe së fundi, do të përpiqemi me dhënë ndihmesën tonë modeste, së paku me sugjerime e propozime konkrete, se si mund dhe duhet me u zgjidhë në gjuhën tonë çështjet e hapura gjuhësore lidhur me këtë problematikë shumë komplekse, siç është: **emërtimi i profesioneve**, punë kjo që ne nuk e shohim pa rrugëdalje.

Konstatime paraprake

Para se të japim konstatimet tona se çfarë duhet bërë që edhe **Lista e profesioneve në gjuhën shqipe** të jetë më e niveluar dhe të vlejë për të gjitha trevat e hapësirës shqiptare po njoftojmë lexuesit se me gjendjen dhe rrjedhat e kësaj problematike (rreth emërtimit të profesioneve) kemi qenë të involvuar mjaft përnjëmend që në fillim të viteve të '80-a të shekullit të kaluar e pak përpara, d.m.th, para formulimeve të ISCO-88, (pra, para materialit nga burimi i dytë i sipërcekur i përkthyer nga ekspertët e Tiranës), ngase qysh atëherë duke qenë i ballafaquar me probleme të emërtimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe te ne (Kosovë), sidomos në ndërmarrje prodhuese metalpërpunuese (Uzina e Amortizatorëve - Prishtinë), ku isha i punësuar si përkthyes, qemë të interesuar të njihemi më gjerësisht rreth problematikës në fjalë. Dhe këtë interesim nuk e patëm kufizuar vetëm me kërshërinë, por aq më shumë e patëm ndërlidhur e kuptuar seriozisht si zotim për t'i kryer si duhet me ndërgjegje të plotë, punët dhe detyrat nga vendi i punës, sipas të drejtës ligjore, që më fort ishte e drejtë fakultative, që na lejohej në atë kohë, andaj i cytur ndërgjegjësisht (si arsimdashës që më dhunë më ishte marrë ditari i mësuesit) u angazhuam që në këtë fushë të rrahur jo sa duhet gjuhësisht, si te ne, ashtu edhe më gjerë, ta përqaqnim temën rreth emërtimit të profesioneve dhe sadopak ta jepnim kontributin tonë në këtë kontekst. Po atëbotë bëme përpjekje që të merrnim njohuri se si dilte e zgjidhur kjo çështje, jo vetëm në kuadër të Kosovës e në shkallë ndërshtetërore (Jugosllavi – Shqipëri), por edhe më gjerë në suaza europiane e botërore.

Qysh atëherë, pra, kryesisht nëpërmjet literaturës në gjuhën serbokroate ishin në dijeni rreth regjistrit të profesioneve nga ILO-ja (Zyra Ndërkombëtare e Punës), përkatësisht u njohëm sadopak me të dhëna për ISCED com. Paris (Unesko) 1976 etj., ngase atëherë në ish-Jugosllavi bëhej përpjekje për reforma jo vetëm në sistemin shkollor-arsimor, por edhe më

gjerë, në mënyrë që sistemi ekonomik i vendit të ndërli dhej me tregun e punës (me ekonominë e tregut) në shkallë europiane e botërore, andaj edhe në administratën shqipe që praktikohej sadokudo në atë kohë shumica e emërtimeve të tilla të profesioneve u përkthyen në shqip (u kalkëzuan) nga serbokroatishtja, qoftë për nevojat e Entit Statistikor Federativ, qoftë për Institucionin e punësimit.

Kështu, ndërkohë pikërisht rreth verifikimit të përshtatshmërisë gjuhësore të barasvlerësve përkatës të emërtimeve në fjalë serbokroatisht shqip e anasjelltas ose rreth qëndrueshmërisë, apo jo, të rasteve të veçanta të tyre, hetuam mjaft golle në këtë fushë dhe ndërkohë e me kohë filluam t'i shprehnim vëzhgimet tona edhe botërisht, kështu, në të vërtetë, patëm filluar me botue artikuj, duke ngulmuar me forcën e mendjes që emërtimet në gjuhën shqipe patjetër drejtshkrimisht duhet të ishin në përputhje me normën letrare, në frymën e *Kongresit të Drejtshkrimit* 1972, përkatësisht që edhe gjuha e profesioneve në shqipe përmbajtësisht gjithsesi të ishte në përputhje me natyrën e gjuhës sonë dhe patjetër të ishte në harmoni, sa ishte e mundur, me ato emërtime që i dinim se përdorehin në Shqipëri. Nga ato shkrime (artikuj e trajtesa) të botuar që preknin këtë çështje, numri i të cilave kalonte pesëdhjetshin, këtu, për lexuesin e nderuar, po i rikujtojmë vetëm titujt e këtyre katër trajtesave:

1. *Çështje të emërimit të njerëzve sipas profesionit (Seminari... 1983).*
2. *Çështje rreth emërimit të profesioneve në shkollat tona të mesme (reviste "Gjuha në shkollë") 1987.*
3. *Çështje rreth emërimit të njerëzve sipas veprimtarisë në gjuhën shqipe nga ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore, botuar në revistën Përparimi (Prishtinë) nr.3/89, f. 377-397)) dhe :*
- 4) *Rreth specifikimit të prapashtesave në emërtimin e njerëzve sipas profesionit sipas tipave kuptimorë (Seminari...2003).*

I përmendëm këto trajtesa, ngase mendojmë se rezultatet nga përmbajtja e tyre ende nuk janë konsumuar si e sa duhet në jetën tonë praktikisht.

Ç'është e vërteta, po në këtë fillim-periudhë, d.m.th. në vitet e '80-a të shekullit të kaluar po kësaj problematike i patëm kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje dhe këtë e dëshmojmë me faktin se po në atë kohë e ndërkohë e patëm trajtuar si tezë doktrate temën me titull: **Struktura**

fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe, të cilën e patëm mbrojtur më 1992. Këtë punim para mbrojtjes dhe më pas, e patën vlerësuar shumë pozitivisht studiuesit e njohur (oponentë) të asaj e të kësaj kohe, si prof. Idriz Ajeti, prof. Androkli Kostallari, prof. Latif Mulaku (mentor), prof. Rexhep Ismajli, prof. Mehmet Halimi, prof. Murat Blaku e të tjerë, tekst ky që, ishte paraparë me u botue në edicionin e botimeve të Institutit Albanologjik të Prishtinës, por mjerisht për shkak të rrethanave jo të favorshme që pasuan, mungesës së mjeteve etj., jo me fajin tonë, punimi në fjalë shumë kohë pati mbetur dorëshkrim.

Në të vërtetë, po bëjmë me dije opinionin, se ne atëherë, pos fjalorëve përkatës gjithandej të botuar deri në ato kohë nuk patëm mundësi ta kompletionin punimin me të dhëna zyrtare nga shteti shqiptar, përkatësisht nuk patëm mundësi të konsultonim emërtimet përkatëse në institucionet dhe ndërmarrjet përkatëse prodhuese të atëhershme të Shqipërisë, po këtu në Kosovë i patëm konsultuar, jo zyrtarisht, por mbi bazë shoqërore), pothuaj shumicën e organikave (sistematizimeve të vendeve të punës) të institucioneve dhe të ndërmarrjeve përkatëse të njohura të vendit, ku aplikohet dygjuhësia (serbokroatisht-shqip).

Sidoqoftë, ne që atëherë në punimet e botuara për zgjidhjet më të përshtatshme terminologjike në gjuhën tonë patëm dhënë mjaft supozime e risime, zgjidhje teorike e më fort praktike rreth konsolidimit të emërtimeve në fjalë, por që mjerisht mjaft çështje të diskutueshme për të cilat atëherë ofronim zgjidhje të pakundërshtueshme ose të përshtatshme, nuk gjetën implementim dhe kështu deri në ditët e sotme mbeten të pazgjidhura, ngase nuk njiheshin nga ekspertët e caktuar, si te ne, ashtu edhe më gjerë (në Shqipëri), por megjithatë, disa mendime e sugjerime tona nuk mbeten krejtësisht pa jehonë. Madje ndonjë gjurmë të kësaj jehone hetohet edhe në guidat që po i trajtojmë këtu.

Në të vërtetë, atëherë kishte implikime jo të vogla rreth disa termave që binin në kundërshtim me sistemet përkatëse shkollore si dhe disa në raporte ndërshtetërore, andaj ato ndryshime mbeten si të tilla deri në ditët tona. E themi me keqardhje, *mbeten deri në ditët tona*, edhe pse tashti në dhjetëvjetshin e parë të këtij **Mijëvjeçari të ri** u krijuan kushte shumë më të favorshme për trajtimin edhe të kësaj teme, seç i kishim ne atëherë. Them *me keqardhje*, sepse ende nuk është bërë punë e duhur në të mirë të harmonizimit të terminologjisë përkatëse shqipe, siç kërkonim ne atëherë dhe kërkojmë më me ngulm edhe sot, harmonizim ky që duhet ta bëjnë sa më shpejt e mirë institucionet tona përkatëse ndërshtetërore Shqipëri-

Kosovë-Maqedoni. Ç'është e vërteta, tashti ka mundësi që kjo punë të bëhet në një atmosferë konsultimi shumë të përshtatshme, jo vetëm në raportin ndërshtetëror Shqipëri – Kosovë, por edhe me bashkëpunim të drejtpërdrejtë të qendrave përkatëse profesionale në kuadër të fakulteteve e ndërmarrjeve prodhuese shtetërore e private, kombëtare e ndërkombëtare.

Më sa dimë, pra, një harmonizim i tillë ende nuk ka filluar me seriozitetin e duhur dhe lidhur me këtë mbase mund të ketë ndonjë arsye, por ne, në mos qofshim të gabuar, kemi bindjen se një mospunë e tillë më fort është rrjedhojë e shkaqeve subjektive, se sa për aso subjekto-objektive. Me sa dimë, sot nuk mungojnë kuadro ekspertësh, por më tepër mungon organizimi, iniciativa dhe financimi i një bashkëpunimi të tillë ndërinstitucional Tiranë - Prishtinë e më gjerë. Nuk mund të besojmë që faktorët përkatës ndërshtetërorë nuk e kuptojnë rëndësinë e këtij veprimi. Me fjalë të tjera nuk dimë pse nuk po shfrytëzohen sa duhet këto dy favore që ne nuk i kishim më përpara:

e para, bashkëpunimi, pa pengesa, ndërshtetëror i terminologëve (Tiranë-Prishtinë-Shkup) dhe

e dyta, sistemi shkollor pothuajse unik, ngase në të gjitha qendrat arsimore shqiptare (sidomos Shqipëri –Kosovë) është duke u zbatuar sistemi shkollor, sipas kurrikulave përkatëse të Bashkimit European, siç dëshmojnë edhe tri guidat e sipërcekura.

Pra, nga ai sistem (ISCO-88), në tri burimet e sipërpërmendura nuk është përvetësuar vetëm metoda e mënyra e klasifikimit, por janë përvetësuar me kalkëzim (përkthim e përshtatje) shumica e emërtimeve në fjalë, me ndonjë ndryshim specifik jo aq me peshë. Si rrjedhojë e kësaj nënkuptohet se ne tashti nuk e diskutojmë, pra as metodën e punës, as shifrimin a mënyrën e klasifikimit të profesioneve, por e diskutojmë dhe tërheqim vërejtje vetëm rreth qëndrueshmërisë, apo jo, të gjuhës dhe të terminologjisë shqipe në tekstet e burimeve në fjalë dhe përgjithësisht.

Sidoqoftë, ne tani, vëzhgimet tona për materialin e këtyre tri burimeve, të cilat më pak ose më shumë, përveç të mirave që kanë përshkohen nga lajthitje e anomali të ndryshme gjuhësore, të tolerueshme e të patolerueshme, po e shfrytëzojmë si krye më vete, për të përplotësuar dhe rifreskuar të njëjtën temë ose një segment të saj, që e patëm trajtuar në monografinë tonë *Struktura fjalëformuese e emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe*, që tani mendojmë ta botojmë me titull të modifikuar: **Rreth formëzimit të emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe**. Së këtejmi, po japim në vazhdim disa zgjidhje e sugjerime që i gjykojmë se janë me

shumë interes praktiko-shoqëror e teoriko-shkencor që kryesisht kanë të bëjnë me emërtimin e njerëzve sipas profesioneve në gjuhën shqipe, të dhëna këto që e përplotësojnë sadopak, siç u paracak, objektivin e punimit tonë të doktoratës, duke paraqitur të dhëna të reja rreth versioneve të formulimit të klasifikimit të profesioneve në grupe dhe kodimin e tyre shifror, numrin e grup-profesioneve sipas guidave në shqyrtim dhe pasqyrën e emërtimeve të grupeve të mëdha sipas burimeve në shqyrtim dhe nivelimin ose shkallën arsimore sipas ISCO-88.

1) Versionet e formulimit të klasifikimit të profesioneve dhe kodimi i tyre

Tash fill po i themi dy fjalë rreth versioneve të formulimit të klasifikimit të profesioneve në grupe dhe kodifikimin shifror të tyre sipas ISCO-88, ku janë bazuar të tri burimet e sipërcekura, por edhe punimi ynë i doktoratës (edhe pse ai që kryer nën ndikimin e doracakut përkatës të gjuhës serbokroate), burime këto që do t'i citojmë me këto shkurtesa:

- *Klasifikimi i profesioneve në Kosovë, shkurtesa **KPK***;
- *Standardi ndërkombëtar i nomenklaturës së profesioneve sipas ISCO-88, shkurtesa: **T1***;
- *Lista kombëtare e profesioneve, shkurtesa **T2** si dhe*
- *Klasifikimi unik i profesioneve në ish-Jugosllavi (1986), ku është bazuar disertacioni ynë (shënuar formulimi serbokroatisht e përkthimi shqip), shkurtesa **Ds**.*

Siç dihet në tri guidat e mësipërme emërtimi shqip i profesionit ose më mirë: **emërtimi i njeriut sipas profesionit**, është bërë nën ndikimin (kalkëzimin) e emërtimeve të tilla në gjuhët përkatëse zyrtare të BE-së, e në veçanti në versionin në gjuhën angleze, ndërsa në punimin tonë të doktoratës të viteve të '80-a të shekullit të kaluar që kryer nën ndikimin e emërtimeve të gjuhës serbokroate, sipas doracakut: "*Klasifikimi unik i profesioneve Lista alfabetike e emërtimeve të profesioneve*, botim i Entit Federal të Statistikës Beograd, dhjetor 1986. (Shih *Jedinstvena klasifikacija zanimanja Abecedni spisak naziva zanimanja*, Beograd, decembar 1986.)

Ja si dalin formulimet ose emërtimet e paralajmëruara lidhur me kodimin në fuqi:

I. Kodi me 1 shifër (shifra e parë):

angl. major groups;

shq. KPK – grupi kryesor, T1 dhe T2 – grupet e mëdha;

Ds: grupe zanimanja / grupe profesionesh.

II. Kodi me 2 shifra:

angl. sub-major groups;

shq. - KPK - grupi nënkryesor, T1 nëngrupet e mëdha, T2 nëngrupe të mëdha (fusha të aktivitetit);

Ds - vrste zanimanja / llojet e profesioneve.

III. Kodi me 3 shifra:

angl. minor groups;

shqip: KPK - grupet e vogla të profesioneve, T1 - grupet e vegjël, T2 grupet e vogla ;

Ds: podvrste zanimanja / nënlojet e profesioneve.

IV. Kodi me 4 shifra:

angl. unit groups;

shq. KPK- grupi njësi i profesioneve– T1 njësitë e profesioneve

T2 – grupet njësi (profesionet);

Ds - skupine zanimanja / grupet bashkënjësi ose grupet bashkësi të profesioneve.

V. Ndërsa kodi me 6 shifra ose kartërshifrori + 01, 02 etj...

sipas KPK-së nënkuptohet profesioni, T2-shit numri i profesioneve, ndërsa sipas disertacionit në fjalë shpjegohet:

numri i profesioneve të veçanta:

a) me profilim të gjerë,

b) pa profilim të ngushtë dhe

c) me profilim të ngushtë.

Është interesant se në Vendimin e Qeverisë së Shqipërisë, dt. 11.06.2009, shifrimi shpjegohet kështu:

Kodi numerik i profesionit është një bashkësi me 6 shifra, të cilët tregojnë:

a) shifra e parë “grupin e profesionit,”

b) shifra e dytë, “nëngrupin e profesionit,”

c) shifra e tretë dhe e katërt së bashku “Profesionin” dhe

ç) shifra e pestë dhe e gjashtë së bashku “Punësimin”.

Siç po shihet në të gjitha burimet e sipërcekura terminologjia nuk është bash e njëjtë, po kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të njëzohet plotësisht në tekstin unik shqip, nëse çështja (ri)shtrohet para një komisioni ekspertësh mikst, i përbërë nga profesionistë të degëve përkatëse prej të gjitha trevave shqiptare, ku do të merrnin pjesë patjetër edhe gjuhëtarët e përgatitur.

2) Numri i grup-profesioneve, sipas guidave në shqyrtim

Sa i përket numrit të **grupit kryesor ose grupeve të mëdha** lidhur me **kodin shifror** gjendja qëndron konstant 10, ndërsa sa i përket numrit të grupeve a profilimeve të tjera të kodeve shifrore, sipas burimeve dalin ndryshime si më poshtë:

Tabela e numrit të kodeve sipas burimeve

Burimi	kodi1	kodi3	kodi4	kodi 6-shifror	
KPK	1	28	12	382	2.022
T1	1	28	116	390	3.600 (?)
T2	1	37	125	435	4.224
Ds	1	58	127	1021	21.000

Siç po shihet, veç rubrikës së parë të gjitha shifrat e tjera ndryshojnë, për nga numri. Ne punimin tonë të doktoratës, sipas kodit 6-shifror, patëm manipuluar, me afro 20 mijë emërtime të profiluara profesionale.

3) Pasqyra e emërtimit të grupeve të mëdha sipas burimeve në shqyrtim dhe nivelimi arsimor sipas ISCO-88

Duke tërhequr vëmendjen në tekstin përkatës, sipas burimeve të caktuara, po japim pasqyrën e kodit të grupeve të mëdha ose të grupeve kryesore dhe shkallën e kualifikimit ose të aftësive a shkathtësive të fituara sipas nivelit arsimor:

Kodi	Emërtimi i grupeve të mëdha	Niveli arsimor
------	-----------------------------	----------------

1. KPK:	Ligjvënësit, zyrtarët e lartë dhe menaxherët	
T1:	Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	
T2:	Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	
2. KPK:	Profesionistët	IV
T1:	Specialistë me arsim të lartë	
T2:	Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	
3. KPK:	Teknikët dhe profesionistët e ngjashëm	III
T1 e T2:	Teknikë dhe specialistë në zbatim	
4. KPK:	Nëpunësit	
T1:	Nëpunës të thjeshtë	II
T2:	Nëpunës	
5. KPK:	Punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes në dyqane e në treg	
T1:	Punëtorë të shërbimit të shitblerjes dhe dyqaneve	II
T2:	Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	
6. KPK:	Punëtorët e kualifikuar të bujqësisë dhe të peshkimit	
T1:	Punëtorë të bujqësisë dhe të peshkimit	II
T2:	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit	
7. KPK:	Zejtare dhe punëtorë të ngjashëm	
T1:	Zejtare dhe tregtarë	II
T2:	Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to	
8. KPK:	Operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinave	
T1:	Punëtorë të uzinave mekanike edhe montues	II
T2:	Punonjës të montimit dhe të përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	
9. KPK:	Profesionet elementare	
T1:	Punëtorë fillestarë	I

T2: Punëtorë të profesioneve elementare

0. KPK: Forcat e armatosura

T1 e T2: Forcat e armatosura.

Siç po shihet grupi i parë nën 1 (Ligjvënës...) dhe grupi i dhjetë nën 0 (Forcat e armatosura), nuk janë përfshirë në nivelin arsimor të ISCO-s bazuar në ISCED-76, ndërsa nga të dhënat rreth nivelit arsimor, moshës dhe kohëzgjatjes së arsimimit kuptohet që:

a) për nivelin I (profesionet elementare) po sipas këtij përcaktimi parashihen 5 vjet shkollë (prej 6-7 deri 11-12 vjet moshë),

b) për nivelin II për kodet (4,5,6,7 e 8) parashihet 5+3 vjet shkollë (5+3=8 vjet shkollë) ose 14-15 vjet moshë që quhet cikli i ulët, dhe + 3 vjet cikli i lartë i shkollës së mesme profesionale) që do të thotë 12 vjet shkollë, d.m.th. kryhet shkolla e mesme,

c) nivelin arsimor III (nën kodin 3 fillon në moshën 17-18 vjeçare + 4 vjet arsimim arrin moshën 20-21 vjeçare ose kryen 15-16 vjet shkollë, nivel ky që barazohet me vitin I të universitetit,

ç) niveli arsimor IV (nën kodin 2) fillon në moshën 17-18 vjeçare + 3 - 4 ose më shumë vjet, varësisht nga dega e specializimit, që nënkuptohet se kap moshën mbi 21-22 vjeçare.

Sigurisht sqarime më të hollësishme arrihen varësisht nga sistemi konkret shkollor shtetëror (shoqëror) e privat që zbatohet në shtetin përkatës. Por kjo punë sa u përket emërtimeve përkatëse në gjuhën shqipe, mund dhe duhet të harmonizohet patjetër në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetëror e ndërgjuhësor në hapësirën mbarëshqiptare jo vetëm formalisht por edhe përmbajtësisht.

(1) KONSTATIME TË VEÇANTA RRETH GJUHËS SË TRI GUIDAVE TË SOTME TË PROFESIONEVE

Në të vërtetë, ne, në vijim, siç e theksuam më sipër, pa mohuar anët gjithsesi pozitive të të tri burimeve në shqyrtim, pra, pa mohuar, së pari, tekstin si libër a guidë me grumbullim materiali në vëllim të konsiderueshëm, siç thuhet me plot *lëndë të parë*, kryesisht të (gjysmë)përpunuar dhe së dyti, metodën e punës si dhe mënyrën e klasifikimit të profesioneve si dhe të disa emërtimeve të grupeve bazë të përpunuara, sepse ato janë mbështetur në kritere të qëndrueshme universale, do të përpiqemi me i paraqitë vlerësimet a konstatimet tona vetëm rreth gjendjes shkrimore-gjuhësore e terminologjike të shqipes që i përshkojnë këto burime. Natyrisht, këtë rast, pa mohuar, pra, anët pozitive, do të vëmë në pah lajthitjet eventuale, të shkaktuara, qoftë nga pakujdesia, qoftë nga mungesa e përvojës së *ekspertëve* përkatës për t'u marrë me një fushë të tillë të panjohur e të parrahur mirë, qoftë nga plogështia e organizimit të organeve shtetërore në etapën e caktuar të ashtuquajtur të transicionit që ka kaluar ose po kalon shoqëria përkatëse shqiptare, e ku ta dimë.

Sidoqoftë, këto fjalë jo të mira që sapo na shpëtuan ose na shpërthyen, si me thënë, spontanisht, për punën e bërë në këto tri guida, janë teprime apo jo, le të vlerësohen, pasi të njihet lexuesi i nderuar dhe ekspertët e degëve përkatëse me disa nga konstatimet dhe vërejtjet tona konkrete, të cilat edhe mund t'i shikojnë me sy kritik, madje edhe t'i kundërshtojnë ose edhe t'i korrigjojnë e përplotësojnë ato.

Ç'është e vërteta, vlerësimin tonë rreth gjuhës së teksteve të burimeve në shqyrtim po i japim veç e veç, duke filluar nga burimi i Prishtinës (**KPK**) dhe pastaj tek ato të Tiranës (**T1** dhe **T2**), pasi këto dy të fundit janë të një vendburimi hartues dhe dalin disi në një kontinuitet sadopak të hetueshëm.

A. NGA KLASIFIKIMI I PROFESIONEVE NË KOSOVË

Në këtë burim, që ka titullin *Klasifikimi i profesioneve në Kosovë*, janë përfshirë mbi 2000 profesione dhe janë përzgjedhur (shprehur) 1000 përshkrime të profileve të profesioneve ose të punëve e të detyrave nga vendi përkatës i punës. Kështu teksti përgjithësisht (pra edhe me përshkrimet) sasiorisht, kundruar veç e veç, del më i gjerë se dy burimet e Tiranës dhe, siç do të shohim nuk duket se pati ndikim a ndërlydhje kontinuale me to, por që të gjitha (që të tri burimet) në parim janë hartuar ose kanë pasur orientimin drejt ISCO-88. Në të vërtetë, siç pohohet në hyrje-sqarim të këtij teksti, që nga viti 2002, paska lindur interesimi nga nevoja për një klasifikim të versionit të ri të klasifikimit të profesioneve, sepse klasifikimi i profesioneve në Kosovë, pas Çlirimit nga Serbia, që tani e kishte si bazë zbatimore *Standardin Ndërkombëtar të Klasifikimit të Profesioneve* ose **ISCO-88.com** që përdoret në Bashkimin Europian, nuk u përshtatej kërkesave e kushteve të Kosovës, madje edhe versionet që përdorshin në ish-Jugosllavi tashmë nuk ishin të zbatueshme(!). Kështu, që në vitin 2004 qenka formuar një grup punues i përbërë prej 10 ekspertësh vendës dhe plus dy këshilltarë ndërkombëtarë, grup ky, i cili pas plot 16 muajsh pune intensive (dhjetor 2004 deri në mars 2006) e paska përfunduar tekstin e ri, pikërisht këtë që e kemi tani në shqyrtim me titull **Klasifikimi i profesioneve në Kosovë**, i cili u nënshkrua nga palët kompetente shtetërore më 30 maj 2006 dhe hyri në fuqi “*si standard i obligueshëm në aktivitetet e palëve nënshkruese të MM*” më 15 qershor 2006. Hartuesit e këtij versionit, siç thuhet, patën si orientim konsultimi edhe versionin e klasifikimit të profesioneve përkatëse të Sllovenisë si dhe atë të Maqedonisë, ndërsa atë të Beogradit si dhe atë të Tiranës nuk i përmendin fare.

Sido që të jetë, në të vërtetë, ky tekst-guidë, nëse mund të shprehemi kështu, del si një bina-ndërtesë që me pa nga jashtë duket si me qenë objekt i përfunduar mirë, madje edhe nga brenda duket se i ka të ndara mirë hyrjet, korridoret, apartamentet etj., por shikuar edhe më nga përbrenda zhgënjën, rezulton si një punë jo e kryer si duhet, sepse del e pabanueshme gjuhësisht, ngase i mungon akomodimi me suvatimin e nevojshëm e të domosdoshëm gjuhësor. Themë kështu sepse, ç’është e drejta, siç u cek më sipër, në mjaft raste zgjidhjet që jepen aty, me sa pamë ne e do t’i shohim së bashku lexues i nderuar, dalin nën nivelin e zgjidhjeve që jepeshin ose ishin në përdorim e sipër në administratën shqipe në Kosovë në vitet e ’70-a, e më pas, kur qe bërë përkthimi (ose kalkëzimi) zyrtar i nomenklaturës së profesioneve nga

serbokroatishtja në shqipe, madje nuk del as në harmoni me disa emërtime të kësaj natyre që kishin traditë pozitive përdorimi si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë e më gjerë.

Sidoqoftë, siç paralajmëruam, për vlerësimin e këtij burimi, së pari a fillimisht do të vëmë në pah ndonjërin nga lëshimet e përgjithshme formale teknike e parimore dhe së dyti, do të japim konstatime e vërejtje konkrete që kanë të bëjnë me lajthitje nga fusha drejtshkrimo–gramatikore dhe logjike-gjuhësore, me të cilat përshkohet ky tekst.

1) Konstatime ose vërejtje të përgjithshme formale teknike e parimore

Edhe pse gëzon fakti se teksti i këtij burimi nuk del dhe aq me lëshime të mëdha e serioze formale teknike e parimore, siç i ndeshim, siç do t'i shohim, në 2 burimet e Tiranës (T1 e T2), megjithatë nuk është edhe krejt pa to. Konstatimet dhe vërejtjet tona lidhur me këtë po i përmbledhim në këto tri pika:

Së pari, si gabime shtypi me pasoja, po përmendim rastet: *judiktaturë* (juridikaturë), *gjyeti*. f. 72, (gjueti), *enolog* (etnolog), *suvates* (suvatues), *labninator* (laborator), *shtetëtore* (shtetërore), *marrëdhënje* (marrëdhënie), *biblotekist* (bibliotekist), *manykrist*, f. 396, (manikurues), *paleta*, f 364, (palestra), *kosmetologt* (kozmetikolog) etj. etj.

Së dyti, si lajthitje parimore po përmendim faktin se janë me qinda raste shembujsh në të cilët nuk ka përshtatje gjinie e eptimi, dhe kjo për arsye se:

1) Nuk është përfillur trajta përfaqësuese emërtimit të profesionit, po dalin të shënuar bashkë emrat mashkullorë e femërorë, andaj, për shkak të një ngatërrimi të tillë të panevojshëm, treguesit e togfjalëshit sqarues të emërtimit patjetër lënë mangët ose lënë pezull patjetër, njërin emërtim sipas gjinisë përkatëse, p.sh.

arsimtar/arsimtare i fizikës: asistent/asistente e fizikës (f. 384), gjeodet/gjeodete projektant (f. 31), elektroinxhinier/elektroinxhiniere serviser (f. 29), matematikan programere (f. 27) etj. etj.

Sigurisht për t'i kthyer mbarë gramatikusht gabimet e tilla lypset intervenim mbase në mija raste të të gjitha emërtimeve në fjalë.

2) Edhe te përshkrimi i detyrave nga vendi i punës, pothuajse, ndeshim me qinda e qinda raste të mospërshtatjes së rasës ose të eptimit të foljes me atë që kërkohet nga fjalia paraprirëse, p.sh.:

Detyrat përfshijnë:

a) *Përmbajtja...* b) *kontrollim...*(f. 148); a) operimi..., b) saldimi..., c) prerja..., ç) realizim..., d) mbikëqyrja...(f. 283) etj. etj.

Siç dihet, kur kemi parasysh togun: *Detyrat përfshijnë:* në të gjitha pikat, emri do të duhej të fillojë në kallëzoren e shquar: *përmbajtjen...* etj. ose folja e fillimit do të duhej fshirë ose të ndryshonte eptimin (diatezën).

Së treti, si defekt po përmendim faktin se, me sa pamë, mungon shifra bashkë me tekst-emërtimin profesioneve të grupit të vogël, me këtë përmbajtje (Shih f. 49):

324 Përdoruesit e mjekësisë tradicionale dhe shëruesit besnikë(!)

3241 Përdoruesit e mjeteve tradicionale

3242. Shëruesit besnikë(!).

Sqarim.- Teksti është marrë nga faqja 200, prej nga kuptohet se rastësisht ka ndodhur defekti. Sidoqoftë, lidhur me tekst-fragmentin e më sipërm, jemi të detyruar të sqarojmë si më poshtë:

a) Me *shëruesit besnikë*, sigurisht (nën)kuptohet të *shëruarit me besim*.

b) Pas dy shifrave të fundit sipas rregullit do të duhej të dilnin emërtimet përkatëse të profiluara gjashtëshifrore, të cilët mungonin edhe te sqarimi f. 200.

Sidoqoftë, edhe pse, siç u tha, teksti i burimit në fjalë, nuk vuan aq nga defekte të rënda sa i përket anës formale, pos gabimeve të shtypit e të tjera që prej tyre u përmendën vetëm disa, megjithatë, vëzhguar në anën tjetër, edhe më keq del teksti, ngase përshkohet nga një mal lajthitjesh e gabimesh gjuhësore, siç do të shohim në vijim, sa që në disa raste dalin aq lëshime neveritëse sa nuk mund të kalojnë pa pasoja për lexuesit e rëndomtë, madje edhe për vetë përdoruesit e shfrytëzuesit e tekstit në fjalë, e mos të flasim për opinionin e gjerë dhe nëpunësit e thjeshtë e të tjerë, pa

përvojë, të ndërmarrjeve e institucione të ndryshme shoqërore e private, të cilëve u dedikohet.

2. Konstatime dhe vërejtje konkrete gjuhësore

Në konstatime a vërejtje gjuhësore do të përfshijmë tërë tekstin jo vetëm listën e emërtimeve të profesioneve me pjesën e përshkrimit të grupeve të profilimeve të profesioneve. Pra, kemi parasysh edhe pjesën që e parashoqëron dhe atë që passhoqëron: *klasifikimin dhe përshkrimin e profesioneve*.

Së pari, që nga fillimi (te nenet e MM-së (Memorandum Mirëkuptimi) dhe në vijim tekstin e përshkojnë shumë shprehje të shqipes së përdëshiruar, si p.sh.:

Sistemi KPK është zhvilluar (n.v. hartuar!) që mund të themelojnë një fjalor (të hartojnë listë emërtesash të profesioneve); ... për gjatë tërë Kosovës.../ose/. për gjatë Bashkimit Evropian (për Kosovën, ose BE-në/ ose në kuadër të Kosovës ose në suazat e BE-së); palët ndajnë përgjegjësinë...; (marrin zotimin ose obligohen); kjo marrëveshje do të hyn (n.v. hyn ose do të hyjë) në fuqi; Menaxhmenti operativ i njësisë do të ofrohet...nga komiteti Drejtues (do të udhëhiqet (drejtohet a menaxhohet!) nga Komiteti drejtues); Marrëveshja do të ekzistojë (do të jetë në fuqi n.v.) deri sa një instrument ligjor i zëvendëson drejtimit brenda këtij MM (deri sa një instrument (nën)ligjor e shfuqizon këtë akt-marrëveshje! etj.

Së dyti, edhe pse konstatohet se kjo guidë është hartuar nga kadri përkatës (përfaqësues të UNMIKUT dhe të 5 institucioneve zyrtare shtetërore të Kosovës:

1. Ministria e Punës dhe e Qenies Sociale- Prishtinë,
2. Enti i Statistikave të Kosovës,
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë- Prishtinë,
4. Oda Ekonomike e Kosovës dhe
5. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës,

teksti në shqipe cilësohet si formulim origjinal bazë dhe si i tillë, siç thuhet aty, *do të përkthehet në anglisht e serbisht*. Në të vërtetë, mund të konstatohet pa drojë se tërë teksti në shqipe i këtij *Memorandum Mirëkuptimi për përdorimin e klasifikimin e profesioneve në Kosovë*, është punuar (kalkëzuar jo mirë) mbi bazë ose nën ndikimin e teksti përkatës në

gjuhën angleze, madje edhe të atij të serbishtes (në mënyrë implicite), pa e përjashtuar edhe ndonjë gjurmë emërtimi nga teksti i Tiranës (T1).

Sido që të ketë qenë, teksti i shqipes stilistikisht e përmbajtësisht ka pasur nevojë të qartësohej dhe gjithsesi gjuhësisht të korrigjohej, madje edhe të harmonizohej edhe më mirë me tekstin anglisht dhe atë serbisht dhe sidomos për raste të caktuara domosdo edhe me atë të Tiranës. Fundja, gjithsesi, tërë teksti në shqipe do të duhej të ishte më në nivelin e duhur se që është tani. Kjo ngritje nivelimi (me korrigjim e përplotësim) do të duhej të përfshinte që të shtatë titujt (kapitujt) që ka përmbajtja e tekstit në shqyrtim.

Së treti, në kontekst, siç u tha, në pikën e mëparshme për të dëshmuar se teksti shqip nuk del i harmonizuar si duhet ose nuk del i hartuar drejt në krahasim me tekstin e versioneve anglisht e serbisht (në të cilat gjuhë do të duhej përkthyer??!), po e ilustruam me një fjali që e shkëputëm nga pjesa e fundit e kryerreshtit të parë nga titulli *Sqarimi metodologjik*, me nëntitull *Përkufizimi dhe qëllimi i klasifikimit të profesioneve*:

Ja, teksti shqip që ndeshet aty:

KPK (Klasifikimi profesioneve në Kosovë, n.v.) përdoret në regjistrime administrative dhe institucionet tjera siç janë regjistrat ose baza e shënimeve dhe analiza statistikore si dhe në regjistrimin e popullsisë.

Teksti anglisht:

The KOC is used in administrative records under the responsibility of public administration and other institutions such as registers or databases and statistical surveys as well as in the census.

Teksti serbisht:

KPK je upotrebljena u administrativnoj evidenciji pod odgovornoshqu javne administracije i ostalih institucija kao shto su registracije ili baze podataka i statistička istraživanja kao i popisi..

Varianti shqip i përshtatur (përkthyer) prej nesh:

KPK-ja ka ligjësi zbatimi në administratën publike dhe në institucione të tjera, siç janë institucioni për hulumtim e evidentim, ai i analizës së të dhënave statistikore siç është edhe institucioni i regjistrimit të popullsisë.

Edhe pse mund të ketë edhe version tjetër teksti, por për ne është me rëndësi që të ketë lidhshmëri logjike, ngase në tekstin e kontestuar prej nesh nuk ishte i shënuar qartë institucioni i parë, e së këtejmi të dilte i arsyeshëm shumësi: *dhe institucionet e tjera*. Madje njëri nga ato institucione mund të quhej *ent, qendër, "databazë" ose bazë e të dhënave statistikore* etj. Së këtejmi, çështja se si mund të përcaktohet fakti se cili destinim e zë vendin e parë e të dytë në radhitje etj. mund të ndërliidhej me kuptimësinë e natyrës së kontekstit. Ne me qëllim e përsëritëm treguesin *institucion* në togfjalëshin e fundit siç është: *institucioni i regjistrimit të popullsisë* që nuk e kishte kështu origjinali, por që nënkuptohej, sipas atmosferës së analizës që po bëjmë ne aktualisht.

Me fjalë të tjera duam të themi se për të hartuar ose për të përkthyer një tekst ai duhet të vështrohet si tërësi dhe dora e fundit patjetër duhet dhënë, duke u bazuar në harmonizimin e tërë përmbajtjes së tekstit sipas destinimit ose natyrës së stilit funksional gjuhësor që i takon. Në këtë kontekst, për mendimin tonë, tekstit *Klasifikimi i profesioneve në Kosovë*, kështu siç është, fillim e mbarim, i mungon harmonizimi i tillë e sidomos kjo shihet tek emërtimet togfjalësha ose kur kemi të bëjmë me shtojca sqaruese shumëfjalëshe, ku ceken punët dhe detyrat përkatëse konkrete në vendet e punës që lidhen me profilimin e profesioneve përkatëse

Së katërti, në këtë burim ka raste të shkeljes së normës në ndërkëmbimin e tingujve, si p.sh.:

a) ndërkëmbim bashkëtingëlloresh:

k/g blektori (blegtori);

q/ç: poqar (poçar);

s/z: gas (gaz);

z/s konzervator (konservator), recenzent (recensues);

q/sh: shiqim (shikim);

gj/xh sharrëgjji /sharrëgjike (sharrëxhi/ sharrëxhije), qerregji/ qerregjike (qerrexhi qerrexhije!);

r/rr karoseri (karroceri), zjari (zjarri);

s/c ose c/s: balansues (balancues), akcioner (aksionar, aksionist);

gj/xh: agjustator agjustatore (axhustator/ axhustatore);

ç/c inçizues (incizues);

b) ndërkëmbim zanoresh:

e/ë amvise (amvisë), roje (rojë);

a/ë: arkatar (arkëtar);

e/a disejner (dizanjues ose dizajnues),;
e/o: regjiser (regjisor);
zero/a: kameraman (kameraman);
a/e: veterinar (veteriner).

Ndonjëri nga rastet e mësipërme mund të jetë edhe i diskutueshëm në raportin dialekt/qëndrueshmëri norme, por ne i shënuam si raste që patjetër duhen rishikuar dhe gjithsesi korrigjuar.

Së pesti, ndeshim edhe mjaft shpërputhje të tjera drejtshkrimore ndaj normës, si: paisje (pajisje), të brendëshme (të brendshme), pastaj trajtat e shumësit: sportista (sportistë), pastruesët (pastruesit) etj.

Së gjashti, në këtë burim, edhe më dukshëm, vihen re formime të paqëndrueshme me prapashtesat përkatëse si p.sh.:

a) Me –IST: mekanist (**mekanik**), daktilografist (**daktilograf**) gjenetist (**gjenetikan**), tapisierist e tapicierist (f. 414) (**tapicier**), grafist (**grafikan**), kosmetolog (**kozmetikolog**) ekologjist (**ekolog**), zoologjist (**zoolog**), farmakologjist (**farmakolog**) dokumentalist (**dokumentist**), fotografist (**fotograf**), agroekologjist (**agroekolog**), numerologist (**numerolog**), librarist (**librar**).

b) Me prapashtesë-mbaresën –A/TOR ka mjaft shembuj të diskutueshëm, por pasi disa raste do të cekem e diskutohen edhe në burimet pasuese, këtu po përmendim vetëm shembullin *preparator* ose *përgatitor* në vend **përgatitës**.

c) Me fundoren shpifëse –CIENT, pa kurrfarë mbështetjeje, për çudi(!), dalin disa shembuj si: fizicient (fizikan), gjeofizicient (gjeofizikan), statisticient (statistikan), matematicient (matematikan), muzicient (muzikant, muziktar).

Së shtati, si pikë më vete po e përmendim raportin ndërgjinisor, jo të natyrshëm, në vend të femërorëzueses –E, janë futur në përdorim, për çudi, pa nevojë fare, prapashtesa a formante të tjera të ndryshme, që në mjaft raste as njëra as tjetra trajtë ndërgjinisore nuk është e qëndrueshme normativisht ose nuk është e padiskutueshme, p.sh.:

- a) me –ISTE ekonometrik/ekonometriste, mekanik mekaniste, elektromekanik/ elektromekaniste, llogaritar/llogaritaristja, aktuar/aktuariste, revizor/revizoriste, fizioterapeut / fizioterapiste;
b) –C/IENT statisticient/statisticene, muzikant/muziciente, gjeofizicient / gjeofizikane

- c) me -KA (prapashtesë sllave): apreter/ apreterka (apretues/apretuese),
- ç) me -ATORE (prapashtesë italiane): disenjer/ disenjatore (dizenjues/ dizenjuese);
- d) me -ESHË (prapashtesë sinonimike shqipe, e panevojshme në raste të tilla sipas stilit zyrtar drejtor/drejtoreshë (*drejtores*), restaurator/restauratoreshë (*restauratores*), ministër/ministreshë (*ministres*);
- dh) me -INJA (prapashtesë sllave): kustos / kustosinja kustos/*kustose*);
- e) me prapashtesën -KE (kontaminim i prapashtesës sllave -KA + E shqipe): zanatçi/zanatçike (*zanatçije!*), bojaxhi/bojaxhike, (*bojaxhije*) bozaxhi/bozaxhike (*bozaxhije*), kazanxhi/kazanxhike (*kazanxhije*), kacaxhi/kacaxhike (*kacaxhije*, kujunxhi/ kujunxhike (*kujunxhije*), plisaxhi /plisaxhike (*plisaxhije*).

Siç dihet, për të gjitha rastet e pikave të mësipërme, nëse trajta e emrit në gjininë mashkullore del e drejtë me bashkëtingëllore fundore për femërorëzimin e tij (të njeriut sipas profesionit), mjafton vetëm prapashtesa femërorëzuese -E. Në të vërtetë, e metë jo e vogël praktike e këtij burimi, siç u cek më sipër, është se nuk është respektuar gjinia përfaqësuese e emërtimit, e cila zakonisht si e tillë konsiderohet ajo e gjininë mashkullore, ndërsa në raste fort të rralla si gjini përfaqësuese për profesionin e caktuar mund të qëndrojë edhe emri në gjininë femërore, por kjo çështje si dukuri si dhe rasti i femërorëzimit të emërtimeve ose emrave me -XHI meritojnë trajtim të veçantë më të hollësishëm. Për mos me u bë gabime të tilla më së miri do të ishte që emërtim i profesionit qoftë ai i gjinisë femërore, qoftë ai i gjinisë mashkullore, kur vendi i punës kushtëzon punonjës in sipas gjinisë, duhet të shënohen veçan në nomenklaturën e profesioneve. Në punimin tonë të doktoratës çështja e emërtimeve të profesioneve me gjini përfaqësuese femërore, është trajtuar në një krye të veçantë.

Së teti, ndonëse edhe te ndonjëri nga shembujt e mësipërm shihen mjaft raste të shpifura nën ndikimin e gjuhës serbe, këtu si pikë më vete do të paraqitim pak më në hollësi pikërisht këtë fenomen, d.m.th. trajtat e emërtimeve nën ndikimin e gjuhës serbe:

E para, po përsërisim trajtat e shembujve të më sipërm me prapashtesat që i quajtm sllave të gjinisë femërore si, p.sh. apreterka

(*apretere a apretuese*), kustosinja (*kustose*).e sidomos do të sqarojmë paksa rastet me –KE, siç ishin shembujt *zanatçike, bojaxhike, kazanxhike, kacaxhike, kujunxhike, plisaxhike*.

E thamë se shembujt e fundit meritojnë trajtim a sqarim më të hollësishëm, sepse prapashtesa serbe –KA del e kontaminuar me femërorëzuesen e shqipes –E. Kjo dukuri ka kapur vetëm disa raste të *gjuhës kosovare*(!) e jo të gjuhën shqipe në tërësi, prandaj këto lypset korrigjuar sa më parë, madje trajtat e tilla duhet larguar edhe nga ligjërimi i përditshëm dhe sidomos nga gjuha e shkruar. Në të vërtetë, për të dëshmuar faktin se është i reflektuar te trajtat e tilla vërtet ndikimi i serbishtes, sa për ilustrim, po i paraqitim këta tre shembuj. Krahaso:

1. serb. f. *komshijka*, m. *komshija* – shq. *fqinj fqinji fqinjë-t ose kojshi kojshiu kojshi-të(!)*; f. *fqinjë-a fqinjat ose kojshije kojshija kojshije-t*;
2. serb. f. *Sheshirxhijka* - m. *sheshirxhija* – shq. m. *sheshirxhi sheshirxhiu sheshirxhi-të (kapelëtar)*; f. *sheshirxhije –a sheshirxhije-t*;
3. serb. *duçanxhijka* nga m. *duçanxhija* – shq. m. *dyqanxhi dyqanxhiu dyqanxhi-të*; f. *dyqanxhije-a dyqanxhije-t*.

Lidhur me këtë bëj me dije lexuesin e nderuar se çështja e shquarsisë së emrave femërorë mbi këtë bazë që bëhet me –i/JE. del e zgjidhur në FGJSH 2006, ku femërorëzimin e gjinisë mashkullore, pra, me formantin –i/(j)e, e ndeshim si në shembujt e mësipërm. Sa për vërtetësim, ja 10 shembuj, nga FGjSh 2006:

dajrexhi (dajrexhije), dallaverexhi (dallaverexhije), fshesaxhi (fshesaxhije), qelepírxhi (qelepírxhije), jorganxhi (jorganxhije), qoftexhi (qoftexhije), qylaxhi (qylaxhije), qiraxhi (qiraxhije), shkresaxhi (shkresaxhije), dhe zanatçi (zanatçije),

prandaj trajtat e kontaminura me –KE duhet të korrigjohen patjetër. Fundi i fundit, shqipja, kur nuk ka emër paralel me –K fundore të gjinisë mashkullore, për gjininë femërore përdor prapashtesën –KË e jo –KE. Krahaso: tipi: grek/greke ose fshatarkë /fshatarka (serb.: seljanka), edhe pse qëndron nën hije të trajtës *fshatare*. Ndërsa shumësi me –nj i tipit dyqanxhiNJ-të në vend **dyqanxhi-të**, për ne del i diskutueshëm, sepse –NJ-ja në këto raste del formant i shpifur pa nevojë, ngase i mungon baza **n-j**, nga origjinali i gjuhës dhënëse, siç e kemi shpjeguar gjerësisht dhe mjaft bindshëm në një punim tjetër.

E dyta, janë disa trajta me –T/AR/E, sipas biçimit të serbishtes, siç është shembulli: fotogramatar / fotogramatare (nëse nuk është shënuar

gabim). Sipas rregullit trajta *fotogramatar fotogramatarka* të serbishtes, në shqipe duhet me dalë: m. *fotogrametër/ fotogrametri/f. fotogrametre!ifotogrametra ose fotogrametrist/ fotogrametriste!*, varësisht nga konstrukti dhe kuptimi që ka vetë fjala bazë në kontekst.

E treta, pastaj emërtimi serb. *veterinar* në shqipe del në trajtën: *veteriner* dhe e kundërta ndodh lidhur me emërtimin në serbishte të termit *akcioner*, ashtu siç është edhe në tekstin në shqyrtim, ndërsa norma e shqipes për këtë koncept ka trajtën **aksionar**, madje edhe trajta me -ER. regjiser që aty del si në serbishte, *regjiser* në shqipe del e normëzuar në trajtën **regjisor**, ashtu si edhe kondukter në shqipe **konduktor**.

E katërta, emërtimi i serbishtes *autolimar* në shqipe ka dalë, për çudi, *autolimues(?!)* Them i për çudi, ngase nuk është përkthyer mirë. Është fjala për llamarinë a teneqe që serbisht i thonë *lim* (*teneqe, llamarinë*) e nuk është fjala për. mjetin: **limë lima** (me limue), sepse për **limë** serbishtja e ka barasvlerësin. **turpija** (krahaso foljen: *turpijati-* shq. *limoj me limue a me lëmue!*). Pra kemi të bëjmë me profesionin: *autollamarinist* e jo me atë të *autolëmuesit(!)*, ngase nuk është profesion të lëmuarit e autos, ose të llamarinës me limë(!), por profesionisti është llamarinist (autollamarinist).

E pesta, tek emërtimi *operator i makinave për prodhimin e glazurës dhe brusës(!!!)* fjala e fundit *brusa* është barbarizëm i *cullakuar(!)* nga serbishtja. Fjala *brus* në shqipe ka barasvlerësin *grihë-a, rrasë mprehëse*. Pra, në shqipe emërtimi i drejtë do të ishte: *operues i makinave për prodhimin e smaltit (glazurës) dhe të grihës (qostrës, rrasës mprehëse, formash të ndryshme)*.

E gjashta, në vende përkatëse ndeshim edhe fjalë, të cilat janë shkruar sipas drejtshkrimit të serbishtes e jo sipas normës së shqipes, p.sh. gas (shq. gaz-i), gips (shq. gjips-i), ambalazha (shq. ambalazh-i), restoran (shq. restorant-i) etj. – madje gjatë një përshkrimi të punëve dhe të detyrave nga vendi i punës ndeshëm brenda togfjalëshit fjalën e serbishtes *crep !!!*, (f. 270) e cila siç dihet në shqipe ka barasvlerësin *tjegull* (krahaso: *crepana – tjegulltore*).

E shtata, edhe prapashtesa –qar (-çar) e specializuar në serbokroatishte për emërtimin e profesioneve sidomos nga ndërkombëtarizmat me –IK(ë) fundore si:

matematika matematiçar, fizika fiziçar, estetika estetiçar, mehanika mehaniçar, kozmetika kozmetiçar f. kozmetiçarka, statistik(a) statistiçar statistiçarka etj.

shihet se ka pasur ndikim të tërthortë te ne përftrimi a përqafimi i trajtave të paqëndrueshme dhe neveritëse të shqipes me *-cient, -cist*, siç janë shembujt e tipit: *mekanicist/ mekaniciste* ! (në vend: *mekanik mekanike*), ose *kosmetolog /kosmetologe!!!* (f. 59) për *kozmetikolog kozmetikologe, po ashtu staticient statisticente* në vend: *statistikan statistikane*, e kështu me radhë.

E teta, edhe te disa kalkëzime shihet ndikim i serbishtes si p.sh.:

a) *motrat medicinale* (medicinske sestre), *pajime, pajisje medicinale* (medicinski pribori, uredjaji) *biokimist medicinal* (medicinski biohemiçar), në vend *motër mjekësore a infermiere spitali*) etj.;

b) aty ndeshim (*mami lindore!!!* serb. *babica porodilja*, d.m.th. mami që ndihmon gratë në lindje. Për mendimin tonë më drejt: do të dilte emërtimi i tillë në shqip *lindatore* si ngjeshatore etj. tip ky që në shqipe ka model fjalëformues. Ne kemi prova për këtë. Krahaso kontekstin: serbisht *babica (po)rodilja* (roditi – me lindë), shqip: *mami lindatore* e ku ta dimë;

c) pastaj ndeshim fjalën *trokitje* (serb. trokiranje), kuptimi i së cilës ka të bëjë me lloje qëndizmash me trokëtime ose me qepje sipas stilit të veçantë, me tegela tërthorë- tërthorë;

ç) në këtë burim ndeshëm edhe emërtimin: *elektroinxhinier në repart* (f. 40), ku fjala *repart* gjithsesi si keqpërktim vjen si barasvlerës i emrit *pogon* të serbishtes, i cili në atë gjuhë ka dy kuptime, më pak atë të repartit (si në shqipe huazuar nga italishtja) e më tepër atë të *makinave me ngasje (pogonske mashine)*, prandaj rasti këtu sipas gjase është përkthyer gabim. Po shtoj edhe këtë fakt se te ne, ashtu si fjala *pogon* e keqpërkthyer për të gjitha konceptet me *repart*, është kapërthyer edhe fjalë-termi *stabiliment* për *postrojenje*, i cili në serbishte shpreh edhe koncepte të makinerive përkatëse, ndërsa në shqipe sipas normëzimit ka kuptimin vetëm si ngrehinë. Po ashtu edhe fjalë-termi *axhustator* te ne përdorej gabimisht si barasvlerës për tri-katër emërtime profesionale të serbishtes, prandaj tërheqim vëmendjen zyrtarëve të sotëm përgjegjës për arsimin se të gjitha ato emërtime profesionale që në shqipe (në tekstin e diplomave) që kanë në përbërjen e tyre fjalët (me origjinë italiane): *repart, stabiliment* dhe *axhustator*, duhet të verifikohen, ngase shumica, mjerisht janë (ishin) përkthime të gabuara dhe mjerisht ashtu janë përdorur si trajta kinse të drejta

të profesioneve në degët përkatëse të shkollave tona të mesme ose të shkollës së lartë teknike. Diplomat e tilla (teksti i titujve të të diplomuarve) duhet të korrigjohen ose të modifikohen sipas emërtimeve të pranuar dhe të shifruara si duhet sipas ISCO-88, përkatësisht sipas Listës së re kombëtare të profesioneve në versionin që do të pasojë në gjuhën shqipe.

Së nënti, janë disa raste (huazime turke) edhe pse janë shprehje të stilit bisedor, në këtë burim, për çudi, janë shënuar si profesione të mirëfillta të shqipes p.sh. *nallbane* (nallban) *kuajsh* për mbathtarë! (mbathtar) *kuajsh*(!), *berbere* (berber) në vend rrojtare (rrojtari), *pastaj qatipe qatipet* ! (qatip qatipët!) në vend *shkrues/it ose nëpunës/it për ndihmë klientëve* - emërtime këto që pa vështirësi mund të shpreheshin me barasvlerës të mirëfilltë të gjuhës shqipe..

Së dhjeti, po përmendim edhe disa shprehja të (sh)këputura nga përkthimi i detyrave të profileve të caktuara të profesioneve nga vendet përkatëse të punës, që nga teksti dalin fort të palogjikshme, pasi formulimi aty del ngatërrueshëm, dukuri kjo e shkaktuar nga përkthimi i fjalëpërfjalshëm i tekstit nga gjuha dhënëse, duke mos e bërë radhitjen kuptimore të fakteve (togfjalëshave) sipas natyrës së gjuhës sonë. Ja disa shembuj që shkëputëm nga teksti në shqyrtim, si:

Tharja e kafshëve..., regjia e kafshëve..., prerja e mishit të therur..., mbledhja e lëngjeve dhe korrja e tyre..., pemë me kokrra si dredhëza(!!!), manaferra..., kultivuesja e shpendrritësve..., kultivues i bletarëve..., shkelja e drithërave, makina për prodhimin e pemëve, perimeve, lajthive, arrave..., prerja e detyrave në prodhimin e produkteve... thithja elektrike me makinë, sekretar shoqëror, etj etj.

S'do mend se kafshët që theren nuk mund të *thahen a të regjen*; por mishi a lëkura e tyre, *pastaj mishi i prerë mund të copëtohet*; lëngjet *nuk mund të mblidhen as të korren*; *dredhëza nuk është pemë po barrnishte*; sigurisht, *nuk mund të kultivohen shpendrritësit as bletarët*(!), po shpendët ose bletët. Pastaj pemët, perimet (si fruta) nuk prodhohen, po ato si fruta vilen e përpunohen etj.

Së njëmbëdhjeti, ndeshëm edhe emërtimin *fryesxhamash/ frysexhamash* (f. 388) dhe lidhur me këtë japim këto dy vërejtje:

e para, togu është shënuar bashkë si të ishte kompozitë. Dihet se kompozitë sipas modelit formohet jo kështu fryesxhamash, por duke i ndërruar vendet

gjymtyrët përbërëse **xhamfrys**, sipas pjesores së shkurtë të gegnishtes, ose sipas pjesores së toskërishtes, norma e sotme: **xhamfryrës**;

e dyta, është shënuar gabim prejpjesori me dyzanorshin me –YE, fryes, sepse kjo folje nuk mbaron me diftong –YE, por vetëm me –Y. Krahaso: fryj, me fry, fryrë, frymë, frymoj, frymëzim etj.

Së dymbëdhjeti, janë disa emërtime jofunksionale për Kosovën, ngase aty në disa raste shënohen profesione ose detyrat që lidhen ekskluzivisht me detin, si p.sh.: *montuesit nënujore*, të cilët *raportojnë mbi kushtet e anijeve të përmbytura*; pastaj riparuesi *anëtari i ekuipazhit* të anijes, i cili kryen punë riparimi në “mole dhe muret e porteve”! pastaj kemi emërtimin *kultivues i gjallesave* ujore, peshkut, guacave, midhjeve (f. 265), punonjësi i caktuar *pastron fundin e detit*, kryen punë dhe detyra lidhur me *kultivimin ujqor, brenda ose në breg të detit* (f. 265)it, bën mbledhjen *e algave të detit të molusqeve*, etj. (f. 375), gjithashtu *vrojton hyrje-daljet në det ose mbikëqyr spirancat e anijeve* (f. 364) etj. etj

S’ do mend se, vërtet, nga këto profesione, ose nga këto punë e detyra, lidhur me detin duhet të lirohet teksti i Prishtinës.

Sidoqoftë, ne po i përfundojmë vrojtimet tona, edhe pse mund të thuhet se janë me qinda e më shumë raste (të tjera të kësaj natyre), që (gjuhësisht e logjikisht) kërkojnë intervenimin e korrekturës. Me fjalë të tjera, teksti kështu si është shikuar gjuhësisht, sipas normës letrare, më tepër është i dëmshëm se i dobishëm, ndërsa pas një redakturë të mirëfilltë, jo dosido, sigurisht më tepër do të jetë i dobishëm se i dëmshëm dhe vetëm, si i tillë mund të qëndrojë, si të thuash, *si lëndë e parë*, e dobishme, e cila mund të shfrytëzohet patjetër për hartimin e listës së përbashkët unike të emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe

Lajthitjet e këtij teksti janë të korrigjueshme pa vështirësi të mëdha, por, siç do të shohim në vijim nuk kanë mundur t’u shpëtojnë lajthitjeve të tilla formale teknike si dhe, fatkeqësisht, edhe atyre gjuhësore e logjike as hartuesit burimeve përkatëse të Tiranës, siç do të shohim në vijim.

B. NGA STANDARTI NDËRKOMBËTAR I NOMENKLATURËS SË PROFESIONEVE SIPAS ISCO- 88

Për versionin e Tiranës që e kemi në dorë me titull *Standarti ndërkombëtar i nomenklaturës së profesioneve sipas ISCO-88*, i cili si duket është punuar nga një grup punonjësish me urdhër qeverie, shikuar gjuhësisht mund të themi se është punuar dhe publikuar nën kushte e rrethana jo aq normale (ndoshta në fillim të shekullit tonë), ngase as të përkthyerët ose të përshtaturit e lëndës të afro 3500 emërtimeve të profesioneve sipas ISCO-88. në shqipe nuk del si punë e kryer me pedanteri, siç do t'i kishte hije një punë të rregullt zyrtare të një shoqërie me qeveri stabile. Themi se është kryer në kushte *jo fort normale* dhe *jo pedantërisht* në aspektin gjuhësor, ngase teksti, që kemi në dorë, jo vetëm nuk del në nivelin e dëshiruar, por ai ka dalë nën mesataren që ka pasur mundësi të bëhej, sepse përveç mangësive profesionale jo aq të mëdha, vende-vende materiali del i punuar jo me përkushtimin e kujdesin e duhur formal e gjuhësor.

Në të vërtetë, edhe pse kemi të bëjmë me botim zyrtar institucional-shtetëror, sipas bindjes sonë, mbase për ndonjë mangësi tejet profesionale, mund të qëndrojë ndonjë arsye, por kur është fjala për disa pakujdesi totale formale, kjo s'mund të ketë kurrfarë tolerance a *falje gabimi!*. Kjo vërejtje jona me fjalë kritike jo të lehta, do të dëshironim gjithsesi të mbetet ngacmuese e përhershme në ndërgjegjen e disa punonjësve nga Tirana, kryerës të punëve të kësaj natyre me interes shoqëror e kombëtar që ta shtojnë kujdesin. S'do mend se ne nga Tirana, si qendër e shqiptarisë, si qendër e kulturës gjuhësore shqiptare, gjithmonë kemi pritur dhe ende presim dhe kemi të drejtë të presim e të kërkojmë që çdo botim dhe sidomos ato të natyrës zyrtare normëzuese, gjuhësisht me qenë shembull që të shërbejë si rreze shëmbëllese me vlerë të një modeli të arrirë për të gjitha trevat shqiptare e shqipfolëse, gjithandej e gjithkëndej, an'embanë, gjë që për tekstin në fjalë, mjerisht, nuk mund të thuhet.

Ja disa nga konstatimet dhe vërejtjet tona, së pari, siç u paracek, po përmendim ndonjë anomali të përgjithshme formale teknike dhe së dyti do

të paraqitim disa nga lajthitjet gjuhësore drejtshkrimore e të tjera që e përshkojnë tekstin e këtij burimi.

1. Disa konstatime dhe vërejtje për defekte të përgjithshme formale (teknike)

1) Si anomali të parë po përmendim faktin se daktilogafimi i tekstit në shqyrtim ka si mangësi dy shkronjat karakteristike të alfabetit shqip: –**Ë-në** dhe **Ç-në**. Në të vërtetë, **Ç**-ja del vetëm në tri-katër raste, të cilat, për çudi, *shpifen* sipas shqiptimit italian, si me thënë, për të sfiduar normën e sotme standarde, si p.sh. *elektriçist* (6 raste, f. 14) në vend elektrikist, *inçizim* (norma incizim), *liçencë* në normë licencë, *çistrenë* për cisternë.

A ishte i drejtë një shfaqje e tillë vetëm për sfidim në këto raste dhe të mos përdorej ajo shkronjë e shqipes në tërë tekstin, kur mundësia e aplikimit të saj (shkronjës në fjalë) paska ekzistuar(!!!), le të vlerësohet. Për ne, një veprim i tillë është i patolerueshëm dhe siç thuhet në zhargonin gazetaresk: *no koment!*

2) Janë afro 50 raste emërtimesh të shifruara, por që u mungon teksti përkatës fare. (Shih: f. 66, 67,69,74,83,97 etj.) Nuk dihet pse është bërë shifrimi pa tekstin paralel barasvlerës?!

3) Në afro 30 shembuj emërtimi në vend që të fillojë me emër vepruesi (profesioni) fillon me emër veprimi ose me ndonjë fjalë-emër tjetër që nuk është emërtim i mirëfilltë profesioni, si p.sh.:

- vënie në kallëp (*kallëpist*),
- burrë (*punëtor*) i aftë për..., grua (*punëtore*) e aftë për...,
- mbështjellje e (*mbështjellës i ..*),
- organizatë e.. (*aktivist* ose *organizues i..*),
- derdhje e shkronjave... (*derdhës i ...*), 2 raste,
- gravurë shtypi (*gravues*) 4 raste,
- rafiniturë (*rafinues*), 1 rast. etj., madje vetëm f. 76 ndeshim 8 raste të tilla.

Gjithsesi, për të gjithë këta shembuj me lehtësi ka pasur mundësi me u shënue emërtimi i profesionit, ndoshta ashtu siç bëmë ne më sipër me emërtimet përkatëse, me shkronja të pjerrëta që i vumë brenda kllapash.

4) Janë disa raste, numerikisht i afrohen 20-shit, ku teksti del në grafinë origjinale të gjuhës dhënëse, pa u përkthyer ose pa u transkriptuar fare në alfabetin shqip. Edhe shembujt e tillë do të duhej kalkëzuar ose transkriptuar, p.sh.: attendant, tod crib f. 57, gatherer, glass 73, salvagewoman, f. 59, offal worker f. 77, williyer etj. etj.

Po sqarojmë lidhur me këtë, nëse konceptet e emërtimeve të tilla paraqiten të domosdoshme në shqipe dhe nuk mund të zëvendësohen dot me fjalë e shkrim shqip, atëherë së paku, shembujt e tillë të përfshirë domosdo në përmbajtje të tekstit, patjetër, do të duhej përshtatur me ortografinë e gjuhës sonë. Nëse jo, gjithsesi lypset sqaruar pse shënohet fjala me shkronjën që s'e kemi dhe të sqarohet për afërsisht edhe shqiptimi i emërtimeve të tilla.

5) Ka paqartësi lidhur me kodimin e emërtimeve të profesioneve gjashtëshifrore, ngase gjashtëshifrori nënkuptohet në hyrje-sqarim të tekstit në fjalë, por nuk konkretizohet askund, d.m.th., gjatë shtjellimit nuk jepet qartë asnjë emërtim si shembull gjashtëshifrori. Është fjala për grupëzimin e profileve përkatëse të profesioneve pas grupit të *bashkënjësisë* përkatëse katërshifrore, ndonëse aty manipulohet edhe me pesë shifra plus para emërtimeve të profilit të profesionit përkatës (!?), që për ne këto shifra janë jofunksionale në krahasim me dy burimet e tjera, ku shifrimi funksionalisht del i qartë.

6) Janë disa emërtime perifrastike me shkurtime fjalësh, gjë që një veprim i tillë në tekste të natyrës unike nuk është i lejueshëm, si p.sh. inxh. elektrik spec. për ndriçimin; gjeofizikan spec. në gjeomanjetizëm; gjeolog spec. në paleontologji; kimist spec...(25 raste); fizikant spec. (14 raste), f. 32 etj. Pastaj ndeshim edhe në shkurtime të tjera si sip. (f. 84), n.q.s. (f. 8).

Po sqarojmë se këto shkurtime nuk janë të pranuar zyrtarisht, ngase si të tilla nuk figurojnë jo vetëm në fjalorët shpjegues normëzues, por as në fusnotë ose as në faqen përkatëse të tekstit në fjalë.

7) Po i përmendim si anomali edhe disa teprime emërtimeve, ngase aty janë shënuar edhe disa profesione jofunksionale për trojet e gjuhës shqipe, siç janë b.f.:

zbutës i elefantëve, peshkatar a peshkatore ose gjahtar a gjahtare fokash, deri edhe emërtimi *rrjepës i balenave (!!!)*, ndërsa janë lënë jashtë disa emërtime të ngjashme që janë ose duhet a mund të jenë profesione potenciale për mjediset tona, si p.sh.

përkujdesës ose ushqyes i specieve të rralla, si b.f rojtar i çerdheve të pelikanëve në legunë ose i çerdheve të shqiponjave, kultivues i luleve ose i bimëve të rralla aromatike vendëse, si kultivimi i lulkuqeve (bozhureve!) të Kosovës) etj.

8) Për mendimin tonë në f. 7, menjëherë pas titullit *Probleme të veçanta që lidhen me klasifikimin e profesioneve* do të duhej me u shënue nëntitulli:

1. *Punonjës që kryejnë të njëjtin profesion.*

Pra, para tekstit përkatës, ngase vetëm kështu arsyetohet nëntitulli vijues që është shënuar me vend në faqen tjetër:

2. *Punonjës që kryejnë më shumë se një punë.*

Natyrisht edhe teksti pas këtij nëntitulli lypset sqaruar ose rregulluar më mirë, mbase edhe aty nevojitet një nëntitull i ri.

9) Janë disa raste emërtime të njëjta me të njëjtën shifër dhe me të njëjtin tekst, andaj rastet e tilla pasi nuk tregojnë grupe as koncepte të veçanta të emërtimeve sipas kodit të shifrimit, nuk do të duhej të përsëriteshin fare nga dy herë. Ja disa shembuj:

prestigjator f. 55, arbitër sporti, f. 55, shërues fetar f. 51, frut kultivues f. 39, fermer për grurë f. 61, drukthyes f. 78, mprehës intrumentash f. 70, biostatisticien f. 33, e ndonjë tjetër.

10) Disa emërtime, një numër mjaft i madh, janë shoqëruar me shenja të panevojshëm pikësimi. Ja disa shembuj, por të ngjashëm me ta ka jo pak:

- *drejtor i përgjithshëm ndërmarrje/ transporti etj.*, mbi 80 raste të ngjashme f. 28, 29, 30 etj.;

- *infermiere, e specializuar/ konsultore; oficer, infermier kryesor/ ushtri;*

- *mësues, post i dytë edukimi/ shkrim e këndim për të ri*, f. 44, si dhe f. 41, 42, 43, 44 etj. ku ndeshim mbi 100 raste të ngjashme me emrin mësues.

Pra, janë me qinda raste ku presja, del e panevojshme ashtu si edhe vizëla e pjerrët, e cila duhet të zëvendësohet me përcaktorin përkatës (*në, për e ndonjë tjetër*), si b.f.

- *drejtor i përgjithshëm i një ndërmarrjeje transporti;*

- *infermiere e specializuar për (ose në) konsultore;*

- *arsimtar mësimdhënës shkrim-leximi për të rij, e kështu me radhë.*

11) Teksti që e kemi në dorë për konsultim, nuk e ka të shënuar titullarin, i mungon emërtimi i botuesit dhe emrat e ekipit të përbërësve ose të hartuesve si dhe viti ose data e publikimit.

12) Si pikë më vete po i paraqitim disa raste të gabimeve të shtypit që si të tilla janë me pasoja, sepse trajta e shkruar jo vetëm krijon vështirësi deshifrimi, por ashtu, siç është cekur më herët, tek lexuesi në përgjithësi krijon ngatërresë ose bën edhe efekt shumë negativ, sidomos në trevat, ku lexuesit (shfrytëzuesit) kuptimisht nuk janë të ndërlidhur drejtpëdrejt me gjuhën e kontekstit. Së këtejmi, ata, për arsye super-respekti ndaj Qendrës së normëzimit (Tiranës), trajtën *e re*, edhe pse realisht të përgjymtuar ose të ndryshuar, e gëlltitin si fjalë *atraktive*, me koncept të posaçëm. Dhe kështu për hir super-respekti jo me vetëdije lëndohet kuptimi i vërtetë i fjalës së mirëfilltë. Krahaso:

fugon për *furgon*, ngase te ne për fjalën *furgon*, zakonisht përdoren sinonimet: *taksi-kamion*, *autotaksi*, *kombibus*, *veturëkamionetë*, etj., *patilog* f. 38 (për *patolog*,) *bolijer*, f. 68 (*bojler*), *mbledhësit e plerave* (2 herë), f. 25 (*grumbulluesit i mbeturinave*, plehrave), sipas *klasikit* f. 8 (sipas *klasifikimit*), *infirmiere obstetike* f. 41 (*infirmiere obstetrike*), prodhime *mkanike* f. 9 (prodhime *mekanike*), *jaje* (*lajme*), *bulbore* (*lulebore*), *travesa* (*traversa*), *trolobus* (*trolejbus*), *mbarështrimi* i *deleve*./ i *kuajve* (*mbarështimi* i ...), *veshje e papëshkrueshme* në... f. 62-63 (*veshje e papëshkrueshme* në... .), *agjetë* f. 16 (*agjentë*), *mesës* (*mësues*) (f. 16), linja *automatikë* f. 23 (*vija automatike*) etj. etj.

Po përfundojmë, duke theksuar se të gjitha këto anomali pa mëdyshje ia ulin vlerën punës së bërë institucionalisht jo pa mund dhe jo pa dobi e pa kosto (fundja, pra, jo edhe pa harxhime), për çka u bie hije jo e mirë jo vetëm autorëve e bashkëndihmëse të tyre, por edhe sekretarive e organizmave dhe organeve drejtuese ligjvënëse të institucioneve të shtetit që e përgatiten dhe publikuan atë. Ndërkaq edhe më keqsjellëse për autorët e tillë dhe autoritetet a organizmat zyrtarë të kohës janë disa nga anomalitë gjuhësore që e përshkojnë pothuajse tërë tekstin në shqyrtim, siç do të shohim në vijim.

2 Disa nga vërejtjet e veçanta gjuhësore

Numri i lëshimeve gjuhësore është mjaft i madh. Më poshtë po i paraqitim vetëm disa, edhe pse nuk janë këto më të dalluarat, por sidoqoftë edhe këto ia vlen të vihen në pah:

Së pari, po fillojmë me ndërrim a ndërkëmbim tingujsh që bien ndesh me standardin dhe nuk janë aq pak raste, si p.sh.:

a) me ndërrim bashkëtingëlloresh:

g/k: guzhinë (*kuzhinë*), egzekutiv (*ekzekutiv*);

t/d: osteopet (*osteoped*), standart f. 49 (*standard*);

s/c: aksizë (*akcizë*), agjensi (*agjenci*) delikuensë (*delikuencë*);

sh/k: arshivë (*arkivë*);

th/t: patolog (*patolog*);

t/c: restuaration (*restuaracion*);

xh/zh: xhetona (*zhetona*), xhvendosësh trungjesh (*zhvendosësh trungjesh*);

s/c: balcamues f. 59 (*balsamues*);

ç/c: liçencë/licencë), elektriçist (*elektriciçist*);

rr/r: motorr, f. 70, 10 raste (*motor*), gurrore (*gurore*), rregjës mishi (*regjës*), rradhites (*radhitës*), ndrues i shinave f. 14 (*ndërrues*), zjerrësh pijesh f. 93 (*zierës*);

r/rr: rjepës (*rrjepës*), korier (*korrier*), luleritës f. 62 (*lulerritës*), korespondues f. 10, 2 raste (*korrespondues*) rafshimi i gurëve f. 85, 87 (*rrafshimi*), zjari, 2 raste, f. 48 (*zjarri*);

s/z: fisioterapist (*fizioterapist*), disenjator (*dizenjues*);

nj/gn: manjetik (*magnetik*);

ll/l: illuzionist (*iluzionist*), ilustrues f. 20, 54, dy raste, (*ilustrues*), llustraxhinj f. 9 (*lustraxh, lustruesi*), klloun f. 55 (*kloun*).

b) me ndërrim zanoresh:

a/ë: karmill (*kërmill*);

i/ë: çamçakiz (*çamçakëz*);

y/i: qylym f.74 (*qilim*);

j/i: kjoskë (*kioskë*), inxhinjer (*inxhinier*), materjal (*material*), studjo (*studio*), pjano (*piano*), kamjona (*kamiona*).

i/j trainer / trajner,

Vërtet, jo për shumicën, por, pothuaj, për të gjitha rastet e mësipërme as që ia vlen të diskutohet qëndrueshmëria e tyre normëzuese.

Së dyti, ndeshim shpërputhje të tjera drejtshkrimore në krahasim me normën, si p. sh.:

a) Te fjalët: gjysëm (*gjysmë*), puntor (*punëtor*), paisje (*pajisje*), tregëti (*tregti*), manifaturë (*manifakturë*), muzeume, muzej (*muze*), përgatitës (*përgatitës*), pasuri e patundëshme (*pasuri e patundshme*), të qenurit (*të qenët*), të pa kualifikuar (*të pakualifikuar*), trainer f.. 55, 10 raste (*trajner ose trajnues*) etj.

b) Te togfjalëshat si: *instruktor makine* në vend **instruktor automjeti**, dyke *patur*, më drejt: **duke pasur**, *djegje e brendëshme*, norma: **djegje e brendshme**, *kultura potazhere (zarzavate)*, më shqip: **kultura perimore** etj.

Së treti, vihen re disa teprime më fort italianizma pa cilësi ndërkombëtarizmi si:

a) Me –o fundore, si: kontrato, banjo!, interpreto, tamburo dhe faturino, të cilën vetëm f. 58 e ndeshim në 9 raste (it. fattorino).

b) Me prapashtesën –ator(e) si: dizenjator f. 54, 19 raste, prestigjator, dekorator, saldator, operator, investigator, navigator, estimator, rivelator, masazhator, reanimator, montator, skiator etj.

Shumica e rasteve të tilla në shqipe priren ose emërtimet e tilla tashmë dalin të përfutuara si prejfoljorë me –UE/S fundore, si *dizenjues a dizajnues, dekorues* etj. ose me ndonjë prapashtesë tjetër, si p.sh. *skiator – skitar, masazhator, masazhist ose masazher*, madje *masazhues*, nga bëj *masazh – masazhoj, me masazhue*, e kështu me radhë.

c) Me –ier ose –jer fundore si guzhinjer (it. cucciniere) – kuzhinier (gjellëbërës), siç ndeshet ky emër, f. 58.

Së katërti, gjithashtu vihen re disa formime të *paqëndrueshme* ose të diskutueshme me shtesa a prapashtesa të shpifura pa nevojë, si p.sh.:

a) Me –IST: zoologjist (*zoolog*), daktilografist (*daktilograf*), paleontologjist (*paleonteolog*), gjeomorfologjist (*gjeomorfolog*), ekologjist e ekologist f. 38 (*ekolog*), agroekologjist f. 39 (*agroekolog*), embriologjist (*embriolog*), epidemiologjist, f. 40 (*epidemiolog*), filologjist f.15 (*filolog*), trichologist (*trikolog!*), numerologist (*numerolog*) e ndonjë tjetër. Pastaj dalin të diskutueshme edhe emërtimet: elektrolit mbase për *elektrolizues*,

librarist në vend *librar*, termist (*termikan*), termodinamist, (*termodinamikan*), hidrodinamist (*hidrodinamikan*), aerodinamist, f. 32 (*aerodinamikan*) optometrist (*optometrikan*!),

madje edhe elektronist në vend *elektronikan*, ngase nuk është fjala për *termo-*, *dinamo-*, *elektron-*, por për *termikë*, *dinamikë*, *elektronikë*.

b) Zgjojnë interes emërtimet me –etër dhe –atër fundore si p.sh. gjeometër që shënohet dy herë, por me ndryshim shifror të kodit (f. 37). Madje kur kemi parasysh trajtën e normëzuar të tipit; *psikiatër*, *fiziatër*, andaj nuk dimë pse mos me dalë në këtë mënyrë edhe emërtimi *podiatër*, që aty del *podiatrist* (f. 50) Po sqarojmë se njeriu sipas profesionit me emërtimin *podiatër*, pra, pa -IST fundore ka kuptimin. *shërues i dhimbjes së këmbëve* (*leqeve*) ose *i gjymtyrëve të poshtme* (gr. podos-këmbë).

c) Me fundoren –ANT të shpifur arbitrarisht, vetëm në f. 32 trajtën *fizikant* (për fizikan) e ndeshim në 20 raste, ku përfshihet edhe kompozita *astrofizikant*. Po ashtu në faqen tjetër 33 ndeshim 7 raste të emërtimit *gjeofizikant*. Ndërkaq, f.. 38, e ndeshim trajtën e mirëfilltë *biofizikan*, ashtu siç do të duhej të shënoheshin edhe rastet e tjera. Lidhur me këtë, po shprehemi qilterisht se na është paksa e çuditshme pse edhe trajtat e tjera shkrimore nuk janë përdorur në trajtë-prapashtesën –AN si shembulli i fundit *biofizikan*?! Mos vallë, dikush nga hartuesit e guidës nuk e ka pasur të qartë se emërtimi fizikan aspak nuk bën pjesë në grupin a tipin e emrave me –ANT fundore, si p.sh.: *diverzant*, *agjutant*, *aspirant* etj. !?

ç) Me fundoren –CIEN, të shpifur në normë, sipas FGjSh e kishim vetëm trajtën e diskutueshme *teoricien*, ndërsa këtu dalin edhe trajta të tjera, si, *statisticien*, f. 33 (16 raste), *informaticien* (3 raste), pastaj *logjicien* f. 33 *gjeomanjeticien* *biometricien* e *biostatisticien* f. 33 dhe të gjitha këto trajta janë përfutuar nën ndikimin e formantit të gjuhës frënge –cien, i cili në atë gjuhë shqiptohet –SJEn. Për mendimin tonë, rastet me fundore-formantin –CIEN duhet konsideruar si shpifje fort të pambështetura, kur në vend të këtij formanti, siç u cek më sipër te rasti fizikan /gjeofizikan, duhet parapëlqyer prapashtesën –AN, zgjidhje kjo që do të sforcohet edhe më shumë më poshtë gjatë analizës, po në këtë krye të punimit.

d) Po e përmendim si pikë më vete rastin *mekanik elektronist*, f. 71 (9 raste), ngase kur kemi për bazë temën e qartë fjalëformuese *elektronikë*, siç u cek edhe pak më sipër (që është ndërkombëtarizëm me –IKë fundore), s’ka arsye që edhe emërtimi i profesionit mos me dalë **elektronikan** (jo elektronist) sepse nuk është fjala tek tema **elektron**, por tek *elektronikë*.

Së pesti, për mendimin tonë del e diskutueshme edhe trajta druvar (f. 64) që na kujton trajtën drvar të serbishtes. Pse mos të hiqet nga nomenklatura e profesioneve të mirëfillta ky emërtim, kur për të njëjtin nocion kemi në praktikë numër të konsiderueshëm të trajtave më të pranueshme barsvlerëse, madje edhe më motivuese dhe më të qarta, si p.sh: drutar (drurëtar), drucoptues, druprerës, drushitës, sharrtar drusharues etj.

Gjithsesi për ne më e parapëlqyeshme do të ishte trajta **drutar** se ajo druvar.

Së gjashti, mendojmë se emërtimi *çorës gjahu* (f. 64) më mirë do të dilte në trajtën *çirrës* ose *gjahtrembës*, ngase i përgjigjen konceptit, por sipas FGJSH-së 2006 edhe më mirë se këta emra sinonimë e mbulon atë koncept fjalë-termi **ngarës**, që aty ka këtë sqarim - *ai që tremb* (ngan a nget) *gjahun dhe ua çon gjahtarëve në pritë*. (Aty f. 683). Me fjalë të tjera, pasi kemi të bëjmë me *profesionin* e trembësit të gjahut me çirrije, zhurmim, me ngarje, me ngacmim, atëherë s'dimë arsyen pse në burimin në fjalë nuk është shënuar emërtimi **ngarës gjahu** që asociacionon trajtën *ngamës* (*ngaas me nga, me ngacmue*).

Së shtati, i diskutojmë trajtat e dy emërtimeve: **bërës i majasë** dhe **bërës i rruazave**:

a) për ne, rasti i parë, më mirë kishte me dalë si kompozitë *majabërës* ose *tharmës* a *tharmëbërës*, se *bërës i majasë*;

b) kurse rasti i dytë, gjithsesi del më i kapshëm po të parapëlqehet emërtimi *rruzabërës*, sepse kështu do të ishte më lehtë për shqiptim dhe për mbamendje. Me sa dimë fjala *rruzë rruza* ka përhapje më të gjerë se *rruaza* ose *rrueza!*, ndërkaq, krahaso edhe emrin **rruzare**, trajtë kjo e normëzuar për *tespihe*, ku si po shihet fjala *rruzare* është normëzuar pa dyzanorshin **ua** ose **ue**.

Së teti, të diskutueshme për ne janë edhe këto katër emërtime:

1) *Fermer për lin* (është fjala për *li lini* ose *li liri*) më i kuptueshëm do të ishte emërtimi në trajtën: *fermer për kulturën e linit* ose *të lirit*.

2) Më shqip na duket emërtimi *kultivues perimesh* ose *perimtar* se sa kultivues zarzavatesh (turq zarzavat) ose kultivues i kulturave potazhere(!).

3) Gjithashtu e diskutueshme, për ne, është edhe trajta *varkëtar* (f. 85), e cila aty del si trajtë e vetme e parapëlqyer kundrejt sinonimeve: *lundërtar* ose *barkëtar*. Në të vërtetë, pikërisht në FGJSH 2006 rekomandohen dy

sinonimet e tjera *barkë* ose *lundër* dhe së këtejmi: **barkëtar, lundërtar** dhe jo trajta varkë varkëtar.

4) Si duket vetëm për mungesë përvoje a njohurie aty nuk përkthehet trajta *atrecues* (f. 69, 18 raste) në *vegëltar*. Trajta *vegëltar* (veglatar!) ka motivim të mjaftueshëm dhe si e tillë është trajtë e njohur, e cila ka gjetur përdorim mjaft të gjerë në gjuhën tonë teknike, sidomos te ne, prandaj në të ardhmen duhet t'i zërë vendin huazimit transfer *atrecues*(!!?).

Së nënti, zgjon interes dukuria e emërtimit të profesionit infermier që ndërlihet me trajtën përfaqësuese të profesionit, sipas objektit të shërbimit ose grupit të nivelit arsimues. Kështu, f. 50, në 15 raste, është shënuar emri i profesionit *infermier*, d.m.th. në gjininë përfaqësuese mashkullore, ndërsa vetëm një rast *motër infermiere specialiste*, sepse është fjala për grupin III. Ndërkaq këtë emërtim infermier f. 41 te grupi II në gjininë femërore e ndeshim në 15 raste, kurse vetëm një rast *oficer infermier kryesor / ushtri* - në gjininë mashkullore. Gjithsesi, sipas kësaj kuptojmë se nga natyra e vendit të punës, varet edhe gjinia përfaqësuese e profesionit si dhe shkalla e arsimimit, por ne mendojmë se megjithatë si gjini përfaqësuese zyrtare në parim për të gjitha shkallët e arsimimit duhet parapëlqyer emërtimi infermier, d.m.th. në gjininë mashkullore, siç është vepruar në T2.

Së dhjeti, po në faqe 50 është shënuar profesioni *terapist* në 5 raste, ndërsa *terapeut* nuk e ndeshim aty. Po kështu *terapist* e ndeshim edhe në FGJSH 2006. Në të vërtet ky rast do të preket paksa si i diskutueshëm më poshtë, ngase kemi të bëjmë me dy fjalë ndërkombëtare.

Së njëmbëdhjeti, në vend *dhëmbëtar* është përdorur zakonisht trajta baravlerëse *dentist*, mirëpo si emërtime të specializuara dalin edhe këto trajta të diskutueshme: *ortodontist, pedodontist, perodontist* dhe *prostodontist*, sepse janë përdorur sipas traditës së emërtimit grek e jo atij latin. Greqisht *dontos* d.m.th dhëmb, ndërsa latinisht *dens dentis* (dhëmb), prandaj sipas traditës për ne më të përshtatshme dalin trajtat *ortodontist* – mjek, drejtues, rregullues i dhëmbëve; *pedodontist* – mjek, dhëmbëtar i fëmijëve; *perodontist* – mjek i mishit të dhëmbëve dhe *prostodontist* - mjek i nofullave dhe ngjitës i dhëmbëve. Me fjalë të tjera trajtat me –*odontist* fundore duhet t'ua lënë vendin trajtave me gjymtyrën e dytë –*dentist*.

Së dymbëdhjeti, janë disa emërtime që formulimi sipas mendimit tonë duhet rishikuar, po japim disa shembuj:

a) Punëtor të prodhimit të sendeve të imta me precizion të lartë me dorë/ artizan, f. 21.

b) Prodhues të gurëve abrazivë dhe poçerisë f. 21.

c) Mbërthyes për metale strukturore f. 68.

Edhe shembujt e tjerë të kësaj natyre duhet të mbarështrohen, ngjashëm siç po veprojmë me shembujt e mësipërm:

a) *Punëtor artizan i punimit me dorë të sendeve të imta me precizion të lartë.*

b) *Prodhues poçerie dhe të gurëve abrazivë.*

c) *Mbërthyes i strukturave metalore.*

Së trembëdhjeti, edhe pse i tepruar ndaj standardit të sotëm në raste si *liberalizimi gjuhësor* i përdorur në tekstin në fjalë, megjithatë, për mendimin tonë ka nxjerrë në pah edhe një prirje që ia vlen të theksohet, por edhe patjetër duhet pasur në konsideratë. Është fjala për shumësin me mbaresën –A të emrave mashkullorë të gjerave konkrete, si p.sh.

përcjellësa për telefona 14 raste f. 72, instrumenta f. 72, 15 raste, pastaj barometra, elementa, zarfa, kartona, kamiona, traktora, fibra, motora, autobuza, përçuesa, gjysmëpërçuesa etj.

Lidhur me këtë prirje a dukuri jemi shprehur më gjerësisht në një punim tjetër, ku shumësi i emrave mashkullorë i emrave konkretë priret me marrë mbaresën-A, i atyre frymorë –Ë dhe të emrave të kuptimit (me disa toponime), me marrë mbaresën –E. Pra gjurmë të prirjeve të tilla i ndeshim edhe ndër shembujt e këtij burimi, gjë që sipas nesh është dukuri pozitive.

Së katërbëdhjeti, po e përmend edhe një rast që kërkon sqarim. Është fjala për profesionin e shënuar aty *Mbajtës bagazhesh (hamall)* f. 99. Thamë *kërkon sqarim* për arsye se treguesi në kllapa *hamall* na jep me kuptue se nocioni i profesionit në fjalë nuk është *mbajtja e bagazhit*, por është *bajtja* ose *bartja e bagazhit*. Këtu shkruesi i trajtës së tillë *mbajtës (me mbajtë)* e ka ngatërruar nocionin me trajtën *bajtës (me bajtë)*, ngase në gegërishte (sidomos te ne) dallohen fort qartë nënfushat semantike të foljeve *me mbajte* dhe *me bajtë*:

a) **me mbajtë** d.m.th me ruajtë (një gjë) në të njëjtin vend, ndërkaq

b) **me bajtë** (letrarishtja e sotme bart ose mbart) do me thënë me çue (një gjësend) nga një vend në një vend tjetër, si me thënë, me *hamallue*.

Krahaso edhe: *me bajtë fjalë* (d.m.th. me ngatërrue, më bë ngatërresë), ndërsa me *mbajtë fjalën* (d.m.th. me qenë besnik).

Pra emërtimi në fjalë ka kuptimin **bajtës ose mbartës i bagazhit**, jo mbajtës.

Së pesëmbëdhjeti, po i përmendim edhe tri raste të veçanta që zgjojnë interes në kompletimin e analizës:

a) krahas emrave në trajtën e shumësit me –NA përveç *lojna, barna* ndeshëm edhe këta dy shembuj: *yndyrna e likerna* (f. 96);

b) një emërtim del *vinikulturist*, me sa e kuptojmë është fjala për venëprodhuesit, për rrush vene (vere) ose kemi të bëjmë me *kultivuesit e kulturave të prodhimit të venës*, andaj së këtejmi, për mendimin tonë sa shënohet vinikultura ose winacultur, s'ka arsye të mosshënohet profesioni verëprodhues ose edhe më qartë *venëprodhues*;

c) së fundi, konteksti kërkon që kur përmendet fakti se *në forcat e armatosura përfshihen të gjitha forcat ajrore e detare (?) si dhe në shërbimi ushtarak dhe rekrutët* (bëjnë pjesë)... (f. 7) do të duhej përplotësuar edhe me të dhënën që mungon aty (te pikëpyetja që e shënuam në brenda tekstit), me mbiemrin “*e tokësore*”, që do të thotë se përfshihen edhe *forcat tokësore si dhe në shërbimin ushtarak përfshihen edhe rekrutët*.

Sidoqoftë, marrë në tërësi nga pikëpamja gjuhësore ka qenë nevojë e domosdoshme, që para se të shumëzohej a publikohej ky tekst, patjetër t'i shtrohej një intervenimi të domosdoshëm redaktorial gjuhësor, me ç'rast do të përmirësoheshin me dhjeta e qinda raste edhe të tjera që ne nuk i shënuam këtu, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që edhe ndonjë rast i tillë (qoftë për të keq qoftë për të mirë) po nga ky burim të përmendet në vijim të analizës.

C. NGA LISTA KOMBËTARE E PROFESIONEVE

Burimi **Lista kombëtare e profesioneve** për ne zgjoi interes të veçantë dhe të ligjshëm, për këto tri arsye:

së pari, për vetë titullin **listë kombëtare**, që fjala *kombëtare* asociacionon dhe josh, sidomos për ne, një listë unike zyrtare kombëtare të profesioneve në gjuhën tonë për çka kemi nevojë organike,

së dyti, sepse përfshin **numër më të madh emërtimesh të profesioneve** në krahasim me dy burimet e sipërcekura, veç e veç dhe

së treti, është **botim më i ri** (2009) dhe i miratuar nga organet më të larta të shtetit shqiptar, të Republikës së Shqipërisë.

Prandaj, duke pasur parasysh këto fakte të pamohueshme burimin në fjalë e përqafuam fillimisht me entuziazëm të natyrshëm ekzagjerues, duke ia veshur edhe cilësinë edhe përmbajtjen e duhur, të dëshiruar si për anën stilistike gjuhësore, ashtu edhe atë përmbajtësore shkencore, mirëpo gjatë konsultimit ose leximit që i bëmë gjuhës së tekstit ai entuziazëm na u kthye jo aq në dëshprim, sa në një përdëshirim. Kështu themi se, në të vërtetë, ky tekst na dha, copë në dorë realitetin. Dhe kështu duke na bërë të kalojmë nga bota e dëshirës në botën e realitetit, na dha të këndellur dhe na obligoi që të përpiqemi edhe më shumë për të arritur atë idealin e synuar: **te njëzimit të shumëçkaje kombëtare**, natyrisht edhe të njëzimit të terminologjisë tekniko-shkencore në përgjithësi dhe të emërtimeve të profesioneve që ende nuk e kemi, në veçanti. Këtë të vërtetë e mësojmë edhe nga ky dokument, sepse teksti në fjalë, përkundër vlerave që ka, nuk është hartuar sipas parametrave që do të mbulonin tërë hapësirën mbarëkombëtare të emërtimeve në fjalë. Me thënë të drejtën me sa pamë, nuk duhet qartë se hartuesit e kishin një synim të tillë, apo jo, madje është edhe një e pamirë tjetër që vërehet në atë guidë, nuk dimë arsyen, pse teksti, edhe për elementet më të thjeshta, para se të miratohej dhe publikohej, nuk është korrigjuar fare gjuhësisht?!

Fundi i fundi, shtrohet çështja, duke e pasur parasysh gjendjen e sotme politike shoqërore a ka qenë e mundur që ky tekst me u punue përnjëmend

si ka hije që të shërbejë si një model i qëndrueshëm unik me vlerë zbatimimi për të gjitha trevat shqiptare, apo jo?

Përgjigjja mund të jetë po edhe gjysmë po e gjysmë jo, por sidoqoftë, s'ka mëdyshje, gjithsesi teksti ka pasur mundësi të jetë shumë më cilësor. Ç'është e drejta edhe kështu siç është, edhe pse nuk i plotëson të gjitha kriteret sipas nevojave të hapësirës mbarëshqiptare, ka disa anë pozitive. Madje në krahasim me dy guidat e para (KPK dhe T1) ka epërsi të konsiderueshme edhe në aspektin gjuhësor, por kjo nuk mjafton. Dhe ky mosmjaftim, do të kuptohet më mirë pasi t'i bëjmë një vlerësim kritik këtij teksti, sipas rrugës që ndoqëm për dy guidat e mëparshme, së pari, do të japim vërejtjet tona rreth anomalive nga ana formale teknike, dhe së dyti, do të paraqitim vëzhgimet a vërejtjet tona konkrete për disa nga lajthitjet më të theksuara gjuhësore e logjike që mjerisht i ndeshim edhe në shqipen e tekstit në shqyrtim.

1) Konstatime dhe vërejtje të përgjithshme formale (teknike)

1. Për çudi edhe në këtë burim, sipas versionit që e kemi në dorë (është botim i vitit 2009 në internet) alfabetit të shqipes i mungon shkronja **ç**, e cila del e zëvendësuar me një e të vogël të përmbysur ose me një si z (3) cirilike. Edhe ky lëshim edhe pse për dikë mund të duket *cikërrim*, i jep hije jo të mirë jo vetëm tekstit të publikuar kështu, pas miratimit nga organet më të larta të shtetit shqiptar, por provokon edhe sekretarinë e organizmat përkatës të institucioneve të caktuara që e përgatitën dhe ia servuan opinionit të gjerë një tekst të tillë, pa një shkronjë të alfabetit origjinal të shqipes.

2. Në disa raste nuk del e respektuar hapësira e bardhë ose tërë rreshti si hapësirë e bardhë në funksion kryerreshti që duhet të dallojë sipas rregullit ndarjen e grupeve të *bashkënjësive të profesioneve*. Për këtë shih: f. 70, 71, 117 dhe 118.

3. Edhe në këtë burim, për çudi, ndeshim disa defekte teksti, si p.sh.:

a) në f. 46 ka ndodhur gabim shifrimi, kështu para tekstit përkatës në vend të shifrave: 3334 dhe 3334.01 duhet të ishin shënuar shifrat: 3335, 3335.01;

b) në f. 66 mungon shifra 6224.01 para tekstit përkatës: *gjahtar dhe vendosës kurthash*;

c) në faqen 67 shifra 6160.03 dhe 6160.04 duhet të kalojnë në radhë para shifrës 332 dhe po në atë faqe para teksteve përkatëse duhen vënë shifrat që mungojnë: 6320.01, 6320.02 dhe 6339.01, 6330.02.

ç) edhe në faqet 99, 100 dhe 105 duhet të bëhet harmonizimi në radhitje i shifrave ndaj teksteve gjegjëse.

4. Tekstit i mungon parathënia dhe pjesa e hyrjes rreth historikut të përgatitjes së një teksti të tillë zyrtar, si dhe në fund lista alfabetike e profesioneve, si zgjidhje që praktikohet në raste të tilla në të gjitha gjuhët përkatëse të zhvilluara.

5. Po i cekim edhe disa gabime shtypi, të cilat vërtet janë me pasoja. Po fillojmë me rastin e trashëguar nga guida T1 (të cekur) për trajtën **fugon**, e cila përsëritet tri herë: *Shofer fugoni*, *drejtues fugonësh dhe shoferë fugonësh* f. 107 në vend *drejtues* ose *shofer furgonash*, pastaj fletues në vend *filetues*; biofizikat për *biofizikan*; *elektolist* (f. 94) ndoshta për *elektrolizues*; gjeofizik më drejt *gjeofizikan*; higjenist në vend *higjienist*; përgjegjës për transport pasagjeresh, në vend *përgjegjës për mbartjen* (transportimin) *e udhëtarëve*; mësues ekonomiksi f. 22, ndoshta *mësues i ekonomisë*, prestigjator në vend *magji(s)tar ose prestigjator (magjibërës)* (f. 32) etj.

6. Edhe këtu në këtë burim, e themi me keqardhje, ndeshim disa raste që emërtimi parësorisht nuk shënohet siç duhet, me një emër vepruesi, po del qysh nuk duhet me një emër veprimi a me ndonjë tip tjetër emri që nuk është emër i mirëfilltë profesioni, si p.sh.:

a) *Moda e model për ekspozimin e veshjeve* f. 61.

Siç dihet profesion nuk është *moda ose modeli* (edhe pse aty janë shënuar 5 raste), madje profesion nuk është as *top-modeli* a *super-modeli*, sepse profesion i mirëfilltë është *modelisti*, përkatësisht *modisti*;

b) jo derdhja e shkronjave. 80, po *derdhës i shkronjave*, pastaj jo person që vë në lëvizje kukulla, po *aktor* që...;

c) s'do mend se as *famulli* (f. 48), as *ungjillor* (mbiemër) nuk janë profesione të mirëfillta, sigurisht për konceptet përkatëse të ushtruesit të profesionit më tepër u përgjigjen trajtat përkatësisht: *famullitar, ullgjilltar*;

ç) jo *lidhje libri me anë të mermerta* ose *lidhje libri me anë të praruara* (f. 88), po *lidhës libri* ose *libërlidhës me ...*;

d) jo *përpunim i çokollatës*.(f. 87), po *përpunues i çokollatës* dhe së fundi:

dh) jo Forcat e armatosura, po: *Profesionet e pjesëtarëve të forcave të armatosura* ose *Profesionet në forcat e armatosura* ose **profesionet në ushtri**.

Sigurisht, këto të meta formale teknike pa marrë parasysh se si kanë ndodhur, mbase ndonjëra nga pakujdesia (!), janë shenjë jo e mirë për hartuesit dhe botuesit e këtij burimi dhe gjithsesi këto lajthitje duhen përmirësuar, jo sa më parë, po **menjëherë, dhe gjithsesi edhe** nga faqet e internetit.

2) Vërejtje të përgjithshme e të veçanta gjuhësore

Disa nga vërejtjet e përgjithshme e të veçanta gjuhësore të tekstit në shqyrtim po i përmbledhim në disa pika.

E para, edhe në këtë burim, ndonëse jo aq shumë, mjerisht, ndeshim ndërrime tingujsh (bashkëtingëllore e zanore) në raport me standardin, p.sh.:

a) xh/zh staxhionues (*stazhionues*) (f. 87),

l/lI balave tekstesh (f. 98). duhet *ballave tekstesh* (është fjala për masë) ;

ç/q: verniçe f. 79 shumësi nga vernik, duhet *vernika* ose *vernique*,

ç/zh: çbllokues f. 14 në vend: *zhbllokues*,

r/rr: shndrim f. 38 në vend *shndërrim*,

c/s balcamosës (f. 41), – *balsamosës*, **balsamues**.

b) a/e marmalad, (f. 86) norma: marmelatë.

o/a montues i zdrukthove f. 88, në vend. *montues i zdrukthave*.

E dyta, rregullat e përdorimit të shkronjës së madhe nuk janë respektuar jo në pak vende, shih f. 2, 3, 4, 13, 28, 32, 43, 44 etj., madje vetëm f. 116 ndeshim 16 raste të tilla.

E treta, edhe disa shenja të pikësimit nuk janë përdorur me vend, si b.f., viza e pjerrët në mjaft raste si dhe pika në fund të disa emërtimeve togfjalësha, ngase shenjat e tilla të pikësimit si dhe ndonjëherë kllapa, presja etj. nuk u shkojnë në të mirë emërtimeve në fjalë, sepse konteksti i profesionit kërkon që emërtimi të jetë sa më i qartë, pa u vënë fare kllapat

ose ndonjë shenjë tjetër e pikësimit. Shembuj të tillë me anomali pikësimi nuk janë të paktë, sa për ilustrim po i cekim vetëm këta tre shembuj:

- Specialist i automatizimit/softuerë /database, f. 116;
- Teknik/inxhinieri nafte f. 34;
- Arkitekt, baze të dhënash, f. 27 etj.

S'do mend se emërtimi duhet shënuar pa këta shenja të pikësimit, natyrisht duke e njomë kuptimisht edhe me treguesit e caktuar ndërlidhës përkatës që këtu mungojnë.

E katërta,, nuk janë respektuar rregullat për drejtshkrimin e kompozitive, p.sh.

a) krye-dispeçer (f. 7) - *kryedispeçer*, ndihmës drejtor - *ndihmësdrejtor*, ndihmës veteriner (f. 58) -*ndihmësveteriner*, krye mami – *kryemami*, nën oficer f. 118, 9 raste, mbase edhe emërtimi *tregues-historish në radio-televizion*, më mirë do të dilte *historitregues* (it. *annalist*) në radiotelevizion (f. 31), operator, audio/vizuale (f. 51) mbase më mirë: *operues i veprimeve audiovizuale*;

b) ndoshta edhe emërtimet togfjalësha, si birues guri, shtrues tubash, çarës guri, lëmues guri, lëmues mermeri, lëmues graniti (f..70), mprehës metalesh (f .74), punues jorganash, mekanik automjetesh, mbledhës qirashë (f. 55),etj., më mirë do të ishte të përdroreshin si kompozita: *gurëbirues, gypashtrues, gurëçarës, gurëlëmues (gurëlatues), mermerlëmues, granitlëmues, metalmprehës, jorganpunues, automekanik, qirambledhës, e kështu me radhë.*

E pesta, harmonizimi i trajtave njëjës / shumëz nuk del si duhet në disa raste. Mjafton të përmendim raportin e nyjës së përparme të gjinore të shumësit me të me atë të njëjësit me **i** . (Shih për këtë f. 23, 26 raste; f. 24 , 13 raste etj.)

E gjashta, mungesa e parapëlqimit të sinonimit përkatës, duke i shënuar si dy profesione pa nevojë fare, pa e treguar konceptet e ndryshme sinonimike, nëse i mbulojnë ose priren t'i mbulojnë. Ja disa nga shembujt e tillë, si p.sh.:

kovaç/farkëtar, f. 73, arbitër sporti/ gjyqtar sporti (49), specialist për bojra / specialist për ngjyra f 15), inxhinier fonderie /inxhinier i shkrites (?) etj

E shtata, edhe mungesa e përcaktuesve: **në, për, i, ose ndër e ndaj** është mjaft e pranishme në këtë tekst. Aty ndeshim:

infirmier, nivel i mesëm pediatri (anestezi, infirmieri, ortopedi) f. 42 ose nëpunës poste / klasifikim (grupim); arkëtar restorant f. 61, nëpunës kontrolli inventari f. 52, botanist gjenetikë (histologji, mykologji, pedologji, taksonomi) f. 11; fiziolog, zoologji apo zoolog embriologji, (entomologji, fiziologji, iktologji, mamologji, ornitologji, parazitologji, taksonomi, (f. 12),

Pra në vend se të shënohej b.f.:

a) botanist gjenetike ose botanist për gjenetikë ose botanist në gjenetikë ose botanist i gjenetikës ose botanist gjenetikan;

b) zoolog embriologjie, ose zoolog në embriologji ose zoolog për embriologji ose zoolog i embriologjisë, e kështu me radhë aty ndeshim trajtën pa kuptim fare ose të parregullt gjuhësisht.

Madje është një e keqe jo e vogël se rastet e tilla janë në numër të konsiderueshëm. Për këtë mjafton të shikohet lënda në këto faqe të tekstit:

f. 10 (disa raste), f. 11 (11 raste), f. 13 (19 raste), f. 33 (30 raste), f. 4 (33 raste), f. 35 (7), f. 38 (9)), f. 51 (18 raste),

e kështu me radhë.

Pra, shprehim habi, pse nga autorët e tekstit është parapëlqyer ose është lejuar një trajtë e tillë e paqëndrueshme (shih shembuj kryerreshtit të parë), duke i anashkaluar 4 -5 zgjidhje a mundësi të paqortueshme, sipas shembujve tanë, që i ofruam si zgjidhje të rregullta nga praktika?!!!

Sidoqoftë, nëse vazhdohet kështu, kjo dukuri e pamirë mundet me u bë edhe më gangrenëse për natyrën e gjuhës shqipe, andaj duhet të korrigjohen sa më parë, kudo ku shfaqen rastet e tilla.

E teta, nuk ka arsye që ndonjë emër i gjësëndit konkret që sipas FGjSh i takon stilit bisedor të gjejë vend në këtë burim dhe të përdoret si emërtim i mirëfilltë në vend të emrit të gjësëndit që i përgjigjet emërtimit të mirëfilltë bashkëkohor të profesionit. Këtu na bie në sy emri *makinë* për **automjet** që po e theksojmë edhe këtu si rast më vete.

Një praktikë të tillë e ndeshim f. 112 (8 raste), f. 108 (6 raste) dhe f. 107 (5 raste), pra të gjithë shembujt e tillë që sillen rreth numrit 30, emri *makinë* duhet me u zëvendësue me emrin *automjet* ose me ndonjë fjale tjetër adekuate, sepse kemi të bëjmë me lloje automjetesh që karakterizohen si mjete lëvizëse me motor dhe së paku zyrtarisht nuk duhet me u ngatërrue pa nevojë me emërtimin *makinë*, si pjesë e makinerisë, sepse zakonisht mjete

përkatës i quajtur *makinë* qëndron i vendosur në një vend të caktuar dhe aty shfrytëzohet, pa u lëvizur nga vendi, e jo si automjetet me motor që lëvizin në hapësirë.

E nënta, si çështje të diskutueshme dalin jo aq fjalët ndërkombëtare ose të huaja në tërësi si fjalë-terma të pranuar, sa dalin të diskutueshme formantet fundore ose prapashtesat përkatëse të tyre. Ja disa shembuj:

a) Prapashtesa –ATOR: (it. –atore) tipi: operator, masazhator, administrator etj. fundore-prapashtesë kjo, e cila konkurrohet nga trajta të tjera, qoftë me origjinë të huaj –ER a –IER , -IST ose vendëse - TAR e sidomos –S, (me variantet: -UE/S, -YE/S. ËS dhe –S,) si b.f. skiator – skitar, përkatësisht: masazhator - masazher, masazhist por edhe ajo shqipe masazhues (bëj masazh masazhoj) dhe kjo e fundit me –UE/S duhet përkrahur për me pasë më tepër të ardhme.

Kemi edhe rastin e huazuar *precipator* që në shqipe përveç *precipitues* del edhe i kalkëzuar *fundrues*, që për ne, trajta e fundit duhet parapëlqyer, sepse në perspektivë sigurisht do të ketë sforcim përdorimi dhe shtrirje më të gjerë në organizatat tona punuese.

b) Me prapashtesën -IST: dalin disa emra të diskutueshëm si *analist* i huazuar nga italishtja *analista*, po në italishte del edhe trejta *annalista* (me dy **nn** që ka të bëjë me konceptin e aneve. Kështu me trajtën *annalista* (me dy –nn) quhet personi që ka të bëjë me shkrime analesh, përkatësisht është *studiuës analesh*, ose *analeshkrues* a *analestudiuës*, kurse *analista* quhet personi që merren me analizë (analizim) ose me analitikë. Prandaj te ne, pasi tema *anal-ist* motivon fjalën *anal-i* ka raste që ngatërrohen këta dy terma, duke u përdorur trajta **analist** për të dy a tri konceptet: edhe për *analeshkrues*, edhe për *analizues* a *analitikan*.

Sidoqoftë, sipas asaj që sapo e shprehëm, detyrohemi të shpjegojmë paksa, se për konceptin e profesionit që lidhet me **analizë** (me analizim) me analizë shkencore zakonisht, emërtimi në shqipe s'ka pengesa mos me dalë *analizues*, i cili mund ta zëvendësojë trajtën *analist*, trajtë kjo që në shqipe ka përdorim të gjerë, edhe pse nuk ka temë të qartë motivuese, ndërkaq për konceptin që ndërlidhet me ndërkombëtarizëm **analitikë**, njeriu sipas profesionit, normalisht mundet me dalë emërtimi **analitikan**.

Në të vërtetë, këto trajta mbeten raste konkurruese ndaj huazimit *analist*, por, po përsërisim. Ie të dihet se dy rastet *analizues* dhe *analitikan* në shqipe janë më të kuptueshme ngase, siç u cek, kanë në vete temën e qartë përkatëse motivuese fjalëformuese që i paraprin shembullit përkatës.

Krahaso: *analizë* (së këtejmi analizoj me analizue) – **analizues**), përkatësisht, *analitikë* + *prapashtesa e specializuar* -AN, kushtëzon që emërtimi i profesionit me dalë në trajtën: **analitikan**.

c) Për ne aty del një rast tejet i diskutueshëm që lidhet me ndërkombëtarizmen **statistikë**, që emërtimi i profesionit mbi këtë koncept del *statisticien*, f. 10 (në më shumë se 15 raste). Për mendimin tonë, pasi edhe ky koncept ndërlidhet me **statistikë**, pra mbi bazë të ndërkombëtarizëm me -IK(ë) fundore, siç e kemi cekur disa herë më përpara, është krejt e zakonshme që emërtimi i profesionit me marrë prapashtesën -AN, pra **statistikan**, sikurse ka marrë në këtë burim shembulli **informatikan** nga **informatikë**. Trajtën **statistikan** e ndeshim edhe në fjalorin e fjalëve ndërkombëtare të M. Ndreçës (1986).

ç) Edhe trajtat me -ER ose -IER fundore shpesh konkurrohen nga trajtat e motivueshme shqipe. Krahaso programer – programues, ku trajta e dytë del e sforcuar pikërisht nga folja programoj, me programue, model ky që është edhe prodhues edhe veprues në shqipen e sotme.

E dhjeta, në këtë tekst ndeshim disa raste të diskutueshme sa i përket alfabetimit të gjuhës shqipe, prej tyre po veçojmë: së pari, rastin *reumatolog* (në vend **reumatolog** dhe së dyti *website* në vend **uebsite**.

Lidhur me këtë dukuri bashkëkohore tërheqim vëmendjen tek fakti se te burimi në fjalë sidomos do të duhej të respektohej patjetër alfabeti i shqipes. Madje edhe në punime shkencore trajtat e fjalëve me alfabet të huaj lypset sqaruar a transkriptuar me alfabetin e shqipes, përndryshe trajtat e tilla dhe të tjera të kësaj natyre që ndeshim në përdorim do të quhen shkelje të normës në fuqi.

Sidoqoftë, edhe këto raste me Rh, W, duhen përshtatur me alfabetin e shqipes. ashtu siç është vepruar e po veprohet për shembuj të tjerë të ngjashëm edhe në këtë burim, si b.f. *harduer*, *softuer* etj. Është tjetër çështje nëse natyra e punës kërkon që duhet shënuar në kllapa origjinali ose transkriptimi, varësisht nga konteksti.

E njëmbëdhjeta, në këtë tekst ndeshim këto trajta si këngëtar–bas a s’është më mirë të jetë kështu bas-këngëtar, solokëngëtar, mezo-soprano (këngëtare) e kështu me radhë?

E dymbëdhjeta, disa emërtime mendojmë se duhen rishikuar, qoftë me korrigjim ose duke i shoqëruar me ndonjë fjalë sqaruese ose me mbarështrimin e gjymtyrëve të togfjalëshit, si p.sh.

a) Raste të mbarështruara me fjalë sqaruese plotësuese:

- *inspektor i mbrojtjes së zjarrit* më drejt **inspektor për mbrojtjen nga zjarri** (f. 33);
- *kontrollor avullues në përpunim teknik* – **kontrollues i avullit gjatë përpunimit teknik** (ndoshta termik!),
- *ngritës (shënues) metalesh strukturore*, mbase më drejt: **ngritës (përgatitës) a shënues strukturash metalike** (f. 73), ngase theksi kuptimor bie te struktura!,
- *bërës mjetesh peshku* – më mirë **bërës mjetesh peshkimi ose për peshkim** (f. 75),
- *trazues betoni* mbase më drejt **përzierës betoni** (f. 68).
- *prerës binarësh* – **prerës (përgatitës) trungjesh për binarë** (f. 65);
- *operator audio-vizuale* – **operues i veprimeve audiovizuale** (f. 51) etj.

b) raste me mbarështrimin e gjymtyrëve a të togfjalëshave:

- *përgjegjës prodhimi mbikëqyrës*, më drejt ndoshta vetëm: *mbikëqyrës prodhimi* (f. 36);
- *drejtues në ferma me kualifikim miks* (bujqësore blegtorale), më drejt: **drejtues i kualifikuar në ferma mikste bujqësore-blegtorale** (f. 65)
- *Nëpunës regjistrues të dhënash / konvertues* (nga karta në shirit dhe anasjellatas), më drejt: **nëpunës regjistrues e konvertues i të dhënave** ose vetëm **regjistrues e konvertues i të dhënave**, ngase vetë grupi sipas shifrave tregon se kemi të bëjmë me grupin **nëpunës-it** (f. 54).
- *fermer për lin, më qartë: fermer për kulturë lini* (ose liri) (f. 62), siç është sqaruar edhe te burimi T1;
- *punonjës të pyjeve, të peshkimit gjahtarë dhe vendosës kurthash për treg*, formulimi i tillë mund të kthehet mbarë kështu: **Vendosës kurthash në pyje ose në det për të siguruar mish ose peshk për treg** (f. 65), ngase, siç dihet, sipas kontekstit, tregtohet mishi jo kurthat (!);
- *veshës me flet metali për anije* (f. 72), mbase më mbarë: **veshës i anijes me fletë metali** etj.

E trembëdhjeta, si pikë të veçantë po e trajtojmë rastin nga ky burim, ku kemi të bëjmë me dy emërtime barbarizma të kulluet nga gjuha italiane *fatorino* (it. *fattorino*) dhe *picajol* (it. *pizzicagnolo*).

Emri i parë fatorino ka të bëjë me konceptin e shoqëruesit (zyrtar) të një autobusi ose një treni udhëtarësh që ka afri ose zëvendësim me termin *konduktor* që përdoret edhe te ne, dhe termi i dytë ka të bëjë me konceptin e pices (lloj piteje) ose të profesionit të picetarit ose picagatuesit, picashitësit ose të *picatores*, emërtim në gjininë femërore, *ajo që bën pica*

Prandaj që të dy këta terma (fatorino dhe picajol) pasi nuk janë ndërkombëtarizma dhe pasi dalin të zbërthyeshëm me trajta të tjera sinonimike të njohura të shqipes, nuk prish punë nëse hiqen krejtësisht si të panevojshëm nga nomenklatura zyrtare e profesioneve në gjuhës shqipe. Nëse kemi qenë të detyruar me e huazue dikur fjalën fatorino ose faturino (siç del në T1 dhe siç po dëgjohet ende në qarqe të caktuara në Shqipëri) sot ajo, sipas gjase, nuk na duhet më, e aq më keq në trajtën e deformuar(!). Madje nëse jemi të detyruar ta huazojmë sot emrin pice (lloj piteje a byreku) assesi nuk kemi nevojë me e huazue edhe emërtimin e profesionit picejol (picajol), madje dhe këtë në trajtën e deformuar, kur për koncept të tillë na ofrohen zgjidhje nga modelet fort të kapshme fjalëformuese të shqipes.

Pra për **fatorino** kemi barasvlerësin *shoqërues autobusi (treni)* ose *konduktor*, ndërsa për **picajol** mund ta fusim në përdorim trajtën m. **pitetar** ose **picetar** ose edhe më anë të kompozitave picagatues, e piceshitës etj, por edhe më mirë në gjininë femërore *picagatuese* ose **picatore**, sikurse *fliatore*, *bukatore*, *gjellatore* etj.

E katëmbëdhjeta, siç e thamë më sipër (f. 33) nuk është mirë të thuhet në stilin administrativ *drejtues* a *shofer makine* në vend **drejtues** ose **shofer automjeti**, po këtu po i rikthehemi çështjes jo për ta përforcuar atë që është thënë më parë, por për të tërhequr vëmendjen se në burimin në shqyrtim (f. 80) është bërë një gabim mjaft i rëndë, sepse tek emërtimi *drejtues të makinave të ngjeshjes* në kllapa është shënuar sqarimi *rrylat*. Pra vërejtja jonë nuk qëndron vetëm për rastin që në vend të emrit *makinë* do të duhej përdorur fjalën *automjet*, edhe pse aty është përdorur numri shumë në vend të numrit njëjës, por edhe për faktin se aty në kllapa është shënuar sqarimi *rryl* në vend **rul**.

Pra emërtimi i profesionit duhej të ishte shënuar kështu:

8332.06 drejtues i automjetit të ngjeshjes (rulit),

sepse **rulat** janë automjete që karakterizohen me cilindra metalikë të lëvizshëm që përdoren për ngjeshjen e dheut, të gurëve në trase, në rrugë, (nën)themele ndërtesash etj.,. ndërsa me fjalën *rryl rrylat* kuptohet krejt diçka tjetër, madje kemi të bëjmë edhe me nuancë kuptimore pejorative (me

kuptim njeri trashaman) që gjithsesi s'ka të bëjë fare me cilindra metalikë që *shërbejnë për ngjeshje trualli apo rruge.*

Po shtojmë edhe këtë që, po aty, në këtë burim, dalin edhe dy emërtime të tjera të ngjashme që kërkojnë sqarim: *shofer trajler* d.m.th. **shofer i automjetit me rimorkio**, dhe tjetri *drejtues zetori* (it. zaterra), që do të thotë **drejtues i një anijeje shpëtimi.**

E pesëmbëdhjeta, tek emërtimi *staxhionues i drurit* në shqipe më mirë na duket qëndron emërtimi *stazhionues druri* ose **stinues druri**, d.m.th. *tharës stinor (stivues stinor) i drurit*, ngase për t'u përpunuar mirë druri ai duhet tharë dhe për këtë duhet përshtatur stinës përkatëse.

E gjashtëmbëdhjeta, në këtë tekst e ndeshim një profesion që del i emërtuar: *teknik / inxhinieri civil (vadtije).*

Siç po shihet edhe këtu shenjat e pikësimit (viza e pjerrët dhe kllapat) janë përdorur pa nevojë dhe nuk dimë pse nuk është shquar trajta civil(e), pastaj pse është përdorur barbarizma serbe *vadtije!* kur dihet mirëfilli se në shqipe kemi fjalën adekuate *ujitje (ujitjeje ose për ujitje)*, dhe së këtëjmi emërtimi do të duhej shënuar kështu:

teknik i inxhinierisë civile për ujitje.

E shtatëmbëdhjeta, në kuadër të grup-bashkënjësisë së emërtimit **elektromontues** në këtë burim dalin të shënuar nja tri emërtime perifrastike me fjalën e parë kompozitë: *elektroaut*, përkatësisht aty ndeshim emërtimet:

- 1) elektroaut për anije,
- 2) elektroaut për automobila dhe
- 3) elektroaut për avionë

që për ne janë trajta tejet të diskutueshme. Dihet se është fjala për profesionin e elektromontuesit, i cili si specialist monton mjetet ose rrjetin elektrik, siç ceket aty: në anije, në automobila ose në aviona, që këto emërtime zakonisht mund të shënoheshim në trajtën: *elektromontues + emërtimi i mjetit përkatës.*

Te ne në vend *elektroaut*, d.m.th. montues i rrjetit elektrik në automjete, zakonisht është manipuluar dhe manipuilohet me emërtimin *autoelektricit* dhe sipas kësaj mënyre (modeli) normalisht mund të dalin edhe emërtimet si:

autoelektricit edhe anijelektricit, avioelektricit,

e kështu me radhë, por sipas analizës që bëmë nuk do të ishin të huaja në shqipe edhe emërtimet në versionin: **autoelektrikan, anijelektrikan ose avioelektrikan** (sipas gjedhes: *automekanik, anijemekanik, aviomekanik*), kur kemi parasysh temën e qartë fjalëformuese *elektrikë elektrika*. Sa për kërshtëri, po i njoftoj lexuesit se në *Listën e profesioneve në gjuhën serbokroate*, të cekur prej nesh, janë regjistruar mbi 200 emërtime me **elektro-** si gjymtyrë e parë e kompozitës së profesionit zakonisht togfjalësh (perifrastik), ndërsa me **auto-** si gjymtyrë e parë, po aty janë regjistruar mbi 60 profesione, ndërsa vetëm me *autoelektriçar* (autoelektricit ose autoelektrikan) janë regjistruar vetëm 8 raste. Ashtu ndodh edhe në gjuhë të tjera. Prandaj për ne ndërtimi *elektroauto (!!!)*, duke mos dalë emërtimi pa ndonjë prapashtesë specifikuuese na duket si ndërtim i nxituar, *jo fort i natyrshëm për gjuhën shqipe*, prandaj edhe e quajtmë tejet të diskutueshëm, sepse edhe sipas FGJSH 2006, f. 60 në tre zëra, në stilin libror **auto-**shënohet si pjesë e parë e fjalëve të përbëra që sipas natyrës së punimit tonë *auto-* i përgjigjet (sipas anglishtes amerikane) si shkurtesë ndaj konceptit të fjalës automobil, ndërsa si pjesë e dytë e kompozitës *-auto(!)*, jo vetëm nuk del në fjalorët tanë *normativë*, por nuk dimë se mund të haset gjëkund, jo vetëm në praktikën tonë gjuhësore emërformuese, por as në gjuhë të huaja!

Gjithsesi me rastin e rihartimit ose të korrigjimit të listës së profesioneve, madje edhe gjatë përdorimit të përditshëm duhet të kihet parasysh vërejtjet tona edhe për këtë pikë.

E tetëmbëdhjeta, gjithashtu në kuadër të grup-bashkënjësisë *fizioterapist*, f. 20, ku bëjnë pjesë edhe profesionet: *masazhist e pedolog*, janë shënuar edhe këto tri profesione të profiluara:

- 1) elektroterapeut,
- 2) ergoterapeut dhe
- 3) fizioterapeut,

të cilët kërkojnë sqarim, sepse edhe sipas FGJSH 2006 është parapëlqyer vetëm fjalë-termi **terapist** (jo terapeut), që së këtejmi kuptohet se për konceptet përkatëse mjaftojnë trajtat: *elektroterapist, ergoterapist* ose *fizioterapist*. Megjithatë, natyrisht duke pasur parasysh edhe faktin se si del e zgjidhur kjo çështje edhe në gjuhë të huaja të zhvilluara, edhe ky rast kërkon sqarim, ngase edhe *terapist* edhe *terapeut* janë fjalë ndërkombëtare.

E nëntëmbëdhjeta, në këtë tekst ndeshim edhe këto dy emërtime: *aromatizues* (f. 86) dhe *klimatizues* (f. 14), pastaj klimatolog f. 32, 39 që

nuk janë aq të kritikueshme, por duke pasur parasysh pikërisht temën e qartë fjalëformuese motivuese: **aromë** (jo aromat-) dhe **klimë**, (jo klimat-) dhe foljezimin e tyre *aromëzoj* dhe *klimëzoj*, prandaj ne propozojmë që infiksi –AT- në gjuhën tonë të hiqet, ngase del fare i panevojshëm dhe si i tillë mund të elidohet pa pasoja, kështu emërtimet e tilla fare natyrshëm duhet të jenë **aromëzues**, përkatësisht **klimëzues** ose **klimolog**, të cilat sigurisht kanë më shumë aromë e klimë shqipe se ato me –AT- aromatizues e klimatizues, ku infiksi –at- del si mish i egër brenda fjalës së shqipes.

Ndonëse tekstit në shqyrtim mund të bëhen edhe vërejtje të tjera ne po e mbyllim me kaq, por pa hequr dorë nga kërkesa që lënda e kësaj guide të shërbejë si bazë dhe si e tillë duhet të përforcohet me të korrigjuar e më të përplotësuar me lëndë edhe më të përzgjedhur dhe më cilësore për nga përfaqësimi sipas grupeve të profesioneve,

Sipërfundim

Edhe pse të tria teksteve në shqyrtim, mund t'u bëhen edhe vërejtje të tjera të veçanta që nuk janë të parëndësishme, ne po përfundojmë me konstatimin se tek të tria këto burime ka elemente pozitive që nuk mund të mohohen, por shikuar gjuhësisht, jo vetëm teksti i doracakut **Standarti kombëtar i nomenklaturës së profesioneve sipas ISCO -88**, është i pazbatueshëm, por, siç doli nga analizat e mësipërme, shikuar po nga ky këndvështrim, jo plotësisht të zbatueshme, më shumë e më pak, dalin edhe guidat e miratuara nga organet më të larta shtetërorë si në Kosovë **Klasifikimi i profesioneve në Kosovë** (2006), ashtu edhe në Tiranë, **Lista kombëtare e profesioneve** (2009), prandaj, së këtejmi del e nevojshme që ato domosdo duhet të korrigjohen e të përmirësohen edhe sa i përket standardit gjuhësor. Kjo është arsyeja që ne e pamë të nevojshme që në vijim të qëmtojmë paksa rreth emrave përkatës të vepruesit në **Fjalorin e gjuhës shqipe** 2006, me theks në ndajshitesat speciale të emërtimit të profesioneve të përfshira aty, sepse ky është burimi më i ri normativ përshkrues i gjuhës sonë i dalë nga mendja e Akademisë shqiptare dhe sigurisht do të na ndihmojë që të arrijmë përfundime sa më cilësore lidhur me përplotësimin dhe konsolidimin e emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe.

(2) KONSTATIME RRETH EMËRTIMIT TË PROFESIONEVE NË FGJSH 2006

- me theks konkurrenca e prapashtesave emërformuese

Meqenëse materiali nga fjalorët e tjerë normativë lidhur me emrat e vepruesit, ku bëjnë pjesë edhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit, si me thënë, është eksploruar dhe shfrytëzuar në punimet tona të mëparshme që në vitet e '80 të shekullit të kaluar e më vonë, e pamë të arsyeshme që po për këtë lëndë ta konsultonim edhe në FGJSH 2006, i cili është burimi më i ri normativ i gjuhës sonë.

Në të vërtetë, edhe pse thuhet se ky burim i takon *tipit të fjalorit të vogël*, vëllimisht në krahasim me lëndën e trajtuar në fjalorët e mëparshëm përshkruar normëzues e të tjerë, faktikisht nuk duket se është edhe aq i vogël e modest nga përmbajtja, madje, në krahasim ndaj fjalorëve të mëparshëm, ka disa përparësi, jo vetëm sa i përket bashkëkohësisë, por edhe për lëndën që e përfshin aty, ngase, siç theksohet në parathënie të tij, ky fjalor *“si fjalë themelore (në krye e në çerdhe) ka mbi 43.000 njësi*, madje *si fjalë që përdoruesi i fjalorit i ndërton ose mund t'i ndërtojë vetë, sipas shkurtesave që jepen aty si b.f. për mbiemrat, ndajfoljet e sidomos për emrat e foljet (trajtat sipas gjinisë, numrit, vetës, diatezës etj.) aty dalkan “mbi 4.500 njësi” dhe “përveç shumë thënieve dhe njësive frazeologjike, fjalori përmban gjithsej mbi 48.000 fjalë* (Aty f. 3), prandaj e thamë se nuk është aq modest e i vogël, por i ka dhe edhe disa cilësi të tjera. Po cilat janë karakteristikat e veçanta, sa u përket emërtimeve të profesioneve (emrave të vepruesit) që është temë e trajtimit tonë, do të përpiqemi t'i mësojmë dhe t'i paraqitim më poshtë, duke përdorur të njëjtën metodë pune që e zbatuam për tri burimet e sipërcekura:

së pari, do të nxjerrim në pah disa konstatime të përgjithshme rreth ndonjë lëshimi eventual formal teknik që ne quajtën si gabime shtypi dhe

së dyti, do të bëjmë fjalë rreth disa konstatimeve më të theksuara jo si lajthitje, por si konkurrenca të brendshme sinonimike gjuhësore lidhur me emërtimet e profesioneve në shqyrtim, me theks në emërformimin me prapashitesat speciale që ndërlidhen doemos me emërtimet e profesioneve.

Ky është edhe synimi i kësaj analize, që nga konkurrenca e trajtave të caktuara të identifikojmë përparësitë a epërsitë e formanteve përkatëse dhe kështu të arrijmë në rezultate që do të ndihmonin konsolidimin e mëtejshëm të emërtimeve në shqyrtim.

1. Konstatime rreth lëshimeve formale teknike (si gabime shtypi)

Meqë, fatbardhësisht, nuk mund të bëhet fjalë për lëshime të dukshme formale teknike, ne u përqendruam në disa, t'i quajmë, *gabime shtypi*, të cilat na ranë në sy gjatë lexim-konsultimit të sipërfaqshëm të kësaj vepre.

Së pari, vërejtëm se në f. 784, teksti me sqarim i fjalës **përdorues** ka dalë i shpifur para fjalës **përdoruj**, i cili (ky tekst) duhet të fshihet, sepse është përsëritur si zë i veçantë pas saj (foljes *përdoruj*), ku edhe e ka vendin.

Së dyti, në f. 1113 në zërin (çerdhen) e foljes **tukeq**, në vend të emrit të veprimit tukeqje ka dalë prejpsori në trajtën **tulkeqje**. Pra, këtu, **l**-ja e shpifur duhet të hiqet, të korrigjohet.

Së treti, f. 491, te zëri **kreditor** është ngatërruar në të njëjtin zë fjala **kredo-ja**, e cila duhet me dalë në kryerreshtin e radhës si një zë i veçantë.

Së katërti, në togun "**tashmë të njohur!**", f. 7, duhet përmirësuar fjala e fundit **njohur**, d.m.th. pa **h** e parë të shpifur.

Së pesti, kemi vërejtje në tekstin sqarues (f. 19-20): *Me referim jepen vetëm trajtat supletive ose fjalët e prejardhura nga tema plotësuese e trajtave përfaqësuese të fjalëve kryesore*, p.sh.

pashë *kr. th.* e **shoh**.

qe,-të sh. i **ka.-, -u**.

Pra, këtu kemi vërejtje tek të dy shembujt e parë, ngase nuk janë shënuar me shkrimin e pjerrët (italik) **e** dhe **i** sikurse pjesa pararendëse e tyre, sepse kuptimisht janë të pandara me pararendëset përkatëse. Kështu p.sh. **kr. thj.** **e....** do me thënë: *e kryera e thejshë e foljes (në trajtën përfaqësuese)* **shoh** (*me pa*), Po ashtu shkurtesat **sh. i.** ka kuptimin: *shumësi i emrit (në trajtën*

përfaqësuese, njëjës) ka, -u. (shumës *qetë*). Korrigjimi duhet bërë edhe te zërat përkatës, f. 868 e f. 761.

Së gjashti, te femërorëzimi i emrit **liberal –i** (f. 552) **liberale** mbaresa e shquarsisë, njëjës ka dalë – **ia**, në vend –**JA**. Dihet se emri i tillë i gjinisë femërore ka këtë zhvillim shquarsie: nj: **liberale liberalja**, sh. **liberale liberalet**.

Mbase në rast rishikimi më të hollësishëm mundet me dalë edhe ndonjë cikërrim tjetër lajthitës, por ne po e mbyllim me kaq.

2. Kontatime rreth pranisë së emrave të vepruesit me cilësi profesioni dhe prirja e prapashtesave speciale në luftën e konkurrencës

Nga konsultimi që u bëmë emrave të vepruesit, ku bëjnë pjesë edhe emrat e njerëzve sipas profesionit, sasiorisht arritëm në konstatime, pothuajse të njëjta, që i kemi cekur në punimin tonë të mëparshëm, megjithatë e shohim të nevojshme të përsërisin ose të përforcojmë ndonjërin nga ato konstatime:

Së pari, do theksuar se janë të gjalla po ato prirje sa i përket prodhueshmërisë së formimeve të emrave të vepruesit, ku bëjnë pjesë edhe emërtimet e profesioneve. Gjithsesi nga prodhueshmëria prijnë emrat me prapashtesat e specializuara vendëse, për nënfushat e caktuara semantike: – S, –TAR, –AR dhe –AN

Kështu, formimet me prapashtesën –S kalojnë dukshëm 300-shin, ato me –TAR i afrohen 200-shit, shembujt me –AR përgjysmë janë më pak, dhe ato me –AN edhe më pak, megjithatë, siç e kemi cekur edhe më përpara, secila (prapashtesë) prej tyre mund të quhet formant i specifikuar ose i specializuar për nënfusha të caktuara të qarta semantike.

Ç’është e vërteta, duke u bazuar në funksionin që kryen, siç po shihet, për të parën herë, këtu, si risi, në kuadër të prapashtesave të specializuara – S, –TAR dhe –AR del edhe formanti –AN. E merendiam formantin –AN si prapashtesë, pothuajse, të specializuar vendëse, sepse, siç do të shohim, në asnjë rast tek fjalë-temat me –IK(ë) fundore, nuk del ngjashëm ose identike me formantet sinonimike të ndonjë gjuhë tjetër, edhe sa i përket formës shkrimore edhe sa i përket shqiptimit, siç do të sqarojmë më poshtë.

Së dyti, nga formantet e huazuara si më prodhimtare dalin formimet me fundoret ose formantet: -IST, -(A)TOR,/-OR, -ER /-IER, -ANT. Ndër këto për nga sasia prijnë formimet me -IST, pastaj vijnë të tjerat.

Së treti, ndër prapashtesa të tjera jo aq prodhuese ndeshim formimet me fundore-prapashtesat e shpifura -C/IEN/-C/ENT, -C/IST, të cilat siç do të shohim në disa raste dalin jo vetëm të diskutueshme, por edhe shumë të paqëndrueshme e të dëmshme në krahasim me barasvlerësit përkatës sinonimikë konkurrentë specialë që imponohen si të përvetësuar ose me origjinë nga burimi vendës i shqipes.

Së katërti, siç u cek më sipër, përveç faktit që kemi të bëjmë me fjalor të tipit normativ, megjithatë ndeshim edhe çështje të diskutueshme, përkatësisht në raste ballafaqohemi edhe me çështje të pazgjidhura fare ose të zgjidhura jomirë, të cilat na imponohen, qoftë nga trashëgimia, ose dalin si përfitime të kohës. Andaj edhe pse lënda nga ky burim konsiderohet si bazë e standardit, ashtu siç është e vërtetë, megjithatë, siç do të shohim, ka vend edhe për çështje të imponueshme, të cilat kërkojnë zgjidhje të reja edhe më të qëndrueshme, në aspektin semantik, sipas prirjes së specifikimit a specializimit ndërkohë të formanteve të caktuara sipas nënfushave semantike, nevojë kjo që shtrohet si dukuri normale, kur kemi parasysh vetë zhvillimin e shoqërisë e të gjuhës sot dhe prirjet e zhvillimit të tillë që kanë të ardhme, sidomos kur kemi të bëjmë me bashkëkohësinë a ecjen drejt modernizimit të gjuhës e të standardit të hqipes.

Për mendimin tonë nuk është krejt e panatyrshme pse lënda e këtij burimi (FGJSH 2006) nuk përputhet në mjaft raste me zgjidhjet që janë dhënë, jo vetëm në dy guidat e botuara para ose gjatë vitit 2006, por nuk përputhen plotësisht as me zgjidhjet nga guida e fundit *Lista kombëtare e profesioneve* e vitit 2009, prandaj konstatimet, vërejtjet dhe sugjerimet tona që do të pasojnë në disa pika, lidhur me përparësitë ose epërsitë që duhet të ketë formimi i emrave përkatës në cilësi profesioni me formantet përkatëse, mendojmë se janë me interes të ndiqen dhe të vlerësohen, qoftë nga lexuesit e pasionuar, qoftë nga ekspertët e profilimeve përkatëse të profesioneve.

Këto vërejtje a sugjerime janë rezultat i studimit tonë për disa vite lidhur me këtë temë, por edhe në saje të materialit që ndeshim në tri burimet e mësipërme, andaj prirjet a përparësitë e tilla që janë të pranishme në ato burime si dhe në këtë burim normativ (FGJSH 2006), pa përjashtuar edhe vëzhgimet e mëparshme e të sotme tona dhe të tjerëve, jo vetëm për guidat në shqyrtim, por edhe për fusha të tjera, ku ceket konkurrenca lojale e

formanteve të caktuara, sa janë të drejta ato konstatime e sa jo, duhet të vlerësohen, por gjithsesi mendojmë që hartuesit e ardhshëm të listave të profesioneve, patjetër duhet t'i kenë parasysh.

Ne, luftën konkurren të ndajshesave të caktuara ndërsinonimike e shohim të gjallë edhe në fushën e emërtimeve të profesioneve dhe për këtë, siç do të shohim tash fill, do të paraqitim shembuj karakteristikë, të cilët i volëm kryesisht nga FGjSh 2006, ku në shumë raste edhe aty shënohet ose rekomandohet trajta *dominante*, e cila mund të përputhet ose edhe jo, me atë që do të dalë nga analiza jonë.

1) Përparësitë e prejppjesorëve me prapashtesën –S ndaj huazimeve me fundore a formante të huaja

Para se të kalojmë në paraqitjen e shembujve konkretë, ku prapashtesa –S e emrave mbi bazë foljore (prejppjesore) ka përparësi ndaj formanteve të ndryshme të huaja, po sqarojmë paksa se prapashtesa –S përdoret edhe te disa emërtime profesionesh mbi bazë të temës emërore, tipi, *mullis, kalorës, gjykatës, dhuratës* etj. por gjithsesi ky tip nuk është as prodhimtar as veprues sa janë emërtimet mbi bazë foljore (prejppjesore), ku prapashtesa –S del si formant i specializuar ose në ndonjë rast ende me prirje specializimi.

Po japim në vazhdim në disa pika shembuj, kur prapashtesa e huaj zëvendësohet ose prirët të zëvendësohet plotësisht me prapashtesën –S:

a) Të gjitha emërtimet e fjalë-temave të huazuara (zakonisht mbi bazë foljore në gjuhën dhënëse) të reflektuar në shqipe me –ANT fundor, në shqipe janë foljezuar ose prirën me u foljezue, dalin si emra paralel me variantin me –S, p.sh.:

konsultant/konsultues, diskutant/diskutues,
manipulant/manipulues, komandant/komandues,
projektant/projektues, shifrant/shifruer etj.

b) I njëjti proces ndodh edhe me formantet: –ATOR, -TOR dhe -OR, si p.sh:

operator/ operues, disenjator / disenjues, frezator / frezues,
tornitor/ tornues, kontrollor/kontrollues, redaktor/redaktues,
drejtor/drejtues, pagator/pagues (pagëpagues),
organizator/organizues, provokator/
provokues etj. etj.

- c) Me prapashtesën –ER si p.sh.:
 programer/programues, preser/presues, dubler/dublues,
 trajner/trajnuet etj.
- ç) Me fundoren –ENT si p.sh.:
 recensent/ recensues, konkurrent/ konkurrues, referent/referues
 etj.
- d) Me fundore-prapashtesn –IST, si p.sh.:
 propagandist/propagandues, reklamist/reklamues,
 faturist/faturues, normist/normues etj.
- dh) me fundore-prapashtesën –AR, tipi:
 komandar/komandues, s(h)tampar/stampues (botues),
 adresar(!)/adresues, ashtu si rastet brenda shqipes:
 spicar/spicues, sukullar/sukullues, e ndonjë tjetër.

Me fjalë të tjera, kur fjalë-temat e emërtimeve të profesioneve që ndërkohë dalin të foljezuara, atëherë jo vetëm kanë mundësi, por normalisht fitojnë përparësi për zëvendësimin e emrave të tillë të huazuar sipas mënyrës transfer, me trajtën foljore prejpjesore, siç ishin edhe shembujt e mësipërm. Në këtë proces, kur është fjala, sidomos tek disa nga fjalët e huazuara si më sipër, duhen dalluar a qartësuar dy gjera:

- a) si është huazuar emri dhe
- b) si është huazuar folja,

prandaj po përpiqemi që tash fill me dhënë sadokudo sqarimin sa për ta kuptuar më lehtë këtë proces.

Është e vërtetë se emrat e huaj si p.sh. **diskutant**, **disenjator**, **programer**, **recensent**, **komandar** janë pranuar nga gjuha dhënëse si fjalë ndërkombëtare, sipas mënyrës transfer, siç u cek më parë, zakonisht bashkë ose nën ndikim me konceptin përkatës të foljes e cila qëndron zakonisht si temë fjalëformuese e tyre në gjuhën dhënëse:

Krahaso:

diskutant: it. discutere (diskutoj me diskutue – diskutues),

disenjator: fr. dessiner, it. disegnaire (dezenj me dizenjue - dizenjues),

programer: fr. programmer, it programare (programoj me programue - programues),

recensent: lat. (recensens) recensere (recensoj me recensue recensues);

komandar: it. comandare fr. commander (komandoj me komandue -komandues) etj.,

mirëpo foljet në shqipe, sidomos foljet më –Oj me rastin e huazimit, siç shihet nga shembujt e mësipërm, fundore-prapashtesën e foljes së huazuar automatikisht e kanë konvertuar (zëvendësuar) me fundore-prapashtesën foljore të shqipes –Oj (ose me –UE *O fundore).

Kështu në kohë e ndërkohë në shqipe ka vazhduar të përdoret në trajtën tranfer vetëm trajta e emrit ose e emërtimit të njeriut sipas profesionit a veprimtarisë në trajtën:

diskutant, disenjator, programer, recensent, komandar,
ndërkaq folja del e huazuar pjesërisht, duke u shqipezuar në shqipe me prapashtesën e vet vendëse, andaj shumica e foljeve të tilla mund të quhen fjalë të përvetësuar ose që priren me u përvetësue në gjuhën tonë.

Ç’është e vërteta, në këtë proces, me kohë e ndërkohë kur trajta foljore në shqipe tashmë u bë, u përvetësua, përkatësisht kur koncepti i procesit të tillë i foljezuar, si me thënë, konsiderohet i shqipezuar plotësisht, atëherë në gjuhën tonë në mënyrë të rregullt doli ose si rrjedhojë u përftua **prejfoljori** përkatës (emri i vepruesit) si emërtim i njeriut sipas veprimtarisë a profesionit, i cili te shembujt përkatës të emërtimeve të profesioneve të huazuara, ku më shumë e ku më pak, filloi të mbulonte (zëvendësonte) konceptet e emrave të huazuar. Prandaj, së këtejmi dolën trajtat e shqipes:

**diskutues, dezenjues a dizajnues,
programues, recensues, komandues,**

si rivale të reja ose më mirë si sinonime, por që kështu u goditen në sistem trajtat e huazuara të cilat normalisht apo gradualisht mund ta humbin forcën që e kishin para se të lindte rivalja sinonimike, e cila del si trajtë sigurisht më e shqipes, por ndodh që ajo e vjetra ende të qëndrojë në konkurrencë e ndërkohë mund të kalojë në pjesën e rezervës, përkatësisht në shtresë stilistike (jo sdhe aq pasive, ku mund të vazhdojë aktivitetin, sidomos në stilin shkencor me të njëjtin prestigj ose edhe të specifikohet në situata të caktuara, për një pjesë të atij koncepti, prandaj ky zëvendësim (raporti: *trajta shqipe/ trajta e huazuar*, duke kaluar herë njëra herë tjetra në pjesën e rezervës) përherë nuk shkon aq lehtë për t’u dalluar sa i përket përparësisë, por gjithsesi lindja e prejpjesorëve të shqipes e sforcon identitetin e gjuhës sonë, andaj edhe në krijimin e emrave të tillë nuk duhet hezitur, ngase në këtë mënyrë tregohet edhe vitaliteti, gjallëria dhe e ardhmja e kësaj gjuhe.

Gjithsesi ky proces është fort i gjallë aktualisht, andaj edhe duhet të përcillet e të përkrahët nga standardologët tanë e sidomos nga hartuesit e

fjalorëve në përgjithësi dhe nga hartuesit e emërtimeve të profesioneve në veçanti. Së këtejmi del e vërteta se në fjalor si dhe në organikat e ndërmarrjeve ekonomike dhe në institucionet përkatëse do të kenë shëndet më të plotë dhe duhet të kenë edhe jetë më të gjatë, siç thuhet deri në amshim, ato fjalë që formohen mbi bazë të modeleve të gjalla të shqipes, pra edhe ato të profesioneve që ndërlidhen me koncepte të caktuara të fushave të ndryshme semantike, fushë kjo ende e studiuar jo sa duhet në gjuhën tonë, prandaj kjo prirje duhet ndihmuar edhe subjektivisht nga teorizuesit tanë, pa i përjashtuar *en bloc* ndërkombëtarizmat, zotërimi i të cilave e stolis dijen e çdo intelektualit.

2) Përparësitë e prapashtesës –TAR ndaj formanteve të tjera

Pse i japim përparësi prapashtesës –TAR ndaj të tjerave jemi shprehur në një vend tjetër, ndërsa këtu po shënojmë disa shembuj, tek të cilët (trajtat e dyta sinonimike), d.m.th. me formante a fundore të tjera, për mendimin tonë në guidat e profesioneve ose edhe në fjalorët e ardhshëm normativë mund të mos shënohen fare, sidomos atëherë kur konceptin përkatës e mbulon plotësisht ose parësisht emri me prapashtesën –TAR.

Sidoqoftë, në ndonjë rast edhe nëse mbetet ndonjë shembull paralel dysor, gjithsesi si dominante a si trajtë normative për emërtimin e profesionit, sidomos në ambientet e shoqërive shqiptare, duhet parapëlqyer trajta me –TAR.

Sa për orientim disa nga shembujt konkurrues përkatës po i japim në vijim në katër pika:

a) Në raportin –TAR /-AR, te shembujt në vijim, siç u tha, përparësia u takon atyre me –TAR, si:

arëtar/arar, fshesëtar/fshesar, vorbëtar/vorbar, ujëtar/ujar/, barkëtar/
barkar, djathëtar/djathar/, cergëtar cergar, e kështu me radhë.

b) Po kështu edhe te rastet paralele në raportin –TOR, –ATOR e –TAR, gjithsesi duhet të vazhdojnë të kenë përparësi trajtat me -TAR ose të jenë si trajta të vetme normëzuese. Ja disa shembuj:

skitar/skiator, pastaj qebaptar/qebaptor, gjahtar/gjahtor,
farëtar/farëtor, ëmbëltar/ëmbëltor, blegtar/blegtor,
çapëtar/çapëtor, barrëtar/barrëtor,

e kështu me radhë.

c) Gjithashtu në raportin –TAR ndaj –ATAR, duhet të ketë përparësi ose duhet të qëndrojë si trajtë e vetme normative ajo me -TAR, p.sh.:

armëtar/armator, cergëtar/cergatar, peshktar/peshkatar,
vegëltar/veglatar, plaçkëtar/plaçkatar, ujëtar/ujatar etj.

ç) E dimë nga tradita se edhe emërtimet e profesioneve me prapashtesën me origjinë turke me –XHI zëvendësohen pothuajse fare natyrshëm në stilin zyrtar me prapashtesën –TAR, madje për të njëjtin koncept pa profilim të ngushtë, si p.sh:

sharrtar/sharrëxhi, xhamtar/xhamaxhi, plistar/plisaxhi qymyrtar/
qymyrxhi, e kështu me radhë.

Lexuesi duhet ta ketë të qartë se, duke i dhënë përparësi prapashtesës TAR, për nënfushën përkatëse semantike të emërtimit të profesioneve, dhe duke i mënjeluar të tjerat si –AR, –OR, TOR etj. nga kjo nënfushë semantike, aspak nuk dobësohet gjuha, përkundrazi ajo sforcohet, sepse formantet e tjera, nëse janë të përvetësuara në shqipe do ta kenë më lehtë me u specifikue në nënfusha të tjera semantike, sidomos ajo –AR në lëmin e emërformimit, qoftë ajo –OR e –TOR në fushën e mbiemërformimit etj. Në të vërtetë, rreth kësaj dukurie tashmë janë dhënë prova dhe janë hetuar prirje nga studiuesit tanë, por edhe prej nesh, të cilat ia vlen të ndihmohen me përqafim (përdorim) praktikisht, por të forcohen edhe teorikisht.

3) Përparësi e formantit –AN ndaj formanteve të tjera mbi bazë të ndërkombëtarizmit me –IK(ë) fundore

Që në vitet e 80-a e patëm trajtuar mjaft në hollësi temën *Çështje rreth emërtimit të njerëzve sipas veprimtarisë në gjuhën shqipe nga ndërkombëtarizmat me –IK(ë) fundore*, botuar në revistën *Përparimi* të Prishtinës më 1989, ku patëm shënuar të gjitha variantet e mundshme të emërtimeve në fjalë mbi ketë bazë, që i ndeshnim në praktikën gjuhësore të kohës, d.m.th. emrat mbi temë prodhuese fjalëformuese në gjuhën tonë, të ndërkombëtarizmit me –IK(ë) fundore dhe po atëherë, në të vërtetë, patëm vërejtur se parapashtesa –AN dilte më e dalluara si dhe më e përshtatshme nga formantet e tjera për këtë nëntip emërformues. Madje përveç shembujve konkretë që patëm vjelë, një konstatim të tillë e patëm sforcuar, duke u mbështetur edhe në këto fakte:

së pari, Xhuvani – Cipo që në vitet e 30-a më vonë në punimet e tyre mbi ketë bazë më shumë kishin parapëlqyer prapashtesën –AN se të tjerat,

së dyti, Xhuvani–Çabej formantin –AN, në monografinë *Prapashtesat e shqipes*, e konsiderojnë si prapashtesë anase të shqipes,

së treti, pasi patëm konsultuar edhe përfitimet e emërtimeve të profesioneve mbi këtë bazë në krahasim me gjuhë të huaja kjo mënyrë dilte më identifikuese për shqipen dhe

së katërti, duke respektuar, në parim, temën e qartë motivuese fjalëformuese pra patëm arritur në përfundimin se kjo prapashtesë duhet të shërbejë si zgjidhje më e parapëlqyer, kundrejt formanteve të tjera sinonimike, sidomos për ato dyjare që deri atëherë nuk dilnin aq të konsoliduara ose të ngulitura sa përfitimet me prapashtesën –AN.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth zgjidhjeve me -AN mbi këtë bazë e shohim të arsyeshme që t’ia rikujtojmë lexuesit të vërtetën se si i ndeshim disa nga emërtimet e tilla të profesioneve në gjuhë të ndryshme, më të njohura:

së pari po shënojmë zgjidhjet e praktikuara në shqipen e sotme pa prapashtesën –AN mbi bazë të ndërkombëtarizmit me –IK(ë) fundore që shërben si temë prodhuese,

së dyti zgjidhjet me prapashtesën –AN po mbi këtë bazë dhe

së treti japim sqarime rasti lidhur me shembujt përkatës të të dyja mënyrave.

a) Zgjidhjet në shqipen e sotme pa prapashtesa–AN

Sa për ilustrim po i paraqitim katër shembuj që duken të ngulitur në shqipen e sotme pa prapashtesën –AN, me zgjidhjet përkatëse të emërtimeve të profesioneve, në disa gjuhë, të përfutuara mbi bazë të ndërkombëtarizmit me IK(ë) fundore:: **muzikë, botanikë, elektrikë, mekanikë:**

1) Shq. **muzikant** (muziktar), angl. *musician*, fr. *musicien*, it. *musicista*, sp. *musico*, gjerm. *Muziker*, sued. *muziker*, rus. *muzikant*, serb. *muzičar* (muzikant), turq. *muzikçi* (muzisyen);

2) Shq. **botanist**, angl. *botanist*, fr. *botaniste*, it. *botanico*, sp. *botanico*, gjerm. *Botaniker*, sued. *botaniker*, rus. *botanik*, serb. *botaničar*, turq. *botanikçi*;

3) Shq. **elektricitist**, angl. *electrician*, fr. *electricien*, it. *elettricista*, sp. *electricista*, gjerm. *Elektriker*, sued. *elektriker*, rus. *elektrotehnik*, serb. *električar*, turq. *elektrikçi*;

4) Shq. **mekanik**, angl. *mechanic*, fr. *mecanicien*, it. *mecaniko*, sp. *mecanico*, gjerm. *Mechaniker*, sued. *mecaniker*, rus. *mehanik*, serb. *mehaniçar*, turq. *mekanik* (*mekanist*).

b) Zgjidhjet në shqipen e sotme me prapashtesën –AN:

Sa për ilustrim po i poaraqitim tre shembuj në shqipe **me prapashtesën –AN**, me zgjidhjet përkatëse në disa gjuhë të emërimit të profesioneve të përfuara mbi bazë të ndërkombëtarizmave me –IK(ë) fundore: **matematikë, fizikë dhe statistikë**:

1) Shq. **matematikan**, angl. *matematician*, fr. *matematicien*, it. *matematico*, sp. *matematico*, gjerm. *Mathematiker*, sued. *matematiker*, rus. *matematik*, serb. *matematiçar*, turq. *matematikçi*;

2) Shq. **fizikan**, angl. *physicist*, fr. *physicien*, it. *fisico*, sp. *fisico*, gjerm. *Physiker*, sued. *physiker*, rus. *fizik dhe serb. fiziçar*, turq. *fizikçi*;

3) Shq. **statistikian(!)**, angl. *statistician*, fr. *statisticien*, it. *esperto in statistica*, sp. *estatistico*, gjerm. *Statistiker*, sued. *statistiker*, rus. *statistik*, serb. *statistiçar*, turq. *istatistikçi (!)*.

c) Sqarime rasti:

Që në gjuhën tonë sa i përket fundores së emërimit të profesionit mbi bazë të ndërkombëtarizmit me –IK(ë) fundore nuk del një dorë shihet qartë nga shembujt e dy pikave të mësipërme, ku përveç prapashtesës –AN (sipas shembujve nga pika e parë) ndeshim edhe këto fundore-prapashtesa: -ANT /(-TAR), -IST/(-c/IST)) dhe ZERO, dhe pikërisht vështruar në krahasim (ngjashmëri) me fundore-prapashtesat nga gjuhët e huaja nga shembujt e mësipërm po i nxjerrim disa konstatime:

Së pari, trajta muzikant e shqipes ka ngjashmëri shkrimi dhe barasvlerësi kuptimi me rusishten. Në të vërtetë ekziston një trajtë e tillë edhe në italishte, por ajo në atë gjuhë tani ka kuptim paksa jo të mirëfilltë, ngase fjala *musicanto* e italishtes shpreh nocionin e një muzikantit rrugësh.

Së dyti, trajta *botanist* e shqipes ka ngjashmëri me trajtat anglisht e frëngjisht, por në shqipe i mungon tema e qartë motivuese e ajo do të ishte vetë fjala *botanikë*.

Së treti, trajta elektricist ka ngjashmëri shkrimore me atë të italishtes e të spanjishtes, por edhe kësaj trajte në shqipe i mungon tema e qartë motivuese (elektrikë), madje edhe shqiptimi nuk përkon me atë të italishtes.

Së katërti, trajta mekanik me prapashtesë zero ose pa mbaresë, ka ngjashmëri me trajtën e rusishtes dhe të anglishtes, por edhe të turqishtes, por në turqishte del edhe trajta mekanist (por për një nocion tjetër sinonimik), mos vallë kjo trajtë mund të ketë ndikuar që në guidën e Prishtinës të dalë trajta *mekanist* për *mekanik(!)*, që ne e quajtëm si ndikim indirekt të serbishtes mehaniçar. Sido që të jetë, edhe kjo mënyrë (formimi mbi prapashtesën zero) nuk motivohet nga tema fjalëformuese në shqyrtim, ngase ajo del si pararendëse e fjalë-temës së ndërkombëtarizmës: me –IK(ë) fundore: *mekanikë* (*mekanik*).

Po shtojmë edhe këtë se jo të gjitha trajtat pa mbaresë të shqipes kanë të njëjtin zhvillim në gjuhë të huaja, kështu p.sh. trajta teknik në anglishte ka barasvlerësin technician.

Së pesti, trajtat **matematikan** e **statistikan**, me prapashtesën –AN, nuk janë identike me asnjë trajtë të gjuhëve të tjera ashtu si edhe ajo **fizikan**. Është e vërtetë se trajta e anglishtes afrohet me trajtëshkrimin e shqipes, por dallon nga shqipja për shkronjën –I –ian (parashtojcë ndaj –AN-it që e ka shqipja), ndërkaq, shqiptimisht, siç do ta shohim nuk ka kurrfarë afrie. Në të vërtetë, shqipja ka ngjashmëri shkrimore me anglishten te emërtimet e profesioneve mbi fjalë-temat me –I fundore, si: histori **historian**, komedi **komedian** e ndonjë tjetër, po rastet e tilla janë në numër të vogël.

Së gjashti, kur është fjala tek trajtë-tema motivuese ajo del e qartë shkrimisht e shqiptimisht vetëm në gjuhën gjermane, suedeze dhe turke, madje edhe te ajo ruse te rasti muzikant, mirëpo etimologjikisht tek të gjitha këto në formën shkrimore del gjurma e temës së qartë fjalëformuese me C- në (k) fundore karakteristike të ndërkombëtarizmës përkatëse. Dihet se shkronja C- latinisht e në disa gjuhë të tjera shqiptohet –K, por në rastet e fundoreve konkrete te shembujt nga gjuhët e huaja, ajo nuk shqiptohet –K por ndryshe, p.sh.

anglisht: SH (-SHËN jo IAN),

frëngjisht S (-SJEn jo –CIEN!),

serbisht: Ç (-ÇAR), i

talisht -Ç (-çista jo -CIST)

dhe, si me thënë, vetëm në shqipe ka shkrim-shqiptim normal sipas versionit fundore e temës + prapashtesën –AN, sipas demonstrimit tonë: **-k/AN**. Prandaj çdo prapashtesë ose fundore tjetër si –CIEN aq më keq –CIEN, -

ANT, madje edhe –IST e –C/IST, po ashtu edhe ajo gjermane e suedeze –K/ER si dhe ajo me mbaresë zero, e përdorur për raste ende të pakonsoliduara ose të pangulitura fort në gjuhën tonë, del e paqëndrueshme ose e përjashtueshme. Ky konstatim vlen, siç u paracek, sidomos për shembujt ende të pangulitur me fundoret –CIEN/-CIENT,-ANT, -IST/-C/IST si dhe me mbaresë zero dhe jo për ato që konsiderohen të ngulitura, mirëpo nëse sforcohet modeli i parapëlqyer prej nesh e të tjerë, atëherë ky model mund të përthithë edhe rastet që tani për tani na duken të ngulitura dhe një veprim i tillë nuk do të quhej i qortueshëm, për hir të temës së qartë prodhuese, dëshmi kjo që e forcon këtë model emërformimi.

Sidoqoftë, na merr mendja se tash e kemi të qartë pse e kemi parapëlqyer dhe pse duhet parapëlqyer prapashtesa –AN për këtë nëntip emërformues të shqipës. Sigurisht, një zgjidhje e tillë qysh tash, por edhe më mirë në të ardhmen do të jetë e mirëseardhur për të konsoliduar sistemin emërformues të gjuhës sonë në përgjithësi dhe në këtë pikë në veçanti. Ne e konsiderojmë të drejtë të parapëlqyerit e trajtës me –AN **statistikan**, ashtu si e ka edhe M. **Ndreca** në Fjalorin e tij të fjalëve ndërkombëtare. Madje përgëzojmë edhe hartuesit e fjalorit FGjSh 2006, të cilët e kanë hetuar prirjen që po propagandohet prej nesh, duke i shtuar tipit me –AN shembullin **sinoptikan**, të përftuar mbi bazë të ndërkombëtarizmes **sinoptikë**. (Shih, aty f. 963), si dhe hartuesit e **Listës kombëtare të profesioneve (2009)** për termin **informatikan** mbi bazë të ndërkombëtarizmes **informatikë** (Shih f. 26).

Po e përmbylim këtë pikë me konstatimin se duke u bazuar në të njëjtat fakte, duhet parapëlqyer pa hezitim shembujt e më poshtëm –AN, të cilësuar si emërtime të profesioneve:

antroponomistikan, aritmetikan, kozmetikan, kronikan, grafikan,
ashtu sikurse **fizikan, matematikan, gramatikan, analitikan,**
sinoptikan, fonetikan, politikan republikan, optikan,
informatikan, metodikan, estetikan, sinoptikan, onomastikan,
logjikan, elektronikn, statikan, dinamikan, energjitikan,
belestritikan, gjeomagnetikan, gjenetikan, biometrikn,
onomastikan, termikan etj.

që i kemi ndeshur në burime të ndryshme, duke përjashtuar zgjidhjen e dyjareve eventuale me fundoret **-ANT, -IST/-c/IST, -CIEN/CIENT** e ndonjë tjetër si trille ose shpifje jo të zakonshme, sidomos për të gjitha ato raste të emrave me këto fundore të shpifura, kur emërtimit të profesionit i mungon tema e qartë motivuese, por njëherazi, duke i përfocuar edhe zgjidhjet me fundore–siprapashtesën **-LOG** për emërtimin e profesionit të studiuesve të fushave të caktuara, po sipas ndërkombëtarizmit me **-IK(ë)** fundore si p.sh.: **kozmetikolog, gramatikolog, estetikolog** etj

4) Formanti i huazuar –IST si fundore-prapashtesë e favorizuar në shqipe

Emërtimet e profesioneve të huazuara me formantin **-IST** dalin në numër më të madh ndaj fundore-prapashtesave të tjera të huazuara. Numri i emrave me **-IST** me cilësi e pa cilësi të mirëfilltë profesioni të përfshirë në FGJSH 2006 kalon 100-shin. Ne edhe shembujt me **-IST** dhe qëndrueshmërinë e tyre po i trajtojmë në disa pika:

Së pari, po theksojmë se ky formant konsiderohet si prapashtesë më e familjarizuar në shqipe në raport me fundore-prapashtesat e tjera të huazuara dhe ky familjarizim shihet edhe me faktin se ky element del si prapashtesë e mirëfilltë për emërtime të caktuara mbi bazë të disa fjalëve vendëse dhe, si me thënë, ato vërtet, po krijohen, ose po përtërihen me lehtësi, sidomos në sferën e jetës së përditshme shoqërore-politike, si:

ballist, zogist, nëdëshist (NDSH-ist), enverist, pëdëist, pësëist, lëdëistë, majtist, djathtist, uçëkë-ist etj.

Së dyti, në gjuhën tonë me këtë formant mbi bazë të fjalë-temës së huazuar me cilësi ndërkombëtarizmi, mbesin pa konkurrencë një shumësi emrash, si p.sh.:

pamfletist, instrumentist, pompist, violinist, mandolinist, kitarist, farmacist, dokumentist, dogmatist, autonomist, evangjelist, okulist etj, etj.,

qëndrueshmëria e të cilëve në shumicën e rasteve as që del e diskutueshme.

Së treti, është e vërtetë se në disa raste, varësisht nga cila gjuhë huazohet fjala ndërkombëtare, ky formant, has në konkurrencë me disa fundore a prapashtesa sinonimike, por megjithatë në shqipe del favorit si p.sh.

a) ndaj formantit **-ER**, siç janë rastet: masazher / masazhist, futboller/futbollist, pensioner/pensionist, aksioner / aksionist (!) etj., por ka

raste, siç është shpjeguar në tjetër vend, kur formantit –ER nuk i konkurren fare prapashtesa –IST, si p.sh. moler, dispeçer etj.;

b) ndaj fundores –AUT, terapeut / terapist që në këtë burim, FGjSh 2006, parapëlqehet trajta me –IST.

c) ndaj prapashtesë-fundores së huazuar –AR, si për shembull: arhivar/arkivist, modelar/modelist, shtampar/ stampist, sekular/sekulist, e ndonjë tjetër, por ka raste ende të diskutueshme në reportin -AR/IST, siç janë edhe shembujt mbi bazë të ndërkombëtarizmit me –EK(ë) fundore, tipi bibliotekë, përkatësisht emërtimi i njeriut sipas profesionit **bibliotekar/bibliotekist**, që po e trajtojmë paksa tash fill.

Sapo u cek se në vazhdë të diskutimit në gjuhën tonë hyjnë edhe trajta e emërtimit të profesionit mbi bazë të ndërkombëtarizmit (me origjinë greke) me –EK(ë) fundore si

*apotekë, bibliotekë, diskotekë,
fonotekë, hipotekë, kartotekë,*

që në gjuhë të huaja edhe në serbishte emërtimi i profesionit zakonisht del me prapashtesën –AR si *apotekar, bibliotekar, hipotekar, diskotekar, fonotekar, kartotekar*, por edhe në gjuhën shqipe i ndeshëm të normëzuar emërtimet: **bibliotekar** e **hipotekar** (Shih: FGjSh 2006 f. 89, 388), madje pikërisht trajta. **bibliotekar** në raport me **bibliotekist**, del e ndihmuar nga trajta e latinishtes *bibliothecarius*, si dhe nga gjuhët e tjera si italisht, gjermanisht, rusisht e serbisht etj. atëherë pse e quajmë të diskutueshme trajtën me –AR, ose pse në shqipe ka prirje të fortë që si në gjuhën e folur si dhe në atë të shkruar trajtat e tilla të parapëlqehen me prapashtesën –IST:

**apotekist bibliotekist, diskotekist,
fonotekist, hipotekist, kartotekist,**

e kështu me radhë?

Ne nuk kemi hasur në ndonjë përgjigje të prerë, vetëm se nga parapëlqyesit e trajtës me –IST te ne është thënë se kjo bëhet për lehtësi shqiptimi dhe njëherazi si alergji ndaj trajtës së serbishtes, por ne mendojmë se aty ka edhe diçka tjetër, është fjala tek tema fjalëformuese e pa përshtatshme me –K fundore + prapashtesa –AR. Kështu edhe trajta **bankar** nuk del e parapëlqyer ndaj trajtës **bankier**. Me fjalë të tjera në shqipe si emra modern të profesioneve nuk ndeshim emra me –AR të krijuar mbi një temë fjalëformuese me –K fundore.

Sidoqoftë, jo vetëm në guidat e sipërtrajtuara të profesioneve, por edhe në dy fjalorët e fjalëve ndërkombëtare të botuara në Prishtinë, në atë të

M. Ndreçës (1986), por edhe në atë të Institutit Albanologjik (1988), ndeshim edhe trajtën **bibliotekist**. E ndeshim me –IST, edhe në Fjalorin shqip-serbokroatisht 1981 si dhe në përdorim të përditshëm të masmediave tona.

Besojmë se çdo lexues shqipfolës e sidomos çdo standardolog i shqipes e kupton alergjinë pse në këto raste nuk parapëlqehen trajtat me fundoret –k-AR por ato me –k-IST si *bibliotekist, fonotekist, kartotekist, hipotekist etj.*

Së katërti, më sipër përmendëm disa raste ku prapashtesa –IST del e favorizuar me konkurrencë të fituar ndaj disa koncepteve e formanteve të tjera, por tani për rastet që do t'i trajtojmë nuk del aq e favorizuar sot sa ishte më përpara.

Në të vërtetë, siç është përmendur më sipër, emri me formantin –IST konkurrohet nga prejpjesori përkatës me fundore-prapashtesën –UE/S të shqipes, si p.sh.:

arkivist / arkivues, modelist / modelues, drenazhist / drenazhues, ka edhe jopak shembuj të tjerë, madje përparësia e trajtës së prepjesorit as që diskutohet në rastet kur emër-tema përkatëse del e foljezuar, siç ishte rasti arkivoj me arkivue – arkivues ndaj trajtës arkivist, modeloj me modelue – modelues ndaj trajtës modelist etj., por megjithatë trajtat me –IST, duke u ushqyer me autoritetin shkrimor edhe pse homonim të trajtës përkatëse të gjuhëve të huaja, të mëdha, me cilësi ndërkombëtarizmi, sidomos në stilin rigoroz zyrtar vazhdojnë të qëndrojnë, madje shpesh edhe në përparësi ndaj simotrës me rrënjë-temën e prapashtesën shqipe. Meqenëse kjo temë është trajtuar në tjetër vend edhe më në hollësi këtu nuk po zgjatemi më tepër, por s'po mundemi me e lënë pa e thënë e pa e theksuar në fund se ia vlen të ndiqet raporti i emërtimeve të profesioneve me –IST / -S (-UE/S), ngase si duket ende do të mbesin emërtime dysore, siç është cekur më përpara në raportin e përparësisë **plasim/rezervë**, sidomos kur është fjala te mjedisi përkatës, qoftë në përdorim brenda shqipfolësve, ose në raport me gjuhë të tjera apo në ndërmarrje mikste.

5) Bashkëjetesa e formanteve të specializuara –S dhe –TAR mbi temë të njëjtë prodhuese

Bashkëjetesën jo aq alternativisht të formanteve –S dhe –TAR po e trajtojmë paksa në këto dy aspekte: raporti emërformues –TAR/-S mbi temë

të njëjtë foljore dhe raporti emërformues -TAR/- S mbi temë kompozite, siç do ta shohim në pikat vijuese.

a) Tani po fillojnë së trajtuari si qëndron raporti -TAR / -S mbi të njëjtën temë foljore fjalëformuese, si:

*mbathtar/mbathës, mbjelltar/mbjellës, mihtar/mihës,
mblestar/mblesës, ngrohtar/ngrohës, mbushtar/mbushës etj.,*

Sipas studimit që kemi bërë, del se që të dyja këto trajta kanë mundësi të bashkëjetojnë për mrekulli, nëse vazhdojnë prirjen duke i ndarë nënfushat semantike. Kështu, diferencimi bëhet ose prirjet me u dallue, varësisht nga kuptimi që i qaset më fort konceptit të foljes ose konceptit të procesit tekniko-teknologjik, jo emrit prejpjesor, por emrit me -TAR. Pra, nëse kuptimi i afrohet foljes ose konceptit të procesit tekniko-teknologjik atëherë ka përparësi prejpjesori përkatës me -S (sipas varianteve: -UE/s, -YE/s, -Ë/s ose -S) për t'u specifikuar kuptimisht. Me fjalë të tjera, koncepti anon drejt *a profilimit i ngushtë i profesionit*, ndërkaq emërtimi me prapashtesën -TAR i mbështetur në konceptin sipas emrit përkatës, mbetet të mbulojë një hapësirë të veçantë pa profilim të ngushtë. Në këtë kontekst, gjithsesi emrat me -TAR edhe pse nuk janë aq prodhues e veprues sa ata me -S, megjithatë mbulojnë nocione më të përgjithësuara.

Sidoqoftë ka mendime që trajta me -TAR që sot konsiderohet e përftuar mbi temë të vetës së parë të foljes së dëftores, ka gjasa se ajo ishte përftuar mbi bazë të emrit prejpjesor pandajshtesor, tipi: mbathë -a, mbjellë -a, mbushë -a, blojë, rojë etj. Së këtejmi prirja për dallimin semantik të kuptimeve të tilla në finesa është dhe duhet të jetë e pranishme edhe në shqipen e sotme standarde. Pra emrat me -TAR mbi temë ta quajmë foljore ose emërore (nga prejpjesori pandajshtesorë) vërtet kuptimisht afrohen më shumë me nocion të pëërgjithshëm emëror se sa mbi temë foljore që asociacionon një proces tekniko-teknologjik.

Krahaso: 1. mbath me mbathë mbathë-a – **mbathtar**
ndaj 2. mbath (mbathur me mbathë) - **mbathës**.

b) Për dallim ose në përputhje me atë sa u tha në pikën e mësipërme raporti semantik i formimit me -TAR ndaj atyre si te shmebulli me prapashtesa -S, **mbathtar/mbathës, ngrohtar/ngrohës** del edhe më i qartë në raportin e emrave me -TAR ndaj kompozitave, kur gjymtyra e dytë përbërëse është emër prejpjesor me prapashtesën -S.

Krahaso shembujt: 1. *mishtar, lultar, vreshtar, rrushtar, pylltar* etj. - si emra të prejardhur ndaj

2. *mishshitës, lulerritës, vreshtpunues, rrushpërpunues, pyllruajtës* etj. – si emra të përbërë (kompozita).

Le të kujtohet edhe rasti i trashëguar i profesionit mbathtar, i cili në kohën tonë për t'u kuptuar masivisht duhet të sqarohet mbathtar – mbathës i kuajve ose kalmbathës, ngase ka edhe mbathës i fëmijëve në foshnjore, mbathës i patinave në ushtrime patinazhi për fillestarë etj.

Së këndejmi, dallimi sinonimik del edhe më qartë sa i përket nënfushës semantike ngase emërtimet me kompozita ndërlidhen kryekëput me profilimin edhe më të ngushtë të profesionit ndaj trajtave të emrave të prejardhur prejfoljor me -S, ndërkaq trajta me -TAR mbetet gjithsesi për të mbuluar profilim më të gjerë të konceptit përkatës.

Pra, në raste si mishtar /mishshitës, trajta me -TAR ndërlidhet ose mund të ndërlidhet edhe me konceptin e pronarit të mishtores ku shitet mish, ndërsa me termin mishshitës identifikohet personi që kryen funksionin drejtpëdrejt, d.m.th. ai që e shet atë artikull. Me fjalë të tjera emërtimet me -TAR (tipi: tregtarët) më tepër se prefljorët ose kompozitat sinonimike, madje se edhe vetë shembulli me prapashtesën -S mund të përfaqësojnë grup-bashkënjësinë e profesionit deri 4-shifrore, prej nga rrjedhin nënprofesione ose profile profesionale të ngushta, të cilat karakterizohen rëndomë si 6-shifrore, që siç u tha, zakonisht për nga ndërtimi janë kompozita ose emërtime perifrastike, ndërtime këto që janë karakteristikë e profesioneve të profileve të ngushta. Vetëm në kuadër të mishtarit si pronar i mishtores ose tregtarit si pronar i tregtizës (mini-marketit), mund të punësohen punëtorë për punë e detyra të veçanta ose me gërshtëtim punësh e detyrash profilesh të ndryshme, pra, në kuadër të emërtimit **mishtar** përveç *mishshitës*, dalin edhe *mishcoptues, mishgrirës, seleksionues i tulit të mishit, i mishit me eshna, ose seleksionues i mishit sipas cilësisë ose sipas prejardhjes, furnitor a furnizues i mishtores me mish* viçi (*shtjerre, pule, rose*) etj. etj.

Në të vërtetë, ne këtu nuk po i trajtojmë në hollësi përparësitë ose konkurrencën sinonimike të fundore-prapashtesave të tjera, edhe pse edhe ajo është temë që zgjon jo pak interes për sistemin fjalëformues të shqipës në tërësi dhe për emërtimet e profesioneve në veçanti, sepse, me atë që bëmë deri tash, kemi bindjen se lexuesi i interesuar ose studiuesi i interesuar ka fituar idenë dhe tani nga konstatimet e thëna deri këtu e ka të qartë se çështja e emërtimit të profesioneve përkatëse del e zgjidhshme praktikisht brenda institucioneve a ndërmarrjeve përkatëse, ku punët dhe detyrat nga

veprimtaria përkatëse i diktojnë edhe vet profesionet dhe profilimet e tilla, por për të qenë emërtimet në përputhje me natyrën e gjuhës shqipe ato duhet të verifikohen nga ekspertët njohës të fjalëformimit të shqipes në përgjithësi dhe për strukturën emërformuese në veçanti, ku edhe prapashtesat speciale luajnë rolin e vet të pazëvendësueshëm.

Pra, këtu po e ndërprejmë analizën rreth përparësive të formanteve të caktuara në fushë të emërtimeve të profesioneve, për t'u lënë vend kritereve dhe konstatimeve përmbyllëse në të cilat sigurisht do të ritheksohet edhe ndonjëra nga përparësitë e formanteve të caktuara sipas modeleve përkatëse që kanë të bëjnë enkas rreth emërformimit të profesioneve.

(3) KRITERE DHE KONSTATIME PËRMBYLLËSE RRETH EMËRTIMIT TË PROFESIONEVE NË GJUHËN SHQIPE

Disa nga vëzhgimet tona, ato më kryesoret, lidhur me profesionet në gjuhën shqipe, pas konsultimit të teksteve të tri guidave të sipërtrajtuara dhe materialit të konsultuar detyrimisht për nevoja hulumtuese më përpara gjatë procesit dhe përfundimit të punimit të temës së doktoratës si dhe të materialit që qëmtuam nga FGJSH 2006 e më vonë, që nuk ishin të pakta, të cilat mund të cilësohen edhe si rezultate analitike, do të përpqemi t'i inkorporojmë në vijim në dy pika kryesore:

së pari, rreth kriterëve që duhen pasur parasysh nga hartuesit e versionit shqip unik të listës së re të profesioneve në shkallë kombëtare dhe së dyti, do t'i trajtojmë në disa pika disa konstatime përmbyllëse, të cilat besojmë se do të ndihmojnë në aspektin e plotësim-konsolidimit të emërtimit të profesioneve në gjuhën shqipe.

1. Disa kriterë themelore rreth hartimit të listës unike kombëtare të profesioneve

Disa nga kriteret më praktike që duhen pasur parasysh me rastin e rishhartimit të **Listës kombëtare të profesioneve** që rezultojnë nga analiza që i bëmë çështjes së emërtimit të profesioneve, po i shprehim më poshtë në disa pika:

E para, mund të themi me plotëgjë se materiali nga tri guidat e sipërtrajtuara, edhe pse përveç lëndës së shëndoshë, të qëndrueshme që kanë, përshkohen edhe me lajthitje jo të lehta, që të gjitha duhet të kihen parasysh në hartimin e listës unike të profesioneve në hapësirën mbarëshqiptare, në mënyrë që nga ato mësimet e pësime të nxjerrim vetëm mësimet.

E dyta, patjetër nga të dyja këto burime të Tiranës (T1 dhe T2) duhet të merren të gjitha pikat e pakontestueshme dhe teksti të harmonizohet me rregullat drejtshkrimo-gramatiko-leksikore e fjalëformuese të shqipes sipas standardit në fuqi dhe prirjeve që çojnë drejt përplotësimin dhe modernizimit të tij (standardit), kjo duhet bërë në bashkëpunim edhe me ekspertët e degëve të caktuara nga institucionet përkatëse të ekonomisë, tekniko-teknologjisë etj. etj., por domosdo duhet ta kenë vendin e duhur aty edhe ekspertët nga institucionet përkatëse profesionale të gjuhësisë, sidomos duhet pasur kujdes në përkufizimin e secilit emërtim, sipas natyrës së gjuhës shqipe dhe në këtë drejtim duhet shfrytëzuar parathënia e tekstit të hyrjes të burimit T1 (të Tiranës). Por natyrisht si bazë për hartimin e listës unike të profesioneve në gjuhën shqipe duhet të shërbejë *Lista kombëtare e profesioneve* (2009), si dhe të kihen parasysh zgjidhjet e dhëna në *FGJSH* 2006 si dhe përkufizimi i punëve dhe të detyrave sipas vendeve të punës ose profileve të profesioneve që jepen në burimin e Prishtinës (2006). Po, duhet me i pasë parasysh edhe e arritjet e pakundërshtueshme nga punimet e studiuesve dhe tonat mbi këtë problematikë.

E treta, për të pasur sukses në hartimin e listës së re të profesioneve, siç mësojmë, sidomos nga T2, burim i vitit 2009, për të gjitha emërtimet e profesioneve në shqipe, patjetër, parësorisht lypset respektuar trajta e emrit në gjinisë mashkullore si trajtë përfaqësuese, pos rasteve të veçanta, kur natyra e punëve dhe e detyrave kërkon emrin femëror si gjini përfaqësuese ose si gjini e vetme, siç është rasti *mami mamia (lindatore!)*. Mirëpo aty ku patjetër lypset që në vendin e punës të punësohet personi i gjinisë femërore (sekretar paraqit;se e programi TV etj.) që e ka të njëjtin profesion që mund ta kryejë edhe personi i gjinisë mashkullore, por në një vend tjetër të punës, atëherë del e nevojshme që në konkurse të përcaktohet gjinia femërore, Sidoqoftë në organika (listën e profesioneve të institucionit përkatës) duhet të dallohet formulimi, dhe të bëhet shifrimi veçmas për vendin e caktuar të punës, ku punët dhe detyrat duhet t'i kryejë domosdo, përndryshe gjinia përfaqësuese mashkullore përgjithësisht mund të jetë e mjaftueshme në letër.

E katërta, nga lënda që konsultuam nënkuptohet rregulla se për të gjitha kodet deri katëshifrore (grupet e mëdha, nëngrupet e mëdha, grupet e vogla dhe grupet bashkënjësi) si trajtë përfaqësuese të emrit të profesionit (kuptohet: **trajta përfaqësuese e emërtimit të njeriut sipas profesionit**), normalisht duhet me dalë **shumësi i emërtimit përkatës**, ndërsa vetëm për

kodin 6-shifror si trajtë përfaqësuese duhet me u praktikue vetëm **njëjësi i emërimit përkatës**. Ky rregull ka mundësi të zbatohet edhe më mirë sepç është bërë në T2 (2009). Respektimi i një rregulle të tillë do të eliminonte shumë mëdyshje që ne i quajtmë lajthitje në burimet që konsultuam. Mirëpo del një çështje tjetër, karakteristikë e veçantë e gjuhës shqipe që lyp zgjidhje praktike me mirëkuptim: **është çështja e përcaktimit të trajtës së shquarsisë së emrit përkatës në njëjës e shumës**. Edhe në këtë pikë ndeshim luhatje (lajthitje), sidomos në burimin e Prishtinës. Besojmë se kjo çështje mund të zgjidhet jo me vështirësi, nëse respektohet prirja, të cilën po trajtojmë në dy pikat e mëposhtme:

Së pari, sa i përket trajtës së shquarsisë për emër-emërtimet e grup-profesioneve, nga njëshifrori deri te katërshifrorë, duke përfshirë, pra edhe grupet dy e treshifrore, me sa pamë në T2 mbizotëron **shumësi i emërimit përkatës në trajtën e pashquar**, ndërsa te burimi i Prishtinës mbizotëron **shumësi në trajtën e shquar**. Secila trajtë mund të ketë arsyetimet e veta. Për tiranësit mjafton trajta e shumësit të pashquar dhe këtë, veç ndonjë rasti e argumentojnë praktikisht, në të gjitha emërtimet, ndërsa prishtinasit e kanë praktikuar shumësin e shquar për këto dy arsye e para, sepse në krahasim me gjuhët e huaja (zakonisht me atë serbokroate), shquarsia e bën shumësin e emrit dhe krejt emrin e shqipes më të dallueshëm nga barasvlerësi i serbokroatishtes dhe i gjuhëve të tjera, dhe e dyta, për shkak se në shqipe jo pak emërtime dalin homonim në njëjësin dhe shumësin e pashquar ose dallohen vetëm me një –Ë fundore jo aq të ndjeshme për nga shqiptimi p.sh. njëjësi: **teknik** tekniku ndaj **teknikË** **teknikËT** ose **tregtar**, **tregtarË** **tregtarËT**, përkatësisht: **ligjvënës** **ligjvënësi**, shumësi **ligjvënës** **ligjvënësit**, **mjeshtër**-i ndaj **mjeshtër** –it etj.

Sidoqoftë, komisioni hartues ka të drejtë të vendosë se cila mënyrë shquarsie duhet parapëlqyer.

Së dyti, kur është fjala për përcaktimin e shquarsisë së njëjësit në emërtimet gjashtëshifrore në guidat e Tiranës sidomos në T2 si prirje është trajta e pashquar, ndërsa në atë të Prishtinës dalin të dyja trajtat e njëjësit. Mendojmë se ajo që është praktikuar në burimet e Tiranës, duhet të respektohet pa rezervë nga të gjithë, ngase tek emërtimet e tilla 6-shifrore në tekstin e burimit në fjalë T2, qofshin emërtime njëfjalësh, kompozita, qofshin emërtime togfjalësh a perifrastike mjafton si trajtë e vetme: përfaqësuese **njëjësi i emrit në trajtën e pashquar** Dhe një zgjidhje e tilla as që ka nevojë të diskutohet, sepse përkon me rregullën që jepet si kriter edhe në Gramatikën e Akademisë.

Fundja, përzgjedhja e njëjësit të pashquar tek emërtimet e kodit gjashtëshifror e thamë se nuk ka nevojë të diskutohet, ndërsa tek kodet nga njëshifrori deri te katërshifrori, cilado nga trajtat që do të parapëlqehet si trajtë e vetme përfaqësuese: **shumësi i pashquar** ose **shumësi i shquar** funksionalisht mund ta kryejë misionin për mrekulli dhe kështu do të eliminoheshin me qinda e qinda lajthitje e dilema të trashëguara nga guidat e mëparshme, qoftë rreth shquarsisë së njëjësit, qoftë atij të shumësit.

E pesta, patjetër lypset respektuar e vërteta aksiomo-logjike se çdo profesion edhe ata perifrastikë në nisë duhet të paraprihen nga një emër vepruesi si emërtim profesioni e jo ndonjë emër veprimi ose ndonjë emër jo me kuptim të mirëfilltë profesioni, siç i kemi ndeshur në burimet që i konsultuam dhe i kemi gjykuar këto defekte si lajthitje të rënda.

E gjashta, të gjitha emërtimet e profesioneve togfjalësha etj. nuk duhet të kenë shkurtesa fjalësh, vizëla ndarëse a kllapa të panevojshme, ngase çdo fjalë në funksion profesioni patjetër duhet të jetë në formën e plotë dhe me përkufizim sa më kuptimplotë.

E shtata, fjalë-termat ose fjalët sqaruese ose shprehjet e huaja në kuadër të tekstit të emërtimeve të profesioneve në shqipe, nëse nuk mund të zëvendësohen ose të kalkëzohen, ato patjetër duhet të sqarohen ose të transkriptohen si version i parë në alfabetin e shqipesdhe ashtu duhet të përdoren në kuadër të organizatës përkatëse shqiptare.

E teta, fjalë-termat sinonimikë të stilit bisedor si dhe krahinorizmat nuk vijnë në konsideratë si emra të mirëfilltë të profesioneve, natyrisht në rastet kur ekzistojnë sinonime të pranuar nga standardi ose ekzistojnë modele të qarta dhe të kapshme fjalëformuese e fjalëndërtuese të pranuar normativisht, nga të cilat formohen emërtimet përkatëse që rastësisht nuk ekzistojnë, por potencialisht i përshtaten kontekstit kuptimisht e formalisht.

2) Konstatime përmbyllëse rreth plotësim-konsolidimit të profesioneve në gjuhën shqipe

Edhe konstatimet përmbyllëse do t'i shprehim në disa pika, duke përsëritur e përplotësuar ndonjë temë të prekur më përpara gjatë analizës ose duke e trajtuar edhe ndonjë mini-temë shtesë paksa të re që sjell ndonjë risi,

qoftë me përmbajtje të përgjithshme parimore, qoftë brenda strukturës emërformuese të emërimit të profesioneve:

E para, për të pasur sukses të plotë rreth rihartimit të **Listës kombëtare të profesioneve** patjetër lypsen respektuar modelet fjalëformuese që janë treguar funksionale dhe në kuadër të tyre lypset inkorporuar pa hezitim shembuj të rij sipas gjedhes së parapëlqyer në bazë të rezultateve që kanë dalë nga studimet përkatëse, si p.sh.:

a) Prapashtesën **-AN** të përdoret pa hezitim në emërtimet e profesioneve nga ndërkombëtarizmave me **-IK(ë)** fundore, sikur tipi:

matematikan, fizikan, duhet të dalin edhe emërtimet statistikan, informatikan, kozmetikan, logjikan, semantikan, optikan, etj., etj.,

edhe pse ende nuk i ndeshim të regjistruar ashtu në FGJSH, ngase ky formant është shënuar si model i qëndrueshëm, mbasi edhe nga tradita e praktika e sotme nuk del jo vetëm si model i qortueshëm, por edhe i rekomandueshëm. Kështu me një zgjidhje të tillë gjithsesi rastet me **-CIEN, -CIENT, -C/IST, -IST, -ANT** mbi këtë bazë mund korrigjohen menjëherë, përveç rasteve nëse ashtugjykon dikush se dalin të rrënjosura thellë, por në burime normative edhe të ato raste mund të shënohen trajta me **-AN** si trajta dyjare.

b) Prapashtesa **-IST** të mos përdoret te rastet kur emërtimi i profesionit ose i studiuesit të degës përkatëse e shpreh nocionin përkatës plotësisht me **-log** fundore që i paraprijnë emërimit të disiplinës përkatëse ditunore me **-gj/i** ose **/i** fundore si p.sh. ekolog jo ekologjist, terminolog jo terminologjist, zoolog jo zoologjist, embriolog jo embriologjist, morfolog jo morfologjist etj .

c) Madje edhe trajtat me **-IST** të shpifur pa nevojë te rastet *daktilografist* dhe *ekologjist*, edhe pse shënohen kështu në FGjSh 2006 duhet të thjeshtëzohen në **daktilograf, ekolog**, ngase shqipja për këso raste sidyjare nuk ka kurrfarë nevoje, andaj edhe këto dy raste duhet të kenë zhvillim të ngjashëm si *fotograf, gjeograf* ose *psikolog, zoolog* dhe assesi: *fotografist, gjeografist, psikologjist, zoologjist(!)* etj. Pra, në raste të tilla mjafton të përdoret vetëm trajta e shkurtër pa **-IST** fundore. Këtu, nuk duhet të na hutojë tipi: telegrafist, shaptilografist e raste të ngjashme, sepse fjala telegraf, shaptilograf, ashtu si shembulli i tipit telefon mbulojnë nocione të gjë-sendeve konkrete e jo emërtimin e profesionit përkatës, andaj në raste të tilla emërtimi i profesionit del me prapashtesën **-IST**: *telegrafist, telefonist, shaptilografist* e kështu me radhë.

ç) Po ashtu kur është fjala te formimet me **-IST**, mbi temë ndajfoljore, siç është shembulli *instrumentalist*, edhe nëse e ndeshim ashtu në gjuhë të huaja, në shqipe del si trajtë jo e drejtë, sepse në gjuhën tonë i qëndrueshëm do të dalë vetëm emërtimi i mbështetur mbi fjalë-temën motivuese emërore, si b.f. instrument ((instrument+ist) – **instrumentist**.

d) Rastet me **-EUT** dhe ato me **-AR** fundore, në raport me trajtat me **-IST** tipi **terapeut/terapist ose bibliotekar/ bibliotekist** që u prekën paksa në pjesën e mëparshme që mbeten të diskutueshme mund të përdoren dyjarisht edhe me trajtën me **-IST**, për derisa ekspertët ta japin zgjidhjen përfundimtare të tyre, prandaj këtu nuk po zgjatemi më tepër.

dh) Kur fjalë-temat e huazuara të emërtimeve të profesioneve me prapashtesën **-ATOR** (të përfutuara nën ndikimin e italishtes) fillojnë të foljezohen, patjetër duhet parapëlqyer trajtat e shqipes dhe format e porsalindura, sidomos atëherë, kur emërtimet me **-ATOR** ose **-TOR** nuk janë ndërkombëtarizma, por edhe në raste të tjera, kur janë ndërkombëtarizma të mirëfilltë si p.sh. në raportet dysore:

*operator/operues, numerator / numrues, programator / programues,
manovrator / manovrues, axhustator / axhustues, saldator / saldues,
etj.,*

duhet pranuar si të tillë, por siç është cekur më përpara përparësia e trajtës përkatëse varet nga ambienti i përdorimit, varet nga stili i të shprehurit të dysorëve sipas imponimit *plasim/rezervë*. Kuptohet jeta e mëtejshme e dysorëve të tillë varet edhe nga sforcimi i foljes përkatëse në shqipe: *operoj (me operue), programoj (me programue), manovroj (me manovrue), axhustoj (me axhustue), saldoj (me saldue)* e kështu me radhë, në përdorimin e përditshëm zyrtar sipas nënfushave semantike dhe llojit të stilit funksional. Nëse kemi të bëjmë me stilin shkencor akademik në simpoziume shkencore etj., kur raporti me gjuhët e huaja është ndërndikues, atëherë ndërkombëtarizmat me **-ATOR** ose **-TOR**, tipi operator, mund të jenë më të parapëlqyeshëm ose gjithsesi të paqortueshëm, ndërkaq, në situata, kur procesi i konvertimit në raste del i zhvilluar, sidomos në ligjërimin popullor etj, trajta me prepjesorin përkatës duhet konsideruar me konkurrencë të fituar. Dhe në raste të tilla trajta me **-ATOR** a **-TOR** kalon në pjesën e rezervës, por ende nuk mund të quhet fjalë e pasivizuar apo e cilësuar si barabarizëm.

e) Lidhur me sa më lart del edhe një dukuri tjetër që ka të bëjë me polisemantizëm ose me homoniminë shkrimore të emrit përkatës të huazuar si dhe atij të shqipëruar në prepjesor, të cilët dalin edhe si emërtim i njeriut

sipas profesionit, por edhe si emërtim i një aparati a gjësendi konkret. Më poshtë po i japim disa shembuj të tillë së pari me fundoren –A/TOR të huazuar sipas mënyrës transfer dhe së dyti po i përsërisin të njëjtit me fundore-prapashtesën -UE/S, të pëftuar nga zhvillimi i brendshëm i shqipes:

a. operator, axhustator, numrator, programor a programator, distributor, izolator, kalkulator, kontrollor, stabilizator, manovrator etj.,

b. operues, axhustues, numrues, programues, distribues, izolues, kalkulues, kontrollues, stabilizues, manovrues,
e kështu me radhë,

prandaj lidhur me këtë shprehim mendimin që është shumë më me vend të insistohet që emrat prejpjesorë me -(A)TOR fundore, nga pika a) **të përliqjen vetëm si emërtime të aparateve a të gjë-sendeve konkrete**, të cilët edhe ashtu e kanë cilësinë e ndëkombëtarizëm apo të fjalës ndëkombëtare, ndërsa trajtat e emërtimeve nga pika b) **të përliqjen me anim vetëm si emërtime të njerëzve sipas profesionit, në organizatat puninjëse shqiptare.**

Me këtë duam të themi se nuk jemi të pëlqimit që edhe emërtimi i aparatit të shqipërohet si prejpjesor, siç vërehet në burime të caktuara. Po japim një shembull konkret në të dyja versionet, siç mendojmë ne se lypset diferencuar semantika edhe me format shkrimore të emrit përkatës, p.sh.:

1) Operuesit tanë po kontrollojnë operatorat e makinerive që sapo u vunë në veprim në impiantin tonë.

2) Operatorat e sapo ardhur u vunë në funksion nga operuesit tanë në impiantin përkatës

Me thënë të drejtën një prirje e tillë tashmë vërehet gjithnjë e më shumë në mjediset tona të caktuara si, p.sh.:

Operatorat ilegalë ia ulin vlerën PTK-së. (Shih: Zëri 07.10. 2010 f. 06.) ose

Operuesit e PTK-së shkyçën operatorat ilegalë.

Gjithsesi, për natyrën e shqipes plotësisht është normale që emërtimi i profesionit përkatës me dalë si prejpjesor, rastet:

operues, numrues, programues, manovrues, axhustues, distribues, izolues etj.,

ndërsa aparatet le ta ruajnë trajtën origjinale të huazimit tranfer, siç u shënuan më sipër: *operator, numrator, programator, axhustator, distributor, izolator*.

Ky dallim që tani është në proces e sipër, supozojmë që në të ardhmen mund t'i diferencojë edhe më mirë nënfushat përkatëse semantike.

ë) Po kështu emërtimet e profesioneve me trajtat fundore: –ER/-IER, -IST/-C/IST, –ANT etj. mund të konvertohen në trajtën me –UE/S, ose me ndonjë formant a fundor tjetër të shqipes, kur tema prodhuese e fjalës së huaj del e shqipezuar ose e foljezuar zakonisht me –O/j ose me –UE fundore të pjesores si p.sh.: former / formues, preser a presist / presues; gomist / gomëtar (gomues), muzikant / muziktar (muzikues), elektrikist /elektrikan, shifrant/ shifrues, diskutant/ diskutues, e kështu me radhë.

E dyta, kur del e nevojshme mund dhe duhet të krijohen ose të modifikohen edhe emërtime të reja. Mirëpo për t'u formuar një fjalë e re nevojiten njohuri praktike e teorike, natyrisht, si pikë e parë, njohje solide e sistemit fjalëformues të shqipes, sidomos në nënfushën përkatëse. Gjithsesi fjala e re duhet gjithandej të ketë mbështetje edhe logjike në përputhje me kontekstin të cilit do t'i takojë. Andaj, lidhur me këtë po rrëfëhemi se si rastisi që u detyruam me krijue ose me formëzue një fjalë të re për të arsyetuar profilimin e emërtimit përkatës ose të grup-emërtimeve përkatëse të profiluara që na mungojnë, qoftë në krahasim me realitetin tonë, qoftë me nevojën e gjetjes së barasvlerësve në raport me zgjidhjet që jepeshin në gjuhë të huaja. Është fjala për disa profile profesionesh ose punësh e detyrash që lidhen konkretisht me përpunimin e gëzofit.

Siç dihet me fjalën **gëzof** sot për sot parësisht mbulohet koncepti i një veshe të gatshme, nocion ky që në gjuhë të huaja ka këta barasvlerës:

turqisht *kurk* (qyrk), angl. *fur*, it. *pelliccia*,

fr. *fourrure*, serb. *kozhuh*, gjerm *Pelz*

dhe siç dihet në shqipe emërtimi i profesionit *me profilim të gjerë del gëzofitar*, ndërsa *pa profilim të ngushtë*, sipas koncepteve të sotme të gjalla, del gëzofpunues, gëzofshitës etj. Gjithashtu *me profilim të ngushtë* mund të dalin edhe më shumë emërtime të tjera si gëzofqepës, gëzofhekurosës, gëzofpastrues, gëzofarnues, qepës i pullave të gëzofit në gëzofitore, përzgjedhës i modeleve të gëzofave sipas ngjyrës (sipas cilësisë, sipas moshës: gëzofa për fëmijë, për pleq, për të rinj), pastaj sipas madhësisë, sipas gjatësisë etj. dhe për të gjitha këto koncepte në gjuhën shqipe, po thuaj, normalisht i gjejmë ose mund të krijojmë barasvlerës të qëndrueshëm

fare natyrshëm, ngase realiteti, aftësia e emërformimit në gjuhën tonë në bazë të strukturës fjalëformuese na jep një mundësi të tillë vetëm mbi bazë të fjalë-emrit gëzof si veshë (teshë) e gatshme.

Këtë që sapo e thamë vlen, pra, vetëm për rastet kur kemi parasysh konceptin e gëzofit si veshë a veshje të gatshme, por kur është fjala për materiale gëzofi dhe për procesin e përpunimit të materialit ose të lëndës së parë gëzofore në krahasim me termat përkatës të gjuhëve të huaja në gjuhën tonë hasim, siç hasëm edhe ne në vështirësi të pakapërcyeshme, sepse paraqiten vështirësi në gjetjen ose krijimin e barasvlerësve të përshtatshëm përkatës mbi bazë të fjalës gëzof. Kështu, sipas guidave që konsultuam edhe për konceptet e tilla procesin e përpunimit të materiali, përdoret po fjala gëzof(!!!??), që për ne dilnin emërtimet tejet të papërshtatshme, kur kemi parasysh konceptin e gëzofit të pranuar si veshje konkrete.

Ja disa shembuj ku procesi i punës që diktohet sot për sot e për nesër është i papërshtatshëm për konceptet shtesë të fjalës gëzof si veshë e gatshme:

qethës i gëzofit; rrjepës i gëzofit; rregullues i fibrave të gëzofit, tendosës i gëzofit, zhveshësh i gëzofit (f. 90.), pastrimi i gëzofit nga mishi etj. etj.

S'do mend se nga përmbajtja e këtyre emërtimeve kuptojmë se nuk kemi të bëjmë, pra, aspak me gëzofin si veshë të gatshme, po kemi të bëjmë lëndën e parë, me lëkurën e kafshës ose atë artificiale sintetike, e cila përpunohet në **gëzofitore** (*fabrikën përkatëse*), ku, në të vërtetë, edhe prodhohet veshja që quhet *gëzof*. Pikërisht kjo lëkurë qoftë e kafshëve, qoftë sintetike në gjuhë të huaja ka emërtimin e posaçëm, si p.sh.:

angl pelt, gjerm Fell, it pelle, fr. feau, serb. krzno.

Lidhur me këtë në guidën e Prishtinës i ndeshëm këto dy emërtime:

- 1) *teknolog/teknologe për lëkurtari dhe gëzof* (f. 31 dhe
- 2) *teknik/teknike i teknologjisë së lëkurës dhe gëzof* (f. 45, 414).

Pra edhe te këta dy shembuj shihet se hartuesi e krijon si duket spontanisht, nga zori i “*përkthimit*”, një fjalë të re nga nevoja për konceptin që del jashtë konceptit të gëzofit si veshë konkrete, por si koncept të materialit gëzofor,

duke e femërorëzuar emrin *gëzof* të gjinisë mashkullore me prapashtesën –E *gëzofe gëzofja* (njëjës) dhe *gëzofe gëzofet* (shumës).

Edhe ne duke hetuar një mungesë të tillë në gjuhën tonë, ngase kuptimi që jepet në fjalorët tanë me shumëkuptimësinë e fjalës *gëzof* që përfshin të dyja kryekonceptet: *lënda e parë / vësha e gatshme*, siç e cekëm më sipër, nuk mund të ishte e përkapshme e funksionale për këtë zgjerim kuptimi shtesë, prandaj për konceptin që lidhet me lëkurë-gëzofi, qoftë nga kafshët, qoftë nga fibrat atificialë, krijuam ose fomëzuar nga *gëzofe* emrin **gëzofje**, si barasvlerës pakashumë të plotë për konceptet e fjalëve të huaja që u cekën më sipër.

Për krijimin e fjalë-emrit **gëzofje** (*gëzofja /gëzofje gëzofjet*) patëm mbështetje me dhjeta përfitime të ngjashme që tashmë dalin jo vetëm në jetën praktike, por janë edhe të regjistruara në fjalorët tanë normativë, që ne sa për ilustrim tash po përmendim vetëm këto tri përfitime:

brumje, leshje, bukje,

andaj siç e krijuam ashtu dhe propozojmë që kjo fjalë *gëzofje* të hyjë në përdorim si barasvlerës i fjalëve të huaja të sipërcekura:

angl pelt, gjerm Fell, it pelle, fr. feau, serb. krzno, shq. gëzofje

që siç e pamë me to emërtohej materiali që përdoret në teknologjinë e përgatitjes së veshës të quajtur **gëzof**,

Pra sikurse *brumje* për brumë, *bukje* për bukë, *ballje* për shirit balli ose si te shembujt e tjerë si: *këpuçje, frytje, barkje, kokje, këmbje, flokje* etj., analogjikisht doli edhe emërtimi *gëzofje*.

Pa mohuar këtë që sapo u tha ne kemi edhe një shpjegim tjetër. Meqë prapashtesa –JE del si formant i specializuar për të formuar emra që tregojnë veprim konkret ose rezultatin konkret të veprimit nga foljet me konsonant fundor, madje edhe të foljeve të formuara pa asnjë ndajshitesë me konversion nga emrat përkatës me kuptimësi të shkallës së parë, siç janë shembujt që po i japim si ilustrim skemën e mëposhtme:

emri	folja		prefoljori
1) brumë-i	brum	me mbrumë	brumje
2) lesh—i	lesh	me leshë	leshje
3) kripë-a	krip	me kripë	kripje
4) ndryshk-u	ndryshk	me ndryshkë	ndryshkje
5) shoshë-a	shosh	me shoshë	shoshje etj.

Shembuj këta të padiskutueshëm, supozohet se mund t’u bashkohet edhe shembulli i përftuar ndjek po këtë ecuri:

gëzof-i gëzof me gëzofë (!) gëzofje

Siç vetkuptohet nga procesi përpunimit “teknologjik të lëndës së parë” të emrit përkatëas *brumë, lesh, krip, ndryshk, shoshë* doli emri konkret **brumje, leshje, kripje, ndryshkje, shoshje**, i cili arsyetohet nga folje përkatëse: **me brumë, me leshë, me kripë, me ndryshkë, me shoshë** dhe së këtejmi gjen mbështetje edhe përftimi **gëzofje** (*bëj gëzof (gëzof me gëzofë gëzofje, me bë gëzofje*). Me fjalë të tjera një mundësi të tillë zgjidhjeje në procesin e *gëzofbërjes* na jep vetë sistemi formëzues fjalëformues i gjuhës sonë.

Fundi i fundit vetëm kështu, nëse trajta **gëzof** për konceptin e materialit përkatës zëvendësohet me **gëzofje** (në procesin e *gëzofbërjes*) emërtimet e sipërshënuara dhe disa të tjera që dalin në numër të konsiderueshëm që i ndeshim në nomenklaturën e guidave përkatëse kanë ose mund të kenë kuptim normal në ligjërimin shqip. Krahaso:

qethës i gëzofjes; rrjepës i gëzofjes; rregullues i fibrave të gëzofjes; tendosës i gëzofjes, zhveshës i gëzofjes, pastrimi i gëzofjes nga mishi etj.

Fundi i fundit për të njëjtin koncept ne e formëzuam fjalën *gëzofje* me prapashtesën –JE, ngase na u duk se ka model më të qartë semantikisht se ajo me –E *gëzofe* që e ndeshëm në guidën e Prishtinës.

Sidoqoftë, po përsërisim, ashtu si me fjalët aktive të gjuhës sonë *brumje, bukje, ballje, leshje*, dhe me dhjeta shembuj të tjerë që shprehin gjë-sende konkrete që ndërlidhen në njëfarë mënyre me konceptet e fjalës bazë temëprodhuese fjalëformuese e motivuese: **brumë, bukë, ballë lesh etj.** (dhe që mund të arsyetohen edhe nga folja përkatëse, e cila për disa shembuj ende qëndron nën hije), pikërisht ashtu u përftua edhe fjala *gëzofje*, ku (nën)kuptohet qartë koncepti i lëndës, qoftë si lëkurë kafshësh, qoftë si pëlhurë artificiale (sintetike) me të cilën në proces e sipër finalizohet gëzofi. Krahaso zbërthimin: *me brumje bëj brumë, me bukje bëj bukë*, me gëzofje bëhet gëzofi, e kështu me radhë.

E treta, në botimin e fundit (në guidën T2) në grupnjësinë e emërimit **kozmetikologe** që lidhet me fushën e kozmetikës dalin këto profesione të profiluara:

*estetist, grimer për skenë, grimer për studio,
manikyrnist, pedikyrnist dhe kozmetist(!?)*

dhe që për të gjitha këto emërtime e shohim të nevojshme të themi diçka, por që ajo *diçka* emërtime e tilla i bën të diskutueshme.

Së pari, trajtat **kozmetolog, kozmetist** që e ndeshim në botimet e Tiranës (T1 dhe T2 (f. 52) dhe aq më keq në botimin e Prishtinës PR), **kosmetolog** që asociacionon edhe trajtën **kosmetist**, jo vetëm janë të diskutueshme, por janë të patolerueshme. Janë *tejet të patolerueshme*, madje këto të fundit edhe neveritëse, sepse asnjëra as tjetra trajtë nuk motivojnë destinimin. Trajtat e para më tepër na kujtojnë *kozmosin*, se kozmetikën, aq më keq trajtat e dyta na sjellin në kujtesë fjalën *kosmet ose kozmetolog-un (studiuesin ideolog të Kosmetit(!))* (Kujto: Kosmet – **Kos**/ovë e **Met**/ohi), sepse po kështu ende quhet shkurt Kosova nga disa ideologë të frustruarë,

Pra, sipas asaj që thamë trajtat e tilla na sjellin ndërmend parësisht diçka tjetër, por jo konceptin e fjalës **kozmetikë**, që është emërtimi i zanatit të artit të bukurisë, të cilit i referohet.

Sidoqoftë, trajtat e tilla nuk mund të arsyetohen në asnjë mënyrë që të mbesin të pranishme në gjuhën tonë. Është fjala, pra, siç u tha, për profesionin që ka të bëjë me **kozmetikën**, prandaj s'ka pasur arsye që mos të jetë emërtimi i studiuesit në trajtën **kozmetikolog** (jo kozmetolog as kosmetolog), ndërkaq emri i ushtruesit të profesionit përkatës të jetë: **kozmetikan** (jo kozmetist as kosmetist). ngase vërtet vetëm emërtimet *kozmetikolog* dhe *kozmetikan* na motivojnë që ta kuptojmë më lehtë konceptin lidhur me kozmetikën, me dijen ose zanatin e zbukurimit.

Së dyti, në kuadër të profesionit që lidhet me kozmetikën në T2 ndeshim emërtimin *estetist*, i cili sikurse kozmetist a kosmetist është i paqëndrueshëm, ngase një trajtë të tillë për konceptin përkatës nuk e ndeshim në asnjë gjuhë të botës, madje edhe në shqipe nuk motivohet asgjë nga tema e tillë prodhuese. Atë koncept e ndeshim të mbuluar kështu me fjalë-termat përkatëse në gjuhë të huaja:

*angl. aesthete, fr. estheta, it. esteta, sp. esteta, gjerm Esthetiker,
sued. estete, ndërsa serbisht esteta dhe estetiçar.*

Pra, siç po shihet, në asnjërinë nga gjuhët e huaja nuk e ndeshim trajtën *estetist*, madje edhe në shqipe për konceptin *ai që merret me estetikë* e ndeshim trajtën **estet** (Shih FGJSH 2009 f. 252.) e përfutuar ngjashëm sikur

në disa gjuhë të huaja. Është e vërtetë se në shqipe nuk del e nevojshme aspak që emrit *estet* t'i shtohet prapashtesa –IST estetist(!), por nëse del e nevojshme që të shprehet ndonjë koncept me ndonjë nuancë tjetër sinonimike lidhur me **estetikën**, atëherë nuk do ta quanin të qortueshme që përveç trajtës *estet*, të përdoret edhe trajta *estetikan* ose ajo **estetikolog**, sepse që të dy këta terma, motivohen nga tema e qartë fjalëformuese: estetike.

Së treti, aty ndeshim edhe emrin e profesionit **grimer** dhe në raste të tjera ndeshim grimist, që për ne nuk janë të kritikueshme, as njëra as tjetra, por ne pasi kemi rastisur ta ndeshim trajtën **grimues**, e dalë nga folja *grimoj* (*me grimue*), sepse siç e kemi cekur më përpara folja e tillë do të jetë krijuar nën ndikimin e trajtës së huazuar foljore që ka si bazë emrin **grim** ose edhe nga vetë koncepti i emrit **grim** që është i regjistruar si fjalë aktive e shqipes, (Shih FGJSH f. 328.) atëherë të dyja trajtat *grimist* dhe *grimer* që i ndeshim në guidat përkatëse dalin të goditura nga trajta e prejpsjesorit të shqipes **grimues**. Siç e kemi përmendur edhe më parë, një prirje a zhvillim i tillë rreth zëvendësimit të konceptit të fjalës të huazuar me prejfoljorin përkatës duket si zhvillim shumë normal dhe i arsyeshëm në shqipen e sotme.

Së katërti, i quajmë të diskutueshme edhe trajtat e dy emërtimeve **manikyrist** dhe **pedikyrist**, jo vetëm për shqiptimin me –Y-së, por edhe për prapashtesë-fundoren –IST, e cila, siç do të shohim del e tepërt, del si formant i shpifur pa nevojë, ngase ajo nuk del fare në gjuhë të huaja. Ja si dalin emërtimet për konceptin në fjalë në gjuhë të tjera:

1) Shembulli i parë: **mani-** (*dorë -/duarë-*)

angl. manicure, gjerm. Handpflege, fr. manicure, it. manicure, sp. manicuro, serb. manikir,

profesion ky që ka të bëjë me kurimin ose përkujdesjen e duarve (të thonjve të duarve etj), prandaj në shqipe na duket se më e arsyeshme është me dalë trajta **manikurues** ose **duarkurues** duarkuruese se sa manikyrist manikyriste (sipas shqiptimit frëng).

2) Shembulli i dytë: **pedi-** (*këmbë-*)

angl. chiropodist, gjerm. Pedikeur, fr. pedikur, it. pedicur, sp. pedicuro, serb. pediker,

koncept ky që ka të bëjë me kurimin a përkujdesjen e këmbëve (gishtave, shputave), andaj s'ka arsye që në shqipe mos me dalë emërtimi i profesionit: **pedikurues** ose **këmbëkurues**.

Në të mirë të propozimit tonë del fakti se folja **kuroj** (*me kurue a me u kurue*), sipas fjalorëve normativë të shqipes është e regjistruar si fjalë

aktive e fjalësit të gjuhës sonë dhe së ketejmi është *detyruese*(!) me u përdorë në shqipen standarde.

E katërta, kur i lexon njeriu emërtimet e profesioneve nga fusha ekonomike, tekniko–teknologjike, elektroteknike e makinerike dhe të llojeve të tjera, na shkon mendja se jo vetëm përkthyesit, e pa përvojë, por as disa nga ekspertët e degëve përkatëse, jo vetëm te ne po edhe në Shqipëri e më gjerë, nuk i kanë të qarta dallimet semantike të termave *uzinë, fabrikë, impiant, ngrehinë, stabiliment, repart, sektor, seksion, punëtori, punishtë, axhusteri*, e të ngjashme, sepse një ngatërresë të tillë e ndeshim edhe në emërtimet e profesioneve në burimet në fjalë.

Po ia rikujtojmë lexuesit fjalë-termat me origjinë italiane *axhusteri, repart* dhe *stabiliment* që tek ne (nga shqipja zyrtare në ish-Jugosllavi) janë përdorur edhe me ndryshim (zgjerim) kuptimi që ashtu nuk përdoren as në Shqipëri dhe as në Itali(!).

Gjithsesi përkufizimet e termave të sipërcekur e të tjerë, që lidhen me organizimin e punëve në shkallë kombëtare e ndërkombëtare duhen ritrajtuar (rishikuar) e zgjidhur nga ekspertët e përgatitur në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, pra jo vetëm brenda shtetit shqiptar, por të kihet parasysh edhe shtetet e tjera, ku gjuha shqipe del e përdorur, qoftë në administratë, qoftë në masmedia e sektorë të tjerë. Sa për ilustrim po japim dy shembuj:

1) *punëtor i uzinës së përzierjes së betonit* (f 93)

2) *operator i impiantit të prodhimit të plehrave kimikë* (f. 95).

Në rastin e parë, me sa dimë, kemi të bëjmë më shumë me konceptin e impiantit se të uzinës, ndërsa te rasti i dytë më tepër kemi të bëjmë me operuesit në kuadër të uzinës ose të fabrikës se me operues të një impianti, ngase në uzina ose fabrika prodhohen plehra kimikë. Sido që të jetë këto gjëra duhet të qartësohen në shkallë shtetërore a ndërshtetërore (shqipfolëse) e më gjerë, para se të formulohet emërtimi i profesionit përkatës.

E pesta, për ne janë paksa të diskutueshëm këta dy emra profesionesh: *gravurues dhe degustues*, sepse foljet përkatëse gravuroj (me gravurue) dhe degustoj (me degustue), që sipas rregullit duhet t’u paraprinin emrave në fjalë *gravurues, degustues*, nuk dimë sa janë të pranishme për mos me thënë aktive në gjuhën tonë? Po i analizojmë paksa radhazi këto dy raste:

a) Për rastin e parë *gravurues* ose *gravurist* (*shih guida e Prishtinës f. 300*) nga *gravurë* mendoj se nëse nuk mjaftojnë sinonimet e shqipes *skalitje*

skalitës dhe *gdhendje gdhendës* për zëvendësimin e një fjalë-termi të tillë, atëherë mbase më e pranueshme mundet me dalë trajta e emrit të profesionit **gravues** nga folja **gravoj**. Në të vërtetë, trajtën *gravoj* si folje dhe si emër vepruesi **gravues**, e ndeshim në ligjërimet tona, por edhe në guidën e Prishtinës **gravues/gravuese shtypës** (f. 299), mbase e përftuar nga trajta e foljes së frëngjishtes **graver**, por edhe në anglishte del folja (*to*) *ingraver*, por mund të jetë ndikuere edhe trajta serbokroatishtes *gravirati* (e cila nuk del mbi bazë të emrit *gravura*) dhe së këtejmi nga folja **gravoj** (*me gravue*) del i arsyeshëm emërtimi *gravues*. Gjithsesi më i përshtatshëm për shqiptim e kuptim del **gravues** se *gravurues*, edhe pse ky i fundit ka për bazë emrin *gravurë*.

b) Edhe për rastin *degustoj* për mendimin tonë mjafton barasvlerësi *shijues* ose *provues* (i shijes së lëngjeve, gjellërave etj.), por sidoqoftë, ekspertët e standardologët le ta thonë fjalën e tyre.

E gjashta, si pikë më vete po e trajtojmë edhe trajtën e emrit *roje* (T1 e T2, (f. 107), trajtë kjo që në FGJSH del **rojë roja**. S'do mend se është shumë me vend kërkesa që të respektohet trajta e normëzuar **rojë-roja**, jo roje roja dhe për këtë s'duhet pasur mëdyshje. Megjithatë, edhe lidhur me trajtën *rojë roja del* diçka që lypset sqaruar. E kemi fjalën për njëgjininë gramatikore (femërore) të fjalës së tillë, e cila në të vërtetë, është përftuar nga trajta e foljes **ruej (me rue) – ruaj ruajtur *ro+J+Ë rojë** si të gjithë emrat prejfoljorë pandajshesorë, të tipit drojë, mbulojë, rrojë etj., të cilat nuk mund të mashkullorëzohen dot.

Sidoqoftë, edhe trajta e qëndrueshme me Ë fundore rojë roja, formalisht i takon vetëm gjinisë gramatikore femërore, ndërsa realisht *si rojë* me kuptim profesioni, nga tradita, nënkuptohet zakonisht personi i gjinisë mashkullore, *ai që bën rojë*. Prandaj themi se kjo trajtë del e diskutueshme, ngase nuk ka mundësi të mashkullorëzohet as me tregues të tjerë për të treguar gjininë e vepruesit. Nuk thuhet dot ky roje ose ky rojë, po kjo rojë. Prandaj shikuar nga ky aspekt trajta sinonimike **rojtar** del më e parapëlqyer, sepse gramatikisht me të shprehen normalisht të dyja gjinitë e emrit: m. **rojtar**, f. **rojtare**, madje më mirë se *rojës/rojëse* që ndeshet në gjuhën e folur te ne, por pa koncept të *rojës* zyrtare.

Megjithatë, për mendimin tonë, trajta *rojë roja* jo roje roj(j)a !, pasi del si trajtë e ngulitur le të mbetet në përdorim vetëm për rastet si *rojë personale*, përkatësisht *truprojë*, e për të gjitha konceptet e tjera më natyreshëm na duket se duhet me dalë në përdorim trajta sinonimike *rojtar* si

trajtë përfaqësuese e profesionit. Pa dyshim duhet tërhequr vërejtja se parapëlqimi i trajtës rojtar, pra, nuk përjashton plotësisht nga përdorimi trajtën *rojë roja*, por duhet pasur kujdes që në asnjë rast mos të përdoret *roje* (me –E fundore), siç e ndeshim në burimet *profesionale(!)* që i patëm në shqyrtim.

E shtata, si pikë të fundit po e diskutojmë paksa si **realitet** të njohur raportin e emërtimeve të punonjësve të angazhuar drejtpëdrejt në shkollën a arsimimin shqip në Shqipëri e në Kosovë, se si qëndron i pasqyruar ky **realitet** lidhur me përdorimin e profesioneve në burimet zyrtare profesionale që i trajtuam më sipër?

Kështu, b.f., ndërsa në guidën e Tiranës dalin mbi 200 emërtime me fjalën **mësues** në atë të Kosovës nuk del asnjë. Po kështu ndërsa në Kosovë del emërtimi arsimtar për disa emërtime, numër i konsiderueshme (16 raste), në botimin e Tiranës nuk del asnjë. Nuk përputhen aspak as konceptet që mbulojnë emërtimet, jo vetëm *mësues e arsimtar*, por as të tjerat si **pedagog, profesor, jurist, inxhinier** etj. Dihen shkaqet e një joharmonizimi të tillë, por tani duhet me u bë i mundshëm një harmonizim i tillë. Po lehtë është me thënë, po si duhet me u bë, dhe çka duhet me ndërmarrë, janë pyetje që kërkojnë përgjigje.

Për mendimin tonë, shumë gjëra mund të kthjellohen, madje edhe të harmonizohen që në takimin e parë të ekspertëve, të cilët kërkojmë të japin përgjigje të menjëhershme në këto pyetje, nëse i kanë ose le të përgatiten me i pasë të gatshme sa më parë, sepse e kanë për detyrë:

Pse mos të bëhen i mundshëm kthimi i fjalë-termimit zyrtar **mësues** në guidën e Prishtinës, sidomos për punonjësit e arsimit të ciklit të ulët të fillores?

Pse mos të rishikohet emërtimi mësues në Shqipëri, për ciklin e lartë të fillores të shkollës së mesme ose të shkollës për kualifikime të larta?

Pse mos të quhen mësimdhënës (profesorë a ligjërues) ata që në Shqipëri quhen *pedagogë*, kur dihet fakti se në Prishtinë ekziston dega e pedagogjisë pranë Fakultetit të shkencave shoqërore, ku titullin pedagog (profesor i pedagogjisë) e kanë marrë ose e marrin studentët që e kanë kryer ose e kryejnë atë degë të fakultetit dhe si të tillë sipas konceptit që përdoret kjo fjalë në Shqipëri, ata nuk mund të jenë (të quhen) pedagogë, apo jo?

Madje si mund të harmonizohen emërtimet përkatëse, kur në guidën e Prishtinës ekzistojnë vetëm tri emërtime me titullin pedagog: *pedagog baleti, pedagog social dhe pedagog-arsimim parashkollor*, kurse në guidën

e Tiranës T2, janë mbi 70 raste emërtimesh me emërtimin **pedagog**, kurse si barasvlerës të termit *pedagog për arsimim parashkollor* të Prishtinës në T2 dalin këto tri emërtime:

mësues parashkollor, edukator çerdhe dhe edukator kopshti.

Po rikujtojmë faktin se në shkollat fillore, madje edhe të mesme te ne është e preferueshme që të punësohet pedagogu, i cili kryen punë e detyra të caktuara nga vendi i punës, si *pedagog shkolle*. Fundja jemi të njohur edhe me faktin tjetër se në industrinë bashkëkohore qysh moti është paraparë vendi i punës *pedagog industrial* etj., i cili kryen punë e detyra të tjera, gjithsesi jo si ligjërues fakulteti, sipas konceptit të guidave të Tiranës?

Si duhet vepruar, pra në raste të tilla, kur në Kosovë nuk është paraparë fare emërtimi edukator ose edukatore?

Pastaj, si mund të zgjidhet çështja e titujve në diploma *e arsimitarit, të inxhinierit, juristit*, kur në Kosovë ata që e kanë kryer shkollën e lartë, me program 2 vjeçar ose 2 vjet të fakultetit të shkallëzuar, kanë marrë titullin *arsimtar, inxhinier, jurist*, ndërkaq ata që e kanë kryer fakultetin me program 4-5 vjeçar kanë marrë titullin **profesor** i lëndës përkatëse ose **inxhinier i diplomuar** ose **jurist i diplomuar** d.m.th me fakultet të kryer?

Si të bëhet nostrifikimi i diplomave nga shkollat mesme, të të gjitha të shkollave të larta e të fakulteteve të të gjitha degëve e profileve në raportin Tiranë-Prishtinë-Shkup etj. në rastet kur emërtimi i profesioneve nuk përshtatet?

Sido që të jetë, pra, mund të shtrohen edhe shumë e shumë çështje të tjera të kësaj natyre, të cilat ende nuk kanë por kërkojnë zgjidhje. Dhe që të gjitha këto pyetje që i bëmë dhe të tjera, patjetër duhet të marrin përgjigje sa më parë. **Nuk është e thënë që të gjitha emërtimet nga Tirana, duhet të kopjohen ose të diktohen pa oponencë.** Fundi i fundit edhe Tirana si Prishtina e Shkupi duhet t'i paraqesin argumentet e veta, por edhe duhet me lëshue pe në rate (edhe Tirana) në të mirë të njëzimit të emërtimeve zyrtare, kështu dhe vetëm kështu me mirëkuptim të të gjitha palëve mund ta kemi një listë të njëzuar të emërtimeve të profesioneve në shkallë kombëtare.

Mbesin edhe mjaft çështje të patrajtuara prej nesh, edhe në degë të tjera të ekonomisë, teknologjisë e të shkencave etj., por ne po përfundojmë me kaq, duke kërkuar me forcë, sidomos nga organet përkatëse shtetërore që aq sa është e mundur të ndërmerren masa që sa më parë të bëhet

harmonizimi i emërtimeve të profesioneve në shkallë kombëtare, madje gjithsesi para regjistrimit të popullsisë.

Në zgjidhjen e problemeve që shtruan i shohim fare të mundshme, nëse ekspertët nuk ndërlikohen në megalomaninë vetjake ose me ndërskamcat e partive politike të kohës, krerët e të cilave nuk dimë se sa e kanë për zemër mbarëvajtjen e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e dijes e të propagandës dhe të bashkimit së paku shpirtëror kombëtar. Punën tonë do ta quaja të suksesshme, nëse do të arrijmë që sadopak të cytim ndërgjegjen te faktorët përgjegjës që e kanë për detyrë nga pozita dhe vendet e punës që zënë që jo vetëm ta kuptojnë, por t'i qasen me seriozitetin e duhur për zgjidhjen e kësaj problematike (emërtimeve të njerëzve sipas profesionit) me interes shoqëror, kombëtar e ndërkombëtar.

P ë r m b y l l j e

Në fund, duke pasur parasysh lëndën e trajtuar më sipër mund të nxjerrim këto përfundime:

Së pari, pa mohuar anën pozitive të tri guidave në shqyrtim duhet pranuar e vërteta se asnjëra nga ato nuk del pa të meta serioze, por megjithatë *Lista kombëtare e profesioneve* duhet të shërbejë si tekst bazë për hartimin e Listës së re unike të emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe dhe perspektivën që pason.

Së dyti, *Lista unike kombëtare e profesioneve* (2009) duhet të përplotësohet gjithsesi me materialin përkatës të korrigjuar edhe nga doracaku *Klasifikimi i profesioneve në Kosovë* (2006), duke shfrytëzuar nga ai patjetër lëndën e shtruar sipas pjesëve përbërëse të tij që nuk janë pa vlerë dhe në mënyrë të veçantë duhet shfrytëzuar si model pune lista alfabetike e profesioneve si dhe përshkrimi i punëve dhe të detyrave për profesionet e grupeve të veçanta, por gjithsesi duhet rregulluar e mbarështruar teksti përkatës sipas normës drejtshkrimo-morfologjike e sintaksore të shqipes standarde.

Së treti, edhe nga guida pararendëse e *Listës bazë Standarti ndërkombëtar i nomenklaturës së profesioneve sipas ISCO-88*, mund të merret lëndë e pakonsumuar e sidomos është i domosdoshëm teksti i pjesës hyrëse me formulimet e konstatimet përkatëse të qëndrueshme, i cili në raste edhe mund të përpunohet.

Së katërti, teksti i *Listës* bazë duhet t'i shtrohet korrigjimit rigoroz, ngase siç u pa nga analiza, përveç anomalive formale teknike kishte edhe të meta të tjera gjuhësore e përmbajtësore, të cilat duhet të përmirësohen në përputhje me normëzimin e shqipes standarde në fuqi dhe të përplotësohet sipas kërkesave të kohës, përkatësisht të pajiset me një gjithpërfshirje më të mirë si dhe me një përzgjidhje më cilësore të shembujve grup-përfaqësues të emërtimit të profesioneve.

Së pesti, gjithsesi duhet pasur parasysh materiali i vjelë nga *Fjalori i gjuhës shqipe 2006* si dhe rezultatet nga analizat e bëra nga autorë të ndryshëm, por sipas kriterëve përkatëse nga punimi ynë i doktoratës, i cili tani i përpunuar dhe e përplotësuar paraqitet para opinionit nën titullin **Rreth formëzimit të emërtimeve të profesioneve në gjuhën shqipe Prishtinë 2015).**

Së gjashti, patjetër duhet me pasë parasysh shifrimin sipas kodimit të grupeve të profesioneve, duke filluar nga kodi me numrin 1 deri te gjashtëshifrori dhe mundësisht shifrimi të jetë sa më unik e në përputhje me regjistrin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës “ILO” dhe me guidat që përdoren në BE.

Së shtati, meqë kemi të bëjmë me listë unike të profesioneve në shkallë kombëtare në gjuhën shqipe patjetër duhet bërë sa është e mundur harmonizimi i emërtimeve jo vetëm në raport Shqipëri / Kosovë, por edhe me emërtimet që përdoren a duhet të përdoren në gjuhën shqipe si në Maqedoni, Luginë të Preshevës, në Viset shqiptare në Mal të Zi e më gjerë në hapësirën mbarëshqiptare, andaj edhe numri i emërtesave duhet të jetë në harmoni me kërkesat e tilla.

Së teti, kur kemi parasysh aktualitetin shoqëror e politik, që kurdoherë ndodhemi në procesin e regjistrimit të popullsisë, me ç'rast emërtimet e profesioneve duhet të shënohen dhe të kihen parasysh patjetër si e dhënë statistikore, propozojmë që menjëherë pa humbur kohë të takohen komisionet përkatëse të terminologëve ekspertë të gjuhës sonë nergut për harmonizimin e terminologjisë në përgjithësi dhe në veçanti për emërtimet e profesioneve, natyrisht duke bërë menjëhershëm atë harmonizim për çka është e mundur, ndërsa të veçohet lënda që duhet shoshoitur ajo që çka mund të njëzohet së shpejti dhe gjithsesi ndahet lënda për trtyezën e diskutimit, për çka duhen studime e njohje të mëtejshme rreth procesit të njëzimit, apo jo?

Gjithsesi puna e Komisionit përkatës i terminologëve do të jetë e suksesshme, nëse ekspertët u shmangën megalomanisë vetjake dhe ndërskamcave të interesave të ngushta të stafeve të partive politike dhe gjithsesi, duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm mbarëkombëtar, t'i rreken me seriozitet punës rreth zgjidhjes së problemeve lidhur me gjuhën e emërtimit të terminologjisë tekniko-shkencore në përgjithësi dhe për harmonizimin e profesioneve në gjuhën shqipe në veçanti.

Të dhëna bio-bibliografike për autorin



I.

Nuhi (Muharrem) Veselaj u lind në fshatin **Reçan të Therandës** (ish-Suharekë) më 20.08.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948), Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.06.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 03. 09.1959 në Prizren. Shkollën e lartë, përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës – Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.09.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe, më 23. 11. 1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 03. 04. 1980 mori gradën: *magjistër i shkencave filologjike*, ndërsa *tezën e doktoratës e mbrojti* më 24.12.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qendër në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës. Është Anëtar Nderi i SHAK “Elena Gjika Dora d’ Istria, Therandë.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por për moszbulim provash nga ai, u dënua vetëm 2 vjet. Pasi doli nga

burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të ripunësohej në arsim që e kishte ideal veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës (8 herë): Mushtisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejçec (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Zllatar, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur për motive politike iu ndalua puna në arsim e organizata shoqërore-shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në Ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put* të Beogradit – dega në Prishtinë, prej nga kaloi në *Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës*, përkthyes. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai përkundër pengesave e përndjekjeve, me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, arriti të korrë suksese, qoftë në jetën arsimore e shoqërore-politike, qoftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, gjetën strehim e shërim ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij qe objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë eksodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shkojë drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllloboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dekada, pasi, përkundër tentimeve, atij i qe ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë, ky pasi e bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t'i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut, kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyra të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest buroteknik. Ndërkohë kreu me nder çdo angazhim që iu besua, por nuk u ekspozua në parti politike, më tepër u përqendrua në veprimtarinë krijuese.

II.

Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s'ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të

ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashti botoi këto vepra:

1) Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylberta (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;
3. Me buzët në gaz (vjersha për fëmijë), Iliriku, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), Iliriku, Prishtinë) 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), Iliriku, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), Iliriku, Prishtinë 1997;
7. Shfrime nëpër mjegullnajë (reflekse poetike e mendimore), Iliriku, Prishtinë 1997;
8. Mësime nëpër pësime (shfaqje teatrore), Iliriku, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), Rozafa, Prishtinë 1998;
10. Bulëza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), Rilindja, Prishtinë 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), Rilindja, Prishtinë 2000.

2) Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Rilindja 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O – në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002;
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006,
5. Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktrate) MASHT e RK-së, Prishtinë 2014,
6. Rreth identitetit të gjinisë asnjësore në shqipen e sotme, Era, Prishtinë 2015,
7. Shumësi dhe shquarsia e emrave në shqipen standarde, Era, Prishtinë 2015,
8. Drejt standardizimit të gjuhës shqipe, Era, Prishtinë 2015,
9. Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, Era, Prishtinë 2015,
10. Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II, Era, Prishtinë 2015.

Këto të pestat të gatitura për libërtim:

11. Çështje të shqipes standarde rreth 28 temave të diskutueshme, III, Era, Prishtinë,
12. Çështje të shqipes standarde rreth emërtimit të njerëzve sipas veprimtarisë IV, Era, Prishtinë,
13. Çështje të shqipes standarde rreth disa termave nga fusha e teknikës dhe e ekonomisë V, Era, Prishtinë,
14. Çështje të shqipes rreth vendbanimeve, VI, Era, Prishtinë,
15. Fjalor pune (poslovni rečnik) shqip –serbisht, me shtojcën serbokroatisht – shqip, për ndërmarrjet metal-përpunuese – me theks terminologjia tekniko-teknologjike, VII, Era Prishtinë,

Sidoqoftë, edhe pse në moshë të shtyrë (ec në 84-shin) pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha e gjuhësisë, qoftë nga ajo letrare-artistike, për libërtimin e të cilave qëndron në pritje mirëkuptimi nga institucionet dhe organizmat përkatës të qeverisë sonë, por edhe prej sponzorëve eventuale vullnetmirë.

Prishtinë, 2016